LIGJ
Nr. 19/2018

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, REPUBLIKËS SË FRANCËS DHE KOMISIONIT EVROPIAN PËR PROGRAMIN INTERREG V-B MESDHE (MED), 2014–2020

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Francës dhe Komisionit Evropian për programin Interreg V-B Mesdhe (MED), 2014–2020, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.4.2018

Shpallur me dekretin nr. 10771, datë 23.4.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJE FINANCIMI
PËR PROGRAMIN E MESDHEUT (MED) INTERREG V-B
CCI 2014TC16M4TN001

KUSHTET E VEÇANTA

Komisioni Evropian, në vijim i referuar si **"Komisioni**", që vepron në emër të Bashkimit Evropian, më poshtë i referuar si "**Unioni**",

nga njëra anë dhe

Republika e Shqipërisë, në vijim e referuar si "**Përfituesi IPA II**", e përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë,

nga ana tjetër,

si edhe nga pala e tretë,

Republika Franceze, referuar më poshtë si **"Franca",** përfaqësuar nga Rajoni *Provence-Alpes-Côte d'Azur* që vepron si autoriteti menaxhues i Programit të Bashkëpunimit Transnacional (MED) Interreg V-B, në përputhje me ligjin nr. 2014-58, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Francës,

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1
Programi

1. **Unioni** bie dakord për të financuar dhe **Përfituesi IPA II** bie dakord të pranojë financimin e programit të mëposhtëm të bashkëpunimit transnacional, siç përcaktohet në shtojcën I dhe miratuar me vendimin e zbatimit të Komisionit nr. C(2015) 3756, të datës 2 qershor 2015.

"Programi i Mesdheut (MED) Interreg V-B"

CCI: 2014TC16M4TN001,

në vijim i referuar si **"Programi"**.

2. Programi financohet nga buxheti i Unionit në bazë të akteve themelore të mëposhtme:

Rregullorja (BE) nr. 1303/2013, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 17 dhjetor 2013, që përcakton *dispozitat e përbashkëta* për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian, Fondin e Kohezionit, Fondin Evropian Bujqësor për Zhvillimin Rural dhe Fondin Evropian për Sektorin Detar dhe Peshkimin, si dhe *dispozitat e përgjithshme* për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin

Social Evropian, Fondin e Kohezionit dhe Fondin Evropian për Sektorin Detar dhe Peshkimin, Rregulloren e shfuqizuar të Këshillit (KE) nr. 1083/2006 (rregullorja për dispozitat e përbashkëta, "CPR") dhe aktet e miratuara për këtë arsye;

Rregullorja (BE) nr. 1299/2013, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 17 dhjetor 2013, mbi *dispozitat e veçanta* për mbështetjen nga Fondi Evropian për Zhvillimin Rajonal të objektivit për bashkëpunimin territorial evropian[1] (Rregullorja ETC) dhe aktet e miratuar për këtë arsye;

Neni 9, pika 3, të Rregullores (BE) nr. 231/2014, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 mars 2014, për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)[2] (Rregullorja IPA II, IPA II).

3. Vlera totale e parashikuar për Programin është 275 905 320 euro, ndërsa kontributi maksimal i Unionit për Programin nën IPA II është caktuar në vlerën 9 355 783 euro, si kontribut nga titulli 4.

Kontributi i Unionit ndahet në pagesa ose angazhime vjetore sipas shtojcës I. Asgjë në këtë Marrëveshje Financimi nuk mund të interpretohet se nënkupton një angazhim financiar të Unionit në lidhje me kreditë që nuk janë miratuar ende me miratimin e buxhetit të BE-së. Komisioni informon me shkrim Autoritetin Menaxhues në lidhje me miratimin e secilit angazhim vjetor financiar të përcaktuar në shtojcën II.

Programi kërkon kontribute financiare edhe nga përfituesi IPA II edhe nga Unioni. Ndarja e kontributeve përkatëse financiare përcaktohet në shtojcën III.

Neni 2

Periudha e zbatimit dhe periudha e pranueshmërisë

1. Periudha e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje Financimi fillon me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi dhe përfundon 12 vjet pas kësaj date.

2. Në Shqipëri shpenzimet janë të pranueshme për financim nga asistenca ERDF, në qoftë se ato janë shkaktuar nga një përfitues dhe paguhen ndërmjet periudhës 1 janar 2014 dhe 31 dhjetor 2023.

Neni 3

Interpretimi

1. Dispozitat dhe shtojcat e kësaj marrëveshjeje financimi interpretohen si dispozita që plotësojnë dhe përmbushin kuadrin rregullator të parashikuar sipas nenit 1 të kësaj marrëveshjeje.

2. Kur ekzistojnë kundërthënie ndërmjet dispozitave në kushtet e veçanta të kësaj marrëveshjeje dhe në shtojcat e saj dhe në veçanti dispozitat në shtojcën IV (Kushtet e përgjithshme), do të mbizotërojnë dispozitat e përfshira në Kushtet e veçanta të kësaj Marrëveshjeje.

Kur ekzistojnë kundërthënie ndërmjet dispozitave të kësaj marrëveshjeje dhe dispozitave të akteve themelore të renditura në nenin 1, pika 2 ose të akteve të miratuara për këtë arsye, do të mbizotërojnë dispozitat e përfshira në kuadrin rregullator dhe kjo Marrëveshje amendohet ose korrigjohet në përputhje me nenin 73 të Kushteve të përgjithshme.

3. Pavarësisht ndonjë dispozite të shprehur në kundërshtim me këtë marrëveshje, termat e përdorur në këtë Marrëveshje do të kenë të njëjtin kuptim siç u atribuohen atyre në aktet themelore të renditura në nenin 1, pika 2.

4. Pavarësisht ndonjë dispozite të shprehur në kundërshtim me këtë marrëveshje, referimet e bëra në këtë Marrëveshje janë referime të kësaj marrëveshjeje të ndryshuara, të plotësuara ose të zëvendësuara herë pas here.

5. Çdo referencë e bërë në këtë Marrëveshje dhe në shtojcat e saj për instrumentet e Bashkimit Evropian është reference e këtyre instrumenteve të ndryshuara, të plotësuara ose të zëvendësuara herë pas here.

6. Titujt në këtë marrëveshje dhe në shtojcat e saj nuk kanë domethënie ligjore dhe nuk cenojnë interpretimin e saj.

Neni 4

Pavlefshmëria e pjesshme dhe mangësitë e paqëllimta

Në rast se ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshje është ose bëhet e pavlefshme ose në rast se në këtë Marrëveshje ka ndonjë mangësi të paqëllimtë, kjo nuk do të cenojë vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj

[1] GZ L 347, 20.12.2013, f. 259.
[2] GZ L 77, 15.3.2014, f. 11.

Marrëveshjeje,

Në përputhje me nenin 73 të Kushteve të përgjithshme, Palët do të zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme ose do të plotësojnë çdo mangësi të paqëllimtë me një dispozitë të vlefshme, e cila afrohet sa më shumë të jetë e mundur me qëllimin dhe synimin e dispozitës së pavlefshme.

Neni 5

Adresat dhe komunikimi

Të gjitha komunikimet në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi duhet të bëhen me shkrim dhe t'i referohen shprehimisht Programit të identifikuar në nenin 1, pika 1 dhe të dërgohen në adresat e mëposhtme:

a) Për Komisionin:

Drejtoria e Përgjithshme për Politikat Rajonale dhe Urbane
B- 1049 Brussels – Belgium
E-mail:REGIO-TRANSNATIONAL-AND-INTERREGIONAL-COOPERATION@ec.europa.eu;

b) Për Përfituesin IPA II:

Ministria e Integrimit Evropian
Drejtoria e Bashkëpunimit Territorial
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", sheshi "Nënë Tereza" 1010, Tiranë, Shqipëri
E-mail: daniela.cekani@integrimi.gov.al; ana.xhilaga@integrimi.gov.al; cbc@integrimi.gov.al

c) Për Francën:

Region Provence-Alpes-Côte d'Azur
Autoriteti Menaxhues i Programit (MED) Interreg V-B
27, place Jules Guesde – 13481 Marseille Cedex 20
E-mail: programme_med@REGIONPACA.FR

Neni 6

Marrëveshja Kuadër

Në përputhje me nenin 8, pika 6, të Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi marrëveshjet për zbatimin e Asistencës Financiare të Unionit për Republikën e Shqipërisë nën Instrumentin për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II), e cila hyri në fuqi më 16 prill 2015 (referuar më tej si "Marrëveshja kuadër"), rregullat për zbatimin e Programit janë përcaktuar në këtë Marrëveshje Financimi. Si pasojë, Programi duhet të zbatohet në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje Financimi ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë.

Kjo Marrëveshje Financimi plotësohet me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër, në veçanti në ato raste kur kjo Marrëveshje Financimi nuk përmban dispozita të posaçme mbi një çështje të caktuar.

Në rast konflikti midis, nga njëra anë, dispozitave të kësaj Marrëveshjeje Financimi dhe, nga ana tjetër, dispozitave të Marrëveshjes Kuadër, kjo Marrëveshje Financimi merr përparësi.

Neni 7

Shtojcat

Kjo Marrëveshje Financimi përbëhet nga:

a) Këto kushte të veçanta;

b) Shtojcat e mëposhtme të cilat formojnë pjesë integrale të saj:

i) Shtojca I. Programi i bashkëpunimit territorial *Interreg V-B (MED)*;

ii) Shtojca II.Plani financiar (pjesë e angazhimeve vjetore financiare);

iii) Shtojca III. Plani financiar (pjesë e kontributeve financiare të Unionit dhe përfituesve të IPA II)

iv) Shtojca IV. Kushtet e përgjithshme

Neni 8

Dispozitat që përcaktojnë kushtet e zbatueshme për zbatimin e Programit në përputhje me nenin 26 të rregullores ETC

Dispozitat që plotësojnë shtojcën IV:

a) Në plotësim të nenit 14 të shtojcës IV, vendet pjesëmarrëse kanë vendosur që përfituesit nga përfituesi IPA II nuk mund të jenë përfitues kryesorë dhe se subjektet sipas së drejtës private nuk janë të pranueshme,

me përjashtim të subjekteve jofitimprurëse, siç është përcaktuar në seksionin 9.4 të Programit, ndërsa të gjitha rregullat dhe përgjegjësitë e tjera janë të zbatueshme në mënyrë të barabartë për të gjithë përfituesit;

b) Në plotësim të nenit 15 të shtojcës IV, Komiteti i monitorimit i ngritur nga vendet pjesëmarrëse në qershor të vitit 2015, përcakton në rregulloren e tij të brendshme se përfaqësuesit e përfituesit PA II të emëruar zyrtarisht janë anëtarë të plotë të Komitetit të monitorimit;

c) Në plotësim të nenit 55 të shtojcës IV, vendet pjesëmarrëse kanë vendosur që një mekanizëm i avanseve në nivel të projektit do të zbatohet vetëm për përfituesit IPA II;

d) Në plotësim të nenit 65 të shtojcës IV, do të zbatohen dispozitat e nenit 5.4 të Programit në lidhje me ndarjen e obligimeve midis vendeve pjesëmarrëse.

Dispozitat që derogohen në shtojcën IV:

a) Me derogim të nenit 23 të shtojcës IV, në lidhje me tavanin për asistencën teknike, do të zbatohet si më poshtë:

Duke pasur parasysh se ndarja ose alokimi i asistencës teknike është bërë veç e veç për titullin 1(b) (kohezioni ekonomik, social dhe territorial) dhe titullin 4 (*Global Europe*), kontributi (IPA II), për "Asistencën ERDF", shuma e caktuar e asistencës teknike nën IPA II është vendosur në 10%, që korrespondon me 935 578 euro.

Neni 9

Dispozitat plotësuese të shtojcës IV

Dispozitat plotësuese të shtojcës IV:

a) Në plotësim të nenit 12, pika 2, të shtojcës IV, vendet pjesëmarrëse kanë vendosur të aplikojnë opsionin "d";

b) Në plotësim të nenit 33, pika 1, të shtojcës IV, përfituesi IPA II ka zgjedhur për përdorim udhëzuesin praktik për procedurat kontraktuese për aktivitetet e jashtme të BE-së;

c) Në plotësim të nenit 34, pika 1, të shtojcës IV, këto Kushte të veçanta nuk lejojnë pjesëmarrjen në thirrjen për propozime të subjekteve pa personalitet juridik;

d) Në plotësim të nenit 34, pika 5, të shtojcës IV, pranueshmëria sipas këtij neni nuk është e kufizuar më tej në lidhje me kombësinë, vendndodhjen gjeografike ose natyrën e aplikantëve;

e) Në plotësim të nenit 40, pika 1, të shtojcës IV, shtetet anëtare pjesëmarrëse dhe përfituesi IPA II kanë autorizuar autoritetin e auditimit për të kryer funksionet e tij drejtpërdrejt në të gjithë territorin. Ata kanë specifikuar kur autoriteti i auditimit duhet të shoqërohet nga një auditues i një shteti anëtar ose të një përfituesi IPA II;

f) Në plotësim të nenit 41, pika 2, të shtojcës IV, përfituesi IPA II ka autorizuar autoritetin e auditimit për të kryer drejtpërdrejt funksionet e parashikuara në nenin 127, të rregullores (BE) nr. 1303/2013, në të gjithë territorin e mbuluar nga Programi i bashkëpunimit;

g) Në plotësim të nenit 44, të shtojcës IV, koordinatori kombëtar IPA e ka deleguar rolin e tij menaxhues për koordinimin e pjesëmarrjes së përfituesit IPA II (Shqipërisë) në Programin përkatës në Strukturën Operuese të Bashkëpunimit Territorial në Ministrinë e Integrimit Evropian;

h) Në plotësim të nenit 48, të shtojcës IV, shkalla e bashkëfinancimit dhe shuma maksimale e asistencës ERDF për aks prioritar, për kontribut nga buxheti i titullit 1(b) dhe për kontribut nga buxheti i titullit 4 (IPA II) përcaktohen siç është përcaktuar në shtojcën III;

i) Në plotësim të nenit 56, pika 3, të shtojcës IV, metoda e zgjedhur për këtë Program është ajo e përmendur në shkronjën "b", opsioni i dytë i nënparagrafit të parë të këtij neni;

j) Në plotësim të nenit 67, pika 3, të shtojcës IV, vendet pjesëmarrëse kanë vendosur të mos rimarrin asnjë shumë të paguar padrejtësisht, në rast se shuma që do të mbulohet nga përfituesi, pa përfshirë interesin, nuk e kalon vlerën prej 250 eurosh nga kontributi i asistencës ERDF.

Neni 10

Marrëveshje shtesë dypalëshe

Franca dhe Shqipëria kanë rënë dakord që marrëveshjet e detajuara mes tyre nuk duhet të jenë pjesë e kësaj Marrëveshjeje Financimi në formën e një shtojce të veçantë, për shkak se të gjitha çështjet janë të mbuluara sa duhet në Program, në Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta dhe në "Marrëveshjen e zbatimit të Programit MED Interreg 2014–2020", në "Përshkrimin e sistemeve të menaxhimit dhe të kontrollit", në "Manualin e Programit" dhe në "Manualin e Programit të asistencës teknike", të miratuara nga Komiteti i monitorimit.

Këto marrëveshje të detajuara kanë përcaktuar në mënyrë shteruese të gjitha rregullat që drejtojnë

marrëdhëniet përkatëse midis autoritetit menaxhues (duke përfshirë Sekretariatin Teknik), autoritetit certifikues dhe autoritetit të auditimit të Programit, si dhe autoritetet përkatëse në përfituesin IPA II.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Financimi hyn në fuqi në datën që Komisioni merr njoftimin nga përfituesi IPA II që konfirmon përfundimin e procedurave të brendshme të përfituesit IPA II, të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi. Komisioni informon përfituesin IPA II për datën e marrjes së këtij njoftimi.

Kjo Marrëveshje Financimi është hartuar në tri kopje, në gjuhën angleze, një që i dorëzohet Komisionit, një për përfituesin IPA II (Shqipërinë) dhe një për Francën.

Për Përfituesin IPA II:
Klajda Gjosha
Ministër i Integrimit Evropian
Koordinator Kombëtar IPA
Tiranë, ...

Për Komisionin:
Marc Lemaître
Drejtor i Përgjithshëm
Drejtoria e Përgjithshme për Politikat Rajonale
dhe Urbane
Bruksel, … . … . …

Për Francën:
Christian Estrosi
President i Këshillit Rajonal *Provence-Alpes-Côte d'Azur*
Marsejë, … . … . …

Preambul

1. Në përputhje me nenin 9(3) të rregullores IPA II, ku aplikohet, IPA II mund të kontribuojë në Programet transkombëtare të bashkëpunimit ose masat që janë krijuar dhe zbatuar nën rregulloren (BE) nr. 1299/2013 dhe ku përfituesit e listuar në shtojcën I marrin pjesë në rregulloren IPA II.

2. Në përputhje me nenin 26 të rregullores ETC, kushtet që zbatohen për zbatimin e Programit, të cilat drejtojnë menaxhimin financiar, si dhe programimin, monitorimin, vlerësimin dhe kontrollin e pjesëmarrjes së përfituesit IPA II, nëpërmjet kontributit IPA II në programet transkombëtare dhe ndërrajonale të bashkëpunimit, do të hartohen në Programin përkatës të bashkëpunimit dhe, ku aplikohet, në Marrëveshjen e Financimit mes Komisionit, qeverisë së përfituesit IPA II në fjalë dhe shtetit anëtar që pret autoritetin menaxhues të programit përkatës të bashkëpunimit. Kushtet e zbatimit të programit duhet të jenë në linjë me rregulloren e politikave të Unionit për kohezion.

3. Programi Interreg V-B Mediterranean, me nr. CCI: 2004TC16M4TN001, në vijim i referuar si "Programi", do të zbatohet nëpërmjet menaxhimit të përbashkët. Për pasojë, Franca, shteti anëtar që pret autoritetin menaxhues, në vijim i referuar si "Shteti anëtar" dhe Komisioni do të jenë përgjegjës për zbatimin, menaxhimin dhe kontrollin e Programit.

4. Përfituesi IPA II ka konfirmuar, në formë të shkruar, dakordësinë për përmbajtjen e Programit para se të dorëzohet në Komision. Kjo Marrëveshje, gjithashtu, përfshin angazhimin për të ofruar kontribut financiar ndaj përfituesit IPA II.

5. Në përputhje me nenin 3 të Kushteve të veçanta, dispozitat e këtyre Kushteve të përgjithshme shtojnë dhe plotësojnë dispozitat e akteve themeltare të renditura në nenin 1(2) të Kushteve të veçanta dhe të akteve të miratuara bazuar në to. Autoritetet e Programit në Shtetin Anëtar janë të kufizuara nga të gjitha dispozitat e akteve themeltare edhe nëse këto Kushte të përgjithshme mund të mos u referohen në mënyrë specifike të gjitha dispozitave të saj.

6. Autoritetet dhe organet e përfituesit IPA II do të mbështesin Shtetin Anëtar në përgjegjësitë dhe do të bashkëpunojnë ngushtë me autoritetet e një Programi, veçanërisht kur vetëm autoritetet dhe organet e përfituesit IPA II mund të kryejnë detyrat në territorin e tij.

7. Qëllimi i këtyre kushteve të përgjithshme është që të përcaktojë rregulloren për zbatimin e Programit, siç përcaktohet në shtojcën I, të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e përfituesit të IPA II dhe të Komisionit përkatësisht në kryerjen e këtyre detyrave.

8. Këto Kushte të përgjithshme do të zbatohen për detyrimet e përfituesit IPA II në lidhje me kontributin e Unionit, të veçuara ose të kombinuara me bashkëfinancimin kombëtar të përfituesit IPA II.

9. Përfituesi IPA II do të mbetet përgjegjës për mbështetjen e autoriteteve të Programit në Shtetin Anëtar, në përmbushjen e detyrimeve të saj të përcaktuara në aktet themelore edhe nëse përfituesi IPA II u nëndelegon detyra të caktuara subjekteve të tjera të identifikuara në Program. Komisioni, në veçanti, gëzon të drejtën që të ndërpresë pagesat dhe të pezullojë dhe/ose të përfundojë këtë Marrëveshje Financimi në bazë të akteve, moskryerjes së detyrave dhe/ose situatave të çfarëdo entiteti të caktuar.

SEKSIONI I
KUSHTET DHE PARIMET E PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizimet

1. Për qëllimet e Kushteve të përgjithshme do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) "Përfitues IPA II" nënkupton një nga përfituesit e renditur në shtojcën I të Rregullores IPA II;

b) "Vende pjesëmarrëse" nënkupton përfituesin IPA II së bashku me shtetet anëtare që marrin pjesë në një Program shumëvjeçar për bashkëpunim transkombëtar, të hartuar bashkërisht nga vendet pjesëmarrëse;

c) "Marrëveshja kuadër" i referohet marrëveshjes specifike të lidhur ndërmjet Komisionit dhe një përfituesi IPA II, të vlefshëm për të gjitha fushat e politikave të IPA II dhe përcakton parimet e bashkëpunimi financiar mes përfituesit IPA II dhe Komisionit sipas Rregullores IPA II, siç përcaktohet në nenin 6 të Kushteve të veçanta;

d) "Programi" nënkupton programin e përbashkët transkombëtar të bashkëpunimit;

e) "Autoritetet" nënkuptojnë subjekte publike apo organet e një përfituesit IPA II ose të një Shteti Anëtar në nivel kombëtar, rajonal apo lokal;

f) "Marrëveshja e financimit" nënkupton një marrëveshje vjetore ose shumëvjeçare të arritur mes Komisionit dhe një përfituesi IPA II, si dhe Shtetit Anëtar që pret autoritetin menaxhues;

g) "Organ i së drejtës publike" nënkupton në përfituesin IPA II, në përputhje me legjislacionin kombëtar, organet ekuivalente me ato në shtetet anëtare (shih pikën "o" të paragrafit 2 më poshtë);

h) "Operator ekonomik" nënkupton çdo person fizik apo juridik ose subjekt tjetër që merr pjesë në zbatimin e një operacioni në kuadër të Programit, me përjashtim të një Shteti Anëtar ose një përfituesi IPA II që ushtron të drejtat e tij si autoritet publik;

i) "Asistenca ERDF" nënkupton mbështetjen e Unionit për Programin nga linja buxhetore përmes Fondit Evropian për Zhvillim Rajonal (ERDF), si kontributi nga zëri buxhetor 1(b) (kohezion ekonomik, social dhe territorial) dhe kontributi nga zëri buxhetor 4 (Evropa globale) (IPA II), përveç nëse specifikohet ndryshe.

2. Për qëllimet e Kushteve të përgjithshme zbatohen përkufizimet e përcaktuara në nenin 2 CPR, vetëm nëse përshtatet sipas paragrafit 1 dhe në veçanti:

j) "Programimi" nënkupton procesin e organizimit, vendimmarrjen dhe shpërndarjen e burimeve financiare në disa faza, me përfshirjen e partnerëve në përputhje me nenin 5, me qëllim që të zbatojnë, në një bazë shumëvjeçare, veprimin e përbashkët nga Unioni dhe shtetet anëtare për të arritur objektivat e strategjisë së Unionit për rritje "të zgjuar", të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse;

k) "Operacioni" nënkupton një projekt, kontratë, veprim ose grup projektesh, të përzgjedhur nga Komiteti i përbashkët i monitorimit ose autoriteti kontraktues i Komitetit të monitorimit ose nën përgjegjësinë e tij, që kontribuojnë në objektivat;

l) "Përfitues" nënkupton një organ publik apo privat, që është përgjegjës për fillimin dhe zbatimin e operacioneve;

m) "Marrëveshja e partneritetit" nënkupton një dokument të përgatitur nga një Shtet Anëtar me përfshirjen e partnerëve në përputhje me qasjen e qeverisjes shumënivelesh, i cili përcakton strategjinë, prioritetet dhe masat e Shtetit Anëtar për përdorimin e Fondit Evropian Struktural dhe të Investimeve në një mënyrë efektive dhe efikase në mënyrë që të ndjekë strategjinë e Unionit për rritje "të zgjuar", të

qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse dhe që miratohet nga Komisioni pas vlerësimit dhe dialogut me Shtetin Anëtar në fjalë;

n) "Shpenzimet publike" nënkuptojnë çdo kontribut publik për financimin e operacioneve që kanë burim buxhetin e autoriteteve publike kombëtare, rajonale apo lokale, buxheti i Unionit që lidhet me asistencën IPA II, buxheti i organeve të së drejtës publike ose buxheti i shoqatave të autoriteteve publike ose të organeve të së drejtës publike;

o) "Organi i së drejtës publike" nënkupton një organ të një Shteti Anëtar që rregullohet nga e drejta publike, në kuptimin e pikës 4, të nenit 2 (1) të Direktivës 2014/24/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit[3] e të çdo grupimi evropian për bashkëpunim territorial (EGTC) të themeluar në përputhje me Rregulloren (KE) nr. 1082/2006 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit[4], pavarësisht nëse EGTC-ja konsiderohet të jetë një organ i së drejtës publike ose një organ i së drejtës private sipas dispozitave përkatëse kombëtare në zbatim;

p) "Dokument" nënkupton një letër ose një informacion elektronik me rëndësi mesatare të përkatësisë në kontekstin e kësaj Marrëveshjeje të Financimit;

q) "Viti kontabël", nënkupton periudhën nga 1 korriku deri më 30 qershor, me përjashtim të vitit të parë kontabël të periudhës së programimit, që do të thotë periudhën nga data e fillimit të pranueshmërisë së shpenzimeve deri më 30 qershor 2015; viti i fundit kontabël do të jetë nga 1 korriku 2023 deri më 30 qershor 2024;

r) "Viti financiar", nënkupton periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor;

s) "Parregullsi" nënkupton çdo shkelje të legjislacionit të Unionit ose të ligjit kombëtar lidhur me zbatimin e tij, që rezulton nga një veprim ose mosveprim nga një operator ekonomik të përfshirë në zbatimin e asistencës ERDF, e cili ka ose do të ketë, efekt në dëm të buxhetit të Unionit, duke faturuar një artikull të pajustifikuar shpenzimesh në buxhetin e Unionit;

t) "Parregullsi sistematike" nënkupton çdo parregullsi, që mund të jetë e një natyre periodike, me një probabilitet të lartë të shfaqjes në operacione të ngjashme, e cila është rezultat i një mangësie serioze në funksionimin efikas të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit, duke përfshirë edhe pamundësinë për të përcaktuar procedurat e duhura në përputhje me këtë Rregullore dhe rregullat specifike për Fondin;

u) "Mangësi serioze në funksionimin efikas të sistemit të menaxhimit dhe të kontrollit" nënkupton një mangësi për të cilën kërkohet përmirësim thelbësor në sistemin, që ekspozon asistencën ERDF në një rrezik të madh parregullsish, si dhe ekzistenca e të cilit nuk pajtohet me një opinion të pakualifikuar të auditimit për funksionimin e sistemit të menaxhimit dhe të kontrollit;

v) "Rregullat specifike për fondin" u referohen dispozitave specifike të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 të Parlamenti Evropian dhe të Këshillit, të 17 dhjetorit 2013[5], të zbatueshme për Rregulloren (BE) nr. 1299/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshilli[6] (Rregullorja Evropiane për Bashkëpunim Territorial, "Rregullorja ETC") dhe Rregullorja (BE) nr. 1301/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit[7].

3. Referencat në këtë Marrëveshje të Financimit për dispozitat e CPR-së, Rregullores ETC dhe të akteve të miratuara mbi bazën e tyre interpretohen edhe si referuar "përfituesit IPA II", "vendeve pjesëmarrëse" dhe "asistencës ERDF", siç përcaktohet në paragrafin 1.

Neni 2

Përllogaritja e afateve kohore për vendimet e Komisionit

Ku, në zbatim të nenit 10(2) dhe (5) të kësaj marrëveshjeje ose të nenit 107(2) dhe 108(3) CPR, vendoset

---

[3] Direktiva 2014/24/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 26 shkurt 2014, për prokurimin publik dhe që shfuqizon Direktivën 2004/18/KE. Teksti i lidhur me EEA-n, GZ L 94, 28.3.2014, f. 65.

[4] Rregullorja (BE) nr. 1302/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 17 dhjetor 2013, që amendon Rregulloren (KE) nr. 1082/2006, për Grupimin Evropian të Bashkëpunimit Territorial (EGTC), lidhur me sqarimin, thjeshtësimin dhe përmirësimin e krijimit dhe të funksionimit të grupimeve të tilla, GZ L 347, 20.12.2013, f. 303.

[5] Rregullorja (BE) nr. 1303/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 17 dhjetor 2013 që përcakton dispozitat e përbashkëta për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Evropian Social, Fondin e Kohezionit, Fondin Evropian Bujqësor për Zhvillimin Rural dhe Bregdetar Evropian dhe Fondin e Peshkimit dhe që përcakton dispozitat e përgjithshme mbi Fondin e Zhvillimit Rajonal Evropian, Fondin Evropian Social, Fondin e Kohezionit dhe Bregdetar Evropian dhe Fondin e Peshkimit dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1083/2006, GZ L 347, 20.12.2013, f. 320.

[6] Rregullorja (BE) nr. 1299/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 17 dhjetor 2013, për dispozitat e veçanta për mbështetjen e Fondit Evropian të Zhvillimit Rajonal për qëllimin e bashkëpunimit territorial, GZ L 347, 20.12.2013, f. 259.

[7] Rregullorja (BE) nr. 1301/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 17 dhjetor 2013, për Fondin Evropian për Zhvillimin Rajonal dhe për dispozitat e veçanta në lidhje me investimet për qëllimin e rritjes dhe të punësimit e që shfuqizon Rregulloren (BE) nr. 1080/2006, GZ L 347, 20.12.2013, f. 289.

një afat kohor për Komisionin që të miratojë apo të ndryshojë një vendim, me anë të një akti interpretues, që afati kohor të mos përfshijë periudhën e cila fillon në datën pas datës së dërgimit të komenteve nga Komisioni drejt Shtetit Anëtar dhe zgjat derisa Shteti Anëtar të përgjigjet për komentet.

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. Asistenca ERDF do të mbështesë përfituesin IPA II në miratimin dhe zbatimin e reformave politike, institucionale, ligjore, administrative, sociale dhe ekonomike, të kërkuara në mënyrë që të jenë në përputhje me vlerat e Unionit dhe që të përafrohen në mënyrë të vazhdueshme me rregullat e Unionit, standardet, politikat dhe praktikat, me qëllim anëtarësimin në Unionin.

Nëpërmjet kësaj mbështetjeje, asistenca ERDF do të kontribuojë në stabilitetin, sigurinë dhe zhvillimin e përfituesit IPA II.

2. Më konkretisht, asistenca ERDF do të:

a) Mbështesë reformat politike, ndër të tjera përmes bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të mira të fqinjësisë;

b) Mbështesë zhvillimin ekonomik, social dhe territorial, me qëllim rritjen "e zgjuar", të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse; dhe

c) Forcojë integritetin rajonal dhe bashkëpunimin territorial me përfshirjen e përfituesit IPA II dhe shteteve anëtare.

3. Komisioni dhe vendet pjesëmarrëse do të garantojnë, duke pasur parasysh kontekstin specifik të çdo Shteti Anëtar dhe përfituesit IPA II, që asistenca ERDF të përputhet me politikat përkatëse, parimet horizontale të referuara në nenin 3, 5 dhe 6, si dhe prioritetet e Unionit dhe, që të plotësojë instrumentet e tjera të Unionit.

4. Asistenca ERDF do të zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin, Shtetin Anëtar dhe përfituesin IPA II në përputhje me parimin e subsidiaritetit.

5. Vendet pjesëmarrëse, në nivelin e duhur territorial, në përputhje me kuadrin e tyre institucional, ligjor dhe financiar dhe organet e caktuara prej tyre për atë qëllim, do të jenë përgjegjëse për përgatitjen dhe zbatimin e Programit dhe kryerjen e detyrave, në partneritet me partnerët përkatës, referuar në nenin 7, në përputhje me këtë Marrëveshje të Financimit.

6. Rregullimet për zbatimin dhe shfrytëzimin e asistencës ERDF dhe në veçanti burimet financiare dhe administrative, të nevojshme për përgatitjen dhe zbatimin e Programit, në lidhje me monitorimin, raportimin, vlerësimin dhe kontrollin do të respektojë parimin e proporcio-nalitetit në lidhje me nivelin e mbështetjes së alokuar dhe do të marrë parasysh qëllimin e përgjithshëm për reduktimin e barrës administrative për organet e përfshira në menaxhimin dhe kontrollin e Programit.

7. Në përputhje me përgjegjësitë e tyre përkatëse, Komisioni dhe vendet pjesëmarrëse do të garantojnë koordinimin ndërmjet këtij programi dhe programeve të tjera të IPA II dhe në mes të ERDF dhe politikave, strategjive dhe instrumenteve të tjera përkatëse të Unionit, duke përfshirë ato në kuadrin e veprimit të jashtëm të Unionit.

8. Pjesa e buxhetit të Unionit, e alokuar për asistencën ERDF do të zbatohet brenda kuadrit të menaxhimit të përbashkët në mes të vendeve pjesëmarrëse dhe Komisionit, në përputhje me nenin 59 të Rregullores (BE, Euratom) nr. 966/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit[8] (Rregullorja financiare).

9. Komisioni dhe vendet pjesëmarrëse do të respektojnë parimin e menaxhimit të shëndoshë financiar në përputhje me nenin 30 të Rregullores Financiare.

10. Komisioni dhe vendet pjesëmarrëse garantojnë efikasitetin e asistencës ERDF gjatë përgatitjes dhe zbatimit, në lidhje me monitorimin, raportimin dhe vlerësimin.

11. Komisioni dhe vendet pjesëmarrëse do të kryejnë detyrat e tyre përkatëse lidhur me asistencën ERDF, me qëllim reduktimin e barrës administrative për përfituesit.

Neni 4

Përputhshmëria me legjislacionin e Unionin dhe atë kombëtar

Operacionet e mbështetura nga asistenca ERDF do të jenë në përputhje me legjislacionin e Unionit

[8] Rregullorja (BE, Euratom) nr. 966/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 25 tetor 2012, për rregullat financiare që zbatohen për buxhetin e përgjithshëm të Unionit dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE, Euratom) nr. 1605/2002, GZ L 298, 26.10.2012, f. 1.

dhe atë kombëtar ne lidhje me zbatimin e tij (legjislacioni i zbatueshëm).

Neni 5

Nxitja e barazisë mes burrave dhe grave dhe mosdiskriminimi

Komisioni dhe vendet pjesëmarrëse garantojnë barazinë mes burrave dhe grave e integriteti i perspektivës gjinore merret në konsideratë dhe nxitet nëpërmjet përgatitjes dhe zbatimit të Programit, përfshirë në lidhje me monitorimin, raportimin dhe vlerësimin.

Komisioni dhe vendet pjesëmarrëse do të ndërmarrin masat e nevojshme për të parandaluar diskriminimin me bazë gjinore, origjinë racore dhe etnike, fetare ose besimi, aftësi të kufizuara, moshës ose orientimit seksual gjatë përgatitjes dhe zbatimit të Programit. Në veçanti, qasja e personave me aftësi të kufizuara do të merret në konsideratë gjatë procesit të përgatitjes dhe zbatimit të Programit.

Neni 6

Zhvillimi i qëndrueshëm

Objektivat e asistencës ERDF do të ndiqen në përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe me nxitjen e Unionit, me qëllim ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimit të cilësisë së mjedisit, siç përcaktohet në nenet 11 dhe 191(1) Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU), duke marrë parasysh parimin: "Ndotësi paguan".

Komisioni dhe vendet pjesëmarrëse do të garantojnë që kërkesat për mbrojtjen e mjedisit, eficienca e burimeve, zbutja dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, biodiversiteti, elasticiteti ndaj fatkeqësive dhe parandalimi i rrezikut, si dhe menaxhimi, nxiten në procesin e përgatitjes dhe zbatimit të Programit.

Neni 7

Parimi i partneritetit

1. Për Programin, vendet pjesëmarrëse, në përputhje me kuadrin institucional dhe ligjor të tyre, do të organizojnë një partneritet me autoritetet kompetente rajonale dhe vendore. Partneriteti do të përfshijë edhe partnerët e mëposhtëm:

a) Autoritetet kompetente urbane dhe të tjera publike;

b) Partnerët ekonomikë dhe socialë; dhe

c) Organet përkatëse që përfaqësojnë shoqërinë civile, duke përfshirë edhe partnerët e mjedisit, organizatat joqeveritare dhe organet përgjegjëse për nxitjen e përfshirjes sociale, barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit.

Vendet pjesëmarrëse mund të përfshijnë edhe grupimet evropiane të bashkëpunimit territorial që veprojnë në fushën e Programit dhe autoritetet apo organet që janë të përfshira në zhvillimin ose në zbatimin e një strategjie makrorajonale ose të basenit detar në zonën e Programit, duke përfshirë koordinatorët e zonave prioritare për strategjitë makrorajonale.

Aty ku autoritetet publike, partnerët shoqëror dhe ekonomik, si dhe organet që përfaqësojnë shoqërinë civile kanë krijuar një organizatë ombrellë, ata mund të propozojnë një përfaqësues të vetëm për të paraqitur pikëpamjet e organizatës ombrellë në partneritet.

2. Në përputhje me qasjen e qeverisjes shumënivelesh, partnerët e përmendur në paragrafin 1 do të përfshihen nga vendet pjesëmarrëse në përgatitjen e raporteve të progresit dhe gjatë përgatitjes dhe zbatimit të Programit, duke përfshirë përmes pjesëmarrjes në Komitetin e monitorimit për Programin në përputhje me nenin 15.

3. Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) nr. 240/2014[9] do të aplikojë *mutatis mutandis* për elemente të ndryshme të programimit, të përmendura në paragrafin 2.

SEKSIONI II
PROGRAMIMI

Neni 8

Mbulimi gjeografik

Lista e rajoneve të pranueshme që do të përfshihen në Program është si më poshtë:

a) në shtetet anëtare, Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS), rajonet e nivelit 2, të

[9] Rregullore Deleguese e Komisionit (BE) nr. 240/2014, e datës 7 janar 2014, për Kodin Evropian të Kryerjes së Partneritetit në Kuadër të Fondit Evropian Strukturor dhe të Investimeve, GZ L 74, 14.3.2014, f. 1.

renditura në shtojcën III të vendimit zbatues të Komisionit 2014/388/BE, datë 16 qershor 201[10], duke siguruar vazhdimësinë e këtij bashkëpunimi në fusha të mëdha koherente, në bazë të programeve të mëparshme, duke marrë parasysh, sipas rastit, strategjitë makrorajonale dhe të basenit detar;

b) Në përfituesin IPA II, Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS), rajonet e nivelit 2 ose, në mungesë të klasifikimit NUTS, zonat ekuivalente si të renditura, për qëllim informimi, në shtojcën III të vendimit zbatues të Komisionit 2014/388/EU, si dhe të përcaktuara në Programin e miratuar nga Komisioni.

Neni 9

Përmbajtja e Programit dhe përqendrimi tematik

1. Programi do të hartohet në përputhje me parimin e partneritetit siç është përcaktuar në nenin 7 dhe në përputhje me nenin 8 të Rregullores ETC.

2. Objektivat tematikë për Programin do të dakordësohen mes vendeve pjesëmarrëse për secilin kufi apo grup të kufijve, bazuar në objektivat tematikë të përcaktuar në paragrafin e parë të nenit 9 të CPR-së.

3. Prioritetet tematike të asistencës ERDF do të jenë ato të përcaktuara në nenin 5 të Rregullores (BE) nr. 1301/2013 dhe në nenin 7(1)(b) të Rregullores ETC.

4. Të paktën 80% e alokimit ERDF për këtë Program transkombëtar do të përqendrohet në një maksimum prej katër objektivash tematikë të përcaktuar në paragrafin e parë të nenit 9 të CPR-së.

Neni 10

Miratimi dhe ndryshimi i Programit

1. Komisioni do të vlerësojë përputhshmë-rinë e programeve me dispozitat e përgjithshme dhe Rregulloren ETC dhe me rregullat specifike për fondin, kontributi efektiv i tyre për objektivat e përzgjedhur tematikë dhe për prioritetet e Unionit, specifike për ETC-në dhe ERDF-në dhe për sa kohë kjo lidhet edhe me shtetet anëtare pjesëmarrëse, gjithashtu edhe përputhshmëria me Marrëveshjen e partneritetit, duke marrë parasysh rekomandimet përkatëse specifike për vendin, të miratuara në përputhje me nenin 121(2) TFEU dhe rekomandimet përkatëse të Këshillit, të miratuara në përputhje me nenin 148(4) TFEU, si dhe vlerësimet *ex ante*. Vlerësimi do të trajtojë, në veçanti, përshtatshmërinë e strategjisë së Programit, objektivat, treguesit, synimet korresponduese dhe alokimin e burimeve buxhetore përkatëse.

2. Komisioni do të kryejë vëzhgime brenda tre muajve nga data e dorëzimit të Programit. Vendet pjesëmarrëse do t'i sigurojnë Komisionit të gjithë informacionin e nevojshëm shtesë dhe, kur është e përshtatshme, do të rishikojnë Programin e propozuar.

3. Banka Evropiane e Investimeve (EIB), me kërkesë të vendeve pjesëmarrëse, mund të marrë pjesë në përgatitjen, si dhe në aktivitete që lidhen me përgatitjen e operacioneve.

4. Komisioni mund të konsultohet me EIB-në para miratimit të Programit.

5. Kërkesat për ndryshimin e Programit të dorëzuara nga vendet pjesëmarrëse do të jenë të arsyetuara në mënyrë të rregullt dhe do të parashtrojë, në veçanti, ndikimin e pritshëm të ndryshimeve në Program për arritjen e strategjisë së Unionit për rritje "të zgjuar", të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse dhe objektivat specifikë të përcaktuar në Program, duke marrë parasysh dispozitat e përgjithshme dhe Rregulloren ETC, parimet horizontale të përmendura në nenet 5, 6 dhe 7, si dhe Marrëveshjen e partneritetit. Këto kërkesa duhet të shoqërohen nga një program të rishikuar. Paragrafët 3 dhe 4 do të zbatohen për ndryshimet në Program.

Neni 11

Zhvillimi i drejtuar nga komuniteti lokal, planet e përbashkëta të veprimit dhe investimet e integruara territoriale

1. Programi mund të kryejë veprime:

a) Të zhvillimeve të drejtuara nga komuniteti lokal në kuptimin e neneve 32–35 të CPR-së;

b) Të planeve të përbashkëta të veprimit në kuptimin e neneve 104–109 të CPR-së, të hartuara në

[10] Vendimi zbatues i Komisionit i 16 qershorit 2014, që përcakton listën e rajoneve dhe të zonave të pranueshme për financim nga Fondi Evropian për Zhvillim Rajonal nën komponentët ndërkufitarë dhe transkombëtarë të qëllimit evropian për bashkëpunim territorial për periudhën 2014–2020 (njoftuar me numrin e dokumentit C(2014) 3898), GZ L 183, 2014/06/24, f. 75.

përputhje me nenin 4 dhe shtojcën IV, të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 2015/207[11]; dhe

c) Të investimeve të integruara territoriale në kuptimin e nenit 36 të CPR-së.

2. Veprimet e përmendura në paragrafin 1 duhet të kenë parasysh nenet 9–11 të Rregullores ETC.

Neni 12

Përzgjedhja e operacioneve

1. Operacionet në kuadër të Programit do të zgjidhen nga Komiteti monitorues. Komiteti monitorues mund të krijojë një komitet drejtues që vepron nën përgjegjësinë e tij për zgjedhjen e operacioneve.

2. Operacionet e përzgjedhura do të përfshijnë përfitues nga të paktën dy vende pjesëmarrëse, ku të paktën njëri prej të cilëve do të jetë nga një shtet anëtar. Një operacion mund të zbatohet në një vend të vetëm pjesëmarrës, me kusht që të identifikohen ndikimet dhe përfitimet transkombëtare.

Megjithatë, shtetet anëtare pjesëmarrëse mund të vendosin në Komitetin monitorues një pikat më poshtë, vetëm nëse është rënë dakord ndryshe në Program:

a) Operacionet që i nënshtrohen një thirrjeje të caktuar për propozime mund të mos përfshijnë përfitues nga përfituesi IPA II, derisa përfituesi IPA II të ketë përfunduar Marrëveshjen Financiare; ose

b) Përfituesit nga përfituesit IPA II mund të marrin pjesë në një thirrje të caktuar për propozime vetëm me kusht që përfituesi IPA II të ketë përfunduar këtë Marrëveshje Financimi brenda një afati të caktuar; ose

c) Autoriteti menaxhuese mund të shtyjnë nënshkrimin e dokumentit të grantit në lidhje me nenin 14(7), derisa përfituesi IPA II të ketë përfunduar këtë Marrëveshje Financimi brenda një afati të caktuar; ose

d) Autoriteti menaxhuese mund të nënshkruajë dokumentin e grantit në lidhje me nenin 14(7), duke shtuar një kusht në lidhje me vlefshmërinë e nënshkrimit që i referohet datës kur përfituesi IPA II ka përfunduar këtë Marrëveshje Financimi.

3. Përfituesit do të bashkëpunojnë në zhvillimin dhe në zbatimin e operacioneve. Përveç kësaj, ata do të bashkëpunojnë qoftë në plotësimin me staf ose në financimin e operacioneve.

Neni 13

Lejet dhe autorizimi

Çdo lloj leje dhe/ose autorizimi i kërkuar për zbatimin e Programit duhet të sigurohet në kohën e duhur nga autoritetet kompetente të përfituesit IPA II, në përputhje me të drejtën kombëtare, përpara se autoriteti menaxhues t'i dërgojë dokumentin e grantit të përmendur në nenin 14(7) përfituesit kryesor.

Neni 14

Përfituesit

1. Në rastet kur ka dy ose më shumë përfitues për një operacion të Programit, njëri prej tyre caktohet nga të gjithë përfituesit si përfituesi kryesor.

2. Përfituesi kryesor do të kryejë detyrat e mëposhtme:

a) Të përcaktojë rregullimet me përfituesit e tjerë përmes një marrëveshjeje që përmban dispozitat të cilat, ndër të tjera, garantojnë menaxhim të shëndoshë financiar të fondeve të alokuara për operacionin, përfshirë rregullimet për rikthimin e shumave të paguara në mënyrë të papranueshme;

b) Të marrë përgjegjësinë për sigurimin e zbatimit të të gjithë operacionit;

c) Të sigurojë që shpenzimet e paraqitura nga të gjithë përfituesit janë kryer për zbatimin e operacionit dhe që korrespondojnë me aktivitetet e dakordësuara nga të gjithë përfituesit e që është në përputhje me dokumentin e siguruar nga autoriteti menaxhues, në zbatim të nenit 12(5) të Rregullores ETC;

d) Siguron që shpenzimet e paraqitura nga përfituesit e tjerë janë verifikuar nga kontrolli(uesit),[12] kur ky verifikim nuk kryhet nga autoriteti menaxhues në përputhje me nenin 23(1) të Rregullores ETC.

3. Nëse nuk specifikohet ndryshe në marrëveshjet e përmendura në pikën "a" të paragrafit 2, përfituesi

[11] Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2015/207 e 20 janarit 2015, që përcakton rregullat e hollësishme për zbatimin e Rregullores (BE) nr. 1303/2013, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, për sa u përket modeleve për raportin e progresit, dorëzimin e informacionit për një projekt madhor, planin e përbashkët të veprimit, raportet e zbatimit për investime, me qëllim rritjen dhe punësimin, deklaratën e menaxhimit, strategjinë. e auditimit, opinionin e auditimit dhe raportin vjetor të kontrollit dhe metodologjinë për kryerjen e analizave kosto-përfitim dhe në përputhje me Rregulloren (BE) nr. 1299/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit lidhur me modelin për raportet e zbatimit, për qëllim të bashkëpunimit territorial evropian, GZ L 38, 2015/02/13, f. 1.

[12] Siç përcaktohet në nenin 37(3).

kryesor duhet të sigurojë që përfituesit e tjerë të marrin shumën totale të mbështetjes publike sa më shpejt të jetë e mundur dhe të plotë. Nuk do të zbritet/mbahet asnjë shumë dhe nuk do të vilet asnjë taksë specifike apo taksë tjetër me efekt të njëvleftshëm e cila do të reduktonte shumat për përfituesit e tjerë.

4. Përfituesi kryesor do të jetë vendoset në një Shtet Anëtar që merr pjesë në Programin e bashkëpunimit. Megjithatë, shtetet anëtare dhe Përfituesi IPA II që marrin pjesë në një Program bashkëpunimi mund të bien dakord që përfituesi kryesor të vendoset në Përfituesin IPA II, që është pjesëmarrës në këtë Program të bashkëpunimit, me kusht që autoriteti menaxhues të japë pëlqimin që Përfituesi kryesor të kryejë detyrat e përcaktuara në paragrafin 2 dhe 3 dhe që të plotësohen kërkesat për menaxhimin, kontrollin dhe verifikimin.

5. Përfituesit e vetëm duhet të jenë të regjistruar në një Shtet Anëtar që merr pjesë në Programin e bashkëpunimit. Megjithatë, ata mund të jenë të regjistruar në një Shtet Anëtar që nuk merr pjesë në Program, me kusht që të plotësojë kushtet e përcaktuara në nenin 12 (3) të Rregullores ETC.

6. Pavarësisht nga neni 12(2), një EGTC ose ndonjë organ tjetër ligjor i themeluar sipas ligjeve të një vendi pjesëmarrës, mund të aplikojë si përfitues i vetëm për një operacion, me kusht që ai të jetë ngritur nga autoritetet apo organet publike e të paktën dy vende pjesëmarrëse.

7. Autoriteti menaxhues do t'i sigurojë përfituesit kryesor apo përfituesit të vetëm për secilin operacion një dokument që përcakton kushtet për mbështetjen e operacionit, duke përfshirë kushtet specifike që kanë të bëjnë me produktet apo shërbimet që do të ofrohen sipas operacionit, planin e financimit dhe afatin për ekzekutim (Dokumenti i grantit).

Dokumenti i grantit do të përcaktojë edhe metodën që do të zbatohet për përcaktimin e kostove të operacionit dhe kushtet për pagesën e grantit.

Në zbatim të vendimit të marrë nga shtetet anëtare pjesëmarrëse në Komitetin monitorues, në përputhje me nënparagrafin e dytë të nenit 12, autoriteti menaxhues mund:

a) Të shtyjë nënshkrimin e dokumentit të grantit; ose

b) Të përcaktojë në dokumentin e grantit një kusht që dokumenti i grantit të bëhet i vlefshme vetëm për sa ka të bëjë me një përfitues në përfituesin IPA II, kur përfituesi IPA II të ketë respektuar një vendim të tillë.

SEKSIONI III
MONITORIMI, VLERËSIMI DHE ASISTENCA TEKNIKE

NËNSEKSIONI 1
MONITORIMI

Neni 15
Ngritja dhe përbërja e Komitetit të monitorimit

1. Brenda tre muajve nga data e njoftimit të Shtetit Anëtar mbi vendimin që miraton Programin, vendet pjesëmarrëse do të ngrenë Komitetin e monitorimit (KM), sipas një marrëveshje me autoritetin menaxhues për të monitoruar zbatimin e Programit.

2. KM-ja do të hartojë dhe do të miratojë rregulloren e saj.

3. Përbërja e KM-së duhet të dakordësohet nga vendet pjesëmarrëse dhe duhet të përfshijë përfaqësues përkatës nga këto vende. Komiteti i monitorimit mund të ketë në përbërje përfaqësues të EGTC-së që zhvillojnë aktivitetet lidhur me Programin brenda zonës së Programit.

4. Lista e anëtarëve të KM-së duhet të publikohet.

5. Komisioni do të marrë pjesë në punën e KM-së në rolin e kapacitetit mbikëqyrës.

6. Nëse EIB-ja kontribuon në Program, ajo mund të marrë pjesë në punën e KM-së në rolin e kapacitetit mbikëqyrës.

7. KM-ja do të drejtohet nga një përfaqësues i Shtetit Anëtar ose nga autoriteti menaxhues.

Neni 16
Funksionet e Komitetit monitorues

1. KM-ja mblidhet të paktën një herë në vit dhe shqyrton zbatimin e Programit dhe progresin e bërë në arritjen e objektivave. Për të realizuar këtë, ajo duhet t'u kushtojë rëndësi të dhënave financiare, treguesve të përbashkët dhe specifikë të Programit, përfshirë ndryshimet në vlerën e treguesve të rezultateve dhe të progresit ndaj vlerave të synuara sasiore, si dhe arritjeve të përcaktuara në kornizën e performancës së përmendur në nenin 21(1) të CPR-së dhe, ku është e përshtatshme, rezultateve të

analizave sasiore.

2. Komiteti i monitorimit shqyrton të gjitha çështjet që ndikojnë në zbatimin e Programit, përfshirë përfundimet e rishikimit të performancës.

3. KM-ja shqyrton, në veçanti:

a) Çdo çështje që ndikon në zbatimin e programit operacional;

b) Progresin e arritur në zbatimin e planit të vlerësimit dhe ndjekjen sipas të dhënave të vlerësimeve;

c) Zbatimin e strategjisë së komunikimit;

d) Zbatimin e planeve të përbashkëta të veprimit;

e) Veprimet për të nxitur barazinë mes burrave dhe grave, mundësitë e barabarta dhe mosdiskriminimin, përfshirë qasjen e personave me aftësi të kufizuaral;

f) Veprimet për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm.

4. KM-ja shqyrton dhe miraton:

a) Metodologjinë dhe kriteret e përdorura për përzgjedhjen e operacioneve;

b) Raportet vjetore dhe përfundimtare të zbatimit;

c) Planin e vlerësimit për Programin dhe ndonjë ndryshim tjetër të planit të vlerësimit sipas nenit 21(6) të CPR-së;

d) Strategjinë e komunikimit për Programin dhe çdo ndryshim tjetër të strategjisë;

e) Çdo propozim nga autoriteti menaxhues për ndryshime të Programit.

5. Komiteti i monitorimit mund të kryejë vëzhgime në autoritetin menaxhues lidhur me zbatimin dhe vlerësimin e programit, përfshirë veprimet që kanë të bëjnë me reduktimin e barrës administrative për përfituesit. Komiteti i monitorimit monitoron veprimet e ndërmarra si rezultat i vëzhgimeve të saj.

Neni 17

Raportimi

1. Deri më 31 maj 2016 dhe në të njëjtën datë të çdo viti pasardhës dhe përfshirë vitin 2023, autoriteti menaxhues duhet të dorëzojë në Komision një raport vjetor të zbatimit në përputhje me nenin 50(1) të CPR-së.

Raporti i zbatimit i dorëzuar më 2016-ën duhet të mbulojë vitet fiskale 2014 dhe 2015.

2. Për raportet që do të dorëzohen më 2017-ën dhe 2019-ën, afati i përmendur në paragrafin 1 do të jetë 30 qershori.

3. Raportet vjetore të zbatimit përcaktojnë informacione kyç për zbatimin e Programit dhe prioritetet e tij duke iu referuar të dhënave financiare, treguesve të përbashkët dhe specifikë të Programit, përfshirë ndryshimet në vlerën e treguesve të rezultateve ku është e përshtatshme dhe, duke filluar nga raporti vjetor i zbatimit që do të dorëzohet më 2017-ën, arritjet e përcaktuara në kornizën e performancës. Të dhënat e transmetuara duhet të lidhen me vlerat për treguesit për operacione të zbatuara plotësisht dhe, gjithashtu, ku është e përshtatshme, duke pasur parasysh fazën e zbatimit, për operacionet e përzgjedhura. Ato, gjithashtu, duhet të përcaktojnë një sintezë të përfundimeve të të gjitha vlerësimeve të Programit që janë mundësuar gjatë vitit të mëparshëm të financimit, çdo çështje që ndikon në zbatimin e Programit dhe masat e ndërmarra.

Ku është e përshtatshme, raportet vjetore të zbatimit duhet të shprehin progresin në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve madhore dhe të planeve të përbashkëta të veprimit.

4. Në lidhje me raportet vjetore të zbatimit të dorëzuara më 2017-ën dhe 2019-ën, zbatohet neni 14(4) i Rregullores ETC.

5. Raportet vjetore dhe përfundimtare të zbatimit hartohen në përputhje me nenin 8 dhe shtojcën X të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 2015/207.

Neni 18

Takim vjetor për rishikimin

1. Një takim vjetor për rishikimin do të organizohet çdo vit nga 2016-ta deri në dhe duke përfshirë 2023-shin mes Komisionit, Shtetit Anëtar dhe përfituesit IPA II, për të shqyrtuar zbatimin e Programit, duke marrë në konsideratë raportin vjetor të zbatimit dhe komentet e Komisionit ku janë të zbatueshme. Takimi vjetor për rishikimin mund të mbulojë më shumë se një program.

2. Duke u shmangur nga paragrafi 1, Shteti Anëtar dhe Komisioni mund të bien dakord që të mos organizojnë takimin vjetor për rishikimin e Programit në vitet e tjera, përveç 2017-ës dhe 2019-ës. Në këtë rast, rishikimi vjetor mund të kryhet me shkrim.

3. Takimi vjetor i rishikimit do të kryesohet nga Komisioni ose, nëse e kërkon Shteti Anëtar, ai mund të bashkëkryesohet nga Shteti Anëtar dhe Komisioni.

4. Shteti Anëtar dhe Përfituesi IPA II duhet të garantojnë që komentet e Komisionit të ndiqen në mënyrën e duhur pas takimit vjetor të rishikimit, lidhur me çështjet të cilat ndikojnë ndjeshëm në zbatimin e Programit dhe, sipas rastit, informojnë Komisionin, brenda tre muajve, rreth masave të marra.

Neni 19

Transmetimi i të dhënave

1. Deri më 31 janar, 31 korrik dhe 31 tetor të çdo viti, autoriteti menaxhues duhet të transmetojë elektronikisht në Komision për qëllime monitorimi, për Programin dhe ,sipas aksit prioritar:

a) Kostot totale dhe publike të pranueshme për operacionet dhe numrin e operacioneve të përzgjedhura për mbështetje;

b) Shpenzimet totale të pranueshme që janë deklaruar nga përfituesit në autoritetin menaxhues.

2. Përveç kësaj, transmetimi i të dhënave, i bërë deri më 31 janar duhet të përmbajë të dhënat e mësipërme të ndara për kategori të ndërhyrjes. Transmetimi duhet të merret në konsideratë për të përmbushur kërkesat për dorëzimin e të dhënave financiare të përmendura në nenin 50(2) të CPR-së.

3. Parashikimi i shumës, për të cilën autoriteti menaxhues pret të dorëzojë aplikimet e pagesave për vitin aktual financiar dhe vitin pasardhës financiar, duhet t'i shoqërohet transmetimit që do të bëhet deri më 31 janar dhe 31 korrik.

4. Data përfundimtare për transmetimin e të dhënave nën këtë paragraf do të jetë fundi i muajit që paraprin muajin e dorëzimit.

5. Të dhënat financiare dorëzohen në përputhje me nenin 2 dhe shtojcën II të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 1011/2014[13].

Neni 20

Informimi dhe komunikimi

1. Autoriteti menaxhues është përgjegjës për aktivitetet e informimit dhe të komunikimit, siç përcaktohet në nenet 115, 116 dhe 117 të CPR-së.

2. Nenet 3, 4 dhe 5 të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 821/2014[14], që kanë të bëjnë me karakteristikat teknike të masave për informimin dhe komunikimin për operacionet dhe udhëzimet për krijimin e emblemës së Unionit, si dhe një përkufizim rreth ngjyrave standarde do të zbatohen.

NËNSEKSIONI 2

VLERËSIMI

Neni 21

Parimet e vlerësimit dhe vlerësimet specifike

1. Vlerësimet do të kryhen për të përmirësuar cilësinë e hartimit dhe të zbatimit të programeve, si dhe për të vlerësuar efektivitetin e tyre, efikasitetin dhe ndikimin. Ndikimi i programeve do të vlerësohet në kuadër të misionit të ERDF-së, në lidhje me objektivat nën strategjinë e Unionit për rritje "të zgjuar", të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse dhe, duke marrë në konsideratë madhësinë e programit, në lidhje me PBB-në dhe papunësinë në zonën e programit në fjalë, ku është e përshtatshme.

2. Vendet pjesëmarrëse duhet të sigurojnë burimet e nevojshme për kryerjen e vlerësimeve dhe duhet të sigurojnë që procedurat janë aktive për të prodhuar dhe për të mbledhur të dhënat e nevojshme për vlerësimet, duke përfshirë të dhënat që lidhen me treguesit e programeve të përbashkëta dhe, ku është e përshtatshme, të programeve specifike.

3. Vlerësimet duhet të kryhen nga ekspertë të brendshëm ose të jashtëm, të cilët veprojnë të pavarur

---

[13] Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) nr. 1011/2014, e 22 shtatorit 2014, që përcakton rregullat e detajuara për zbatimin e Rregullores (BE) nr. 1303/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, lidhur me modelet për dorëzimin e informacionit të caktuar në Komision dhe rregullat e detajuara në lidhje me shkëmbimin e informacionit ndërmjet përfituesve dhe autoriteteve menaxhuese, autoriteteve certifikuese, autoriteteve të auditit dhe trupave të ndërmjetëm, GZ L 286, 30.9.2014, f. 1.

[14] Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) nr. 821/2014, e 28 korrikut 2014, që përcakton rregullat për zbatimin e Rregullores (BE) nr. 1303/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, lidhur me rregullimet e detajuara për transferimin dhe për menaxhimin e kontributeve të Programit, raportimin mbi instrumentet financiare, karakteristikat teknike të informacionit dhe të komunikimit, masat për operacionet dhe sistemi për të regjistruar dhe për të ruajtur të dhënat, GZ L 223, 2014/07/29, f. 7.

nga autoritetet përgjegjëse për zbatimin e Programit. Komisioni duhet të sigurojë udhëzime për mënyrën e kryerjes së vlerësimeve, menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

4. Të gjitha vlerësimet duhet t'i mundësohen publikut.

5. Vendet pjesëmarrëse kryejnë bashkërisht vlerësime *ex ante* në përputhje me nenin 55 të CPR-së.

6. Neni 56 i CPR-së do të zbatohet për vlerësimin gjatë periudhës së programimit.

Në veçanti, autoriteti menaxhues duhet të hartojë një plan vlerësimi që do t'i dorëzohet KM-së, jo më vonë se një vit pas miratimit të Programit.

7. Neni 57 i CPR-së do të zbatohet për vlerësimin *ex post*.

NËNSEKSIONI 3
ASISTENCA TEKNIKE

Neni 22
Qëllimi

Me nismën e një vendi pjesëmarrës, asistenca ERDF mund të mbështesë veprimet për përgatitjen, menaxhimin, monitorimin, vlerësimin, informimin dhe komunikimin, krijimin e rrjetit, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, kontrollin dhe auditimin. Asistenca ERDF mund të shfrytëzohet nga vendet pjesëmarrëse për të mbështetur veprimet për reduktimin e barrës administrative për përfituesit, përfshirë sistemin e shkëmbimit të të dhënave elektronike dhe veprimet për të rritur kapacitetet e autoriteteve të Shtetit Anëtar, si dhe të përfituesve për të administruar dhe për të shfrytëzuar asistencën ERDF.

Asistenca ERDF mundet, gjithashtu, të shfrytëzohet për të mbështetur veprimet që kanë të bëjnë me rritjen e kapaciteteve të partnerëve përkatës (shih nenin 7 për partnerët dhe partneritetin) në përputhje me shkronjën "e" të nenit 5(3) CPR dhe për të mbështetur shkëmbimin e praktikave më të mira ndërmjet partnerëve të tillë.

Veprimet e përmendura në këtë paragraf mund të prekin periudhat e mëparshme dhe pasardhëse të programimit.

Neni 23
Tavani

Shuma e asistencës ERDF, e alokuar për asistencë teknike do të limitohet në 6% të shumës totale të alokuar për Programin e bashkëpunimit. Për Programe me alokim total që nuk e kalon 50,000,000 euro, shuma e ERDF-së së alokuar për asistencë teknike do të jetë e limituar në 7% të shumës totale të alokuar për Programin, por nuk duhet të jetë më pak se 1,500,000 euro dhe jo më shumë se 3,000,000 euro.

SEKSIONI IV
PRANUESHMËRIA E SHPENZIMEVE DHE KOHËZGJATJA E OPERACIONEVE

Neni 24
Parimet e pranueshmërisë

1. Në përputhje me nenin 18(2) të Rregullores ETC, hierarkia e rregullave të pranueshmërisë për këtë Program është përcaktuar si më poshtë:

Pa cenuar rregullat e pranueshmërisë të përcaktuara në këtë seksion ose në aktet e deleguara që janë përmendur në nenet 27 dhe 30, vendet pjesëmarrëse në KM duhet të vendosin rregulla shtesë për shpenzimet e pranueshme të Programit në tërësi.

Për çështjet që nuk mbulohen nga rregullat e pranueshmërisë, të përcaktuara në këtë seksion ose në aktet e deleguara që janë përmendur në nenet 27 dhe 30 apo në rregullat e vendosura bashkërisht nga vendet pjesëmarrëse, në përputhje me nënparagrafin e dytë, do të zbatohen rregullat kombëtare të Shtetit Anëtar ose të Përfituesit IPA II ku kanë ndodhur shpenzimet.

2. Një operacion mund të marrë mbështetje nën këtë Program dhe nga instrumente të tjera të Unionit, me kusht që artikujt e shpenzimeve të përfshira në aplikimin e pagesës për rimbursim nga asistenca ERDF, nuk marrin mbështetje nga një instrument tjetër i Unionit ose mbështetje nga asistenca ERDF nën një Program tjetër.

3. Në përputhje me nenin 3(2) të Rregullores (BE) nr. 1301/2013, asistenca ERDF mund të mbështesë ndarjen e instrumenteve dhe burimeve njerëzore, si dhe të gjitha llojet e infrastrukturës përgjatë kufijve nën këtë Program.

4. Përveç neneve 22 dhe 23, me përjashtim të nenit 31, do të zbatohen edhe dispozitat e këtij seksioni për asistencë teknike.

Neni 25

Koha e pranimit

1. Shpenzimet janë të pranueshme për kontribut nga asistenca ERDF, si në Shtetin Anëtar dhe në përfituesin IPA II, nëse janë kryer nga një përfitues dhe janë paguar mes 1 janarit 2014 dhe 31 dhjetorit 2023.

2. Në rast se kostot janë rimbursuar në përputhje me shkronjat "b" dhe "c" të nënparagrafit të parë të nenit 26(2), veprimet që përbëjnë bazën e rimbursimeve duhet të kryhen mes 1 janarit 2014 dhe 31 dhjetorit 2023.

3. Shpenzimet që janë të pranueshme si rezultat i një ndryshimi në Program do të pranohen vetëm nga data e dorëzimit në Komision, të kërkesës për ndryshim ose, në rast të zbatimit të nenit 10(6), nga data e hyrjes në fuqi të vendimit që ndryshon Programin.

Neni 26

Format e mbështetjes; format e granteve dhe asistenca e ripagueshme

1. Asistenca ERDF do të përdoret për mbështetje në formën e granteve, çmimeve dhe asistencës së riparueshme ose si kombinim i tyre.

Në rast të asistencës së riparueshme, mbështetja e ripaguar te organi që e siguroi atë ose te një autoritet tjetër kompetent i Shtetit Anëtar, ose të Përfituesit IPA II, duhet të mbahet në llogari më vete ose veçmas me numër llogarie dhe e ripërdorur për të njëjtin qëllim, ose në përputhje me objektivat e Programit (neni 66 i CPR-së).

2. Grantet dhe asistenca e ripagueshme mund të marrin një nga format e mëposhtme:

a) Rimbursimin e kostove të pranueshme që kanë ndodhur dhe janë paguar, së bashku me, ku është e përshtatshme, kontributet në natyrë dhe në amortizim;

b) Matjet standarde të kostos për njësi;

c) Shuma e përgjithshme nuk e kalon 100,000 euro të kontributit publik;

d) Financim me normë të pandryshueshme, i përcaktuar nga aplikimi i përqindjes në një ose më shumë kategori të dhëna të kostove.

Mundësitë e përmendura në këtë nënparagraf mund të kombinohen vetëm kur secila mundësi mbulon kategori të ndryshme kostosh ose kur ato përdoren për projekte të ndryshme, duke formuar një pjesë të një operacioni ose për faza të njëpasnjëshme të një operacioni.

3. Kur një operacion apo projekt që formon një pjesë të operacionit zbatohet drejtpërsëdrejti nëpërmjet prokurimit publik të punëve, të mirave dhe shërbimeve, do të zbatohet vetëm shkronja "a" e nënparagrafit të parë të paragrafit 2. Kur prokurimi publik për një operacion ose projekt që formon një pjesë të operacionit është i kufizuar në kategori të caktuara kostosh, mund të zbatohen të gjitha mundësitë e referuara në nënparagrafin e parë të paragrafit 2.

4. Shumat e përmendura në shkronjat "b", "c" dhe "d" të nënparagrafit të parë të paragrafit 2 do të caktohen në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) Metodë përllogaritjeje e drejtë, e verifikueshme dhe e arsyeshme, që bazohet në:

i) Të dhëna statistikore ose informacione të tjera rreth objektivave;

ii) Të dhënat historike të verifikueshme të përfituesve individualë; ose

iii) Zbatimi i praktikave të zakonshme për llogaritjen e kostove të përfituesve individualë;

b) Në përputhje me rregullat për zbatimin e matjeve korresponduese të kostove për njësi, shumat e përgjithshme dhe normat e pandryshueshme që zbatohen në politikat e Unionit për lloje të ngjashme operacioni dhe përfituesi;

c) Në përputhje me rregullat për zbatimin e matjeve korresponduese të kostove për njësi, shumat e përgjithshme dhe normat e pandryshueshme që zbatohen sipas skemave për grante të financuara plotësisht nga Shteti Anëtar për lloje të ngjashme operacioni dhe përfituesi;

d) Normat e pranuara në këtë Marrëveshje ose rregullat specifike për Fondin;

e) Metoda të veçanta për përcaktimin e shumave, të pranuara në përputhje me rregullat specifike për Fondin.

5. Lidhur me pranueshmërinë e kontributeve në natyrë, në formën e përgatitjes së punëve, të mirave, shërbimeve, vendit dhe pasurive të patundshme, do të zbatohet neni 69(1) i CPR-së.

6. Kostot e amortizuara mund të merren si të pranueshme në përputhje me nenin 69(2) të CPR-së.

Neni 27

Normat e pandryshueshme për kostot e tërthorta dhe kostot e stafit

1. Kur zbatimi i një operacioni sjell kosto të tërthorta, ato mund të llogariten në bazë të normës së pandryshueshme në një prej mënyrave të mëposhtme:

a) Normë e pandryshueshme deri në 25% të kostove të pranueshme të drejtpërdrejta, me kusht që norma të llogaritet mbi bazën e një metode të drejtë, të arsyeshme dhe të verifikueshme llogaritjeje ose mbi bazën e një metode të zbatuar nën skemat e granteve të financuara plotësisht nga Shteti Anëtar ose Përfituesi IPA II për lloje të ngjashme operacioni dhe përfituesi;

b) Normë e pandryshueshme deri në 15% të kostove të drejtpërdrejta të pranueshme për staf pa ndonjë kërkesë për Shtetin Anëtar ose Përfituesin IPA II që të kryejë llogaritje për të përcaktuar normën e zbatueshme;

c) Normë e pandryshueshme për kostot e drejtpërdrejta të pranueshme bazuar në metodat ekzistuese dhe normat korresponduese, të zbatueshme në politikat e Unionit, për lloje të ngjashme operacioni dhe përfituesi.

Nenet 20 dhe 21 të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 480/2014,[15] që kanë të bëjnë me përkufizimin e normës së pandryshueshme dhe metodat përkatëse të përmendura në shkronjën "c" të nënparagrafit të parë të këtij paragrafi do të zbatohen.

Me qëllim përcaktimin e kostove të stafit për zbatimin e një operacioni, norma për orë mund llogaritet duke pjesëtuar kostot vjetore bruto të dokumentuara për punësimin me 1 720 orë.

2. Kostot e stafit të një operacioni mund të llogariten me normë të pandryshueshme deri në 20% të kostove të drejtpërdrejta, të ndryshme nga kostot e stafit të atij operacioni.

Neni 28

Shpenzimet e papranueshme

1. Asistenca ERDF nuk mbështet:

a) Nxjerrjen jashtë përdorimit ose ndërtimin e stacioneve të energjisë bërthamore;

b) Investimet për të arritur uljen e emetimeve të gazit serrë nga aktivitetet e renditura në shtojcën I të Direktivës 2003/87/KE;

c) Prodhimin, përpunimin dhe marketingun e duhanit dhe produkteve të duhanit;

d) Sipërmarrjet në vështirësi, siç përcaktohet nën rregullat e ndihmës shtetërore të Unionit;

e) Investimet në infrastrukturën aeroportuale, vetëm nëse ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit ose shoqërohet nga investime të nevojshme për të lehtësuar apo për të ulur ndikimin e tij negativ në mjedis;

f) Interesat për borxhe;

g) Blerjen e tokës pa ndërtime dhe të tokës me ndërtime, në shumën deri 10% të shpenzimeve totale të pranueshme për operacionin në fjalë. Për pronat e braktisura dhe ato dikur për shfrytëzim industrial që përbëjnë ndërtesa, ky kufizim rritet në 15%. Në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara qartë, ky kufizim mund të rritet mbi përqindjet përkatëse pararendëse për operacionet që lidhen me mbrojtjen e mjedisit;

h) Taksa e vlerës së shtuar (TVSH), përveç rasteve kur ajo është e parikuperueshme nën legjislacionin kombëtar për TVSH-në.

2. Operacionet nuk do të përzgjidhen për asistencë ERDF kur ato janë plotësuar fizikisht ose zbatuar plotësisht përpara se aplikimi për financim nën Program të dorëzohet nga përfituesi tek autoriteti menaxhues, pavarësisht nëse të gjitha pagesat janë bërë nga përfituesi.

3. Në përputhje me shkronjën "I" të nenit 4 të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 481/2014, taksat për transaksione brenda Shtetit Anëtar ose brenda Përfituesit IPA II nuk janë të pranueshme.

Neni 29

Pranueshmëria në varësi të vendndodhjes

1. Operacionet, që përjashtohen siç përmendet në paragrafët 2 dhe 3 do të pozicionohen në zonën e

[15] Siç është amenduar nga Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) nr. 2015/616, e datës 13 shkurt 2015, që ndryshon Rregulloren Deleguese (BE) nr. 480/2014, lidhur me referencat e përdorura në vazhdim në Rregulloren (BE) nr. 508/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, GZ L 102, 21.4.2015, f. 33.

Programit që përbën pjesën e territorit të vendeve pjesëmarrëse, siç përcaktohet në Program (zona e Programit).

2. Autoriteti menaxhues mund të pranojë që i gjithë operacioni ose pjesërisht të zbatohet jashtë zonës së Programit, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Operacioni të jetë në përfitim të zonës së programit;

b) Shuma totale e alokuar sipas Programit për operacionet jashtë zonës së Programit të mos i kalojë 20% të asistencës ERDF në nivel Programi;

c) Detyrimet e autoriteteve të menaxhimit dhe të auditit lidhur me menaxhimin, kontrollin dhe auditimin e operacionit të përmbushen nga autoritetet e Programit ose të hyjnë në marrëveshje me autoritetet në Shtetin Anëtar ose Përfituesin IPA II ku po zbatohet operacioni.

3. Për operacionet që kanë të bëjnë me asistencën teknike, aktivitetet promocionale dhe ngritjen e kapaciteteve, shpenzimet mund të kryhen jashtë zonës së Programit, me kusht që të plotësohen kriteret në shkronjën "a" dhe "c" të paragrafit 2.

4. Duke pasur parasysh objektivat specifikë të IPA II, të përcaktuara në nenin 3(1) dhe (2), kontributi ERDF nga zëri buxhetor 4 (IPA II), nuk duhet të shpenzohet në zonën e Programit që përbën territorin e Unionit.

Neni 30

Rregullat e veçanta të pranueshmërisë për kategori të caktuara të shpenzimeve

1. Zbatohet Rregullorja e Delegimit e Komisionit (BE) nr. 481/2014[16].

2. Megjithatë, pa cenuar nenin 5(5) deri (8) të kësaj Rregulloreje, zbatohet si më poshtë:

a) Për operacionet në lidhje me asistencën teknike ose aktivitetet promocionale dhe ngritjen e kapaciteteve, shpenzimet e shkaktuara jashtë zonës së Programit janë të pranueshme vetëm nëse janë kryer në përputhje me kushtet e përcaktuara në pikat "a" dhe "c" të nenit 29(2).

b) Në lidhje me persona të tjerë, nga ata që mbulohen nga pikat "d" dhe "e", autoriteti menaxhues mund të pranojë shpenzimet e akomodimit dhe të ushqimit që janë kryer në vende/ose ndërmarrje të vendosura jashtë zonës së Programit, por në një Përfitues IPA II si të pranueshme për kontributin ERDF nga zëri buxhetor 4 (IPA II), gjithmonë nëse ndodhin në përputhje me nenin 29(2). Kjo zbatohet edhe për kostot e transportit lokal në vendin e eventit ose të ndonjë aktiviteti jashtë zonës së Programit, por brenda Unionit.

c) Në lidhje me persona të tjerë, nga ata që mbulohen nga pikat "d" dhe "e", autoriteti menaxhues mund të pranojë shpenzimet e akomodimit dhe të ushqimit që janë kryer në vende/ose ndërmarrje të vendosura jashtë zonës së Programit, por në një Përfitues IPA II, si të pranueshme për kontributin ERDF nga zëri buxhetor 4 (IPA II), nëse ndodhin në përputhje me nenin 29(2) dhe (4). Kjo zbatohet edhe për kostot e transportit lokal në vendin e eventit ose të ndonjë aktiviteti jashtë zonës së Programit, por në një Përfitues IPA II.

d) Për stafin e përfituesve të vendosur jashtë zonës së Programit, por brenda Unionit, autoriteti menaxhues mund të pranojë shpenzimet e përmendura në paragrafin 1, përfshi kostot e udhëtimit për dhe nga vendndodhja e një eventi apo një veprimtarie brenda ose jashtë zonës së Programit, si të pranueshme për kontributin ERDF, nga zëri buxhetor 4 (IPA II), nëse janë bërë në përputhje me nenin 29(2).

e) Për stafin e përfituesve të vendosur jashtë zonës së Programit, por në një Përfitues IPA II, autoriteti menaxhues mund të pranojë shpenzimet e përmendura në paragrafin 1, përfshi kostot e udhëtimit për dhe nga vendndodhja e një eventi apo një veprimtarie brenda ose jashtë zonës së Programit, si të pranueshme për kontributin ERDF nga zëri buxhetor 4 (IPA II), nëse janë bërë në përputhje me nenin 29(2) dhe (4).

f) Për stafin e përfituesve të vendosur brenda zonës së Programit, kostot e referuara në paragrafin 1 të nenit 5 të Rregullores së Delegimit të Komisionit (BE) nr. 481/2014, përfshi kostot e udhëtimit për dhe nga vendndodhja e një eventi apo e një veprimtarie brenda ose jashtë zonës së Programit, konsiderohen të pranueshme për asistencën përkatëse ERDF në përputhje me nenin 29(1).

[16] Rregullorja e Delegimit e Komisionit (BE) nr. 481/2014, e datës 4 mars 2014, që plotëson Rregulloren (BE) nr. 1299/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me rregullat specifike për pranueshmërinë e shpenzimeve për programet e bashkëpunimit, GZ L 138, 13.5.2014 f. 45.

Neni 31

Operacionet që gjenerojnë të ardhura neto pas përfundimit

1. Për sa u përket operacioneve të cilat gjenerojnë të ardhura neto gjatë zbatimit të tyre, zbatohet neni 65(8) CPR.

2. Për sa u përket operacioneve të cilat gjenerojnë të ardhura neto pas përfundimit të tyre, zbatohet neni 61 CPR dhe nënparagrafi i katërt i nenit 65(8) CPR.

Në pajtim me nenet 1 dhe 2 të Rregullores së Delegimit të Komisionit (BE) nr. 2015/1516[17] vendoset një normë e sheshtë prej 20% për operacionet në sektorin e kërkimit, të zhvillimit dhe të inovacionit, siç referohet në pikën "a" të nënparagrafit të parë.

Zbatohen nenet 15 deri 19 të Rregullores së Delegimit të Komisionit (BE) nr. 480/2014,[18] në lidhje me metodën për llogaritjen e të ardhurave neto të zbritura të operacioneve që gjenerojnë të ardhura neto.

Neni 32

Qëndrueshmëria e operacioneve

Në lidhje me qëndrueshmërinë ose kohë-zgjatjen e operacioneve, zbatohet neni 71 i CPR-së.

SEKSIONI V
PROKURIMI NGA PËRFITUESIT E IPA II

Neni 33

Rregullat e zbatueshme të prokurimit

1. Për lidhjen e kontratave të shërbimit, të furnizimit dhe të punës, përfituesit nga IPA II ndjekin procedurat e prokurimit:

a) Dispozitat në nenet 190 dhe 191 të kapitullit 3, të titullit IV, të pjesës së dytë të Rregullores Financiare;

b) Dispozitat e neneve 260–276 të kapitullit 3, të titullit II, të pjesës së dytë të Rregullores së Delegimit (BE) nr. 1268/2012[19].

Veç kësaj, përfituesi IPA II mund të zgjedhë të shfrytëzojë udhëzuesin praktik për procedurat e kontraktimit për aktivitetet e jashtme të BE-së (PRAG) që plotëson dispozitat sipas pikave "a" dhe "b" të nënparagrafit të parë. Versioni i PRAG-ut që do të përdoret është ai që është në fuqi në kohën e inicimit të procedurës përkatëse të prokurimit.

Në përputhje me nenin 18 (5) të Marrëveshjes Kuadër, ligji kombëtar i përfituesit IPA II që transpozon Direktivën 2014/24/BE konsiderohet ekuivalent me rregullat e zbatuara nga Komisioni në pajtim me Rregulloren Financiare. Komisioni informon përfituesin IPA II dhe autoritetin menaxhues në lidhje me vlerësimin e këtij ligji kombëtar dhe fikson një datë kur ky ligj kombëtar mund të fillojë të aplikohet për zbatimin e veprimeve ose të operacioneve në kuadër të Programit.

2. Procedurat e prokurimit publik në lidhje me shpenzimet e lidhura me fazën përgatitore të një operacioni dhe të nisura nga përfituesit përpara dokumentit të grantit të përmendur në nenin 14(7) që i ishin dhënë përfituesit ndjekin, gjithashtu, dispozitat e referuara në paragrafin 1.

3. Procedurat e prokurimit publik, në lidhje me asistencën teknike të financuar si nga zëri buxhetor 1(b) edhe nga zëri buxhetor 4 (IPA II) dhe të zbatuara nga autoritetet e Programit të vendosura në Shtetin Anëtar, ndjekin procedurat kombëtare të prokurimit publik që transpozojnë direktivat e BE-së.

Neni 34

Rregullat mbi kombësinë dhe origjinën

1. Pjesëmarrja në dhënien e kontratave të prokurimit, granteve dhe procedurat e tjera të financimit për veprimet e financuara në kuadrin e Programit, janë të hapura për të gjithë personat fizikë që janë shtetas të

[17] Rregullorja e Delegimit e Komisionit (BE) 2015/15, e datës 10 qershor 2015, që themelon në pajtim me Rregulloren (BE) nr. 1303/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, një normë të sheshtë për operacionet që financohen nga Fondet Strukturore Evropiane dhe të Investimit në sektorin e Kërkimit, Zhvillimit dhe Inovacionit, GZ L 239, 15.9.2015, f. 65.

[18] Rregullorja e Delegimit e Komisionit (BE) nr. 480/2014, e datës 3 mars 2014, që plotëson Rregulloren (BE) nr. 1303/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit që përcakton dispozitat *e përbashkëta* për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian, Fondin e Kohezionit, Fondin Evropian të Bujqësisë për Zhvillimin Rural dhe Fondin Evropian të Marinës dhe Peshkimit dhe që përcakton dispozitat *e përgjithshme* për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian, Fondin e Kohezionit dhe Fondin Evropian të Marinës dhe Peshkimit, GZ L 138, 13.5.2014, f. 5.

[19] Rregullorja e Delegimit e Komisionit (BE) nr. 1268/2012, e datës 29 tetor 2012, mbi rregullat e zbatimit të Rregullores (BE, Euratom) nr. 966/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, mbi rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Unionit, GZ L 362, 31.12.2012, f. 1.

(dhe/ose personat juridikë të cilët janë të vendosur në mënyrë efektive në vendet pjesëmarrëse), shteteve të tjera anëtare, përfituesve të tjerë IPA II, palëve kontraktuese të Marrëveshjes për Zonën Ekonomike Evropiane dhe vendeve partnere që mbulohen nga Instrumenti Evropian i Fqinjësisë (më poshtë referuar si "vendet e pranueshme") dhe për organizatat ndërkombëtare[20].

Personat juridikë mund të përfshijnë organizatat e shoqërisë civile, të tilla si organizatat joqeveritare jofitimprurëse dhe fondacione politike të pavarura, organizatat me bazë komunitare dhe agjencitë jofitimprurëse të sektorit privat, institucionet dhe organizatat, dhe rrjetet e tyre në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, për sa kohë pasi ata janë të aftë për të pasur të drejta dhe detyrime ligjore, në përputhje me ligjet përkatëse kombëtare.

Autoriteti menaxhues mund të lejojë pjesëmarrjen në thirrjen për propozime të subjekteve pa personalitet juridik.

2. Të gjitha pajisjet e blera sipas një kontrate të prokurimit ose në përputhje me një marrëveshje granti, financuar nën IPA II, vijnë ose fillojnë nga një vend i pranueshëm.

Megjithatë, ato mund të vijnë nga çdo vend kur sasia e pajisjeve që do të blihet është nën pragun për përdorimin e procedurës konkurruese me negociata[21]. Për qëllime të këtij neni, termi "origjina" është përkufizuar në nenet 23 dhe 24 të Rregullores së Këshillit (EEC) nr. 2913/92[22].

3. Rregullat sipas këtij neni nuk zbatohen dhe nuk krijojnë kufizime të kombësisë për personat fizikë të punësuar ose përndryshe kontraktuar në mënyrë të ligjshme nga një kontraktor i lejueshëm ose, kur është e zbatueshme, nënkontraktori.

4. Me qëllim promovimin e kapaciteteve lokale, tregjeve dhe blerjeve, prioritet do t'u jepet kontraktorëve lokalë dhe rajonalë kur Rregullorja Financiare parashikon dhënien në bazë të tenderit të vetëm. Në të gjitha rastet e tjera pjesëmarrja e kontraktorëve lokalë dhe rajonalë promovohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Rregullores Financiare.

5. Pranueshmëria, siç përcaktohet në këtë nen, mund të kufizohet më tej në Kushtet e veçanta të kësaj Marrëveshjeje Financimi, në lidhje me kombësinë, me vendndodhjen gjeografike apo me natyrën e kandidatëve, ku kufizime të tilla kërkohen nga natyra specifike dhe objektivat e veprimit dhe ku ato janë të nevojshme për zbatimin efektiv të tij, në mënyrë të veçantë për pjesëmarrjen në procedurat e dhënies, në rast të veprimeve të bashkëpunimit.

6. Ofertuesit, aplikuesit dhe kandidatët nga vendet jo të pranueshme ose, pa cenuar nënparagrafin e dytë të paragrafit 2, mallrat me origjinë jo të pranueshme mund të pranohen si të pranueshme nga autoriteti menaxhues, në rast urgjence apo mospasjes së produkteve dhe shërbimeve në tregjet e vendeve në fjalë ose në raste të tjera të arsyeshme, kur zbatimi i rregullave të përshtatshmërisë do të bëjë realizimin e një projekti, Programi apo veprimi të pamundur apo shumë të vështirë.

7. Personat fizikë dhe juridikë të cilëve u janë dhënë kontratat përputhen me legjislacionin e mjedisit në fuqi, përfshi marrëveshjet shumëpalëshe mjedisore, si edhe standardet themelore të pranuara ndërkombëtarisht të punës[23].

Neni 35

Të drejtat e pronësisë intelektuale

1. Kontratat e lidhura me përfituesit e vendosur në vendin përfitues të IPA II, financuar sipas kësaj Marrëveshjeje Financimi sigurojnë që përfituesi IPA II të marrë të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale të nevojshme, në lidhje me teknologjinë e informacionit, studime, ilustrime, plane, publicitet dhe çdo material tjetër të bërë për qëllime të planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit.

2. Përfituesi IPA II garanton që autoriteti menaxhues, Komisioni ose dikush apo ndonjë person i autorizuar nga Komisioni të ketë akses dhe të drejtën për të përdorur një material të tillë. Komisioni do të përdorë materiale të tilla vetëm për qëllimet e veta.

---

[20] Organizatat ndërkombëtare janë organizatat ndërkombëtare të sektorit publik të përcaktuara nga marrëveshjet ndërqeveritare, agjencitë e specializuara të ngritura nga organizata të tilla dhe organizatat e tjera jofitimprurëse asimiluar në organizatat ndërkombëtare me vendim të Komisionit.

[21] Shih pikën "b"/"ii" të nenit 267(1) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE, Euratom) nr. 1268/2012: Kontratat me vlerë më të vogël se 100 000 euro.

[22] Rregullorja e Këshillit (KEE) nr. 2913/92, 12 tetor 1992, që vendos Kodin Doganor të Komunitetit dhe legjislacionin tjetër të Komunitetit që rregullon origjinën jopreferenciale, GZ L 302, 19 tetor 1992, f. 1.

[23] Standardet themelore të punës - Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), konventat për lirinë e shoqërive dhe negociatat kolektive, eliminimin e detyrueshëm të punës së detyruar, eliminimin e diskriminimit në lidhje me punësimin dhe profesionin dhe heqjen e punës së fëmijëve.

SEKSIONI VI
MENAXHIMI, KONTROLLI DHE PËRCAKTIMI

NËNSEKSIONI 1
PËRCAKTIMI DHE FUNKSIONET E AUTORITETEVE TË PROGRAMIT

Neni 36
Përcaktimi i autoriteteve

1. Vendet pjesëmarrëse në Program kanë caktuar, për qëllimet e nenit 123(1) CPR, një autoritet të vetëm menaxhimi; për qëllim të nenit 123(2) CPR, një autoritet të vetëm certifikues dhe për qëllim të nenit 123 (4) CPR, një autoritet të vetëm të auditimit, siç është përcaktuar në tabelën 21 të nenit 5.1 të Programit.

2. Autoriteti menaxhues nuk është përgjegjës për kryerjen e funksioneve të autoritetit certifikues. Autoriteti certifikues merr pagesat e bëra nga Komisioni dhe si rregull i përgjithshëm bën pagesat për përfituesin kryesor në përputhje me nenin 132 CPR.

3. Procedura për përcaktimin e autoritetit menaxhues dhe, sipas rastit, i autoritetit certifikues, e përcaktuar në nenin 124 CPR, kryhet nga Shteti Anëtar në të cilin autoriteti është i vendosur.

Neni 37
Funksionet e autoritetit menaxhues

1. Pa cenuar paragrafin 2 të këtij neni, autoriteti menaxhues i Programit kryen funksionet e përcaktuara në nenin 125 CPR dhe në nenin 23.

2. Meqë autoriteti menaxhues nuk kryen verifikime sipas pikës "a" të nenit 125(4) CPR, në të gjithë zonën e Programit, çdo Shtet Anëtar ose secili Përfitues IPA II cakton organin ose personin përgjegjës për kryerjen e verifikimeve të tilla, në lidhje me përfituesit në territorin e vet (kontrollor/ët), siç përcaktohet në tabelën 22 të seksionit 5.1 të Programit.

3. Autoriteti menaxhues siguron se shpenzimi i çdo pjesëmarrje përfituese në një operacion është verifikuar nga një kontrollues i përcaktuar.

4. Secili vend pjesëmarrës siguron që shpenzimi i një përfituesi mund të verifikohet brenda një periudhe prej tre muajsh nga dorëzimi i dokumenteve nga ana e përfituesit në fjalë.

5. Çdo vend pjesëmarrës është përgjegjës për verifikimet e kryera në territorin e tij.

6. Kur shpërndarja e produkteve apo e shërbimeve të bashkëfinancuara mund të verifikohet vetëm në lidhje me një operacion të tërë, verifikimi kryhet nga autoriteti menaxhues ose kontrolluesi i Shtetit Anëtar ku përfituesi kryesor ndodhet.

Neni 38
Sekretariati i Përbashkët

Autoriteti menaxhues, pas konsultimit me shtetet anëtare dhe çdo Përfitues IPA II që merr pjesë në një Program bashkëpunimi, ngre një sekretariat të përbashkët, siç është përcaktuar në seksionin 5.2 të Programit.

Neni 39
Funksionet e autoritetit certifikues

Autoriteti certifikues i Programit kryen funksionet e përcaktuara në nenin 126 CPR.

Neni 40
Funksionet e autoritetit të auditimit

1. Shtetet anëtare pjesëmarrëse dhe Përfituesi IPA II mund të autorizojnë autoritetin e auditimit për të kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë funksionet e parashikuara në nenin 127 CPR, në të gjithë territorin e mbuluar nga Programi. Ata specifikojnë se kur autoriteti i auditimit duhet të shoqërohet nga një auditues i një Shteti Anëtar ose Përfituesit IPA II.

2. Kur autoriteti i auditimit nuk ka autorizimin e përmendur në paragrafin 1, ai ndihmohet nga një grup i auditorëve që përbëhet nga një përfaqësues për çdo Shtet Anëtar që merr pjesë ose nga përfituesi IPA II dhe që kryen funksionet e parashikuara në nenin 127 CPR, të renditura në tabelën 22 të seksionit 5.1 të Programit. Çdo Shtet Anëtar ose Përfituesi IPA II është përgjegjës për auditimet e kryera në territorin e vet.

3. Çdo përfaqësues nga një Shtet Anëtar ose nga Përfituesi IPA II është përgjegjës për sigurimin e

elementeve faktike që lidhen me shpenzimet në territorin e tij, të cilat kërkohen nga autoriteti i auditimit për të kryer vlerësimin e tij.

4. Grupi i audituesve duhet të ngrihet brenda tre muajve nga vendimi për miratimin e Programit të bashkëpunimit. Ai harton pikërisht rregullat e procedurës dhe do të kryesohet nga autoriteti i auditimit për Programin e bashkëpunimit.

5. Audituesit janë funksionalisht të pavarur nga kontrollorët që kryejnë verifikimet në bazë të nenit 37.

Neni 41

Funksionet e autoriteteve të Përfituesit IPA II

1. Autoritetet dhe organet e përfituesit IPA II mbështesin Shtetin Anëtar në përgjegjësitë e tij dhe bashkëpunojnë besnikërisht me autoritetet e vetme të Programit.

2. Në përputhje me ligjin e vet kombëtar, Përfituesi IPA II mund të autorizojë autoritetin e auditimit për të kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë funksionet e parashikuara në nenin 127 CPR, në të gjithë territorin e mbuluar nga një program bashkëpunimi. Ai autorizim specifikon se kur autoriteti i auditimit do të shoqërohet nga një auditues i përfituesit IPA II.

Kur autoriteti i auditimit nuk e ka autorizimin e përmendur në nënparagrafin e parë, ai ndihmohet nga një përfaqësues i Përfituesit IPA II në kryerjen e funksioneve të parashikuara në nenin 127 CPR.

Në rastin e përshkruar në nënparagrafin e dytë, Përfituesi IPA II është përgjegjës për auditimet e kryera në territorin e tij.

Përfaqësuesi nga Përfituesi IPA II siguron që puna e auditimit merr parasysh standardet e auditimit të pranuara ndërkombëtarisht.

Përfaqësuesi nga përfituesi IPA II është përgjegjës për sigurimin e elementeve faktike, në lidhje me shpenzimet në territorin e tij, të cilat janë kërkuar nga autoriteti i auditimit për të kryer vlerësimin e tij.

Përfaqësuesi nga vendi Përfitues IPA II është funksionalisht i pavarur nga kontrollues/it që kryejnë verifikimet në bazë të nenit 37.

NËNSEKSIONI 2
MENAXHIMI DHE KONTROLLI

Neni 42

Parimet e përgjithshme të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit

1. Në përputhje me nenin 122(1) CPR, Shteti Anëtar siguron që sistemet e menaxhimit dhe të kontrollit për Programin janë ngritur në përputhje me nenet 72, 73 dhe 74 CPR.

2. Në veçanti, Shteti Anëtar siguron që jo më vonë se 31 dhjetori 2015, të gjitha shkëmbimet e informacionit midis përfituesve dhe një autoriteti menaxhues, një autoriteti certifikues, një autoriteti të auditimit dhe organeve të ndërmjetme të mund të kryhen me anë të sistemeve elektronike të shkëmbimit të të dhënave.

Sistemet e përmendura në nënparagrafin e parë do të lehtësojnë ndërveprimin me kuadrin kombëtar dhe atë të Unionit, duke marrë në konsideratë që përfituesit të paraqesin të gjithë informacionin e referuar në nënparagrafin e parë vetëm një herë.

Në lidhje me shkëmbimin elektronik të informacionit, zbatohen nenet 8 deri 10 të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 1011/2014.

Neni 43

Menaxhimi i përbashkët dhe përgjegjësitë

Në përputhje me parimin e menaxhimit të përbashkët, Shteti Anëtar, përfituesi IPA II dhe Komisioni janë përgjegjës për menaxhimin dhe kontrollin e programeve, në përputhje me përgjegjësitë e tyre përkatëse të përcaktuara në Rregulloren (BE) nr. 1303/2013, Rregulloren Financiare dhe Rregulloren ETC.

Neni 44

Përgjegjësitë e Përfituesit IPA II

KKIPA-ja, siç përcaktohet në përputhje me Marrëveshjen kuadër, është përgjegjës për koordinimin e pjesëmarrjes së përfituesit IPA II në programet përkatëse Interreg. KKIPA-ja mund të delegojë këtë detyrë të koordinimit te një koordinator për bashkëpunim territorial apo strukturë operative sipas rastit.

Neni 45

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Zbatohet neni 75 CPR.

Neni 46

Bashkëpunimi midis Komisionit dhe autoritetit auditues

Zbatohet neni 128 CPR.

Neni 47

Kontrolli proporcional i programeve të bashkëpunimit

Zbatohet neni 148 CPR.

SEKSIONI VII
LLOGARITJA BAZË DHE INTENSITETI I NDIHMËS

Neni 48

Baza për llogaritjen e asistencës ERDF

Vendimi i Komisionit që miraton Programin (shih shtojcat I, II dhe III) përcakton nëse shkalla e bashkëfinancimit për secilin aks prioritar dhe për kontributin nga zëri buxhetor 1(b) dhe kontributin nga zëri buxhetor 4 (IPA II) do të aplikohet, për:

a) Shpenzimet totale të pranueshme, përfshi shpenzimet publike dhe shpenzimet private; ose
b) Shpenzimet e pranueshme publike.

Neni 49

Intensiteti i ndihmës

Shkalla e bashkëfinancimit të Unionit në nivel të secilit aks prioritar të Programit nuk është më pak se 20% dhe jo më e lartë se 85% të shpenzimeve të pranueshme.

Përfituesi IPA II respekton normën minimale të kontributit të tij të përcaktuar në shtojcat I dhe III. Në rast të kontributeve si nga përfituesi IPA II dhe Bashkimit Evropian, kontributi i përfituesit IPA II vihet në dispozicion në të njëjtën kohë si kontributi përkatës nga Unioni.

SEKSIONI VIII
MENAXHIMI FINANCIAR, ANULIMI, SHQYRTIMI DHE PRANIMI I LLOGARIVE, MBYLLJA DHE KORRIGJIMET FINANCIARE.

NËNSEKSIONI 1
ANGAZHIMET DHE PAGESAT

Neni 50

Angazhimet buxhetore

Në lidhje me angazhimet buxhetore, zbatohet neni 76 CPR.

Në veçanti vendimi i Komisionit që miraton Programin përbën një vendim financimi brenda kuptimit të nenit 84 të Rregullores Financiare, duke njoftuar Shtetin Anëtar në fjalë, i cili është angazhim ligjor në kuptim të kësaj rregulloreje.

Neni 51

Rregullat e përbashkëta për pagesat

Në lidhje me rregullat e përbashkëta për pagesat, zbatohet neni 77 CPR.

Në përputhje me nenin 27(1) të Rregullores ETC, asistenca ERDF për Programin paguhet në një llogari të vetme pa nënllogaritë kombëtare.

Në pajtim me nenin 21(2) të Rregullores ETC, autoriteti certifikues merr ose pranon pagesat e bëra nga Komisioni.

Në përputhje me nenin 129 CPR, Shteti Anëtar siguron, që me mbylljen e Programit, shuma e shpenzimeve publike që i paguhet përfituesit është të paktën e barabartë me kontributin e asistencës ERDF, paguar nga Komisioni për Shtetin Anëtar dhe përfituesin IPA II.

Neni 52

Rregullat e përbashkëta për llogaritjen e pagesave të përkohshme dhe pagesën e bilancit përfundimtar

Në lidhje me llogaritjen e pagesave të përkohshme dhe pagesën e bilancit përfundimtar, zbatohen nenet 78 dhe 130 CPR.

Neni 53

Aplikimet e pagesës

1. Për sa i përket pagesës për aplikimet, zbatohen nenet 79(2) dhe 131 CPR.

2. Aplikimet e pagesave dorëzohen në përputhje me modelin e përcaktuar në nenin 6 dhe shtojcën VI të Komisionit për Zbatimin e Rregullores (BE) nr. 1011/2014.

Neni 54

Afatet për paraqitjen e aplikimeve të pagesave të përkohshme dhe për pagesat e tyre

Zbatohet neni 135 CPR.

Neni 55

Pagesat për përfituesit

1. Në pajtim me nenin 21(2) të Rregullores ETC, autoriteti certifikues duhet, si rregull i përgjithshëm, të bëjë pagesat për përfituesit kryesorë në përputhje me paragrafët 2 dhe 3.

2. Në varësi të mundësimit të fondeve nga parafinancimi fillestar dhe vjetor, si dhe pagesat e përkohshme, autoriteti menaxhues siguron që përfituesi të marrë shumën totale të shpenzimeve publike të pranueshme, në mënyrë të plotë dhe jo më vonë se 90 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës për pagesë nga përfituesi.

Asnjë shumë nuk zbritet ose mbahet dhe asnjë pagesë e veçantë apo pagesë tjetër me efekt të njëjtë nuk vendoset, që mund të zvogëlojë shumat e caktuara për përfituesit.

3. Në përputhje me nenin 132(2) CPR, afati i pagesës referuar në paragrafin 2 mund të ndërpritet nga autoriteti menaxhues në njërin nga këto raste të justifikuara siç duhet:

a) Kur shuma e kërkesës për pagesë nuk është caktuar si duhet ose dokumentet mbështetëse të përshtatshme, përfshi dokumentet e nevojshme për verifikime të menaxhimit, sipas shkronjës "a" të nënparagrafit të parë të nenit 125(4) CPR, nuk janë siguruar;

b) Kur ka filluar një hetim në lidhje me ndonjë parregullsi të mundshme që ndikon në shpenzimet në fjalë.

Përfituesi në fjalë informohet me shkrim për ndërprerjen dhe arsyet përse ka ndodhur kjo ndërprerje.

Neni 56

Përdorimi i euros

1. Shumat e përcaktuara në programet e paraqitura nga shtetet anëtare, parashikimet e shpenzimeve, deklaratat e shpenzimeve, aplikimet e pagesës, llogaritë dhe shpenzimet e përmendura në raportet vjetore dhe përfundimtare të zbatimit shprehen në euro.

2. Shtetet anëtare që nuk kanë adaptuar euron si monedhën e tyre në datën e kërkesës për pagesë i kthejnë shumat e shpenzimeve të bëra me monedhë kombëtare në euro.

Kur euroja bëhet monedhë e një Shteti Anëtar, procedura e konvertimit e përcaktuar në nënparagrafin e parë vazhdon të zbatohet për të gjitha shpenzimet e regjistruara në llogaritë nga autoriteti certifikues para datës së hyrjes në fuqi të normës fikse të konvertimit ndërmjet monedhës kombëtare dhe euros.

3. Shpenzimet e bëra në një monedhë të ndryshme nga euro konvertohen në euro nga përfituesit, duke përdorur normën mujore të kursit të këmbimit të Komisionit gjatë muajit në të cilin shpenzimi ishte:

a) Kryer;

b) Paraqitur për verifikim tek autoriteti mena-xhues ose kontrollues, në përputhje me nenin 42(3); ose

c) Raportuar te përfituesi kryesor.

Metoda e zgjedhur për këtë do të përcaktohet në Program dhe është e zbatueshme për të gjithë përfituesit.

Konvertimi verifikohet nga autoriteti menaxhues ose kontrolluesi në Shtetin Anëtar ose te Përfituesi IPA II në të cilin përfituesi ka zënë vend.

Neni 57
Parafinancimi

Zbatohen nenet 81, 82 dhe 134 CPR.

Neni 58
Ndërprerja e afatit të pagesave dhe pezullimi i pagesave

1. Në lidhje me ndërprerjen e pagesave nga ana e Komisionit, zbatohet neni 83 CPR.
2. Në lidhje me pezullimin e pagesave nga Komisioni, zbatohet neni 142 CPR.

NËNSEKSIONI 2
ANULIMI

Neni 59
Parimet

1. Programi i nënshtrohet procedurës së anulimit, e krijuar në bazë të shumave që lidhen me detyrimet, të cilat nuk janë mbuluar nga parafinancimi ose nga aplikimi për pagesat brenda një periudhe të caktuar, duke përfshirë çdo aplikim për pagesë, në të cilin një pjesë ose i gjithë aplikimi është pjesë e ndërprerjes së afatit të pagesës ose e pezullimit të pagesave, të cilat duhet të anulohen.
2. Detyrimi financiar në lidhje me vitin e fundit të periudhës anulohet në përputhje me rregullat që duhen ndjekur për mbylljen e Programit.
3. Pjesa e detyrimeve financiare, ende e hapur, anulohet nëse ndonjë nga dokumentet e kërkuara për mbylljen nuk i është dorëzuar Komisionit brenda afateve të përcaktuara në nenin 60.

Neni 60
Afati për anulimin

1. Komisioni anulon ndonjë pjesë të shumës së Programit:
a) Që nuk është përdorur për pagesën fillestare dhe pagesat e përkohshme dhe vjetore të parafinancimit deri më 31 dhjetor të vitit të tretë financiar, pas angazhimit (detyrimit financiar) të vitit buxhetor sipas programit operativ; ose
b) Për të cilën, aplikimi për pagesat i hartuar në përputhje me nenin 53 nuk është dorëzuar në përputhje me nenin 54.
2. Ajo pjesë e angazhimeve (detyrimeve financiare), që është ende e hapur deri më 31 dhjetor 2023, anulohet nëse ndonjë prej dokumenteve të kërkuara sipas nenit 68 nuk i është paraqitur Komisionit deri më 15 shkurt 2025.

Neni 61
Përjashtimet nga anulimi

Zbatohet neni 87 CPR.

Neni 62
Procedura

1. Komisioni informon Shtetin Anëtar, Përfituesin IPA II dhe autoritetin menaxhues në kohën e duhur, kur ekziston rreziku i zbatimit të rregullit të anulimit sipas nenit 59.
2. Në bazë të informacionit që ka marrë deri më 31 janar, Komisioni informon Shtetin Anëtar, Përfituesin IPA II dhe autoritetin menaxhues mbi shumën e anulimit që rezulton nga ky informacion.
3. Shteti Anëtar ka afat 2 muaj për të rënë dakord mbi shumën që do të anulohet ose për të paraqitur vërejtjet e tij.
4. Deri më 30 qershor, Shteti Anëtar i paraqet Komisionit një plan financimi të rishikuar që pasqyron, për vitin financiar në fjalë, shumën e reduktuar të mbështetjes mbi një ose më shumë prioritete të Programit. Nëse ky parashtrim dështon, Komisioni e rishikon planin e financimit duke ulur asistencën ERDF për vitin financiar në fjalë. Ky reduktim alokohet për secilin prioritet, në mënyrë proporcionale.
5. Komisioni amendon vendimin që miraton Programin, me anë të akteve zbatuese, jo më vonë se data 30 shtator.

NËNSEKSIONI 3
LLOGARITË

Neni 63
Përgatitja, paraqitja, shqyrtimi dhe pranimi i llogarive

1. Në lidhje me përgatitjen, shqyrtimin dhe pranimin e llogarive, zbatohen nenet 84, 137 deri në 139 dhe 141(2) CPR.

2. Llogaritë hartohen në përputhje me nenin 7 dhe shtojcën VII të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 1011/2014.

3. Në përputhje me nenin 139(10) CPR, Shteti Anëtar ose përfituesi IPA II mund të zëvendësojë sasi të parregullta të cilat janë zbuluar pas paraqitjes së llogarive, duke bërë rregullimet përkatëse në llogaritë për vitin e kontabilitetit në të cilin parregullsia është zbuluar, pa cenuar nenet 73 dhe 74 të CPR-së.

4. Në përputhje me nenin 141(1) CPR, përveç dokumenteve të përmendura në nenin 138 CPR, për vitin e fundit të kontabilitetit, nga 1 korriku 2023 deri më 30 qershor 2024, autoriteti menaxhues paraqet një raport përfundimtar të zbatimit për Programin.

Neni 64
Mundësimi i dokumenteve

Në lidhje me detyrimet e autoritetit menaxhues për të mundësuar dokumentet, zbatohen dispozitat e nenit 140 CPR.

NËNSEKSIONI 4
KORRIGJIMET FINANCIARE DHE RIKUPERIMET NGA VENDET PJESËMARRËSE

Neni 65
Përgjegjësitë e vendeve pjesëmarrëse

1. Vendet pjesëmarrëse parandalojnë, zbulojnë dhe korrigjojnë parregullsitë dhe rikuperojnë shumat e paguara padrejtësisht, së bashku me ndonjë interes për pagesat e vonuara.

2. Vendet pjesëmarrëse janë në radhë të parë përgjegjëse për investigimin e parregullsive dhe kryerjen e korrigjimeve financiare të nevojshme dhe mbulimin e shpenzimeve. Në rastin e një parregullsie sistematike, vendi pjesëmarrës e shtrin hetimin për të mbuluar të gjitha operacionet që mund të preken.

3. Vendet pjesëmarrëse bëjnë korrigjimet financiare që kërkohen, në lidhje me parregullsitë individuale ose sistematike të zbuluara në operacionet ose në Program. Korrigjimet financiare konsistojnë në anulimin e të gjithës ose të një pjese të kontributit publik për një operacion apo në Program. Vendet pjesëmarrëse marrin parasysh natyrën dhe seriozitetin e parregullsive, humbjen financiare në asistencën ERDF dhe zbatojnë korrigjimin proporcional. Korrigjimet financiare regjistrohen në llogaritë për vitin kontabël në të cilin është vendosur anulimi.

4. Kontributi nga asistenca ERDF, i anuluar në përputhje me paragrafin 3, mund të ripërdoret nga vendet pjesëmarrëse në kuadër të Programit në fjalë, objekt i paragrafit 5.

5. Kontributi i anuluar në përputhje me paragrafin 3 nuk mund të ripërdoret për ndonjë operacion që ka qenë objekt i korrigjimit, kur korrigjimi financiar është bërë për një parregullsi sistematike ose për ndonjë operacion të prekur nga parregullsia sistematike.

Neni 66
Njoftimi i parregullsive

1. Parregullsitë i njoftohen Komisionit në përputhje me nënparagrafin e parë, të dytë dhe të tretë të nenit 122 (2) CPR.

2. Zbatohet Rregulloja e Delegimit të Komisionit (BE) nr. 2015/197022/1970[24], e cila përcakton rregulla të detajuara shtesë mbi kriteret e përcaktimit të rasteve të parregullsive që do të raportohen dhe të dhënave që do të sigurohen.

Në pajtim me nenin 3(4) të Rregullores së Delegimit (BE) nr. 2015/1970, parregullsitë raportohen nga Shteti Anëtar apo Përfituesi IPA II në të cilin shpenzimet janë paguar nga përfituesi për zbatimin e operacionit.

[24] Rregullorja e Delegimit e Komisionit (BE) 2015/1970, e 8 korrikut 2015, që plotëson Rregulloren (BE) nr. 1303/2013 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian, me dispozitat specifike për raportimin e parregullsive që lidhen me Fondin e Zhvillimit Rajonal Evropian, Fondin Social Evropian, Fondin e Kohezionit dhe Fondin Detar dhe të Peshkimit Evropian, GZ L 293, 10.11.2015, f. 1.

Shteti Anëtar ose Përfituesi IPA II informon autoritetin menaxhues, autoritetin certifikues për Programin, autoritetin e auditimit, si dhe kontrolluesin kombëtar siç referohet në nenin 37(2) dhe përfaqësuesin e tij në grupin e audituesve siç referohet në nënparagrafin e dytë të nenit 40(1).

3. Zbatohet Rregullorja e Zbatimit të Komisionit (BE) nr. 2015/1974[25], e cila përcakton shpeshtësinë dhe formatin që duhet të ndjekin raportimet e parregullsive.

Neni 67

Rikuperimet

1. Në përputhje me nenin 27(2) të Rregullores ETC, autoriteti menaxhues siguron që çdo shumë e paguar si rezultat i parregullsive rikuperohet nga përfituesi lider ose i vetëm. Përfituesit i ripaguajnë përfituesit lider çdo shumë të paguar tepër ose padrejtësisht.

2. Në përputhje me nenin 27(3) të Rregullores ETC, nëse përfituesi kryesor nuk ka sukses në sigurimin e shlyerjes nga përfituesit e tjerë apo nëse autoriteti menaxhues nuk do të ketë sukses në sigurimin e shlyerjes nga përfituesi kryesor ose i vetëm, vendi pjesëmarrës në territorin e të cilit përfituesi në fjalë është vendosur ose është regjistruar, në rastin e një EGTC-je - i rimburson autoritetit menaxhues çdo shumë të paguar tepër/padrejtësisht atij përfituesi. Autoriteti menaxhues është përgjegjës për rimbursimin e shumave në fjalë për buxhetin e përgjithshëm të Unionit, në përputhje me metoda e ndarjes së detyrimeve midis vendeve pjesëmarrëse, siç përcaktohet në Program.

3. Në pajtim me fjalinë e dytë të paragrafit të katërt të nenit 122(2) CPR, vendet pjesëmarrëse mund të vendosin të mos rikuperojnë shumën e paguar tepër, nëse shuma që do të mbulohet nga përfituesi, pa përfshirë interesin, nuk i kalon 250 euro kontribut nga asistenca ERDF.

4. Rregulloja e Delegimit të Komisionit (BE) nr. 2016/568[26], e cila përcakton rregulla të detajuara shtesë për kushtet dhe procedurat që do të zbatohen për të përcaktuar nëse shumat të cilat janë të pakthyeshme do të rimbursohen.

NËNSEKSIONI 5
KORRIGJIMET FINANCIARE NGA KOMISIONI

Neni 68

Fushëveprimi, kriteret dhe procedura

1. Komisioni bën korrigjime financiare në përputhje me nenin 85(1), (2) dhe (3) CPR, duke anuluar të gjithë ose një pjesë të asistencës ERDF për Programin dhe ndikon në rikuperimin nga Shteti Anëtar dhe Përfituesi IPA II, duke përjashtuar financimin e shpenzimeve nga BE, që është në kundërshtim me ligjin në fuqi.

2. Në përputhje me nenin 85(4) CPR, në lidhje me kriteret për korrigjimet financiare zbatohen dispozitat e nenit 144(1) deri (5) CPR.

3. Nenet 30 dhe 31 të Rregullores së Delegimit të Komisionit (BE) nr. 480/2014, në lidhje me korrigjimet financiare zbatohen nga Komisioni për sistemet e mangësive.

4. Në lidhje me procedurën, zbatohen dispozitat e nenit 145(1) deri (7) CPR.

5. Për sa u përket pagesave, zbatohen dispozitat e nenit 147 CPR.

Neni 69

Detyrimet e vendeve pjesëmarrëse

Në përputhje me nenin 146 CPR, korrigjimi financiar nga Komisioni nuk cenon detyrimin e vendeve pjesëmarrëse për të ndjekur rikuperimet, sipas nenit 67(2) dhe shtetet anëtare për të rikuperuar ndihmën shtetërore, në kuptim të nenit 107(1) TFEU dhe në bazë të nenit 14 të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 659/1999[27].

---

[25] Rregullorja e Zbatimit e Komisionit (BE) 2015/1974, e 8 korrikut 2015, që përcakton frekuencën dhe formatin e raportimit të parregullsive, në lidhje me Fondin e Zhvillimit Rajonal Evropian, Fondin e Ndihmës Sociale, Fondin e Kohezionit dhe Fondin Detar dhe të Peshkimit Evropian, nën Rregulloren (BE) nr. 1303/2013 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian, GZ L 293, 10.11.2015, f. 20.

[26] Rregullorja e Delegimit e Komisionit (BE) nr. 2016/568, e 29 janarit 2016, që plotëson Rregulloren (BE) nr. 1303/2013 të Këshillit dhe të Parlamentit Evropian në lidhje me kushtet dhe procedurat, për të përcaktuar nëse shumat të cilat janë të pakthyeshme do të rimbursohen nga shtetet anëtare, lidhur me Fondin e Zhvillimit Rajonal Evropian, Fondin Social Evropian, Fondin e Kohezionit dhe Fondin Detar dhe të Peshkimit Evropian, GZ L 97, 13 prill 2016, f. 1.

[27] Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 659/1999, e 22 marsit 1999, që përcakton rregulla të hollësishme për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të KE, GZ L 83, 1999/03/27, f. 1.

SEKSIONI IX
NDËRPRERJA E PROGRAMIT DHE PROBLEMET E ZBATIMIT

Neni 70
Mosnënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

Kur përfituesi IPA II nuk e ka nënshkruar këtë Marrëveshje Financimi deri në fund të vitit pas vitit të miratimit të Programit ose ndryshimit të Programit në mënyrë që të përfshijë edhe asistencën ERDF në favor të tij, Komisioni mund t'i propozojë KM-së një amendament për Programin, me qëllim për të ndërprerë pjesëmarrjen e përfituesit IPA II në program, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 10(4).

Për nenin 71(2) deri (4) zbatohet *mutatis mutandis* (pasi të jenë bërë ndryshimet e nevojshme).

Neni 71
Problemet e zbatimit

1. Kur ajo pjesë e asistencës ERDF të Programit në lidhje me një përfitues në Përfituesin IPA II nuk mund të zbatohet për shkak të problemeve që dalin në marrëdhëniet mes vendeve pjesëmarrëse, si dhe në raste të tjera të justifikuara siç duhet, Komisioni mund t'i propozojë KM-së një amendament për Programin, me qëllim për të ndërprerë pjesëmarrjen e përfituesit IPA II në program, para datës së skadimit të periudhës së ekzekutimit, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 10(4).

2. Kur ndërpritet pjesëmarrja e përfituesit IPA II në Program, autoriteti menaxhues përcjell raportin përfundimtar brenda gjashtë muajve pas vendimit të Komisionit. Pas likuidimit të pagesave të mëparshme të parafinancimit, Komisioni paguan bilancin përfundimtar ose, kur është e nevojshme, nxjerr urdhrin e rikuperimit. Komisioni, gjithashtu, anulon bilancin e angazhimeve.

3. Ajo pjesë e asistencës ERDF në lidhje me një përfitues në Përfituesin IPA II, tashmë subjekt i një dokumenti të granteve pa asnjë kusht, në pajtim me nënparagrafin e dytë të nenit 12(7), i paguhet autoritetit menaxhues nëse nuk është paguar në lidhje me detyrimet kontraktuale të përfituesit të kontraktuara para vendimit të ndërprerjes nga Komisioni.

4. Ajo pjesë e asistencës ERDF, në lidhje me një përfitues në një Shtet Anëtar, tashmë subjekt i një dokumenti të grantit, mbetet në dispozicion për kohëzgjatjen e saj normale, por mund të përdoret vetëm për aktivitete që ndodhin vetëm në Shtetin Anëtar në fjalë dhe të kontraktuar para vendimit të ndërprerjes nga Komisioni.

5. Si një zgjidhje alternative mund të vendoset të reduktohen alokimet e Programit në lidhje me pjesëmarrjen e përfituesit IPA II në fushën e Programit, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 10(4).

SEKSIONI X
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 72
Konsultimi ndërmjet vendeve pjesëmarrëse dhe Komisionit

1. Përfituesi IPA II dhe Komisioni konsultohen me njëri-tjetrin para se të hyjnë në ndonjë mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi edhe më tej, në përputhje me nenin 76 të këtyre Kushteve të përgjithshme ose të ndonjë mosmarrëveshjeje lidhur me interpretimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi që nuk mund të zgjidhet në përputhje me nenin 3 të Kushteve të veçanta.

2. Kur Komisioni bëhet me dije për problematikat në kryerjen e procedurave, në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, për sa i përket Përfituesit IPA II, ai krijon të gjitha kontaktet e nevojshme me Përfituesin IPA II për të përmirësuar situatën dhe për të ndërmarrë masa apo hapa që janë të nevojshëm.

3. Konsultimi mund të çojë në një amendim, pezullim ose përfundimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

4. Komisioni dhe Përfituesi IPA II e mbajnë Shtetin Anëtar të informuar në lidhje me konsultimet ose kontaktet, sipas paragrafëve 1 dhe 2.

5. Komisioni konsultohet me Shtetin Anëtar para se të merret ndonjë masë e listuar në paragrafin 3.

Neni 73
Amendimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Pa cenuar paragrafin 6, kjo Marrëveshje Financimi ndryshohet siç përcaktohet në paragrafët 2 deri 5.

2. Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje Financimi duhet të bëhet në formë të shkruar.

3. Në rast se ndonjë prej vendeve pjesëmarrëse kërkon një ndryshim, kjo kërkesë duhet t'i përcillet Komisionit, të paktën gjashtë muaj para hyrjes në fuqi të këtij ndryshimi.

4. Në rast se Komisioni vjen në dijeni të një mospërputhjeje midis dispozitave të Marrëveshjes së Financimit dhe të akteve bazë të renditura në nenin 1 të Kushteve të veçanta, Komisioni propozon përafrimin e nevojshëm të kësaj Marrëveshjeje Financimi me dispozitat e akteve themelore.

Në rast të një ndryshimi në një akt themelor, Komisioni propozon përafrimin e nevojshëm të kësaj Marrëveshjeje Financimi me dispozitat e ndryshuara të akteve themelore, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e tij.

5. Ndryshimet në Rregulloren e Zbatimit (BE) nr. 2015/207, për sa u përket modeleve të ndryshme, nuk kërkojnë ndryshime në këtë Marrëveshje Financimi. Përfituesi IPA II informohet me shkrim për çdo amendament të tillë dhe hyrjes së tij në fuqi.

6. Autoriteti menaxhues njofton Komisionin me shkrim, për çdo vendim që ndryshon (shtojca V), (dokumenti specifik i përmendur në nenin 10 të Kushteve të veçanta), brenda një muaji nga data e këtij vendimi ndryshues. Vendimi për ndryshimin specifikon datën e hyrjes së tij në fuqi. Komisioni do të pranojë marrjen e këtij njoftimi me shkrim.

Në rastin e një amendamenti të kësaj Marrëveshjeje Financimi, në përputhje me paragrafët 2 deri 5, (shtojca V), (referenca në dokumentin e veçantë të përmendur në nenin 10 të Kushteve të veçanta), zëvendësohet me versionin më të ri të njoftuar Komisionit.

Neni 74

Pezullimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Marrëveshja e Financimit mund të pezullohet në rastet e mëposhtme:

a) Në rast se përfituesi IPA II shkel ndonjë prej detyrimeve të kësaj Marrëveshjeje Financimi;

b) Në rast se përfituesi IPA II shkel ndonjë prej detyrimeve të përcaktuara në dokumentet procedurale dhe standarde, sipas nenit 18, pika 2, të Marrëveshjes Kuadër;

c) Në rast se përfituesi IPA II nuk plotëson kërkesat për ngarkimin e detyrave të zbatimit të buxhetit;

d) Në rast se përfituesi IPA II vendos të pezullojë ose të heqë dorë nga procesi i anëtarësimit në BE;

e) Në rast se përfituesi IPA II shkel detyrimin lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut, parimet e demokracisë dhe të mbizotërimit të ligjit ose në raste të rënda korrupsioni.

2. Kjo Marrëveshje Financimi mund të pezullohet në rastet e *forcës madhore*, siç përcaktohet më poshtë:

"Forcë madhore" do të thotë çdo situatë e paparashikueshme dhe e jashtëzakonshme ose ngjarje që shkon përtej kontrollit të palëve dhe që pengon secilën prej tyre të përmbushë detyrimet e saj, që nuk mund të lidhet me gabime ose neglizhencë nga ana e tyre (e kontraktuesve, agjentëve ose punonjësve) dhe vërtetohet të ketë qenë e pashmangshme edhe pse është përdorur i gjithë kujdesi i mundshëm. Defektet në pajisje ose në materiale, ose vonesat në sigurimin e tyre, mosmarrëveshjet e punës, grevat ose vështirësitë financiare, nuk mund të konsiderohen si *forcë madhore*. Një nga palët nuk mund të konsiderohet të ketë shkelur detyrimet e saj nëse ajo është penguar nga përmbushja e tyre nga rastet e *forcës madhore* nga të cilat pala tjetër është informuar në kohë. Një palë e prekur nga *forca madhore* duhet të informojë palën/palët e tjera pa vonesë, duke deklaruar natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikueshme të problemit dhe të marrë çdo masë për të minimizuar dëmet e mundshme. Në rast se *forca madhore* ndikon vetëm pjesë të Programit, pezullimi i Marrëveshjes së Financimit mund të jetë i pjesshëm.

Asnjë prej Palëve nuk mund të konsiderohet të ketë shkelur detyrimet e saj në kuadër të kësaj Marrëveshjeje Financimi, në rast së është detyruar nga *forca madhore*, me kusht që të marrë masa për të minimizuar ndonjë dëmtim të mundshëm.

3. Komisioni mund të pezullojë këtë Marrë-veshje Financimi pa njoftim paraprak.

4. Komisioni duhet të ndërmarrë çdo masë të nevojshme para se pezullimi të hyjë në fuqi.

5. Në rastet kur njoftohet pezullimi, duhet të saktësohen pasojat mbi prokurimet ose kontratat e grantit, në zbatim ose në fazë nënshkrimi, si dhe të përcaktohen marrëveshjet e delegimit.

6. Pezullimi i kësaj Marrëveshje nuk cenon ndërprerjen e pagesave në përputhje me nenin 58 dhe me përfundimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi nga Komisioni sipas nenit 75.

7. Palët mund të rifillojnë zbatimin e Marrë-veshjes së Financimit në rast se kushtet do ta lejojnë dhe vetëm me miratimin paraprak në formë të shkruar nga Komisioni. Kjo nuk cenon asnjë ndryshim të kësaj Marrëveshjeje Financimi që do të rezultojë i nevojshëm për të përshtatur Programin me kushtet e reja të zbatimit, përfshirë, në rast se është e mundur, kohëzgjatjen e periudhës së lejueshmërisë ose përfundimin e

kësaj Marrëveshjeje Financimi në përputhje me nenin 75.

Neni 75

Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Në rast se çështjet që kanë sjellë në pezullimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi nuk zgjidhen brenda një periudhe maksimale prej 180 ditësh, secila nga Palët mund të përfundojë Marrëveshjen e Financimit pas 30 ditëve nga njoftimi.

2. Kjo Marrëveshje Financimi duhet të përfundohet automatikisht në rastet kur brenda periudhës 2-vjeçare nga nënshkrimi i saj:

a) Nuk është kryer asnjë pagesë;

b) Nuk është nënshkruar ndonjë kontratë zbatimi ose marrëveshje delegimi.

3. Në rastet kur përfundimi është njoftuar, duhet të përcaktohen pasojat për prokurimet dhe kontratat e grantit në zbatim, marrëveshjet e delegimit dhe për kontratat e grantit ose marrëveshjet e delegimit në fazë nënshkrimi.

4. Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi nuk përjashton mundësinë e Komisionit për të bërë korrigjime financiare në përputhje me nenin 68.

Neni 76

Dispozitat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

1. Në rast se mosmarrëveshjet lidhur me këtë Marrëveshje Financimi nuk mund të zgjidhen brenda një periudhe 6-mujore, nëpërmjet konsultimit midis palëve sipas nenit 72, duhet të dorëzohen në juridiksionin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Nëse një vend Përfitues IPA II nuk e pranon një juridiksion të tillë dhe vetëm në këtë rast, mosmarrëveshja paraqitet për procedurë arbitrazhi.

2. Secila prej palëve duhet të caktojë një arbitër brenda 30 ditëve nga kërkesa për arbitrazh. Nëse kjo nuk arrihet, secila palë cakton arbitrin e vet: pas kësaj, të dy arbitrat nga ana e tyre caktojnë një arbitër të tretë brenda 30 ditëve. Me përjashtim kur arbitrat vendosin ndryshe, duhet të zbatohet procedura e përcaktuar në Rregulloren Opsionale të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit që përfshin organizatat ndërkombëtare dhe shtetet. Vendimet e arbitrave duhet të merren me shumicë brenda një periudhe tremujore.

3. Secila prej palëve është e detyruar të marrë masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve të arbitrave.

BASHKËPUNIMI TERRITORIAL EVROPIAN
INTERREG V- B PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT MESDHETAR (MED)
2014–2020
NR. 2014TC16M4TN001

PROGRAMI BASHKËFINANCOHET NGA FONDI EVROPIAN I ZHVILLIMIT RAJONAL (ERDF)

CCI	2014TC16M4TN001
TITULLI	INTERREG V-B MEDITERRANEAN (MED) PROGRAM BASHKËPUNIMI 2014–2020
VERSIONI	1.2
VITI I PARË	2014
VITI I FUNDIT	2020
I PRANUESHËM NGA	1 JANAR 2014
I PRANUESHËM DERI	31 DHJETOR 2023
NUMRI I VENDIMIT TË KE-së	C (2015) 3576
DATA E VENDIMIT TË KE-së	2 QERSHOR 2015
NUMRI I VENDIMIT TË AMENDIMIT TË SHTETIT ANËTAR	
DATA E VENDIMIT TË AMENDIMIT TË SHTETIT ANËTAR	
DATA E HYRJES NË FUQI TË VENDIMIT TË AMENDIMIT TË SHTETIT ANËTAR	

RAJONET NUTS TË MBULUARA NGA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT

AL - SHQIPËRIA
BA - BOSNJA DHE HERCEGOVINA
CYOO - Kunpoc; (Qipro)
EL11 - AvaroAiKii MotKsSovia, 0paKr| (Anatoliki Makedonia, Thraka)
EL12 - KsvipiKii MaKsSovia Maqedonia Qendrore)
EL13 - AuiiKii MaKsSovia (Dytiki Makedonia)
EL14 - 08ooa\ia (Thessalia)
EL21 - 'Hnsipot (Ipeiros)
EL22 - lovia Npaia (Ionia Nisia)
EL23 - AuiiKii EWaSa (Dytiki Ellada)
EL24 - Zispsa EAAaSa (Sterea Ellada)
EL25 - neXonownooc; (Peleponezi)
EL30 - ArriKri (Atika)
EL41 - Bops 10 Aiyaio (Voreio Aigaio)
EL42 - NOTIO Aiyaio (Notio Aigaio)
EL43 - Kpniri (Kriti)
ES51 - Cataluna
ES52 - Comunidad Valenciana
ES53 - llles Balears
ES61 - Andalucfa
ES62 - Region de Murcia
ES63 - Ciudad Autonoma de Ceuta
ES64 - Ciudad Autonoma de Melilla
FR62 - Midi-Pyrenees
FR81 - Languedoc-Roussillon
FR82 - Provence-Alpes-Cote d'Azur
FR83 - Corse
HR03 - Jadranska Hrvatska
HR04 - Kontinentalna Hrvatska
ITC2 - Valle d'AostaA/allee d'Aoste
ITC4 - Lombardia
ITF1 - Abruzzo
ITF2 - Molise
ITF5 - Basilicata ITF6 - Calabria
ITH3 - Veneto
ITH4 - Friuli-Venezia Giulia
ITH5 - Emilia-Romagna
ITI3 - Marche
ME - MAL I ZI
MTOO - Malta
5101 - Vzhodna Slovenija
5102 - Zahodna Slovenija
5103 UKZZ - Extra-Regio NUTS 2

AKRONIMET

AA	Autoriteti auditues
AC	Autoriteti certifikues
PB	Programi i bashkëpunimit
CSG	Udhëzimet strategjike të komunitetit
ENI	Instrumenti Evropian i Fqinjësisë
ERDF	Fondi Evropian i Zhvillimit Rajonal
VSHB	Vlera e shtuar bruto

TIK	Teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit
IPA	Instrumenti për asistencën e paraanëtarësimit
SP	Sekretariati i Përbashkët
AM	Autoriteti menaxhues
PKK	Pika kombëtare e kontaktit
VMS	Vlerësimi mjedisor strategjik
SME	Ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha
SWOT (analiza)	Pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet

HYRJE

Programi transkombëtar MED mbështet shkëmbimet e përvojave, njohurive dhe përmirësimin e politikave publike ndërmjet autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale, si dhe aktorëve të tjerë territorialë të zonës MED të rajoneve të lejueshme. Programi është dygjuhësh (anglisht dhe frëngjisht)

Ai përfshin 57 rajone nga 10 vende të ndryshme të BE-së dhe 3 vende kandidate.

Programi bashkëfinancohet nga Fondi Evropian për Zhvillimin Rajonal (ERDF) dhe buxheti total i tij është 224,332,525 milionë EUR, për periudhën 2014–2020.

Qëllimi kryesor i tij është kontributi në zhvillimin afatgjatë të zonës së Mesdheut dhe forcimi i bashkëpunimit transkombëtar ndërmjet rajoneve dhe vendeve pjesëmarrëse.

Ky Program merr në konsideratë përvojën e periudhës 2007–2013, rezultatet e vlerësimit *in itinere* dhe kapitalizimin e arritjeve të përgjithshme të Programit.


Seksioni i parë i Programit të bashkëpunimit pasqyron një pamje të përgjithshme të përmbajtjes së Programit në lidhje me rregullat, nevojat territoriale dhe politike, si dhe sfidat dhe mësimet nga periudha e mëparshme programuese. Ai prezanton strategjinë e përgjithshme dhe objektivat e Programit.

Mbulimi gjeografik.

Në zbatim të vendimi të Komisionit për hartimin e listës së rajoneve të përshtatshme dhe zonave që janë objektiv i bashkëpunimit territorial evropian, Programi MED mbulon zonat e mëposhtme:

a) Vendet anëtare:

- Qipro: Gjithë shteti
- Franca: 5 rajone: *Corse, Languedoc-Roussillon, Midi-Pyrenees, Provence Alpes Cote d'Azur, Rhone-Alpes*
- Greqia: Gjithë shteti
- Italia: 19 rajone: *Abruzzo, Apulia, Basilicata, Calabria, Campania, Emilia-Romagna, Friuli-Venezia Giulia, Lazio, Liguria, Lombardy, Marche, Molise, Piedmonte, Sardinia, Sicily - Tuscany, Umbria, Valle D'Aosta, Veneto*
- Malta: Gjithë shteti
- Portugalia: 3 rajone: *Algarve, Alentejo, Area Metropolitana de Lisboa*
- Sllovenia: Gjithë shteti (Sllovenia Perëndimore dhe Lindore)
-Spanja: 6 rajone autonome: *Andalusia, Aragon, Catalonia, Balearic islands, Murcia, Valencia* dhe 2 qytete autonome - *Ceut*a dhe *Melilla*
- Mbretëria e Bashkuar: 1 rajon i programimit ekonomik - Gjibraltari
- Kroacia - Gjithë shteti



b) Shtetet partnere

Programi ka ftuar, gjithashtu, vendet mesdhetare potenciale kandidate ose kandidate të Bashkimit Evropian për t'iu bashkuar Programit. Këto vende marrin pjesë nëpërmjet fondeve Evropiane IPA (Instrumenti i paraanëtarësimit). Zonat e lejueshme kështu, përfshijnë vendet IPA në vazhdim bashkë me gjithë territorin e tyre:

- Shqipëria;
- Bosnja dhe Hercegovina;
- Mali i Zi.

Për më tepër, sipas nenit 20 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013, në kontekstin e programeve të bashkëpunimit dhe në rastet e justifikuara siç duhet, autoriteti menaxhues mund të pranojë që i gjithë operacioni ose një pjesë e tij mund të zbatohet jashtë pjesës së Unionit të zonës së programit, por duke u siguruar që të respektohen kushtet e nenit 20 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013.

Shuma totale e alokuar nën Programin e bashkëpunimit për operacionet e lokalizuara jashtë pjesës së Unionit të zonës së Programit, nuk duhet të kalojë 20% të mbështetjes nga ERDF-ja në nivel programi. Pragu prej 20% i ERDF-së do të aplikohet në nivel projekti në mënyrë që çdo projekt mund të përfitojë nga kjo masë.

SEKSIONI 1
STRATEGJIA PËR KONTRIBUTIN E PROGRAMIT TË BASHKËPUNIMIT PËR STRATEGJINË E UNIONIT PËR NJË RRITJE "TË ZGJUAR", TË QËNDRUESHME DHE GJITHËPËRFSHIRËSE, SI DHE ARRITJEN E KOHEZIONIT EKONOMIK, SOCIAL DHE TERRITORIAL

Referenca: Neni 27(1) i Rregullores (BE) nr. 1303/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit[28] dhe pika "a" e nenit 8(2)

[28] Rregullorja (BE) nr. 1303/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 17 dhjetorit 2013, që parashikon dispozitat e përbashkëta për ERDF-në, Fondin Social Evropian, Fondin e Kohezionit, Fondin Bujqësor Evropian për Zhvillimin Rural dhe Fondin Evropian për Detin dhe Peshkimin, që parashikon dispozitat e përgjithshme të ERDF-së, Fondin Social Evropian, Fondit të Kohezionit Fondin Bujqësor

1.1 Strategjia për kontributin e Programit të bashkëpunimit për strategjinë e Unionit për një rritje "të zgjuar", të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, si dhe arritjen e kohezionit ekonomik, social dhe territorial

1.1.1 Përshkrimi i strategjisë së Programit të bashkëpunimit për të kontribuar në shpërndarjen e strategjisë së Unionit për një rritje "të zgjuar", të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, si dhe arritjen e kohezionit ekonomik, social dhe territorial

1.1.1.1 Përmbajtja e Programit

Programi MED është një nga instrumentet për zbatimin e politikës së kohezionit të Bashkimit Evropian. Nëpërmjet kësaj politike, BE-ja ndjek zhvillimin harmonik të Unionit, duke forcuar kohezionin e tij ekonomik, social dhe territorial, në mënyrë që të stimulojë rritjen në rajonet e BE dhe në vendet pjesëmarrëse.

Politika ka si qëllim të reduktojë pabarazitë ekzistuese midis rajoneve të BE-së në lidhje me zhvillimin e tyre ekonomik dhe social, si dhe qëndrueshmërinë mjedisore, duke marrë parasysh mundësitë dhe tiparet e tyre specifike territoriale. Në termat e zhvillimit ekonomiko-social, programet duhet të marrin në konsideratë pasojat e krizës ekonomike, e cila ndryshoi situatën për shumë operatorë ekonomikë, për popullsinë, për institucionet publike lokale ose rajonale të cilat u përballën me kufizime buxheti.

Nga pikëpamja strategjike, orientimet e përgjithshme për vitet në vazhdim janë përcaktuar në strategjinë "Evropa 2020", e cila ka si qëllim ta kthejë BE-në në një ekonomi "të zgjuar", të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, të aftë për të garantuar nivel të lartë punësimi, produktiviteti dhe kohezioni social. Strategjia "Evropa 2020" është një agjendë për të gjithë Unionin, duke marrë parasysh pikat e ndryshme të nisjes së shteteve anëtare, nevojat dhe veçantitë për të promovuar rritjen për të gjithë Bashkimin Evropian. Strategjia "Evropa 2020" ka tri prioritete përforcuese të përbashkëta:

- Rritje "të zgjuar": Zhvillimi i një ekonomie bazuar në njohurinë dhe inovacionin;
- Rritje e qëndrueshme: Promovimi i një ekonomie më efikase të bazuar në burimet, më konkurruese dhe më e gjelbër;
- Rritje gjithëpërfshirëse: Nxitja e një ekonomie duke pasur parasysh punësimin e lartë që garanton kohezionin social dhe territorial.

Strategjia "Evropa 2020", bashkë me Agjendën Territoriale 2020, e cila lidh rritjen "e zgjuar", të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse me kohezionin territorial, ofron kuadrin e përgjithshëm strategjik për politikën e kohezionit të BE-së 2020 dhe si e tillë edhe për Programin MED.

Kuadri rregullator për programin MED është siguruar nga rregulloret për politikën e kohezionit 2014–2020. Ato shoqërohen nga një Kuadër Strategjik i Përbashkët (CSF) që përcakton veprimet kyçe për adresimin e prioriteteve të BE-së dhe jep drejtim për sigurimin e koordinimit midis fondeve.

Qëllimi tematik i Programit MED është siguruar nga 11 objektiva tematikë të përshkruar në Rregulloren e Përbashkët të Dispozitave[30]. Rregullorja e Bashkëpunimit Territorial Evropian[31] dhe Kuadri i Përbashkët Strategjik[32], theksojnë se programet transkombëtare duhet të synojnë forcimin e bashkëpunimit dhe arritjen e një grade më të lartë të integrimit territorial për të kontribuar në bashkëpunimin territorial të Unionit.

1.1.1.2 Kuadri dhe udhëzimet për zbatimin e Programit MED 2014–2020

Për periudhën 2014-2020, Komisioni propozoi disa ndryshime të rëndësishme në mënyrën sesi politika e kohezionit duhet të hartohet dhe të zbatohet. Midis dallimeve të rëndësishme të propozimit, mund të gjenden pikat e mëposhtme:

- Përqendrimi i financimit në një numër më të vogël prioritetesh të cilat janë lidhur më mirë me strategjinë "Evropa 2020" (rritje "të zgjuar", e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse);
- Fokusimi në rezultate (të orientuara drejt rezultateve, më pak projekte por me cilësi më të lartë).
- Kjo gjë kërkon fokusim më të madh në kërkesat, në mënyrë që të identifikohen qartësisht nevojat reale

Evropian për Zhvillimin Rural dhe Fondit Evropian për Detin dhe Peshkimin dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1083/2006 (GZ L 347, 20.12.2013, f. 320).

[29] Rregullorja BE nr. 1299/2013,\ e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 17 dhjetorit 2013, mbi dispozitat e përgjithshme për mbështetjen nga ERDF-ja, për qëllimin e bashkëpunimit territorial evropian (GZ L 347, 20.12.2013, f. 259).

[30] Rregullorja (BE) nr. 1303/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e 17 dhjetorit 2013 që parashikon dispozitat e përbashkëta për ERDF, Fondin Social Evropian, Fondit e Kohezionit Fondin Bujqësor Evropian për Zhvillimin Rural dhe Fondin Evropian për Detin dhe Peshkimin që parashikon dispozitat e përgjithshme të ERDF, Fondit Social Evropian, Fondit të Kohezionit Fondin Bujqësor Evropian për Zhvillimin Rural dhe Fondit Evropian për Detin dhe Peshkimin (neni 9).

[31] Rregullorja BE Nr. 1299/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 17 dhjetorit 2013 mbi dispozitat e përgjithshme për mbështetjen nga ERDF për qëllimin e bashkëpunimit territorial Evropian (neni 7).

[32] Kuadri i Përbashkët Strategjik, aneksi II, Prioritetet për Bashkëpunimin.

të përfituesve dhe përdoruesve të fundit. Gjithashtu kërkon që të garantojë që procesi i kapitalizimit dhe komunikimi i jashtëm të arrijë në mënyrë efektive grupet finale të synuara dhe përdoruesit e fundit, të cilët mund të përdorin rezultatet e projekteve po ashtu në mënyrë efektive;

- Duke marrë parasysh dimensionet territoriale të zhvillimit (zhvillimi urban, zonat bregdetare, ishujt, zonat e largëta dhe ato me densitet të ulët);
- Monitorimi i progresit në lidhje me objektivat e miratuar (përcaktimi i objektivave të synuar dhe të matshëm);
- Rritja e aplikimit të kushtëzimeve për programet rajonale dhe kombëtare;
- Thjeshtëzimi i procedurave (procesi i aplikimit, përzgjedhja, zbatimi, monitorimi etj.).

Gjithashtu, duhet përmendur nevoja për të koordinuar më mirë programet e bashkëpunimit me programet qendrore dhe veçanërisht përdorimin e rezultateve të projekteve të bashkëpunimit territorial Evropian në favor të projekteve ose programeve kombëtare dhe rajonale. Autoritetet rajonale të përfshira në projektet MED do të inkurajohen që të integrojnë rezultatet e projekteve të MED në politikat e tyre ose politikat për integrim.

Për përfituesit, një ndër aspektet më të dukshme të programeve 2014-2020 është fokusi i financimit te zgjedhja e një Objektivi Tematik dhe te prioritetet e investimit. Kjo do të promovojë aktivitete më të orientuara drejt rezultateve dhe do të përmirësojë procesin e monitorimit nëpërmjet inovacioneve në lidhje me konceptimin dhe zbatimin e projekteve MED.

1.1.1.3 Mësime nga e kaluara

Fushat e ndërhyrjes

Gjatë periudhës së kaluar të programimit 2017-2013, janë evidentuar vështirësi në gjenerimin e projekteve në fushat specifike të ndërhyrjes si transporti, siguria detare dhe rreziqet natyrore. Kjo ndodhi për shkak të angazhimit të pamjaftueshëm të aktorëve kyç si autoritetet shtetërore, trupat ndërkombëtare ose private që ndërhyjnë dhe bashkëpunojnë kryesisht nëpërmjet llojeve të tjera të programeve. Megjithatë, këto tematika vazhdojnë të jenë të rëndësishme për zonën e Programit, ndaj shtetet partnere i morën parasysh këto detyrime në hartimin e strategjisë së Programit 2014-2020 (objektiva më të synuar me një alokim buxheti koherent).

Aktivitetet e lidhura me inovacionin, por edhe me disa çështje mjedisore kanë qenë të suksesshme dhe luajnë një rol të rëndësishëm në Akset 1 dhe 3 të Programit 2014–2020.

Llojet e thirrjeve

Programi MED 2007–2013 nisi me 2 thirrje të hapura për 4 akset prioritare. U regjistruan më shumë se 1000 aplikime por vetëm 10% prej tyre u përzgjodhën përfundimisht.

Kjo gjë tregoi domosdoshmërinë për të përshtatur procesin e aplikimit dhe të përzgjedhjes me objektivin, në mënyrë që të reduktohet numri i aplikimeve nëpërmjet fokusimit më të mirë në përmbajtjen e thirrjes, reduktimin e barrës administrative për promovuesit dhe vlerësuesit e projektit dhe përmirësimin e cilësisë së projektit. Metoda e termave specifikë të referencës është vendosur në mënyrë progresive me hapjen e thirrjeve strategjike dhe të synuara, duke reduktuar ndjeshëm numrin e aplikimeve dhe duke përmirësuar monitorimin e përmbajtjes së projektit. Për periudhën 2014–2020, Programi MED do të zbatohet vetëm nëpërmjet thirrjeve më të fokusuara për projekte në një ose disa nga prioritetet.

Informacion për përfituesit

Gjatë periudhës 2007–2013, qasja në informacion, sidomos në lidhje me rezultatet dhe arritjet e projekteve të zbatuara, është përmirësuar nëpërmjet ngritjes së "Librarisë MED" *online*. Ky instrument është akoma duke u kompletuar dhe do të jetë i vlefshëm për periudhën 2014–2020.

Menaxhimi i integruar i fondeve ERDF/IPA

Programi MED vendosi në 2010-ën që të përdorë mundësinë e ofruar nga Komisioni për menaxhimin e drejtpërdrejtë të fondeve IPA të alokuara për Programin. Kjo u zbatua me sukses me një buxhet prej 5.4 milionë eurosh nga fondet IPA, për periudhën 2010–2013. Sistemi i avantazheve për partnerët IPA u miratua nga Komiteti monitorues më 2011-ën, duke rritur në këtë mënyrë interesin e partnerëve IPA ndaj Programit.

1.1.1.4 Vlerësimi i sfidave dhe i nevojave për Programin

Objektivi i këtij seksioni është theksimi i nevojave të përgjithshme të zonës së bashkëpunimit. Më saktësisht, qëllimi është evidentimi i llojeve të nevojave që Programi mund të marrë parasysh në veçanti në përputhje me rolin, buxhetin dhe kapacitetet e tij ndërhyrëse.

Duhet të mbahet parasysh se programet transkombëtare nuk kanë si qëllim mbështetjen e investimeve apo të infrastrukturës së rëndë, të cilat mund të realizohet më mirë nëpërmjet programeve evropiane, kombëtare, rajonale apo të bashkëpunimit ndërkufitar. Programet e bashkëpunimit territorial evropian përqendrohen më shumë ndaj bashkëpunimit institucional, hartimit të strategjive, përmirësimit të qeverisjes dhe shkëmbimit të

përvojave dhe praktikave me objektivin për të përmirësuar integrimin dhe zbatimin e strategjive dhe politikave.

A. Karakteristikat natyrale, fizike dhe gjeografike

Programi MED mbulon një territor të gjerë që shtrihet nga rajonet portugeze të *Area Metropolitana de Lisboa, Algarve* dhe *Alentejo* dhe deri në bregun e Atlantikut, në Qipro, në anën lindore të Mesdheut. Ai përfshin 13 vende (10 shtete anëtare dhe 3 shtete partnere). Zona e lejueshme gjeografike shtrihet në më shumë se 860 000 km^2 ose në rreth 20% të gjithë territorit të Bashkimit Evropian.

Territori ka karakteristika natyrore, fizike dhe gjeografike tepër të ndryshme. Ka më shumë se 15 000 kilometra vijë bregdetare dhe fusha të punueshme pjellore që kanë qenë djepi i bujqësisë së Mesdheut, me rritjen e rrushit dhe plantacioneve të ullinjve dhe agrumeve. Ka, gjithashtu, vargmale të larta, si: Alpet, Pirenet dhe Pindosin. Një nga karakteristikat e tjera të hapësirës MED është përbërja nga shtete pjesëmarrëse me territor të gjerë por me numër të njëjtë të lartë ishujsh, duke përfshirë dhe shtetet e vogla anëtare, si: Malta dhe Qipro, por edhe rajonet ishullore, si: Ishujt Balearikë, Korsika dhe Kreta.

Pavarësisht se Mesdheu ka qenë historikisht një kalim transit midis Evropës, Azisë dhe Afrikës, diversiteti i tij gjeografik ofron një shpjegim të pjesshëm të vështirësisë në aksesim dhe komunikim që janë hasur gjatë udhëtimit brenda, në ose midis rajoneve të ndryshme të tij.

Ballafaqimi i rajoneve kaq të ndryshme krijon së bashku edhe mundësitë edhe sfidat për zhvillimin e zonës së Programit. Klima e tij, bregdeti dhe malet janë asete të vërteta (si për jetesë ashtu dhe për turizëm) dhe zona e Programit është e pasur në biodiversitet dhe potencial për bujqësi.

Vendet mesdhetare kanë një diversitet të gjerë të burimeve natyrore duke përfshirë pyjet, tokat e punueshme, zonat malore, lumenjtë, lagunat, deltat dhe ligatinat.

Këto burime janë aset i rëndësishëm (veçanërisht për bujqësi dhe turizëm), por paraqesin, gjithashtu, burime të dobësisë.

Edhe pse ka ndryshime domethënëse ndërmjet shteteve të MED-së, në lidhje me gjendjen mjedisore dhe gravitetin e problemeve të hasura mjedisore, ekzistojnë akoma disa sfida të përbashkëta për të gjitha vendet, në lidhje me menaxhimin e zonave bregdetare, burimeve ujore, tokës dhe zonave të mbrojtura.

Sfidat e përbashkëta të zonave bregdetare mesdhetare janë paraqitur në Kartën e Bolonjës, në të cilën theksohet, veçanërisht, rreziku që lidhet me efektet e ndryshimeve klimaterike, presionin urban dhe nevojën për promovimin më të mirë të bashkëpunimit midis partnerëve rajonalë.

Midis vendeve të MED-së, ndikimi i aktivitetit njerëzor në mjedis është relativisht i lartë. Për të llogaritur nivelin e konsumit të burimeve[33] në dispozicion, përdoret koncepti i gjurmës ekologjike. Të gjitha vendet e hapësirës MED regjistruan një deficit ekologjik në 2009[34], që do të thotë që kapitali mjedisor u përdor më shpejt se sa mund të rinovohej. P.sh., midis 1995-ës dhe 2009-ës, gjurma ekologjike për banorë pësoi rënie në Maltë, Itali, Greqi dhe Slloveni.

Për më tepër, rajoni është i ekspozuar ndaj ndryshimeve klimatike, prandaj mbrojtjes mjedisore duhet t'i jepet një prioritet i lartë.

Në përgjithësi, vendet e Mesdheut përballen me probleme të mëdha, duke përfshirë mungesën e ujit, shkretëtirëzimin, humbjen e biodiversitetit dhe kushtet ekstreme klimatike, si: përmbytjet dhe thatësira. Ndryshimet klimatike me shumë mundësi do të rëndojnë këto probleme.

Një nga ndikimet kryesore të ndryshimit të klimës ndihet në burimet ujore, veçanërisht në mënyrën e shpejtë se si ndryshimi i klimës po modifikon ciklin e ujit, duke rritur avullimin dhe reduktimin e nivelit të reshjeve[35].

Duke pasur parasysh sa më sipër, hapësira MED mund të karakterizohet mbi bazën e tre treguesve të gjerë, të veçantë për Mesdheun:

- Klima unike dhe flora;
- Vlera e biodiversitetit dhe peizazheve;
- Brishtësia e territoreve të ndryshme të tij, veçanërisht ishujt, objekt i rreziqeve serioze mjedisore (thatësira, erozioni i ujit, përmbytjet, kripësia e tokës, terrenet e thepisura).

Zona MED përmban një numër të madh (rreth 6000) të zonave të "Natura 2000", pjesë tokësore dhe detare dhe ekziston një nevojë e qartë për të kontribuar në menaxhimin efektiv të këtyre zonave nëpërmjet krijimit të rrjetit transkombëtar dhe të bashkëpunimit.

---

[33] Ky tregues na lejon të llogarisim deficitin ose rezervën ekologjike të një vendi. Treguesi mat sasinë e hapësirës produktive biologjike që i nevojitet një popullsie ose aktiviteti për të prodhuar burimet e konsumuara dhe për të thithur mbetjet e prodhuara, duke marrë parasysh teknologjitë e vlefshme praktikat e përdorura të menaxhimit.

[34] Plan Bleu, Strategjia e Mesdheut për Vazhdimin e Zhvillimit të Qëndrueshëm: Treguesit kryesorë - Aktualizimi i 2013-ës (maj 2013).


[35] Plan Bleu, Ibidem.

B. Të dhënat demografike

Sot, zona MED është shtëpia e më shumë se 122 milionë njerëzve ose në terma të tjerë, pothuajse çereku i popullsisë evropiane (24,3% e popullsisë së BE27)[36].

Kjo nënkupton që densiteti i popullsisë është veçanërisht më i lartë se mesatarja evropiane (142 njerëz për km^2 në hapësirën MED krahasuar me 116,3 njerëz në Evropën si tërësi[37]). Kjo mesatare, gjithashtu, fsheh pabarazi domethënëse në hapësirën MED, ku densiteti i popullsisë varion në mënyrë të konsiderueshme; nga 1318 njerëz/km^2 në Maltë[38], në 23,9 njerëz/km^2 në rajonin Alentejo[39] të Portugalisë.


Harta 1. Densiteti i popullsisë në hapësirën e MED (Eurostat, GISCO, 2010)



Densiteti i popullsisë në Maltë është > 500 më 2010-ën.

Një numër qytetesh të mëdha (sidomos: Barcelona, Lisbona, Marseja, Tuluzi, Milano, Roma, Napoli dhe Athina etj.) ndodhen brenda hapësirës MED. Një tipar tjetër i rëndësishëm është numri i qendrave më të vogla urbane që lokalizohen përgjatë vijës bregdetare të Mesdheut (qytetet si: Valencia, Montpeljer ose Xhenova, p.sh.). Hapësira përfshin, gjithashtu, një numër territoresh rurale dhe/ose të izoluara, veçanërisht në Greqi.

Harta 2. Topologjia e zonave urbane dhe rurale në rajonet e MED (Espon TerrEvi 2012)



[36] Eurostat, popullsia deri më 1 janar 2012.
[37] Eurostat, popullsia deri më 1 janar 2012.
[38] Eurostat, densiteti i popullsisë deri më 1 janar 2011.
[39] Eurostat, densiteti i popullsisë deri më 1 janar 2011.



Malta është kryesisht territor urban.

Të dhënat demografike tregojnë që hapësira MED ka një tërheqje të fortë. Në fillim të Programit MED 2007–2013, popullsia e tij ruajti nivelin e 110 milionëve. Sot është rritur në 122 milionë (pa 3 rajonet e reja të lejueshme për Programin 2014–2020). Kjo rritje me 6,3% (që nuk përfshin Kroacinë) është domethënëse kur krahasohet me rritjen mesataren evropiane prej 1,6% në të njëjtën periudhë.

Rritja ka ardhur si pasojë e tërheqjes nga kushtet e jetesës (në termat e klimës, gjeografisë dhe kulturës etj.) dhe rajonet si: bregu lindor i Spanjës, bregdeti veri-perëndimor i Italisë dhe bregdeti jugor i Francës, tërheqin një numër thelbësor të profesionistëve të rinj ose njerëzve në pension.

Ky trend demografik ka efekte të drejtpërdrejta në urbanizim, konsumin e burimeve (tokë, ujë, energji) dhe në prodhimin e mbetjeve.

Mbetjet përbëjnë një nga presionet më të forta të mjedisit në rajonet e Mesdheut me rreziqet e mundshme në ujërat nëntokësorë, ujërat sipërfaqësore, helmimin e tokës, degradimit të ekosistemeve, emisionet e GHG etj.[40]

Një dimension tjetër i problemit të mbetjeve dhe efekteve të tij transkombëtare janë mikrombetjet e gjetura në det dhe në vijën bregdetare. Ndikimet njerëzore dhe zhvillimi në rritje i ekonomisë në vendet mesdhetare kanë pasur një ndikim të fortë mjedisor, i cili duket veçanërisht në nivelin e lartë të degradimit të zonave detare dhe bregdetare. Përgjatë gjithë basenit të Mesdheut ka një spektër të gjerë të aktiviteteve industriale, duke filluar nga minierat te prodhimi i të mirave materiale, duke rritur në këtë mënyrë numrin e "pikave të nxehta të ndotjes", ku depozitimi dhe lëshimi i helmeve nga zonat industriale dhe portet e mëdha tregtare janë kërcënime të rëndësishme mjedisore[41].

Me qëllim reduktimin e këtyre efekteve, politikat e ndjekura në nivel rajonal kanë përfshirë ngritjen e zonave të mbrojtura detare (më 1982) dhe futjen e protokollit në lidhje me Zonat e Veçanta të Mbrojtura dhe Diversiteti Biologjik në Mesdhe (më 1995)[42].


Nëpërmjet protokollit në lidhje me Zonat e Veçanta të Mbrojtura dhe Diversitetin Biologjik në Mesdhe (Protokolli SPA/BD), Konventa e Barcelonës shpalli Listën e Zonave të Veçanta të Mbrojtura të Rëndësisë Mesdhetare (lista SPAMIs) për të promovuar bashkëpunimin në menaxhimin dhe konservimin e zonave natyrale, si dhe mbrojtjen e specieve të rrezikuara dhe habitateve të tyre.

Në fund, në disa rajone të MED-së, si: Greqia dhe jugu i Portugalisë, popullsia është në rënie dhe mund të bjerë më tej, si rezultat i krizës ekonomike dhe pasojave për punësim.

Kushtet tërheqëse të hapësirës MED kanë, gjithashtu, pasoja për imigrimin, brenda dha nga jashtë Bashkimit Evropian. Në hapësirën MED vala e migrimeve ka tendencë të bashkëveprojë me rritjen e përgjithshme të popullsisë (shiko hartën 3).

[40] Plan Bleu, Strategjia e Mesdheut për vazhdimin e zhvillimit të qëndrueshëm: Treguesit kryesorë - Përditësimi në vitin 2013.
[41] Plan Bleu, Ibidem.
[42] Plan Bleu, Ibidem.

Harta 3. Rritja e popullsisë në hapësirën MED (Eurostat/GISCO, 2010)



Malta ka një rritje popullsie ndërmjet 4 dhe 8 më 2010-ën.


Një karakteristikë tjetër e hapësirës së MED-së është se ka: a) proporcion më të ulët të njerëzve të rinj në popullsinë e saj se sa mesatarja e BE-së (15% kundrejt 15,6%); dhe b) një proporcion më të lartë të njerëzve të moshuar se sa mesatarja evropiane (19,2% kundrejt 17,8%).

C. Karakteristikat kryesore ekonomike të hapësirës MED

Më 2010-ën, GDP-ja mesatare për frymë ishte 12% më e ulët se mesatarja e GDP-së për frymë e BE-së në tërësi (21 776 EUR, krahasuar me 24 500 EUR, në Evropë në tërësi)[43].

Sidoqoftë, kjo e dhënë fsheh pabarazitë e gjera rajonale. Disa rajone 34 NUTS2 në hapësirën MED kanë një mesatare më të ulët të GDP-së për frymë se sa mesatarja evropiane dhe 18 NUTS2 rajone kanë një GDP për frymë mbi mesataren evropiane[44].

Harta 4. GDP-ja për frymë (standardi i fuqisë blerëse) më 2009-ën (burimi: Eurostat/GISCO)



Malta ka një GDP për frymë prej 84% të mesatares së BE-së më 2009-ën (86% më 2012-ën).

Harta 4, sidoqoftë, nuk tregon pasojat e krizës ekonomike të 2007-ës dhe të krizës së vazhdueshme të borxhit që ka ndikuar në vendet anëtare të BE-së që më 2010-ën (veçanërisht: Greqia, Portugalia, Qipro dhe një ndikim më të ulët në Spanjë, Itali dhe Francë). Ndërkohë, që për shumë vjet, shkalla e rritjes së

[43] Të dhënat e Eurostatit, 2010, përpunuar *Technopolis, 2013*.

[44] Rajonet më të suksesshme janë, nga Italia e veriut (*Trentino, Emilia-Romagna, Lombardia, Vallee d'Aosta* dhe *Haut-Adige*), alpet *Rhone* dhe *Katalonia* (recesioni i Atikës për shkak të krizës ekonomike).

vendeve të Mesdheut ka qenë mbi mesataren evropiane[45], vitet e fundit është shënuar një recesion i theksuar[46]:

Në Itali, GDP-ja ra me 2,4% më 2012-ën dhe 0,9% më 2013-ën.

Në Portugali, GDP-ja ra me 3,2% më 2012-ën dhe 1,4% më 2013-ën, duke shënuar recesionin më të rëndë që nga viti 1975.

Në Greqi, GDP-ja ra në mënyrë të theksuar me 7% më 2012-ën dhe 3,9% më 2013-ën, duke shënuar vitin e gjashtë të njëpasnjëshëm të recesionit ekonomik.

Në Francë, pas një përmirësimi më 2012-ën (+0,1% rritje), GDP-ja ra përsëri më 2012-në dhe më 2013-ën (-1,6% dhe -1,2%).

Në Raportin e Tetë të Progresit, në lidhje me kohezionin ekonomik, social dhe territorial, Komisioni Evropian shqyrtoi dimensionin urban dhe rajonal të krizës[47] dhe theksoi në hyrjen e raportit se periudha e programimit të Politikës së Kohezionit do të fillojë si pasojë e recesionit më të rëndë të pesëdhjetë viteve të fundit. Kriza ktheu përmbys procesin e konvergjencës së GDP-së rajonale për frymë dhe papunësinë brenda BE-së.

Në shkallë evropiane, recesioni filloi në tremujorin e dytë të vitit 2008 dhe zgjati për pesë tremujorë të njëpasnjëshëm. Midis 2007-ës dhe 2011-ës, ndikimi më serioz mbi GDP-në dhe punësimin u ndie në tri vendet baltike dhe në Irlandë, Greqi dhe Spanjë. Ndërsa, më 2010-ën dhe 2011-ën, vendet baltike dhe ekonomitë irlandeze iu kthyen rritjes: "Spanja dhe Greqia, sidoqoftë, nuk janë kthyer akoma në rrugën e rritjes së qëndrueshme". Spanja filloi rritjen më 2011-ën, por GDP-ja e saj u tkurr më 2012-ën dhe 2013-ën. Shkalla e rritjes së GDP-së për Greqinë tregoi një vazhdimësi (por ulje) të recesionit të 2012-ës dhe 2013-ës. Për më tepër, Qiproja u përball me një krizë financiare më 2012-ën, e cila solli një ulje të ashpër të GDP-së dhe të papunësisë dhe që pritet të vazhdojë deri më 2014-ën. Në Greqi, GDP-ja u ul me 25% midis 2009-ës dhe 2013-ës.

Ndikimi i recesionit për papunësinë ka qenë domethënës. Në nivel evropian, shkalla e papunësisë u rrit nga 7% deri 10% midis 2008-ës dhe 2012-ës. Shkalla e papunësisë në vendet anëtare më të prekura, sidoqoftë u dyfishua dhe madje u trefishua për të arritur me 26% në Spanjë dhe 27% në Greqi më 2013-ën (burimi: Eurostat).

Rreziku i varfërisë dhe i përjashtimit, gjithashtu, u rrit fuqishëm: Ata ishin gjashtë shtetet anëtare më të prekura, por ndikimi në Itali dhe në Bullgari ishte, gjithashtu, domethënës. Në Spanjë, efektet e krizës filluan të ndihen vetëm më 2009-ën. Që atëherë, të dyja vendet humbën rreth 8% të të ardhurave të tyre të disponueshme, duke i kthyer në nivelet e 2005-ës. Në Greqi, rënia e të ardhurave të disponueshme filloi me ngadalë më 2007-ës. Më 2009-ës dhe 2010-ës, pësuan një rënie të fuqishme. Si rezultat, të ardhurat e disponueshme greke më 2011-ën ishin më të ulëta se niveli i 2005-ës.

Në fund, "modeli" ekonomik në rajonet e hapësirës MED mund të karakterizohet nga tri tipare të veçanta që i dallojnë nga zonat e tjera të bashkëpunimit. Këto janë:

- **Rëndësia e bujqësisë dhe e agrobiznesit për ekonominë dhe tiparet e veçanta të bujqësisë në Mesdhe** (që bazohet në një gamë të limituar prodhimesh, kryesisht ullinj, verë, agrume, tapa (materiali) etj. të prodhuara nga fermat e vogla);
- Roli dominues i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe varësia e ekonomisë më të gjerë nga to (shiko konkurrueshmërinë e biznesit, veçanërisht e SME-ve);
- Rëndësia e turizmit, një potencial për rritjen që është akoma i fortë dhe nevoja për promovimin e një industrie turizmi më të qëndrueshme (duke marrë parasysh çështjet që lidhen me "rritjen blu");
- Rëndësia e sektorit detar dhe rritjes blu[48], duke përfshirë turizmin detar, bregdetar dhe të lundrimit, industritë kreative, burimet bregdetare dhe detare, mbrojtjen e biodiversitetit, energjinë blu, aktivitetet e portit, industritë detare dhe mjedisore etj.

Rritja blu, VSHB-ja (vlera e shtuar bruto), e gjeneruar nga vendet mesdhetare (Shqipëri, Bosnja dhe

---

[45] Shiko MED OP 2007–2013, f. 10.

[46] Burimet: IEUROSTAT 2014.

[47] Raporti i KE-së për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, Raporti i Tetë të Progresit në lidhje me kohezionin ekonomik, social dhe territorial – Dimensioni urban dhe rajonal i krizës, 26.6.2013: http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2013:0463:FIN:EN:PDF

[48] Iniciativa "rritja blu" ka si qëllim zhvillimin e dimensioneve detare të strategjisë "Evropa 2020". Rritja blu përcaktohet si "rritje ekonomike dhe punësimi, "e zgjuar", e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse nga oqeanet, detet dhe brigjet. Ekonomia detare përbëhet nga aktivitetet ekonomike sektoriale dhe ndërsektoriale në lidhje me oqeanet, me detet dhe me brigjet. "*Rritja blu", skenarët dhe motorët për rritje të qëndrueshme nga oqeanet, detet dhe brigjet detare, Raporti i tretë i përkohshëm, Komisioni i BE-së, DG MARE, mars 2012)* .

Hercegovina, Kroacia, Qipro, Franca, Greqia, Italia, Mali i Zi, Malta, Sllovenia, Spanja dhe Turqia), i kalon 63 miliardë EUR, që është më shumë se trefishi i VSHB-së totale të gjeneruar nga aktivitetet detare ekonomike në Detin Baltik.


Tri vendet e para, Italia, Greqia dhe Spanja, përbëjnë 91% të këtij aktiviteti.

Në terma të nënrajoneve, Mesdheu Perëndimor (Spanja, Franca dhe bregu Tyrrhenian i Italisë) arrin 27,1 miliardë euro (në terma VSHB), i ndjekur nga Mesdheu Qendror (Adriatoko/Jonian) me një total prej 19,3 miliardë eurosh. Mesdheu Lindor (bregu i Egjeut të Greqisë, Turqia, Qipro), arrin vlerën e 16,9 miliardë eurove.

Sa i përket turizmit, hapësira MED kombinon shumë tipare tërheqëse (klima, vija e bregdetit, peizazhi, trashëgimia kulturore etj.), duke e bërë rajonin më popullor turistik në Evropë dhe një nga zonat më të mëdha turistike në botë. Sipas Organizatës Botërore të Turizmit[49], vendet në hemisferën e veriut dhe në Mesdhe tërheqin 18,5% të turistëve të botës. Midis 2005-ës dhe 2012-ës, të dhënat u rritën qëndrueshëm (+2,9%) dhe ishin më të larta se shkalla e rritjes në Evropë (+2,5%). Kjo përbën 15,9% të të ardhurave të turizmit botëror. Për më tepër, Franca, Spanja dhe Italia (i gjithë vendi) ndodhen midis gjashtë vendeve të para të destinacioneve turistike në botë (në lidhje me numrin e turistëve dhe gjenerimin e të ardhurave nga turizmi).

Më 2012-ën, vendet e hapësirës MED (+2%) konsoliduan performancën e tyre nga vitet e mëparshme (+8% në 2011). Kroacia, Portugalia dhe Spanja, regjistruan një rritje prej 4% (mbi mesataren e nënrajonit).

Harta 5. Numri i netëve në hotel më 2009-ën (rezidentë dhe jorezidentë)



Burimi: Eurostat/Nb: Numri i netëve në hotel, më 2009-ës në Maltë ishte 352 312.

Parashikimi afatgjatë i Organizatës Botërore të Turizmit (2030), është për një rritje prej 3,3% çdo vit në ardhjen e turistëve botërorë. Ndërkohë që rritja parashikohet të jetë më e madhe në Azi dhe destinacionet ekonomike në zhvillim, Evropa dhe veçanërisht Evropa Mesdhetare do të vazhdojnë të jenë një destinacion i rëndësishëm me shifra që rriten nga 169 milionë më 2010-në, në 264 milionë më 2030-ën).

Prandaj, sektori i turizmit ofron mundësi thelbësore në lidhje me rritjen ekonomike dhe punësimin (vendet e punës në këtë sektor tashmë janë rrallë herë të kërcënuara nga globalizimi). Shfrytëzimi i këtij potenciali do të kërkojë strategji zhvillimi për infrastrukturën, vendet dhe atraksionet, akomodimin, tregun dhe inovacionin e shërbimeve. Do të jetë,

gjithashtu, e nevojshme të sigurohet qëndrueshmëria në sektor (në kuadër të planifikimit, menaxhimin e qëndrueshëm të bregdetit, biodiversitetit dhe burimeve ujore).

Kultura, në kuptimin e saj të gjerë, është, gjithashtu e rëndësishme për hapësirën MED. Ndërsa kultura ka shumë rëndësi për turizmin, veçanërisht, vendet e saj historike dhe trashëgimia kulturore dhe aktivitetet krijuese, si: festivalet dhe oferta e pasur e ekspozimeve – Kultura është e para dhe qëllimi

[49] Statistikat për turizmin nga UNWTO-ja për vitin 2013: http://www.e-unwto.org/content/hq4538/fulltext.pdf

kryesor për banorët e hapësirës MED.

D. Analiza SWOT e zonës MED

Rritja inteligjente

	Pikat e forta	Dobësitë	Mundësitë	Rreziqet
Kërkimi, zhvillimi teknologjik dhe inovacioni	- Disa rajone lider në R&D (Alpet Rhone, Trentino, Katalonia, Lombardia, Sllovenia ...) - Disa sektorë industrialë me aftësi të larta (bujqësia, agrobiznesi, kimikatet, materialet ...)	- GDP-ja për frymë 12% më e ulët se mesatarja evropiane - Investim i ulët në R&D - Proporcion i ulët i stafit kërkimor në popullsi - Numër i ulët i aplikimeve për patentë - Modelet e inovacionit më të bazuar në diversifikim se sa inovacionin zbulues	- Rritje investimesh në R&D - Rritje e lehtë e aplikimeve për patenta gjatë viteve të fundit - Specializimet R&D në agrobiznes, ndërtim dhe ekondërtim, detar dhe turizëm ... - Një komunitet inovacioni i ndryshëm dhe i lidhur (grupimet)	- Ekonomia e ndikuar seriozisht nga kriza ekonomike dhe e borxhit - Rritja e konkurrencës nga vendet jugore dhe lindore
Teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit	- Mbulim i gjerë i brezit të gjerë (*broadband*) me shpejtësi të lartë - Rritja e përdorimit të ICT nga individët dhe bizneset	- Akses i kufizuar në brezin e gjerë (*broadband*) në të gjitha rajonet MED - Aftësi më të ulëta në ICT të individëve se sa në rajonet e tjera të BE-së - Përdorim i kufizuar i shërbimeve publike *online*	- Zhvillimi i brezit të gjerë (*broadband*) me shpejtësi të lartë - Sektorët R&D të specializuar në ICT	- Pabarazi domethënëse midis rajoneve dhe territoreve në lidhje me përdorimin e ICT-së
Konkurrueshmëria e SME-ve	- Atraksioni i hapësirës MED, e cila është esenciale për turizmin - Rajone me konkurrueshmëri të lartë (Katalonia, PACA, Piedmont, Lombardi, Lacio, Sllovenia perëndimore ...) - Rezultate pozitive të mbështetjes me politikë (inovacioni i biznesit dhe konkurrueshmëria)	- Influencë e fortë e bizneseve tradicionale (sektorët e teknologjisë së ulët dhe të mesme) - Inovacion në rritje që prodhon vlerë të shtuar të kufizuar për SME-të - Produktivitet i ulët i biznesit - Shumica e SME-ve e izoluar dhe me integrim të dobët në rrjetet - Pabarazi të mëdha rajonale dhe rajone me konkurrueshmëri të ulët Kuptim i kufizuar i rëndësisë së pronësisë intelektuale	- Shkallë e lartë e krijimit të bizneseve në disa rajone MED (Portugali, Sllloveni, Francë ...) - Rritja e grupimeve të SME-ve	- Recesion serioz në shumicën e rajoneve MED - Vështirësi të bizneseve për aksesimin e financimit

Rritja e qëndrueshme

	Pikat e forta	Dobësitë	Mundësitë	Rreziqet
Ekonomia me karbon të ulët dhe sektori i energjisë	- Kushte të favorshme për prodhimin e energjisë së rinovueshme - Ndërgjegjësim i rritur për nevojat ndryshimit drejt një ekonomie me karbon të ulët	- Përqendrimi i ozonit më i lartë se mesatarja e BE-së - Indeksi i gazit serrë shumë më i lartë se mesatarja e BE-së - Zhvillim i pamjaftueshëm i energjisë së rinovueshme - Relativisht, shkallë e lartë e varësisë nga energjia - Efikasitet i ulët i energjisë krahasuar me mesataren e BE-së	- Potencial zhvillimor për energjinë e rinovueshme e pashfrytëzuar plotësisht - Vendet MED të angazhuara për reduktimin e emisionit të GHG-së	- Rritje domethënëse në koston e energjisë me karbon të ulët
Ndryshimi i klimës dhe rreziqet	- Ekzistenca e kuadrit evropian dhe politikave kombëtare për reduktimin e emisioneve të karbonit	- Vendet MED më të prekshme nga ndryshimi i klimës se mesatarja e BE-së - Vendet MED midis prodhuesve kryesorë të gazit serrë në Evropë - Zona MED e përballur fuqishëm me rreziqet natyrore me kapacitete të ulëta adaptimi (thatësira, zjarri, përmbytjet ...)	- Angazhim në rritje për zhvillimin e qëndrueshëm	- Rritje e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore për shkak të ndryshimit të klimës - Kosto të larta për riparimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore
Mbrojtja e mjedisit	- Trashëgimi mjedisore tepër e pasur (deti, malet tokat e punueshme, pyjet, lumenjtë, tokat e lagura ...) - Shumë zona të mbrojtura ("Natura 2000", zona me rëndësi mesdhetare)	- Degradimi i zonave të brishta, kryesisht zonave bregdetare dhe ndotja e zonave detare - Ndotje e ajrit dhe e ujit për shkak të përqendrimit urban - Rritja e prodhimit të mbetjeve familjare - Riciklimi i mbetjeve mbetet më i ulët se mesatarja e BE-së	- Zhvillimi i masave për mbrojtjen mjedisore (zonat e mbrojtura ...) - Potencial për përdorimin e energjive të rinovueshme - Ndryshime nga përpunimi tradicional i mbetjeve drejt metodave më të pastra	- Rreziku i rritjes së ndotjes së mjedisit për shkak të rritjes së aktivitetit në turizëm dhe në bujqësi - Rritja e cilësisë së varfër të ajrit - Rritja e mungesës së burimeve të ujit - Rritja e urbanizimit - Rritja e kostos së riciklimit dhe e metodave të ripërdorimit të mbetjeve
Transportet	- Cilësi e mirë në përgjithësi e rrjeteve të transportit - Akses i përgjithshëm i kënaqshëm sidomos për zonat e mëdha urbane - Nivel i mirë i infrastrukturës rrugore - Rrjet i gjerë i qyteteve port të pajisura mirë për të përballuar valën e pasagjerëve dhe mallrave - Lokalizim gjeografik strategjik midis Evropës Lindore dhe Perëndimore dhe Afrikës - Nivel i kënaqshëm i instrumenteve të aeroporteve	- Fragmentarizmi gjeografik dhe izolimi i territoreve të shumta (ishujt, zonat e largëta) - Zhvillim urban i keqmenaxhuar, kryesisht në zonat bregdetare - Varësia e territoreve MED nga transportet rrugore - Mbizotërimi i transporteve individuale në zonat urbane dhe përreth - Densitet më i ulët i linjës hekurudhore se mesatarja evropiane - Akses i ulët multimodal - Zhvillim i pamjaftueshëm i trafikut bregdetar dhe detar	- Pozicionim i mirë i ishujve dhe i rajoneve MED si qendra për turistët dhe tregtinë - Zhvillimi i sistemeve multimodale të transportit - Përforcim i rrjetit hekurudhor ekzistues	- Transporti është një burim i madh i ndotjes - Mungesë evropiane koordinimi në sistemin e komunikimit - Konkurrenca me qendrat evropiane urbane veriore dhe qendrore

Rritja gjithëpërfshirëse

	Pikat e forta	**Dobësitë**	**Mundësitë**	**Rreziqet**
Punësimi dhe lëvizshmëria e punës	- Kushtet tërheqëse të universiteteve të zonës MED - Lëvizshmëria e lartë e studentëve	- Nivel i ulët punësimi, veçanërisht për rininë dhe për gratë - Pabarazi të larta territoriale të niveleve të papunësisë - Shkallë e lartë papunësie afatgjatë	- Lëvizshmëria e punës brenda dhe midis shteteve MED	- Pasojat e krizës financiare Rritje e fortë e shkallës së papunësisë me krizën ekonomike - Zbrazje e burimeve njerëzore, kryesisht e njerëzve të rinj drejt shteteve të tjera të BE-së
Përfshirja sociale dhe lufta kundër varfërisë	- Ulja e solidaritetit të ndërgjeneratave	- Përqindja e lartë e popullsisë në rrezik varfërie dhe përjashtimi social	- Rol i rëndësishëm i luajtur nga ekonomia shoqërore dhe e solidaritetit	- Efekte alarmuese njerëzore dhe sociale të krizës
Aftësitë dhe edukimi	- Gamë e plotë e trajnimit me cilësi të lartë dhe falas - Zgjedhje e mirë e trajnimit profesional	- Nivel i lartë i braktisjes së shkollës krahasuar me mesataren e BE-së	- Zbritje progresive e shkallës së braktisjes së shkollës	

F. Përmbledhje e sfidave kryesore dhe e nevojave të zonës MED

	Sfidat kryesore	Nevojat kryesore
Rritja e zgjuar	- Rritja e konkurrencës nga vendet dhe zonat e tjera në botë - Sfida për arritjen e objektivave e strategjisë "Evropa 2020", me nivel inovacioni më të ulët në rajonet e Mesdheut se mesatarja evropiane - Potencial i mirë zhvillimi në sektorin e rritjes blu dhe "të gjelbër" që duhet të promovohet më mirë	- Nevojë për investime më të fuqishme në R&D - Nevojë për përmirësimin e konkurrueshmërisë së bizneseve - Nevojë për forcimin e lidhjes dhe bashkëpunimit midis kërkimit, inovacionit dhe bizneseve - Nevoja për përmirësimin e lidhjeve midis rrjeteve rajonale dhe grupimeve për gjenerimin e masës kritike në lidhje me kërkimin dhe inovacionin - Nevojë për përmirësimin e kapaciteteve të SME-ve për përdorimin e rezultateve të kërkimit dhe të inovacionit të prodhuara nga polet e mëdha kërkimore dhe të inovacionit - Nevoja për fokusim më të mirë të ndërhyrjeve në sektorët e përbashkët të inovacionit në të gjithë zonën MED (rritja blu dhe sektorët e rritjes së gjelbër)
Rritja e qëndrueshme	- Rritja e pasojave të ndryshimeve klimatike në rajonet MED - Rritja e mungesës së burimeve ujore - Potencial për përmirësimin e prodhimit të energjisë së rinovueshme, por shumë situata të ndryshme midis rajoneve MED dhe vendeve MED - Rritja e presionit urban që kërkon zhvillim urban afatgjatë, të integruar dhe të qëndrueshëm (energjia, uji, planifikimi, transporti, menaxhimi i mbetjeve, shëndetësia) - Rritja e presionit të aktiviteteve ekonomike në burimet natyrore dhe kulturore dhe në zonat bregdetare - Ndikimi i rëndësishëm i bujqësisë në peizazhet dhe burimet natyrore - Ndotje e theksuar e Detit Mesdhe	- Nevojë për përmirësimin e kapaciteteve vëzhguese, normave, teknikave dhe bashkëpunimit midis palëve të interesuara për reduktimin e dobësive të rajoneve MED ndaj rreziqeve natyrore - Nevojë për një menaxhim më të qëndrueshëm të qyteteve mesdhetare (energjia, uji, planifikimi hapësinor, transporti, menaxhimi i mbetjeve, menaxhimi i shëndetësisë) - Të jepen përgjigje specifike ndaj nevojave të ishujve, në lidhje me energjinë dhe menaxhimin e ujit (zgjidhje në shkallë të vogël, pavarësi) - Nevoja për përmirësimin e elasticitetit të zonave bregdetare, biodiversitetit, trashëgimisë natyrore dhe kulturore përballë presionit njerëzor dhe pasojave të ndryshimit të klimës (rritja e ndërgjegjësimit, ndryshimi i zakoneve, masat mbrojtëse ...) - Nevoja për reduktimin e ndotjes detare dhe mbeturinave detare
Rritja gjithëpërfshirëse	- Pasoja të rëndësishme të ndryshimeve demografike në ekonomi, punësim dhe cilësinë e jetës (plakja e popullsisë) - Vështirësi në rritje për përfshirjen socioekonomike të njerëzve të rinj, në veçanti në kohën e krizës	- Nevoja për promovimin më të mirë të inovacionit shoqëror në lidhje me sektorët kyç socioekonomikë (turizmi, energjia, transporti ...) - Nevoja për marrjen më të mirë në konsideratë të çështjeve socioekonomike dhe nevojave të përdoruesve të fundit në konceptimin dhe zbatimin e politikave të qëndrueshme zhvillimore (mjedisi, energjia, transporti)

G. Renditja e sfidave dhe potencialeve të identifikuara

Mes sfidave të mundshme dhe të ndryshme, sfida më e rëndësishme për rajonet mesdhetare të BE-së lidhet me perspektivat e zhvillimit ekonomik dhe riaftësimin ekonomik pas vitesh krize ekonomike dhe financiare. Vendet e Evropës jugore, veçanërisht vuajtën nga kriza ndërsa rajonet MED në përgjithësi, vuajtën nga mungesa e kapaciteteve inovative. Në zonën MED perspektivat e zhvillimit janë veçanërisht të rëndësishme në fushat e rritjes blu dhe të gjelbër me një potencial të lartë zhvillimi të zonave bregdetare, përdorimi i burimeve detare, perspektivave të ofruara nga bioteknologjitë, evolucioni i sistemeve të transportit dhe aktiviteteve të turizmit etj.

Duke marrë parasysh trashëgiminë e tyre të madhe natyrore dhe kulturore, rajonet MED duhet, gjithashtu, të promovojnë një model zhvillimi duke respektuar burimet që luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e tyre social dhe ekonomik. Për këtë arsye, zhvillimi i qëndrueshëm konsiderohet si sfida e dytë më e rëndësishme për t'u marrë parasysh. Kjo kërkon që aktivitetet ekonomike të përdorin arsyeshëm burimet natyrore dhe të sigurojnë zhvillim të balancuar afatgjatë. Për zonën MED, një sfidë të veçantë përbëjnë aktivitetet e turizmit që gjenerojnë një presion të fortë në zonat më tërheqëse dhe më të brishta (toka, ndotja e tokës, burimet ujore ...). Në zonat bregdetare dhe me popullsi të dendur, ekziston, gjithashtu, një sfidë e rëndësishme në lidhje me ndotjen e ajrit, në veçanti për emisionet e NO_2 dhe SO_2 dhe emisionet GHG për shkak të aktiviteteve ekonomike, ndërtuese dhe transportit.

Pavarësisht faktit se shumë zona të mbrojtura janë krijuar në rajonet MED, duhen adaptuar masa mbrojtëse dhe menaxhuese me qëllim që të sigurohet një elasticitet më i lartë në nivel transkombëtar. Menaxhimi i ujit është veçanërisht një shqetësim për shkak të ndryshimeve mjedisore, ndotjes dhe ngrohjes globale.

Në mënyrë më politike, duhet theksuar vështirësia për gjenerimin e politikave transkombëtare në zonën MED që karakterizohet nga diferenca domethënëse gjeografike, socioekonomike dhe politike. Zhvillimi afatgjatë i zonës MED mund të sigurohet vetëm nëpërmjet integrimit të fortë dhe adaptimit më të mirë të proceseve qeverisëse.

H. Identifikimi i sfidave dhe potencialeve për t'u adresuar në kuadër të programit të bashkëpunimit

Në kuadër të Programit të bashkëpunimit, sfidat dhe potencialet e identifikuara në seksionet e mëparshme mund të merren në konsideratë me përshtatjet e mëposhtme.

Zhvillimi ekonomik, promovimi i kërkimit dhe inovacionit paraqesin një sfidë kyçe për zonën dhe një nga shqetësimet kryesore të strategjisë "Evropa 2020". Përpjekje të forta dhe instrumente operacionale janë vendosur nëpërmjet programeve rajonale të bashkëpunimit dhe programeve tematike të BE, si "Horizont 2020" dhe COSME. Duke qenë se MED nuk është përshtatur për të financuar kërkime, infrastrukturë ose të mbështesë inovacionin në shkallë të madhe, në një zonë bashkëpunimi kaq të madhe, ai do të promovojë bashkëpunimin transkombëtar në fushat e synuara të zhvillimit dhe inovacionit, siç sektorët e rritjes blu dhe të gjelbër. Duke marrë parasysh, gjithashtu, vështirësitë për angazhimin e operatorëve ekonomikë dhe respektimin e rregullave të konkurrencës në projektet e bashkëpunimit transkombëtar, promovimi i kapaciteteve inovative do të përdorë vetëm një pjesë të arsyeshme të burimeve të programit (rreth 32% të buxhetit).

Fusha e ndërhyrjes e konsideruar si sfida tjetër më e rëndësishme, "zhvillimi i qëndrueshëm", tregon për një potencial të mirë zhvillimi në Programin MED për arsyet e mëposhtme. Mbrojtja e mjedisit dhe menaxhimi i burimeve janë jetësore për zhvillimin afatgjatë të zonës. Është, gjithashtu, veçanërisht e lidhur me bashkëpunimin transkombëtar me sfidat që kërkojnë zgjidhje matanë kufijve rajonalë dhe kombëtarë.

Kjo fushë e ndërhyrjes, gjithashtu, është marrë më pak në konsideratë nga programet rajonale dhe kombëtare që janë fokusuar më shumë në inovacion, ICT, SME dhe ekonominë me karbon të ulët. Perspektivat e bashkëpunimit transkombëtar janë domethënëse në zonën që kërkon vëzhgim në shkallë të gjerë, shkëmbim të dhënash dhe njohurish, koordinim të instrumenteve të planifikimit dhe politikave publike. Perspektivat e përmirësimit janë domethënëse në zonën MED dhe Programi do të ketë mundësinë të përfshijë palët e interesuara dhe aktorët kyç që janë familjarë me bashkëpunimin transkombëtar (autoritete publike lokale dhe rajonale, agjencitë e mjedisit, universitetet, parqet natyrorë etj.). Për këto arsye, prioritetet e zhvillimit të qëndrueshëm, do të përbëjnë fushën më të rëndësishme të ndërhyrjes së Programit (rreth 34% të buxhetit).

Ata kompletohen me masa që i dedikohen luftës ndaj emisionit të gazit serë (efikasiteti i energjisë, energjia e rinovueshme, transport i qëndrueshëm). Programi MED do të ndërhyjë në këtë çështje të

mëvonshme në një mënyrë plotësuese, duke marrë parasysh programet rajonale dhe kombëtare, me një buxhet më të kufizuar (rreth 20% të buxhetit).

Duke marrë parasysh vështirësitë e bashkëpunimit transkombëtar të hasur në zonën MED, Programi do të marrë, gjithashtu, në konsideratë përmirësimin e proceseve të bashkëpunimit. Kjo mund të arrihet duke marrë parasysh qasjen makro rajonale. Përmirësimi i proceseve të bashkëpunimit mund të arrihet nëpërmjet testimit të masave të veçanta të ndërhyrjes të cilat nuk kërkojnë një buxhet të rëndësishëm (rreth 8% e buxhetit të Programit).

1.1.1.5 Strategjia e Programit trans-kombëtar med

A. Objektivi i përgjithshëm i Programit

Objektivi i përgjithshëm i programit MED është promovimi i rritjes së qëndrueshme në zonën e Mesdheut, nëpërmjet nxitjes së praktikave dhe koncepteve inovative (teknologjitë, qeverisja, shërbimet inovative ...) përdorimi i arsyeshëm i burimeve (energjia, uji, burimet detare ...) dhe mbështetja e integrimit social nëpërmjet përqasjes së integruar dhe territoriale të bashkëpunimit.

Në koherencë me buxhetin në dispozicion dhe mbulimin e gjerë gjeografik, programi ka si qëllim kryesisht forcimin e strategjive transkombëtare dhe rajonale të ndërhyrjes në fushat e rëndësisë mesdhetare, ku bashkëpunimi transkombëtar mund të kontribuojë në përmirësimin e praktikave rajonale dhe territoriale. Prandaj, programi MED do t'i japë një vëmendje të veçantë koherencës, plotësimit dhe transferimit të përvojave dhe praktikave me programet rajonale dhe kombëtare të ERDF-së, të cilat mund të ushqejnë aktivitetet transkombëtare dhe të përfitojnë nga rezultatet e tyre. Për periudhën 2014–2020, transferimi i përvojave ndërmjet aktorëve, territoreve dhe programeve, konsiderohet si qëllimi kryesor për Programin MED.

Kjo do të arrihet duke marrë parasysh potencialin dhe sfidat e sektorit specifik në lidhje me rritjen blu dhe të gjelbër, si: turizmi, bujqësia dhe agrobiznesi, deti dhe industritë mjedisore, energjia, transportet por, gjithashtu edhe industritë krijuese dhe ekonomia sociale, që janë veçanërisht të rëndësishme për zonën MED. Në këta sektorë të ndryshëm, objektivi është identifikimi më i mirë i potencialit zhvillimor dhe i sfidave në nivel transkombëtar, për të mbështetur palët e interesuara që promovojnë inovacionin dhe për t'i ndihmuar ata për t'u organizuar dhe për të ndarë përvojat dhe njohuritë me strukturat nga rajonet dhe vendet e tjera.

Programi do t'i japë një vëmendje të veçantë krijimit të kushteve të favorshme për diskutime transkombëtare dhe procesit transkombëtar të vendimmarrjes. Kjo do të mbështetet në veçanti në perspektivën e zhvillimit të strategjive makrorajonale ose të basenit të Detit në Mesdhe. Programi ndan një pjesë të madhe të zonave të tij të bashkëpunimit (4 shtete anëtare: Italia, Sllovenia, Kroacia, Greqia dhe 3 shtete joanëtare: Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Shqipëria) me Strategjinë e BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe Jonian (EUSAIR) i ndërtuar mbi katër shtyllat e mëposhtme: 1. Rritja blu; 2. Lidhja e rajonit; 3. Cilësia mjedisore; 4. Turizmi i qëndrueshëm. Plani i veprimit të EUSAIR-së u miratua nga Komisioni Evropian më 17 qershor 2014 dhe u dorëzua në konkluzionet e Këshillit të miratuara nga takimi i Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme më 23–24 tetor 2014[50].

Bashkë me Programin Adriatiko-Jonian, Programi MED 2014–2020 mund të kontribuojë në zbatimin e planit të veprimit të strategjisë së EUSAIR-së; sinergjitë dhe aktivitetet koordinuese midis programeve janë parashikuar në akse të ndryshme prioritare dhe prioritete investimi.

Në këtë kuadër, Programi (nëpërmjet Sekretariatit të Përbashkët) do të garantojë koherencën dhe plotësimin me programet tematike të BE-së, si: "Horizont 2020", Programi LIFE, COSME ose Programi për ndryshimin social dhe inovacionin social dhe programeve të tjera të bashkëpunimit si, ENI MED dhe programet mesdhetare të Ballkanit. Kjo do të arrihet duke u informuar mbi aktivitetet e tyre dhe kur është përkatëse, përshtatjen e thirrjeve nga Programi MED, me qëllim gjenerimin e sinergjive.

Në një mënyrë të kryqëzuar, një vëmendje e veçantë do t'u jepet zhvillimit dhe shpërndarjes së arritjeve ekoinovative që kanë si qëllim sigurimin e përdorimit më të qëndrueshëm të burimeve dhe reduktimin e ndotjes (ndotja e ajrit, ndotja e ujit, ndotja detare dhe mbeturinat detare ...).

"Inovacioni" u referohet zgjidhjeve teknike, shkencore, sociale, mjedisore, menaxheriale, organizative,

[50] Komunikatë (COM (2014) 357 përfundimtare) nga Komisioni për Parlamentin Evropian, për Këshillin, për Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe për Komitetin e rajoneve lidhur me Strategjinë e Bashkimit Evropian për rajonin Adriatiko-Jonian dhe planin e saj të Veprimit (SWD (2014) 190 përfundimtare).

tregtare ose administrative që çojnë në vlera krijimi (përmirësimi i teknologjive, proceset, sistemet e menaxhimit dhe qeverisjes, prokurimi publik i inovacionit ...).

Një përqasje ekosistemike

Përqasja është "e integruar" ose "ekosistemike" kur rezultati nuk është seri propozimesh të izoluara që fokusohen në aspekte të kufizuara të turizmit, transportit, industrisë krijuese, por një përpjekje globale koordinimi që i bën këto sfera të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të territoreve (duke marrë parasysh metodat në dispozicion, politikat ekzistuese publike, konfliktin e përdorimit, krijimin e vendeve të punës, përfshirjen e operatorëve publikë dhe privatë etj.). Partnerët duhet t'i bëjnë aktorët përkatës të sektorëve të mbrojtjes mjedisore, transportit, mjedisit etj., të punojnë së bashku. Me këtë përqasje, bashkëpunimi transkombëtar do të kontribuojë në zhvillimin e aspekteve të planifikimit strategjik.

Projektet duhet të zhvillohen, gjithashtu, duke marrë parasysh analizimin dhe eksplorimin e idesë, ndërtimin e strategjisë, zbatimin e aktiviteteve (përfshirë veprimet pilot kur është e mundur) dhe një shpërndarje më të gjerë të përvojave dhe rezultateve në territoret drejt të gjithë përdoruesve të fundit. Në programin MED, qasja materializohet nga "module" të ndryshme ose hapa që përfituesit duhet t'u referohen gjatë përpunimit të projektit (shihni pjesën 2.A.6.2, "*Parimet udhëzuese për përzgjedhjen e operacioneve*").

... **për një rritje inteligjente të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse**

Për rritjen e zgjuar, Programi do t'i kushtojë vëmendje të veçantë zhvillimit të strategjive rajonale të inovacionit dhe strategjive inteligjente të specializimit (RIS3) që ndikon në sektorët kyç të përmendur më parë. Ai do të mbështesë proceset e shkëmbimit në mënyrë që të zhvillojë këto strategji, të forcojë grupimet, rrjetet, sektorët ekonomikë, zinxhirët e vlerës dhe të përmirësojë zbatimin e tyre dhe të rrisë bashkëveprimin e tyre midis rajoneve të Mesdheut. Kjo do të arrihet veçanërisht falë promovimit të mundësive të bashkëpunimit midis institucioneve kërkimore dhe SME-ve inovative, midis SME-ve të rajoneve të ndryshme (midis grupimeve të tyre) dhe koordinimit, dhe monitorimit të operacioneve inteligjente të specializimit në nivel rajonal dhe ndërrajonal.

Në lidhje me rritjen e qëndrueshme, duke marrë parasysh presionin e evidentuar në zonat urbane dhe bregdetare të Mesdheut, Programi MED do të kërkojë të promovojë përdorimin e burimeve të energjisë me emision të ulët karboni, reduktimin e ndikimit të aktiviteteve njerëzore në burimet natyrore dhe përmirësimin e mjedisit të jetës dhe të shëndetit. Ai do të fokusohet veçanërisht në strategjitë e përziera të energjisë, përmirësimin e menaxhimit të ujit dhe menaxhimin e burimeve natyrore në zonat detare dhe bregdetare.

Në këto fusha, një vëmendje e veçantë do t'i jepet koordinimit me programet kombëtare dhe rajonale të BE-së, me qëllim përdorimin e të dhënave ekzistuese dhe shpërndarjen e rezultateve të projekteve MED. Në lidhje me këtë, partnerët e projekteve transkombëtare duhet të jenë të vetëdijshëm për nevojat rajonale dhe të propozojnë mënyra për shpërndarjen e rezultateve drejt programeve rajonale qendrore.

Nga pikëpamja territoriale dhe gjeografike, përveç zonave urbane dhe bregdetare, Programi do t'u kushtojë një vëmendje të veçantë ishujve dhe zonave të largëta, me qëllim promovimin e transferimit të politikës në nivel transkombëtar që aktualisht mungon.

Në nivel transkombëtar, dikush mund të evidentojë fusha të rëndësishme për ndërhyrje ku bashkëpunimi midis shteteve dhe rajoneve është i pamjaftueshëm. P.sh., për Planifikimin Hapësinor Detar (MSP), Menaxhimi i Integruar i Zonave Bregdetare (ICZM), siguria detare, transporti, energjia ose ndotja e Detit Mesdhe (ndotja detare dhe mbeturinat detare). Në këto fusha, nevojitet një angazhim më i lartë institucional dhe politik dhe mund të promovohet nëpërmjet një përqasjeje makrorajonale, të mbështetur nga Programi MED. Kjo do të bëhet nëpërmjet bashkërendimit të ngushtë me zbatimin e Direktivës Kuadër të BE-së për Strategjinë Detare dhe në bashkëpunim me Konventën e Barcelonës.

Për zbatimin e një përqasjeje makrorajonale ose në lidhje me zhvillimin e sektorëve kyç ekonomikë mesdhetarë ose menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve, përfshirja e autoriteteve ose ekspertëve nga bregu jugor i Mesdheut është një aset për të ardhmen (menaxhimi i ujit, bujqësia në Mesdhe etj.) dhe kontributi i tyre do të inkurajohet mjaft.

B. Lloji i kontributit që pritet nga Programi MED

Duke u kushtuar vëmendje dimensioneve të ndryshme të një projekti (analiza, përcaktimi i strategjive, zbatimi i aktiviteteve dhe i projekteve pilot, shpërndarja/transferimi i përvojave), Programi do të japë mundësi për përmirësimin e ekspertizës, njohurisë, rrjetëzimit dhe do të mbështesë ngritjen e kapaciteteve për organet publike dhe private. Kur është e përshtatshme, Programi do të mbështesë aksionet pilot për

testimin e instrumenteve, proceseve dhe sistemeve të qeverisjes që kontribuojnë në përmirësimin e ndërhyrjeve publike dhe mbështetjen e zhvillimeve afatgjata dhe të qëndrueshme në sektorët kyç të rritjes së gjelbër dhe blu (energjia, bujqësia dhe agrobiznesi, bioteknologjitë, ekondërtimet etj.).

Si një Program transkombëtar, kontributi kryesor i tij është shkëmbimi dhe transferimi i përvojave midis rajoneve, mbështetja e strategjive transkombëtare dhe ngritja e kapaciteteve dhe garantimi që rezultatet të shpërndahen dhe të përdoren përtej partnerëve të projektit, duke arritur një numër të madh përdoruesish të fundit.

Programi do të mbështesë veçanërisht, formimin e ekipeve shumënivelesh dhe ndërsektoriale të punës dhe partneriteteve, me qëllim tejkalimin e vështirësive administrative dhe sektoriale, bashkë me përfshirjen e qytetarëve dhe organeve lokale, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Në nivel territorial, një çështje kyçe do të jetë reduktimi i konflikteve të përdorimit të cilat formojnë aspektin kryesor të strategjive të zhvillimit të qëndrueshëm (promovimi i energjisë së rinovueshme, mbrojtja e trashëgimisë dhe natyrore, dhe kulturore, reduktimi i emisionit të karbonit etj.).

Ndërmjet kushteve kuadër për zbatimin e veprimeve, palët e interesuara duhet të kenë parasysh që projektet nuk kanë si qëllim të plotësojnë nevojat e një numri të kufizuar të partnerëve, por të kontribuojnë për kushte më të mira jetese në territoret e MED-së (aktivitetet ekonomike, cilësia e mjedisit, siguria etj.).

Duke marrë parasysh vështirësitë për krijimin e marrëveshjeve të gjera politike në nivel mesdhetar, Programi kërkon, gjithashtu, të promovojë proceset vendimmarrëse midis rajoneve dhe shteteve pjesëmarrëse. Krijimi i mikrorajoneve dhe i strategjive të basenit të detit përbëjnë një hap përpara në këtë drejtim. Në periudhën 2014–2020, me krijimin e strategjisë së BE-së për rajonin e Adriatikut dhe Jonit (EUSAIR), Programi MED mund të ofrojë mbështetje në çështjet që janë përkatëse me prioritet e tij. Programi MED do të kërkojë, gjithashtu, të përmirësojë integrimin e politikave dhe strategjive në fushat e tij të ndërhyrjes duke shtruar rrugën për një bashkëpunim transkombëtar me të fortë dhe më efecient në vitet në vijim.

Nga pikëpamja e veprimit dhe rezultateve, duke marrë parasysh strategjinë e programit, Programi MED ofron kryesisht:

- Politika dhe strategji;
- Metodologji dhe mjete;
- Aksione pilot;
- Sisteme menaxhimi të përbashkëta dhe marrëveshje bashkëpunimi.

Si një Program transkombëtar, Programi MED nuk do të mbështesë as investime të rënda, zhvillime të mëdha infrastrukturore dhe as kërkime shkencore dhe strukturore si të tilla. Investimet në instrumentet ose infrastrukturën në shkallë të vogël, mund të mbështeten në rastin e projekteve pilot dhe përvojave territoriale. Programi MED mbështet, në veçanti, veprimet e paprekshme ose "të buta", të cilat mund të kenë potencialisht një efekt afatgjatë dhe që ofrojnë vizibilitet për Programin (studime dhe kërkime, rrjetëzime, shpërndarja e njohurive dhe e të dhënave etj.).

Në lidhje me zbatimin e veprimeve, ka një dallim të qartë midis "përfituesve" dhe "grupeve të synuara" ose "përdoruesit e fundit". Në kontekstin e Programit, përfituesit janë trupa dhe organizata që do të përfshihen drejtpërdrejt në projektet e financuara nga Programi dhe do të jenë ata që do të krijojnë, do të diskutojnë dhe do të zhvillojnë produktet e përshkruara më sipër. "Grupet e synuara" ose "përdoruesit e fundit" janë organe, grupe dhe individë të cilët duhet të përdorin rezultatet e projekteve ose do të përjetojnë një ndryshim në aktivitetet dhe jetën e tyre për arsye të rezultateve.

C. Objektivat tematikë të përzgjedhur, prioritetet në investime dhe objektivat specifikë

Për çdo objektiv tematik, një set i prioriteteve të veçanta të investimit (PI) është parapërcaktuar, duke reflektuar sfidat me të cilat po përballen rajonet e Mesdheut:

- Diagnoza dhe nevojat e identifikuara për rajonet MED;
- Mësimet e nxjerra nga periudha 2007–2013;
- Aplikimi i përqendrimit tematik në një numër më të vogël të prioriteteve që lidhen me strategjinë "Evropa 2020" dhe vlerësimin e rezultateve;
- Plotësimi me Programe të tjera tematike dhe rajonale të BE-së;
- Veçantitë e programeve të bashkëpunimit transkombëtar.

Për Programin MED janë përzgjedhur 4 objektiva tematikë dhe 6 prioritete të investimeve, si më poshtë:

Aksi prioritar 1. Promovimi i kapaciteteve inovative të Mesdheut për zhvillimin e rritjes "inteligjente" dhe të qëndrueshme

Objektivi tematik 1. Forcimi i kërkimit, i zhvillimit teknologjik dhe i inovacionit, përmes:

PI 1b: Promovimit të investimeve të biznesit në R&I, të zhvillimit të lidhjeve dhe sinergjive ndërmjet ndërmarrjeve, qendrave të kërkimit dhe zhvillimore dhe sektorëve të arsimit të lartë, në veçanti promovimit të investimeve në zhvillimin e programeve dhe produkteve, transferimit të teknologjive, inovacionit social, ekoinovacionit, aplikacioneve të shërbimeve publike, stimulimeve të kërkesave, rrjetëzimit, grupimeve dhe inovacioneve të hapura nëpërmjet specializimit "të zgjuar" dhe mbështetjes teknologjike dhe kërkimit të aplikuar, linjat pilote, aksioneve të hershme të vleftësimit të produkteve, kapaciteteve të avancuara të industrisë përpunuese dhe prodhimit të parë, në veçanti, në teknologjitë kyçe mundësuese dhe përhapjen e teknologjive për qëllim të përgjithshëm.

OS 1.1: Për të rritur aktivitetin transkombëtar të grupimeve inovative dhe të rrjeteve të sektorëve kyç të zonës MED.

Aksi prioritar 2. Nxitja e strategjive me karbon të ulët dhe eficienca e energjisë në territoret specifike të MED-së: qytete, ishuj dhe zona rurale

Objektivi tematik 4. Mbështetja e ndryshimit drejt një ekonomie me karbon të ulët në të gjithë sektorët, duke:

PI 4c: Mbështetur eficiencën e energjisë, menaxhimin "e zgjuar" të energjisë dhe përdorimin e energjisë së rinovueshme në infrastrukturat publike, përfshirë ndërtesat publike dhe në sektorin e banesave;

OS 2.1: Ngritur kapacitetet për një menaxhim më të mirë të energjisë në ndërtesat publike në nivel transkombëtar;

PI 4e: Promovuar strategjitë me karbon të ulët për të gjitha llojet e territoreve, në veçanti për zonat urbane, duke përfshirë promovimin e lëvizshmërisë urbane multimodale të qëndrueshme dhe masa adaptuese të zbutura;

OS 2.2: Duke rritur shpërndarjen e burimeve lokale të energjisë së rinovueshme në strategjitë dhe planet e përziera të energjisë, në veçanti në territoret e MED-së;

OS 2.3: Duke rritur kapacitetet për përdorimin e sistemeve ekzistuese të transporteve me karbon të ulët dhe lidhjet multimodale midis tyre.

Aksi prioritar 3. Mbrojtja dhe promovimi i burimeve natyrore dhe kulturore të Mesdheut

Objektivi tematik 6. Ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i eficiencës së burimeve, përmes:

PI 6c: Konservimit, mbrojtjes, promovimit dhe zhvillimit të trashëgimisë natyrore dhe kulturore;

OS 3.1: Nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm dhe të besueshëm të turizmit bregdetar dhe detar në zonën MED;

PI 6d: Mbrojtjes dhe rimëkëmbjes së biodiversitetit dhe të tokës dhe promovimit të shërbimeve të ekosistemit edhe nëpërmjet "Natura 2000" dhe infrastrukturës së gjelbër;

OS 3.2: Mbajtjes së biodiversitetit dhe ekosistemeve natyrore nëpërmjet fuqizimit të menaxhimit dhe rrjetëzimit të zonave të mbrojtura.

Aksi prioritar 4. Përmirësimi i qeverisjes në Mesdhe

Objektivi tematik 11. Nxitja e kapaciteteve institucionale të autoritete publike dhe palëve të interesuara dhe eficiencës së administratës publike, nëpërmjet veprimeve për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe eficiencën e administratës publike dhe shërbimeve publike në lidhje me zbatimin e ERDF:

PI 11: Përmirësimi i qeverisjes në Mesdhe;

OS 4.1: Mbështetja e procesit të fuqizimit dhe zhvillimit të kornizave të koordinimit multilateral në Mesdhe për përgjigje të përbashkëta ndaj sfidave të përbashkëta.

Informacioni i detajuar për objektivat specifikë paraqitet në seksionin 2.

D. Dimensionet horizontale

Përveç orientimit tematik, Programi MED adreson aspektet tematike horizontale të theksuara në rregulloret e BE-së: Zhvillim i qëndrueshëm, mundësi të barabarta dhe mosdiskriminimi, barazia midis burrave dhe grave. Këto parime horizontale zhvillohen më tej në seksionin 8 të Programit të bashkëpunimit.

Përveç përqendrimit tematik dhe zgjedhjes së objektivit tematik, çështje specifike do të adresohen në një mënyrë të kryqëzuar në prioritetet e ndryshme të investimit të Programit, duke kontribuar në

objektivat e përgjithshëm të Programit:

Teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit

Zhvillimi i produkteve të TIK-ut, shërbimeve dhe aplikacioneve përbëjnë një mbështetje përkatëse për zhvillimin socioekonomik, qeverisjen, rrjetëzimin etj. Si një instrument, TIK-u mund të përdoret në mënyrë tërthore në mënyrë që të përmbushen objektivat e disa prioriteteve të investimit.

Kohezioni social dhe inovacioni social

Në fusha të ndryshme të ndërhyrjes, një vëmendje pozitive do t'u kushtohet projekteve që përfshijnë partnerë ose marrin masa që kanë efekte pozitive në kohezionin social. Ky është në veçanti rasti, kur përfshirja e ndërmarrjeve sociale ose zbatimi i veprimeve që përmirësojnë kushtet e grupeve të synuara ballafaqohen me vështirësitë e integrimit ekonomik dhe social.

Të dhënat dhe menaxhimi i njohurive

Çdo projekt dhe çdo partner projekti duhet të vërë në dispozicion për publikun, të dhënat e përdorura për projektet ose të gjeneruara nga projektet, në mënyrë që të rrisë shkëmbimin e përvojave dhe rezultateve. Projektet inkurajohen të ofrojnë setet e të dhënave në përputhje me parimin "të dhënat e hapura në mënyrë të parazgjedhur", në mënyrë që të përmirësojnë përhapjen dhe ripërdorimin e të dhënave midis institucioneve publike, partnerëve dhe publikut të gjerë.

Përqasja territoriale dhe ekosistemike

Në çdo territor të synuar (ishuj, zona urbane, bregdetare dhe të largëta), projektet duhet të përfshijnë sektorët përkatës dhe palët e interesuara institucionale nga fusha e ndërhyrjes së projektit. Përqasjet duhet të jenë "të integruara" ose "ekosistemike", në mënyrë që rezultatet të mos jenë propozime të izoluara që përfshijnë aspekte të kufizuara të turizmit, energjisë ose transportit, p.sh., por një përpjekje koordinuese që insiston për kontributin e këtyre sferave në zhvillimin e qëndrueshëm të territoreve (duke marrë parasysh mënyrat në dispozicion, perspektivat ekonomike, politikat publike në vazhdim, konfliktin e përdorimit, detyrimet mjedisore etj.).

Partnerët duhet të zbulojnë si t'i bëjnë të punojnë së bashku aktorët përkatës të mbrojtjes mjedisore, turizmit, sektorëve të transportit etj. Me këtë përqasje, bashkëpunimi transkombëtar do të kontribuojë në zhvillimin e aspekteve të planifikimit strategjik.

E. Arsyetimi për ndryshimet në gjeografinë e Programit

Krahasuar me periudhën 2007–2013, tri rajone shtesë janë pranuar për pjesëmarrjen në Programin MED: *Area Metropolitana de Lisboa* (Portugali); *Midi-Pyrenees* (Francë); *Valle d'Aosta/Valle d'Aoste* (Itali).

Këto rajone kanë plotësuar një pyetësor të dërguar nga autoritetet e Programit, duke specifikuar profilin e tyre, lidhjen e tyre me zonën e Mesdheut dhe kontributin e tyre për sfidat kryesore të Mesdheut (zhvillimi ekonomik, mjedisi, kohezioni territorial ...).

"Dimensioni mesdhetar" i aplikantëve ishte një argument kyç për përzgjedhjen e tyre, si dhe kontributin që ata mund të sillnin në krijimin e strategjive të ardhshme makrorajonale dhe basenin e detit në Mesdhe.

Përqasja makrorajonale është veçanërisht përkatëse për rajonin e *Area Petropolitana de Lisboa* si një rajon kryeqytet. Për më tepër, përfshirja e rajonit *Area Petropolitana de Lisboa*, si një qendër ekonomike dhe administrative, forcon, gjithashtu, sinergjinë në Program me rajonet e *Algarve* dhe *Alentejo*.

Rajoni i *Midi-Pyrenees* është tashmë i përfshirë në programe të tjera të Evropës Jugore (SUDOE dhe POCTEFA) me prioritete që janë pothuaj të ngjashme me zonën e Programit MED (kërkimi/inovacioni, mjedisi, aksesueshmëria, zhvillimi i qëndrueshëm urban ...). Ky rajon ka një përvojë domethënëse në fushat shkencore që lidhen me vëzhgimin satelitor, oqeanografinë, meteorologjinë dhe ujitjen, duke qenë një vlerë e shtuar për Programin MED.

Rajoni i *Valle d'Aosta/Valle d'Aoste* merr pjesë në eurorajonin Aple–Mesdhe por nuk ka qenë i përfshirë në Programin MED 2007–2013. Ky rajon ka shqetësime, në çështje si rreziqet natyrore, ndryshimi i klimës dhe i aksesit, duke qenë koherent me prioritetet e Programit MED. Ai ka një përvojë të madhe në projektet e bashkëpunimit territorial me një përfshirje aktive në dy programe të bashkëpunimit ndërkufitar (ALCOTRA dhe Itali/Zvicër) dhe dy transkombëtare (*Alpine Space* dhe *Central Europe*).

1.1.2 Arsyetimi për përzgjedhjen e objektivave tematikë dhe prioritetet korresponduese në investime

Tabela 1. Një pamje e përgjithshme e arsyetimit për përzgjedhjen e objektivave tematikë dhe prioritetet e investimit

Objektivi tematik i përzgjedhur	Prioriteti i përzgjedhur i investimit	Arsyetimi për përzgjedhjen Secili, 1000 karaktere
Objektivi tematik 1 **Forcimi i kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit (...)**	**Prioriteti i investimit 1b** Promovimi i investimi të bizneseve në lidhjet e inovacionit dhe të kërkimit, dhe të zhvillimit dhe sinergjitë midis ndërmarrjeve, qendrave R&D dhe arsimit të lartë (...)	- Nevoja për përmirësimin e kapaciteteve të inovacionit, konkurrueshmërisë dhe ndërkombëtarizimit të SME-ve përballë konkurrencës ndërkombëtare (turizmi, agrobiznesi, industritë kreative ...) - Nevoja për përmirësimin e bashkëpunimit midis aktorëve të spirales së katërfishtë, veçanërisht midis kërkimit dhe bizneseve - Nevoja për përforcimin e sektorëve të rritjes që përfaqësojnë potencial të rëndësishëm për punësim (sektorët e rritjes blu dhe të gjelbër) - Nevoja për mbështetjen e inovacioneve sociale në kontekstin e krizës së fortë ekonomike dhe buxhetit publik të kufizuar
Objektivi tematik 4 **Mbështetje për kalimin drejt një ekonomie me karbon të ulët në të gjithë sektorët**	**Prioriteti i investimit 4c** Mbështetja e eficiencës së energjisë, menaxhimin "e zgjuar" të energjisë dhe përdorimin e energjisë së rinovueshme në infrastrukturat publike, duke përfshirë ndërtesat publike dhe sektorin e banesave	- Nevoja për reduktimin e emisionit të GHG-së në rajonet e Mesdheut - Eficiencë e dobët energjie në sektorët ekzistues rezidencialë dhe ndërtesave të tjera në rajonet MED - Autonomi e pamjaftueshme e energjisë që kërkon kursim më të lartë energjie dhe eficiencë energjie - Njohuri e pamjaftueshme e pronarëve, menaxherëve dhe autoriteteve publike në lidhje me rritjen e eficiencës së energjisë në ndërtesat publike - Kushte specifike ekonomike, gjeografike dhe klimatike në rajonet e MED-së (qytetet, zonat bregdetare, ishujt, zonat e largëta) që kërkojnë marrjen e masave *ad hoc*, në favor të eficiencës së energjisë
	Prioriteti i investimit 4e Promovimi i strategjive me karbon të ulët për të gjitha llojet e territoreve, në veçanti për zonat urbane, përfshirë promovimin e lëvizshmërisë së qëndrueshme urbane multimodale dhe masave adaptuese përkatëse zbutëse	- Emision shumë i rëndësishëm i GHG në sektorin e transportit dhe qytetet e Mesdheut - Nevoja për përmirësimin e mjedisit të jetës në zonat me densitet të lartë, reduktimin e efektit të aktivitetit të njerëzve në det, tokë, ajër dhe shëndetin njerëzor - Nevoja për mbajtjen dhe përmirësimin e lëvizshmërisë dhe cilësisë së jetës së popullsisë në kontekstin e krizës ekonomike - Përdorimi i energjisë të rinovueshme më i ulët se mesatarja e BE-së - Ndarje e tepërt e mallrave të transportuara në rrugë tokësore dhe ndikimi i madh i transportit në zonën MED - Presion i lartë në rrugët bregdetare të pafuqishme për thithjen e trafikut në rritje - Shërbime të kufizuara publike transkombëtare detare/hekurudhore për pasagjerët dhe mallrat (përfshirë anijet që mund të jetë, gjithashtu, një burim i madh i emisionit, veçanërisht në portet: PM, SO_2, NO_2 ... që ndikojnë në jetën e njerëzve dhe ekosistemeve) - Nevoja për transport dhe logjistika si leva për zhvillimin e konkurrueshmërisë së zonës MED

Objektivat tematikë të identifikuar	Prioritetet e identifikuara të investimeve	Arsyetimi për identifikimin 1000 karaktere secili
Objektivi tematik 6 **Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi** **i efikasitetit të burimeve**	**Prioriteti i investimeve 6c** Ruajtja, mbrojtja, promovimi dhe zhvillimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore	- Pasuri të rëndësishme kulturore të rajoneve MED, të kërcënuara nga aktivitetet njerëzore - Fluks i lartë i aktiviteteve turistike dhe i urbanizimit, kryesisht në zonat bregdetare të rajoneve MED - Rritje e presionit mbi burimet natyrore për shkak të kombinimit të aktiviteteve njerëzore dhe ndryshimeve mjedisore (kryesisht ndryshimet e klimës) - Rritje e presionit mbi burimet ujore nga një pikëpamje cilësore dhe sasiore
	Prioriteti i investimeve 6d Mbrojtja dhe ripërtëritja e biodiversitetit, mbrojtja e tokës dhe restaurimi, promovimi i shërbimeve për ekosistemin, përfshirë "Natura 2000" dhe infrastrukturën e gjelbër	- Burime të rëndësishme mjedisore të rajoneve MED, të kërcënuara nga aktivitetet njerëzore - Presion mbi biodiversitetin dhe zhvillimi i specieve invazive - Presion mbi cilësinë e ujit me pasoja të drejtpërdrejta mbi biodiversitetin - Rol kyç i mjedisit në atraksionin dhe zhvillimin ekonomik të rajoneve MED
Objektivi tematik 11 **Përforcimi i kapaciteteve institucionale dhe i një administrate publike efikase**	**Prioriteti i investimeve 11c** Zhvillimi dhe koordinimi makrorajonal dhe Strategjitë detare (ETC-TN)	- Nevoja për koordinim të përmirësuar të strategjive ekzistuese dhe strategjive makrorajonale dhe detare - Mungesa e marrëveshjeve transkombëtare në fushat kyçe si transporti, energjia ose pastrimi i Mesdheut nga ndotja

1.2 Arsyetimi për alokimet financiare

Alokimet financiare mbi secilin objektiv tematik janë caktuar në bazë të:

Llojit të aktiviteteve të përcaktuara në Programin e Bashkëpunimit (të cilat udhëzojnë mbi llojin e partneritetit të dëshiruar, probabilitetin e projekteve të investimit/pilote, sasinë e grupeve të interesit të interesuara);

Llojit të grupeve të interesit të parashikuara

Atraksioni i Programit mbi grupet e ndryshme të interesit (kapacitet mobilizues) bazuar mbi përvojën aktuale (kur është e mundur).

Aksi prioritar 1. Promovimi i kapaciteteve inovative të zonës së Mesdheut për zhvillimin e rritjes së zgjuar dhe të qëndrueshme (*Objektivi tematik 1)*

Inovacioni dhe konkurrueshmëria janë veçanërisht të theksuara në strategjinë "Evropa 2020". Kjo është një sfidë shumë e rëndësishme për rajonet MED, të cilat po ndeshen me konkurrueshmërinë ndërkombëtare dhe, gjithashtu, do të jetë një instrument për të kapërcyer krizat ekonomike.

Veprimtaritë konsistojnë kryesisht në vendosjen e grupeve dhe rrjeteve, në zhvillimin e modeleve dhe instrumenteve dhe në transferimin e njohurive, rritjen e ndërgjegjësimit, aktiviteteve të kapitalizimit. Projekte pilote me investime nuk janë të shumta ose të paktën jo të shpeshta.

Grupet kyçe të interesuara janë sipërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME-të) dhe strukturat përkatëse, autoritetet publike dhe strukturat kërkimore (*shihni përkufizimin e SME-ve në shtojcën e Programit të Bashkëpunimit - fjalori)*.

Periudha e prioritetit të inovacionit, 2007–2013, ka përthithur një numër të lartë projektpropozimesh, duke mundësuar programimin e pothuajse të gjithë buxhetit të parashikuar për të dyja thirrjet standarde të hapura. Atraksioni i Programit për grupet e interesit ka qenë tejet i dukshëm dhe rezultatet e paraqitura, në rastin e konsultimeve publike për prioritetet e Programit MED 2014–2020, e kanë dëshmuar këtë pasi fusha e analizuar u klasifikua si më e rëndësishmja nga për Programin e ri të bashkëpunimit nga grupet e ndryshme të interesit.

Për aksin prioritar 1 është parashikuar një buxhet prej 84.450.833 eurosh, duke pasur parasysh nevojat për ngritjen e kapaciteteve inovative në zonën e Programit MED, përpjekjet që do të bëhen për të tërhequr sa më shumë operatorë ekonomikë dhe aftësitë mobilizuese të grupeve të tjera të interesit të spirales së katërfishtë.

Aksi prioritar 2. Nxitja e strategjive me karbon të ulët dhe e përdorimit efikas të energjisë në territore të caktuara të zonës MED: qytete, ishuj dhe zona rurale (*Objektivi tematik 4)*

Ekonomia me nivel të ulët të karbonit është një çështje kyçe për një zhvillim territorial të qëndrueshëm dhe për objektivat e BE-së (ulja e GHG-së, rritja e efikasitetit të energjisë dhe përdorimi i energjisë së rinovueshme). Kjo çështje është e një rëndësie të veçantë, sidomos në zonat MED, për sa i përket uljes së pasojave/ndikimit, që ndryshimet klimatike kanë në këtë rajon. Gjithsesi, kontributi i Programit MED, duhet të jetë në linjë dhe të ketë parasysh edhe mbështetjen e rëndësishme që programet rajonale dhe kombëtare tashmë po ofrojnë në këto zona.

Aktivitetet e parashikuara kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve, rritjen e ndërgjegjësimit, ndërtimin e strategjive, trajnimin dhe shkëmbimin e përvojave (jo vetëm të përdoruesve fundorë, por edhe të autoriteteve publike dhe mundësisht të sipërmarrjeve të interesit). Një pjesë e aktiviteteve do të jetë e lidhur me studime fizibiliteti dhe analiza, me përpunimin e planeve të politikave, me shërbimet dhe mjetet lidhur me këtë aks prioritar. Në këtë prioritet mundësia e investimeve të nivelit të ulët është shumë e lartë dhe mund të jenë të pranishëm projekte pilote që përfshinë këto lloje investimesh (shërbime dhe metoda TIK, mjete për efikasitetin e energjisë, shërbime pilote ...).

Ky aks përfshin tri fusha të ndryshme aktivitetesh: efikasiteti i energjisë, prodhimi dhe përdorimi i energjisë së rinovueshme dhe lëvizshmëria e ulët e karbonit. Grupet e interesit janë autoritetet publike, institutet kërkimore, sipërmarrjet, organizatat joqeveritare/organizatat e shoqërisë civile, ku këto të fundit do të luajnë një rol shumë të rëndësishëm për sa i përket përdoruesit fundor.

Në konsultimin me grupet e interesit, ekonomia me minimizim të karbonit nuk është përfshirë si një fushë kyçe për periudhën e re të Programit, por efikasiteti i energjisë dhe promovimi i energjisë së rinovueshme, janë konsideruar si një çështje me prioritet të lartë.

Pjesa e buxhetit për këtë prioritet, është llogaritur në përputhje me kapacitetin e mobilizimit të grupeve të interesit, si edhe në përputhje me mundësitë e realizimit të investimeve pilote në shkallë të ulët (mundësisht një numër i ulët projektesh pilote, por me një buxhet për projekt më të lartë se mesatarja).

Buxheti për këtë Aks Prioritar është 52.781.771 euro, rreth 20% e buxhetit total të Programit.

Aksi prioritar 3. Mbrojtja e promovimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore të zonës së Mesdheut (*Objektivi tematik 6)*

Në rajonet MED, mbrojtja e mjedisit është një nga sfidat më të mëdha, me vëmendje të veçantë për sa u përket atraksionit të zonave bregdetare, dëmtimeve mjedisore nga zhvillimi urban, kufizimeve gjeografike dhe pasojave të ndryshimit të klimës mbi mjedisin. Ko fushë, gjithashtu, do të jetë një mundësi potenciale punësimi në të ardhmen.

Aktivitetet kryesore: fokusim në analiza, studime, planifikime politikash, zhvillime strategjisë, por edhe transferim përvoje dhe masa për zbatimin e politikave. Projekte pilote me investime nuk do të jenë të vazhdueshme edhe pse disa projekte pilote për testimin e mjeteve ose shërbimeve mund të jenë të mundshme.

Fushat e përzgjedhura për Programin e Bashkëpunimit: zhvillimi i një turizmi të qëndrueshëm, mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, zhvillimi i aktiviteteve njerëzore në përputhje me ndryshimet mjedisore dhe klimatike, si edhe biodiversiteti, të cilat i japin sfida të mëdha zonës MED. Fushat në fjalë kanë nevojë për një koordinim transkombëtar dhe, gjithashtu, nuk janë shumë të mbuluara nga financimet rajonale ERDF.

Grupet e interesit janë të shumta, pasi dhe vetë aksi prioritar prek fusha të ndryshme aktivitetesh, më në veçanti: autoritetet publike, shoqatat dhe organizatat joqeveritare, grupet kërkimore dhe disa sipërmarrje përkatëse.

Fusha përfshin një numër shumë të lartë të grupeve potenciale të interesit dhe do të jetë, gjithashtu, aksi kyç për mbështetjen e projekteve të mundshëm prioritare që lidhen me strategjitë ekzistuese ose të parashikuara makrorajonale ose detare. Niveli i buxhetit është përshtatur rrjedhimisht. Buxheti për këtë aks është 89,729,012 euro, rreth 34% i buxhetit total të Programit.

Aksi prioritar 4. Përmirësimi i qeverisjes së zonës së Mesdheut (*Objektivi tematik 11)*

Ky prioritet është një eksperiment dhe një sfidë, por nevoja për një koordinim sa më të mirë midis autoriteteve të zonës së Programit është padyshim e padiskutueshme. Për më tepër, një pjesë e hapësirës së Programit është e interesuar nga një strategji makrorajonale.

Duke pasur parasysh natyrën eksperimentale të këtij prioriteti dhe, gjithashtu, mundësinë për financimin e projekteve pilote "makrorajonale" të EUSAIR-së nëpërmjet prioriteteve tematike (veçanërisht nëpërmjet prioritetit 3), niveli i buxhetit duhet të përshtatet me parashikimin e mundësive për mobilizimin e grupeve kyçe të interesit të përfaqësuara nga autoritetet shtetërore, rajonale dhe lokale. Duhet pranuar, gjithashtu, se për përdorimin e buxhetit të këtij prioriteti, është e nevojshme mbështetja politike, duke qenë se kemi të bëjmë me një Program ku këto dinamika nuk mund të konsiderohen si të sigurta. Gjithsesi është shumë e rëndësishme që në zona e Mesdheut të jepet një mekanizëm mbështetjeje për inkurajimin e zhvillimit sa më pozitiv të qeverisjes shumëpalëshe të kësaj hapësire.

Buxheti për këtë aks prioritar është 21.112.708 euro, pra rreth 8% i buxhetit total të Programit.

Tabela 2. Pasqyra e strategjive të investimit të Programit të Bashkëpunimit

Aksi prioritar	Mbështetja e ERDF-së (euro)	Niveli në përqindje i financimit total të BE-së për Programin e Bashkëpunimit (sipas fondeve[51])			Objektivi tematik[52]	Prioritetet e investimeve[53]	Objektivat specifikë	Treguesit e rezultateve në bazë të secilit objektiv specifik
		ERDF	ENI (ku aplikohet)	IPA (ku aplikohet)				
1	71,783,208	30.72%	0%	1.28%	1. Përforcimi i aktiviteteve kërkimore, të zhvillimit të teknologjisë dhe të inovacionit	Prioriteti i investimeve 1.b Promovimi i investimeve të biznesit në kërkim dhe në inovacion (R&I), nëpërmjet zhvillimit të kontakteve dhe sinergjive, midis sipërmarrjeve, qendrave kërkimore dhe të arsimit të lartë (...)	1.1 Rritja e aktiviteteve transkombëtare të grupimeve dhe rrjeteve të sektorëve kyç të zonës MED	Shpërndarje e grupimeve inovative (përfshirë aktivitetet RDI) për t'u ofruar anëtarëve të tyre një shumëllojshmëri të konsoliduar aktivitetesh transkombëtare në sektorët kyç të zonës MED
2	44,864,505	19.20%	0%	0.80%	4. Mbështetja e zhvendosjes drejt një ekonomie	Prioriteti i investimeve 4.e Promovimi i strategjive me karbon të ulët për të gjitha territoret, sidomos për zonat urbane, përfshirë promovimin e lëvizshmërisë urbane multimodal të qëndrueshëm dhe marrja e masave për adaptimin përkatës	2.3 Rritja e kapaciteteve për përdorimin e sisteme të transportit të karbonit ekzistues dhe të komunikimeve multimodale ndërmjet tyre	Niveli i planeve urbanistike që përfshin transportin e ulët të karbonit dhe lidhjet multimodale me veprimtari të lehta
						Prioriteti i investimeve 4.c Mbështetja e efikasitetit të energjisë, menaxhimi i energjisë së zgjuar dhe përdorimi i energjisë së rinovueshme në infrastrukturat publike, të përfshira në ndërtesat publike dhe në sektorin e	2.1 Ngritja e kapaciteteve për një menaxhim më të mirë të energjisë në ndërtesat publike në nivel transkombëtar	Shpërndarje e planeve rajonale, nënrajonale dhe lokale mbi efikasitetin e përdorimit të energjisë, përfshirë masat e ndërmarra për sa u përket ndërtesave publike ekzistuese

[51] Prezantimi i përqindjes të fondeve ENI dhe IPA varet nga lloji i menaxhimit të zgjedhur.
[52] Titulli i objektivit tematik; nuk aplikohet për asistencën teknike.
[53] Titulli i prioritetit të investimeve; nuk aplikohet për asistencën teknike.

						banesave private		
						Prioriteti i Investimeve 4.e Promovimi i strategjive me karbon të ulët për të gjitha territoret, sidomos për zonat urbane, përfshirë promovimin e lëvizshmërisë urbane multimodal të qëndrueshëm dhe marrja e masave për adaptimin përkatës	2.2 Rritja e nivelit të përfshirjes së burimeve të energjisë së rinovueshme lokale, në strategjitë dhe planet e ndryshme për energjinë në territore specifike MED	Niveli i energjisë së rinovueshme nga burime lokale në shumëllojshmërinë e energjisë të ishujve dhe zonave rurale MED

Aksi prioritar	**Mbështetja e ERDF-së**	**Niveli në përqindje i financimit total të BE-së për Programin e Bashkëpunimit (sipas fondeve)[54]**			**Objektivi tematik[55]**	**Prioritetet e investimeve[56]**	**Objektivat specifikë**	**Treguesit e rezultateve në bazë të secilit objektiv specifik**
		ERDF	**ENI (ku aplikohet)**	**IPA (ku aplikohet)**				
3	76,269,660	32.64%	0%	1.36%	6. Ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i efikasitetit të burimeve	Prioriteti i investimeve 6.c Ruajtja, mbrojtja, promovimi dhe zhvillimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore	3.1 Për përforcimin e zhvillimit të një turizmi bregdetar dhe detar të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm në zonën MED	Niveli i qëndrueshmërisë së turizmit në rajonet bregdetare MED
					6. Ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i efikasitetit të burimeve	Prioriteti i investimeve 6.d Ruajtja dhe ripërtëritja e biodiversitetit dhe tokës, si edhe promovimi i shërbimeve të ekosistemit nëpërmjet "Natura 2000" dhe infrastrukturës së gjelbër	3.2 Të sigurojë biodiversitetin dhe ekosistemet natyrore nëpërmjet përforcimit të menaxhimit dhe të vendosjes së rrjeteve të zonave të mbrojtura	Niveli i zonave të mbrojtura që kanë arritur objektivat e tyre të ruajtjes (falë përmirësimit të menaxhimit të tyre)

[54] Prezantimi i përqindjes të fondeve ENI dhe IPA varet nga lloji i menaxhimit të zgjedhur.
[55] Titulli i objektivit tematik; nuk aplikohet për asistencën teknike.
[56] Titulli i prioritetit të investimeve; nuk aplikohet për asistencën teknike.

4	17,945,801	7.68%	0%	0.32%	11. Përforcimi i kapaciteteve institucionale të autoriteteve publike dhe grupeve të interesit (...)	Përforcimi i qeverisjes në zonën e Mesdheut	4.1 Mbështetja e procesit të përforcimit dhe zhvillimi i marrëveshjeve për koordinimin shumëpalësh në zonën e Mesdheut, për një përgjigje të vetme mbi sfidat e përbashkëta	Numri i planeve të veprimtarisë me tematika të përbashkëta të cilat do të mundësojnë zbatimin e aktiviteteve strategjike të koordinuara[57]

Akset prioritare	**Financimi ERDF (euro)**	**Niveli në përqindje i financimit total të BE-së për Programin e Bashkëpunimit (sipas fondeve[58])**			**Objektiva tematikë[59]**	**Prioritetet e investimeve[60]**	**Objektivat specifikë**	**Treguesit e rezultateve në bazë të secilit objektiv specifik**
		ERDF	**ENI (ku aplikohet)**	**IPA (ku aplikohet)**				
Asistenca teknike	13.459.351	5.76%	0%	0.24%	E pazbatueshme	E pazbatueshme	5.1 Për zbatimin sa më efikas të Programit të Bashkëpunimit 5.2 Për të përmirësuar mbështetjen për aplikantët dhe përfituesit dhe për të rritur përfshirjen e partnerëve të interesuar në zbatimin e Programit	E pazbatueshme

[57] Të tilla si: ulja e ndotjes së brigjeve, lufta kundër ndotjes së detit, menaxhimi i mbetjeve, plane të integruara të menaxhimit të zonave bregdetare, planifikim hapësinor detar.
[58] Prezantimi i përqindjes së fondeve ENI dhe IPA varet nga lloji i menaxhimit të zgjedhur.
[59] Titulli i objektivit tematik; nuk aplikohet për asistencën teknike.
[60] Titulli i prioritetit të investimeve; nuk aplikohet për asistencën teknike.

SEKSIONI 2
AKSET PRIORITARE
(Referenca: Pikat "b" dhe "c" të nenit 8(2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

2.1 Përshkrimi i akseve prioritare të ndryshme nga Asistenca Teknike

2.1.1 Aksi prioritar 1

ID	AKSI PRIORITAR I
Titulli	Promovimi i kapaciteteve inovative të zonës së Mesdheut për nxitjen e një rritjeje sa më efikase dhe të qëndrueshme
	Aksi prioritar 1, ka si qëllim përforcimin e kapaciteteve inovative të aktorëve publikë dhe privatë të rajoneve të Mesdheut dhe, gjithashtu, mbështetjen e një rritjeje sa më efikase dhe të qëndrueshme. Ky aks i drejton një vëmendje të veçantë rritjes blu dhe asaj të gjelbër, industrive kreative dhe inovacionit social, të cilat janë elemente zhvillimi dhe punësimi potencial në rajonet e Mesdheut. Këtu nënvizohet nevoja për përforcimin e rrjeteve inovative, sektorëve ekonomikë, zinxhirit dhe rrjetit të vlerave përgjatë rajoneve MED.

- Të gjitha akset prioritare do të zbatohen plotësisht vetëm nëpërmjet *instrumenteve të financimit.*
- Të gjitha akset prioritare do të zbatohen plotësisht vetëm *nëpërmjet instrumenteve të financimit të parashikuara në nivel të BE-së.*
- Të gjithë akset prioritare do të zbatohen nëpërmjet *metodës së zhvillimit të orientuar drejt komunitetit.*

2.1.2 Arsyetimi për krijimin e një aksi prioritar i cili do të mbulojë me tepër se një objektiv tematik

Nuk aplikohet

2.1.3 Fondet dhe baza e përllogaritjes për mbështetjen e BE-së

Fondi	ERDF
Baza e përllogaritjes (shpenzimet totale të lejuara ose shpenzimet publike të lejuara)	**71,783,208 euro**

2.1.4 Prioriteti i investimeve 1(b)

(Referenca: Pikat "b"/"i" të nenit 8(2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

PRIORITETI I INVESTIMEVE 1(b)
Promovimi i investimit të biznesit në R&I, zhvillimi i lidhjeve dhe sinergjive ndërmjet ndërmarrjeve, qendrave të kërkimit dhe zhvillimore dhe sektorët e arsimit të lartë, në veçanti promovimi i investimeve në zhvillimin e programeve dhe të produkteve, transferimin e teknologjive, inovacioni social, ekoinovacioni, aplikacionet e shërbimeve publike, stimulimet e kërkesave, rrjetëzimi, grupimet dhe inovacionet e hapura nëpërmjet specializimit "të zgjuar" dhe mbështetjes teknologjike dhe kërkimit të aplikuar, linjat pilot, aksionet e hershme të vleftësimit të produkteve, kapacitetet e avancuara të industritë përpunuese dhe prodhimit të parë, në veçanti, në teknologjitë kyçe mundësuese dhe përhapjen e teknologjive për qëllim të përgjithshëm.

2.1.5. Objektiva specifikë 1.1

(Referenca: Pikat "b"/"i" dhe "ii", të nenit 8(2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

ID	**1.1**
Objektivi specifik	Rritja e aktivitetit transkombëtar të grupimeve inovative dhe rrjeteve të sektorëve kyç të zonës MED
	Objektivi specifik synon të përmirësojë aftësitë inovative të aktorëve publikë dhe privatë të përfshirë në fushat e rritjes blu dhe të gjelbër, industritë kreative dhe ekonominë sociale, nëpërmjet përforcimit të bashkëpunimit transkombëtar dhe komunikimit më të mirë midis aktorëve të spirales së katërfishtë (organet kërkimore, bizneset, autoritetet publike, shoqëria civile). Objektivi ka si prioritet të përmirësojë fuqizimin e këtyre aktorëve me, në brendësi dhe midis grupimeve ekzistuese, sektorëve ekonomikë dhe rrjeteve.

Rezultatet e pritura	Grupime dhe rrjete inovative transkombëtare të përforcuara, të fuqizuara dhe të shumëfishuara në sektorët kyç të zonës MED. Rajonet MED karakterizohen nga kapacitete inovative të pamjaftueshme dhe nga një mungesë bashkëpunimi midis aktorëve të spirales së katërfishtë. Në këto rajone sfidat në fushën e zhvillimit blu dhe të gjelbër janë parësore, si edhe në fushat e industrisë kreative dhe ekonomisë sociale, të cilat kanë nevojë për një bashkëpunim më të mirë midis grupeve të ndryshme (dhe disa herë konfliktuale) të interesit. Rritja e gjelbër përfshin materiale të reja, bioteknologji dhe biokimi, ekondërtime, energji, bujqësi, agrobiznes, agroturizëm, bujqësi bio dhe ushqime bio, transformimi i produkteve, rivlerësimi dhe tregtimi etj. Zhvillimi blu ka të bëjë me të gjitha aktivitetet që kanë një lidhje të fortë me Detin Mesdhe, përfshirë këtu turizmin detar, bregdetar dhe lundrimin, burimet bregdetare dhe detare, mbrojtjen e zonave të bregdetit dhe detare dhe biodiversitetin, energjinë blu (algat, energjinë termike, dallgët), bioteknologjinë blu (ushqimi, shëndeti, dallgët), menaxhimi i qëndrueshëm i porteve, industritë detare dhe mjedisore, zonat e peshkimit dhe akuakulturën etj. Industritë kreative mund të promovohen në rast se aktivitetet kanë të bëjnë me sektorët e rritjes blu dhe të gjelbër që mund të përdoren në aktivitete për dizajnin, media ose aktivitete kulturore të lidhura me turizmin. Inovacioni social mund të promovohet në veçanti në lidhje me zonat margjinale, duke u përqendruar në vështirësitë gjeografike, ekonomike, sociale ose demografike, të cilat mund të pengojnë mundësitë e zhvillimit të sektorëve blu dhe të gjelbër (si p.sh., mbështetje për strategjitë dhe modelet e shërbimeve sociale inovative). **Ndryshimet kryesore të kërkuara** Ndryshimi kryesor i pritur, lidhur me këtë objektiv specifik, është përmirësimi i kushteve të kuadrit ekzistues të inovacionit, përforcimi dhe fuqizimi i rrjeteve dhe i grupimeve, në veçanti, në dimensionin transkombëtar, në fushën e rritjes blu dhe të gjelbër, industrive kreative dhe inovacionit social (lidhje midis grupimeve, midis enteve kërkimore dhe SME-ve, midis enteve kërkimore dhe administratës publike, midis SME-ve dhe grupimeve; mbështetje për laboratorët; përfshirje e konsumatorëve fundorë (biznese ose konsumatorë etj.). Aktivitetet përfshijnë zhvillimin e rrjeteve dhe lidhjeve ekzistuese, me rritjen e partneritetit ose rritjen e përqindjes së tyre/transferime në fushën e inovacionit midis aktorëve të spirales së katërfishtë. Vëmendje e veçantë do t'i përkushtohet, në përgjithësi, promovimit të ekoinovacionit me synim promovimin e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm (si p.sh., përdorimi sa më efikas i burimeve, reduktimi i ndikimit mjedisor të aktiviteteve, ekoinovacion në lidhje me cilësinë e ajrit dhe kontrollin e emetimeve

	etj.). Projektet duhet të jenë në përputhje dhe plotësuese me programet rajonale dhe kombëtare ERDF dhe/ose plane të tjera rajonale/lokale, duke pasur gjithnjë parasysh veprimet që janë ende në zbatim dhe, nëse përkon, duke mbështetur transferimin e rezultateve nga programet MED, në këto programe.

Tabela 3. Treguesit specifikë të rezultateve të Programit *(sipas objektivave specifikë)*

(Referencat: Pika "b"/ "ii" e nenit 8(2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Për secilin objektiv specifik duhet të përdoret një (nëse është e mundur) dhe jo më shumë se dy indikatorë të rezultateve.

ID	Indikatorët e rezultateve	Njësia matëse	Vlera bazë	Viti bazë	Vlera e synuar[61] (2023) 100 karaktere maks.	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia e raportimeve 100 karaktere maks.
PI 1.b OS 1.1 1.1.1	Sasia e rrjeteve inovative (duke përfshirë edhe aktivitetet RDI) që u ofrojnë pjesëmarrësve një kombinim të konsoliduar aktivitetesh transkombëtare në sektorë kyç të hapësirës MED	Rrjete inovative (%)	50% (përqindja aktuale e rrjeteve inovative që u ofron pjesëmarrësve një përzierje të konsoliduar aktivitetesh, shërbimesh dhe mjetesh transkombëtare)	2014	66%	Statistikat nga lista e rrjeteve Sondazhe të zhvilluara për rrjetet e identifikuara për të vlerësuar ekzistencën e aktiviteteve, të shërbimeve dhe të mjeteve transkombëtare	Dy herë gjatë periudhës së programimit (2019/të dhënat e 2018-ës, 2023-shit/ të dhënat e 2022-shit)

[61] Vlera e synuar mund të jetë cilësore ose sasiore.

2.1.6 Aktivitetet që do të mbështeten nën këtë prioritet investimesh

2.1.6.1 Përshkrimi i llojit dhe shembuj të aktiviteteve që do të mbështeten

(Referenca: Pikat "b"/ "iii", të nenit 8(2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Prioriteti i investimeve 1(b)	Promovimi i investimeve të biznesit në kërkim dhe inovacion E&I, nëpërmjet zhvillimit të kontakteve dhe sinergjive midis sipërmarrjeve, qendrave kërkimore dhe të zhvillimit dhe sektorit të arsimit të lartë (...)

1. Lloje dhe shembuj veprimesh dhe kontributet e pritshme për secilin objektiv specifik

Lista e veprimeve të mundshme në vijim është vetëm një listë indikative dhe mund të plotësohet me veprime të tjera të rëndësishme për arritjen e qëllimeve të objektivave specifikë.

Objektivi specifik 1.1. Rritja e aktivitetit transkombëtar të rrjeteve dhe grupimeve inovative në sektorët kyç të zonës MED

Për të arritur këtë objektiv, veprimet duhet të fokusohen në përfshirjen e një bashkëpunimi më të fortë operacional midis aktorëve të spirales së katërfishtë dhe mundësinë e realizimit të projekteve pilote që përfshijnë aktivitete demonstrative. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme mbështetja e strukturimit afatgjatë të rrjeteve dhe shkëmbimeve të mbështetura. Kjo mund të realizohet vetëm nëpërmjet përfshirjes së aktorëve të ndryshëm të spirales së katërfishtë (operatorë ekonomikë, ente kërkimore, struktura trajnuese dhe autoritete publike). Efikasiteti i projekteve, gjithashtu, do të mbështetet në përqendrimin e aktiviteteve në fusha kyçe të ndërhyrjeve (rritje blu dhe e gjelbër, industri kreative dhe inovacion social).

Projektimi i qasjeve dhe i strategjive të përbashkëta në nivel transkombëtar

- Studime dhe analiza mbi tendencat e reja lidhur me nxitjen e inovacionit në nivelet e BE-së dhe MED-së.
- Identifikimi, analizë krahasuese, projektimi dhe adaptimi:

- Instrumente për mbështetjen e vendimmarrjes në fushën e inovacionit;
- Politika publike në fushën e inovacionit;
- Sisteme inovative dhe procese që përdorin modele të reja ekonomike (skemat e përmirësimit të inovacionit), inovacion i drejtuar nga kërkesa (prokurim publik inovativ) dhe partneritet publik-privat.
- Mbështetja e shërbimeve për sektorin privat për stimulimin e mëtejshëm të aftësive të tyre inovative (inteligjencë e teknologjisë dhe tregu, ngritje kapacitetesh, krijimi i partneriteteve dhe rrjeteve, vlerësime financiare).
- Mekanizma që favorizojnë bashkëpunimin midis sektorit të aktiviteteve kërkimore, sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME) dhe sektorit publik (spirale e katërfishtë) për nxitjen e inovacionit dhe të sipërmarrjes.

- Përpunimi i metodologjisë së përbashkët për monitorimin e politikave të inovacionit (ndjekja e ecurisë së zbatimit/së zhvillimit të RIS3).

Aktivitete pilote

Në sektorë ose territore kyç, testimi, vlerësimi dhe demonstrimi i vlerës së tyre të shtuar dhe transferimi potencial i:

- Instrumenteve mbështetëse të vendimmarrjes në fushën e inovacionit;
- Politika publike për inovacionin;
- Sisteme inovative dhe procese që përdorin modeleve të reja ekonomike (skemat e përmirësimit të inovacionit), inovacion i drejtuar nga kërkesa (prokurim publik inovativ) dhe partneritet publik-privat;
- Mbështetja e shërbimeve për sektorin privat për stimulimin e mëtejshëm të aftësive të tyre inovative (inteligjencë e teknologjisë dhe tregut, ngritjen e kapaciteteve, krijimin e partneriteteve dhe rrjeteve, vlerësime financiare);
- Mekanizma për analizimin e rritjes së bashkëpunimit midis sektorit të aktiviteteve kërkimore, sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME) dhe sektorit publik (spirale e katërfishtë) për nxitjen e inovacionit dhe sipërmarrjes.

Krijimi ose përforcimi i rrjeteve, grupimeve të rrjeteve transkombëtare për të arritur një model të qëndrueshëm bashkëpunimi transkombëtar të aktorëve të përfshirë në fushën e inovacionit.

Aktivitete për transferimin, shpërndarjen dhe kapitalizimin

- Shndërrimi i nismave pilote në projekte të një niveli më të lartë.

- Riformulimi, përmbushja dhe përmirësimi i rezultateve, aktiviteteve dhe rezultateve të arrira në projekte të mëparshme bashkëpunimi të miratuara nga Programi MED dhe/ose programe të tjera (si p.sh., programe tematike të Komisionit Evropian, Bashkëpunimi Territorial Evropian ...).
- Zbatimi i politikave publike për inovimin ose përshtatja e planeve të veprimit nga autoritetet publike.
- Transferimi i sistemeve ose i proceseve të përmirësuara transkombëtare në territore ose sektorë të tjerë të interesuar.
- Përfshirja e rajoneve (nëpërmjet partneritetit të drejtpërdrejtë) në përforcimin e marrëdhënieve dhe të bashkëpunimit të strategjive ekzistuese të specializimit efikas (RIS3) në nivel transkombëtar (platforma dhe instrumente bashkëpunimi për plotësimin e dinamikave ekzistuese ...).
- Krijimi ose përforcimi i rrjeteve të qëndrueshme aktive të sistemit të aktorëve të spirales së katërfishtë që bashkëpunojnë në sektorë përkatës me një ndërlidhje me rrjetet ose platformat evropiane të parashikuara (si p.sh., platforma "Seville S3", platforma tematike *Interreg Europe* ...).
- Përforcimi i marrëdhënieve ekzistuese dhe rrjeteve dhe rritja e kontakteve dhe sinergjive të tyre në nivel MED.
- Ngritje kapacitetesh dhe fuqizim i:

- Autoriteteve publike të drejtuara nga niveli i kërkesës për nismë inovative (procedurat e prokurimit publik ...) dhe modele të reja ekonomike (si p.sh., ICT, skema të përmirësuara inovimi) nëpërmjet nxitjes së një bashkëpunimi ndërdisiplinor dhe transkombëtar.
- Menaxherët dhe anëtarët e rrjeteve të inovimit të drejtuar nga kërkesa dhe modele të reja ekonomike (si p.sh., TIK, skema të përmirësuara inovimi) nëpërmjet nxitjes së një bashkëpunimi ndërdisiplinor dhe transkombëtar.
- Aktorët socialë në instrumentet e inovimit të drejtuar nga kërkesat.

2. Identifikimi i grupeve kryesore të interesit (listë joshteruese)

- Autoritete lokale, rajonale dhe kombëtare.
- Sipërmarrje të vogla dhe të mesme (SME) dhe operatorët ekonomikë.
- Universitetet dhe qendrat kërkimore.
- Shoqëria civile.

3. Territoret specifike të interesit

- Për t'u përcaktuar në bazë të nevojave të fushave kyçe të ndërhyrjes: Të gjitha territoret MED përfshihen në këtë prioritet investimesh

4. Lista e përfituesve (joshteruese)

- Autoritetet lokale, rajonale dhe kombëtare.
- Ente ndërmjetësimi të përfshira në zhvillimin ekonomik dhe të inovacionit.
- Agjencitë rajonale të zhvillimit.
- Universitetet dhe institute të tjera arsimore dhe trajnimi.
- Institute kërkimore, qendra dhe rrjete për nisma inovative.
- Qendra dhe agjenci për përkrahjen e biznesit, ndërmjetës në fushën e teknologjisë dhe institucione për transferimin e teknologjive/njohurive.
- Autoritete publike ose të ngjashme të lidhura me fushën e inovacionit, politikave industriale, SME-ve dhe trajnimit.
- Dhomat e tregtisë, shoqatat e biznesit, platforma dhe operatorë ekonomikë.

2.1.6.2 PARIMET KRYESORE PËR PËRZGJEDHJEN E OPERACIONEVE

(Referencat: Pika "b"/ "iii", e nenit 8(2) e Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Prioriteti i investimeve 1(b)	Promovimi i investimeve të biznesit në kërkim dhe në inovacion E&I, zhvillimi i lidhjeve dhe sinergjive ndërmjet sipërmarrjeve, qendrave kërkimore dhe të zhvillimit dhe sektorit të arsimit të lartë (...)

Çdo veprim do t'i nënshtrohet një kontrolli të pranueshmërisë për të siguruar se ai plotëson kriteret kryesore lidhur me objektivat e projektit, partneritetit të tyre, dimensionit transkombëtar dhe buxhetit. Në këtë fazë, aplikimet duhet të jenë në përputhje të plotë me prioritetet e investimit dhe me objektivat specifikë të cilëve ato u referohen.

Aplikimet e pranueshme do t'i nënshtrohen një kontrolli cilësie më të detajuar lidhur me objektivat e tyre, strategjinë e përdorur dhe mjetet në dispozicion.

Kriteret e cilësisë do të përfshijnë, në veçanti:

- Koherencën e projektit me strategjinë e Programit, përmbajtjen e prioriteteve të investimeve dhe objektivave specifikë.
- Koherencën e projektit me politikat kombëtare dhe rajonale dhe masat e zbatuara për krijimin e sinergjive dhe për shmangien e mbivendosjeve.
- Plotësimin me projekte të tjera të BE-së, programet tematike dhe iniciativat.
- Plotësimin me iniciativa të tjera mesdhetare në sektorin në fjalë.
- Dimension transkombëtar të projektit me vërtetimin se partnerët ndajnë nevoja të përbashkëta dhe objektiva të përbashkët.
- Dimensionin inovativ të projekteve, ndikimin e tyre konkret në zhvillimin socioekonomik dhe efektet e tyre në periudhën afatmesme.
- Vëmendje kushtuar ndaj efekteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta mjedisore të projektit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.
- Koherencën e partneritetit, rëndësinë dhe kompetencat e partnerëve në përputhje me objektivat e projektit.
- Koherencën e aktiviteteve me objektivat e rezultatet.
- Lidhjen e planit të financimit dhe të koherencës së buxhetit me objektivat e vendosur.

Një vëmendje të veçantë do t'i kushtohet koherencës se këtyre elementeve me kriteret e çdo thirrjeje për projekte. Në qoftë se është e nevojshme, mund të përfshihen kritere shtesë në termat e referencës në thirrjet për projekte, përfshirë dhe për çështjet mjedisore.

Për hartimin e projekteve të tyre, aplikuesit duhet t'u referohen tri llojeve të "moduleve". Objektivi i këtyre moduleve është fokusimi i projekteve në llojet e aktiviteteve të identifikuara mirë që sjellin një kontribut konkret në përmbushjen e objektivave specifikë.

Një veprim mund të përfshijë një ose disa module në varësi të strategjisë së tij dhe objektivave kryesorë.

Përshkrimi i moduleve të ndryshme

Moduli 1. Një modul i dedikuar për hartimin e qasjeve të përbashkëta dhe për hartimin e strategjive të përbashkëta, modeleve, rregullave dhe normave në nivel transkombëtar, analizave, gjendjen aktuale, shpërndarjen e informacionit dhe krijimin e rrjeteve. Projektet e fokusuara në këtë modul do të analizojnë një fushë të ndërhyrjes, do të plotësojnë të dhënat, rrjetet, referencat dhe do të përpunojnë metodologji, modele dhe strategji të përbashkëta.

Këto aktivitete mund të jenë objektivi kryesor i projektit apo të përbëjnë fazën e parë të një projekti më të gjerë që do të përdorin këto rrjete, modele dhe strategji për të nisur aktivitetet pilot ose për të nisur një proces më të gjerë të kapitalizimit, të shpërndarjes dhe të transferimit të përvojës dhe të rezultateve.

Moduli 2. Një modul i dedikuar për aktivitetet pilot ku partnerët e projektit do të kenë mundësinë për të testuar proceset, teknikat, modelet, me perspektivën e krijimit të zgjidhjeve të zbatueshme për një grup më të gjerë përdoruesish dhe territoresh. Aktivitetet pilot mund të krijohen kur të jenë identifikuar mirë konteksti, të dhënat dhe palët e interesuara dhe kur kushtet teknike dhe institucionale të jenë të favorshme. Në rast të reagimeve të dobëta, aktiviteti piloti mund të përfshijë edhe punën paraprake të analizës dhe zbatimin e aktivitetit pilot.

Moduli 3. Kur metodologjitë, praktikat, mjetet e ndërhyrjes janë testuar dhe zbatuar nga palët e

interesuara në nivel lokal apo rajonal dhe ato paraqesin një interes të fortë për shpërndarjen më të gjerë në zonat përfituese MED, projektet mund të propozojnë kapitalizimin dhe shpërndarjen e aktiviteteve. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet transferimit të rezultateve në drejtim të programeve kombëtare dhe rajonale ERDF dhe përfshirjes së përdoruesve fundorë në proceset e shpërndarjes. Në këtë fazë, aplikantët inkurajohen që të përdorin rezultatet e projekteve të mëparshëm (nga ETC apo programe të tjera të BE-së) dhe të punojnë në rezultatet e moduleve të tjera. Për të siguruar cilësi të lartë të rezultateve, objektivi përfundimtar nuk duhet të konsistojë vetëm në "përhapjen e informacionit". Do të jetë gjithashtu e nevojshme për të siguruar që mjetet, praktikat dhe metodologjitë janë marrë përsipër në mënyrë efektive nga të gjithë aktorët e interesuar dhe zbatohen në nivel lokal, rajonal, kombëtar apo ndërkombëtar sa më gjerësisht të jetë e mundur dhe pa pagesë.

2.1.6.3. PËRDORIMI I PLANIFIKUAR I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

(Referencat: Pikat "b"/"iii", të nenit 8(2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Prioriteti i investimeve 1(b)	Promovimi i investimeve të biznesit në kërkim dhe inovacion R&I, zhvillimi i lidhjeve dhe i sinergjive ndërmjet sipërmarrjeve, qendrave kërkimore dhe të zhvillimit dhe sektorit të arsimit të lartë (...)
Përdorimi i planifikuar i instrumenteve financiare	
Mundësia për realizimin dhe për zbatimin e instrumenteve financiare do të diskutohet gjatë periudhës së zbatimit të Programit.	

2.1.6.4. PËRDORIMI I PLANIFIKUAR I PROJEKTEVE MADHORE

Nuk aplikohet

2.1.6.5. TREGUESIT E REZULTATEVE

(Referenca: Pikat "b"/"iv" të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Tabela 4. Treguesit e rezultateve, të përgjithshëm dhe specifikë të Programit (sipas prioritetit të investimit)

ID	Treguesi i rezultateve	Njësia e matjes	Vlera e synuar (2023)	Burimi i të dhënave (200 karaktere maksimale)	Shpeshtësia e raportimeve 100 karaktere maksimale
1.1.a	Numri i instrumenteve operacionale që do të favorizojnë rinovimin e SME-ve	Instrumente	44	Mjete të monitorimit të Programit	Vjetore
1.1.b	Numri i ndërmarrjeve që përfitojnë grante	Ndërmarrje	35	Mjete të monitorimit të Programit	Vjetore
1.1.c	Numri i ndërmarrjeve që përfitojnë mbështetje jofinanciare	Ndërmarrje	4.000	Mjete të monitorimit të Programit	Vjetore
1.1.d	Numri i grupimeve transkombëtare të rinovimit që kanë fituar mbështetje	Grupime	10	Mjete të monitorimit të Programit	Vjetore

ID	Aksi prioritar 2
ID	Aksi prioritar 2
Titulli	Nxitja e strategjive me karbon të ulët dhe eficienca e energjisë në territoret specifike të MED-së, qytetet, ishujt dhe zonat rurale. Aksi prioritar 2 ka si synim përmirësimin e menaxhimit të konsumit energjetik në ndërtesa, promovimin e energjisë së rinovueshme në strategjitë e zhvillimit territorial dhe rritjen e përdorimit të transportit me emisione të ulëta karboni në zonat urbane. Kryesisht, ky aks ka si prioritet adaptimin dhe përmirësimin e politikave publike dhe praktikave të përdoruesve fundorë.

2.1.7 Aksi prioritar 2

- Të gjitha akset prioritare do të zbatohen plotësisht vetëm nëpërmjet *instrumenteve të financimit.*
- Të gjitha akset prioritare do të zbatohen plotësisht vetëm nëpërmjet *instrumenteve të financimit të*

parashikuara në nivel të BE-së.

- Të gjitha akset prioritare do të zbatohen nëpërmjet *metodës së zhvillimit të drejtuar nga komuniteti.*

2.1.8 Arsyetimi për krijimin e një aksi prioritare, i cili do të mbulojë me tepër se një objektiv tematik

Nuk aplikohet

2.1.9 Fondet dhe baza e përllogaritjes për mbështetjen e Unionit

Fondi	ERDF
Baza e përllogaritjes (shpenzimet totale të pranueshme ose shpenzimet publike të pranueshme)	**44.864.505 euro**

2.1.10. Prioriteti i investimeve 4c

PRIORITETI I INVESTIMEVE 4.c
Mbështetje për eficiencën e energjisë, menaxhimin "e zgjuar" të energjisë dhe përdorimin e energjisë të rinovueshme në infrastrukturat publike, duke përfshirë ndërtesat publike dhe në sektorin e banesave.

2.1.11. Objektivi specifik 2.1

ID	**2.1**
Objektivi Specifik	Ngritja e kapaciteteve për një menaxhim më të mirë të energjisë në ndërtesat publike në nivel transkombëtar.
	Objektivi specifik është përforcimi i kapaciteteve të administratës publike për optimizimin e masave për planifikimin e energjisë që do të çonte në reduktimin e konsumit të energjisë dhe një menaxhim më të mirë të energjisë në ndërtesat publike.

ezultatet e pritura	Rritja e kapaciteteve të pronarëve të ndërtesave dhe të administruesve të tyre për zhvillimin dhe për zbatimin e praktikave efikase energjetike në ndërtesat publike në zonën MED. Në rajonet e Mesdheut, ndërtesat janë ndër shkaktarët kryesorë të emetimeve të GHG-së. Ky stok i ndërtesave publike kërkon përmirësim të sistemeve të izolimit dhe të ftohjes, që aktualisht financohet pjesërisht nga programet kombëtare, rajonale dhe të BE-së. Direktiva për efikasitetin e energjisë përcakton disa nivele të detyrueshme për sa i përket sasisë vjetore të rinovimit të ndërtesave në pronësi ose në përdorim të qeverisjes qendrore, duke njohur rolin e tyre shembullor për rritjen e nivelit të rinovimit, duke rritur performancën e ndërtesave publike. Përveç mbështetjes financiare dhe teknologjive inovative, materialeve ose sistemeve të izolimit, progresi mund të varet edhe nga rritja e kapaciteteve të pronarëve ose administratorëve në lidhje me promovimin e efikasitetit të energjisë (adresuar mungesës së ndërgjegjësimit, rritja e njohurive, përmirësimi i masave mbi efikasitetin e energjisë, përfshirja e instrumenteve të reja financiare për një energji të qëndrueshme ...). Në lidhje me këto çështje, grupet e interesit mund t'u referohen rezultateve të projekteve të Programit MED 2007–2013, të thirrjeve strategjike dhe thirrjeve për projektpropozime dhe Deklaratës së Lubjanës, që përcakton nevojën për një përfshirje më të madhe të BE-së, aktorëve rajonalë dhe lokalë, në favor të një energjie efikase dhe të energjisë së rinovueshme në ndërtesa[62]. Duke qenë se tashmë shumë programe mbështesin përmirësimin e përdorimit të energjisë në ndërtesa, Programi MED do të ndërhyjë në pikëpamjen cilësore nëpërmjet mbështetjes së shkëmbimit të përvojave, praktikave dhe projekteve inovative drejtuar pronarëve ose administratorëve të ndërtesave publike. Programi MED, nëpërmjet masave të tij, do të sigurojë një efekt mesatar, duke maksimizuar rezultatet e granteve. Kjo do të realizohet me përfshirjen e përdoruesve fundorë të ndërtesave publike, si dhe për të garantuar koherencë me masat e parashikuara për ngritjen e kapaciteteve. **Ndryshimet kryesore të kërkuara** Ndryshimi kryesor i pritshëm nga ky objektiv specifik është ngritja e kapaciteteve të

[62] Deklarata e Lubjanës përgjigjet mbi sfidat e energjisë efikase dhe energjisë së ripërtërishme në ndërtesat e zonës së Mesdheut, Lubjanë, 2013.

	pronarëve ose të administratorëve të ndërtesave publike lidhur me hartimin dhe zbatimin e praktikave të mira për një energji sa më efikase. Programi MED do të fokusohet kryesisht në mënyrën e promovimit të praktikave inovative për eficiencë në energji dhe të shpërndarjes dhe të përdorimit të tyre nga pronarët ose administruesit e ndërtesave publike, si edhe nga përdoruesit fundorë. Kjo përfshin mobilizimin e autoriteteve të përgjegjëse për ndërtesat publike ose të atyre që i zotërojnë ato, të përdoruesve fundorë, shpërndarjen e sistemeve inovative, ngritjen e kapaciteteve, rritjen e ndërgjegjësimit dhe aktivitetet informuese, përdorimi i mjeteve me gjurmë karboni dhe aktivitete përmbledhëse me objektiva sasiorë lidhur me menaxhimin e konsumit energjetik etj. Projektet duhet të sigurojnë koherencë dhe të plotësojë programet rajonale dhe kombëtare ERDF dhe/ose me plane të tjera rajonale/lokale, si edhe me programe e politika të tjera tematike të BE-së ose ndërkombëtare, duke marrë në konsideratë veprimet që janë në zbatim dhe, nëse përkon, duke mbështetur transferimin e rezultateve nga Programi MED të këto programe.

Tabela 3. Treguesit specifikë të rezultateve të Programit (sipas objektivit specifik)

Për secilin objektiv specifik, duhet të përdoret një (nëse është e mundur) dhe jo më shumë se dy indikatorë të rezultateve.

ID	Treguesit e rezultateve	Njësia matëse	Viti bazë	Vlera e synuar[63] (2023)	Burimi i të dhënave, 200 karaktere maks.	Shpeshtësia e raportimeve, 200 karaktere maks.
1.1.a	Pjesa e planeve mbi efikasitetin e energjisë në nivel rajonal, ndërrajonal dhe lokal, përfshirë masat mbi ndërtesat publike ekzistuese.	Plane rajonale (%)	2014	34%	- Rishikimi i literaturës. - Aktivitete kërkimore mbi planet rajonale ekzistuese në kuadër të energjisë së qëndrueshme.	Dy herë gjatë periudhës së programimit (2019/të dhënat e 2018-ës, 2023-shit/të dhënat e 2022-shit)
1.1.b	Përqindja e planeve rajonale, ndërrajonale ose lokale mbi efikasitetin e energjisë, përfshirë masat e adaptimit për ndërtesat publike ekzistuese.	Plane rajonale (%)	2014	39%	Instrumente për monitorimin e Programit.	Dy herë gjatë periudhës së programimit (2019/të dhënat e 2018-ës, 2023-shit/të dhënat e 2022-shit)

[63] Vlera e synuar mund të jetë cilësore ose sasiore.

2.1.12 Veprimet që do të mbështeten nga prioriteti i investimeve

2.1.12.1 PËRSHKRIMI I LLOJIT DHE I SHEMBUJVE TË VEPRIMEVE QË DO TË MBËSHTETEN

Prioriteti i investimeve 4.c	**Mbështetje për eficiencën e energjisë, menaxhimin "e zgjuar" të energjisë dhe përdorimin e energjisë së rinovueshme në infrastrukturat publike, përfshirë ndërtesat publike dhe sektorin e banesave**

1. Lloje dhe shembuj veprimesh dhe kontributi i pritur për objektivat specifikë

Lista e veprimeve të mundshme në vijim është vetëm një listë indikative dhe mund të plotësohet me veprime të tjera të rëndësishme për arritjen e qëllimeve të objektivave specifikë.

Objektivi specifik 2.1. **Ngritja e kapaciteteve për një menaxhim më të mirë të energjisë në ndërtesat publike në nivel transkombëtar**

Për të përmirësuar efikasitetin e energjisë në ndërtesat publike është shumë e rëndësishme të promovohen ndërhyrje në nivel strategjik, politik dhe operacional. Veprimet e parashikuara do të nxisin autoritetet publike të përforcojnë aftësitë e tyre të ndërhyrjes dhe do të mbështesin në aktivizimin më të mirë të grupeve kyçe të interesit për sa i përket pikëpamjes operacionale. Kjo do të përfshijë instrumente të reja financiare, përmirësim të njohurive dhe të kompetencave, përshtatjen e zakoneve dhe të sjelljeve që përfaqësojnë një hapësirë kyçe për suksesin e masave në fushën e efikasitetit energjetik.

Projektimi i qasjeve dhe strategjive të përbashkëta në nivel transkombëtar

- Identifikimi, analiza krahasuese dhe adaptimi i qasjeve, modeleve, mjeteve, shërbimeve dhe/ose partneriteteve të reja për përmirësimin e menaxhimit të efikasitetit energjetik në ndërtesat publike.
- Identifikimi, analiza krahasuese dhe adaptimi i strategjive dhe i politikave për përmirësimin e menaxhimit të efikasitetit energjetik (p.sh., numëratorë të zgjuar, shpërndarja e aplikacioneve inteligjente për konsumatorët etj.).
- Hartimi i metodologjive të përbashkëta për studime fizibiliteti dhe modele biznesi për krijimin e funksioneve financiare të inxhinierisë për të mbështetur fondet ERDF dhe fonde të tjera publike me ato të burimeve private financiare.
- Harmonizimi i standardeve, procedurave dhe të dhënave në nivel BE dhe MED.

Aktivitete pilot

Testimi, vlerësimi dhe demonstrimi i vlerës së shtuar dhe transferimi potencial i:

- Studimeve të fizibilitetit dhe modeleve të biznesit për krijimin e funksioneve financiare të inxhinierisë për të mbështetur fondet ERDF dhe fonde të tjera publike me ato të burimeve private financiare;
- Strategji dhe politika për përmirësimin e menaxhimit të efikasitetit energjetik (p.sh., matës elektronik, shpërndarja e aplikacioneve elektronike për konsumatorët etj.);
- Qasje, modele, mjete, shërbime dhe/ose partneritete të reja për përmirësimin e menaxhimit të efikasitetit energjetik në ndërtesat publike në nivel BE dhe MED;
- Standarde dhe procedura të harmonizuara në nivel BE dhe MED;
- Shërbime dhe mjete për ngritjen e kapaciteteve të autoriteteve publike, pronarëve dhe administratorëve për një përmirësim të efikasitetit energjetik në ndërtesat publike;
- Politika të reja publike për menaxhimin e konsumit të energjisë;
- Qasje të reja menaxhimi (p.sh., prokurimi publik me qasje të gjelbër, partneritete publike dhe private, shmangia e pengesave administrative, modele të thjeshtuara).

Aktivitete për transferimin, për shpërndarjen dhe për kapitalizimin

- Shndërrimi i nismave pilote në projekte të një niveli më të lartë: Efekti i levave.
- Ngritja e kapaciteteve dhe rritja e ndërgjegjësimit, adresuar drejt:

Autoriteteve publike që zotërojnë ndërtesa publike dhe menaxhuesve të tyre, si edhe bizneseve të fushës, për përmirësimin e aftësive të tyre teknike dhe administruese për një politikë më efikase në fushën e energjetikës.

Përdoruesit fundorë, konsumatorët dhe qytetarët, në lidhje me ndryshimin e mënyrës së konsumit të energjisë.

- Zbatimi i politikave publike për një menaxhim më të mirë të konsumit energjetik.
- Riformulimi, përmbushja dhe përmirësimi i rezultateve, aktiviteteve dhe rezultateve/produkteve të arrira në projekte të mëparshme bashkëpunimi të miratuara nga Programi

MED dhe/ose programe të tjera (si p.sh., programe tematike të Komisionit Evropian, Bashkëpunimit Territorial Evropian ...).
- Transferimi i sistemeve ose i proceseve të përmirësuara transkombëtare në territore ose sektorë të tjera të interesuara.

2. Identifikimi i grupeve kryesore të interesit (listë joshteruese)

- Autoritetet lokale, rajonale dhe kombëtare që lidhen drejtpërsëdrejti ose jo me çështjet e energjetikës.
- Drejtoritë dhe agjencitë e energjetikës.
- Shoqatat e SME-ve dhe operatorëve ekonomikë (tregu i energjetikës, ndërtesave, banesave, ESCO-ve etj.).
- Përdoruesit fundorë dhe shoqëria civile (p.sh., shoqata e konsumatorëve) për promovimin e zgjidhjeve për përdorimin efikas të energjisë.
- OJF-të dhe grupet e interesit në fushën e energjetikës.

3. Territoret specifike të interesuara

Çdo territor, me një fokus të veçantë në zonat urbane, si konsumator i gjerë të energjisë, me një potencial të lartë kursimi energjetik.

4. Llojet e përfituesve (listë joshteruese)

- Autoritetet lokale, rajonale dhe kombëtare.
- Autoritetet dhe agjencitë kombëtare, rajonale dhe lokale me veprimtari në fushën e energjetikës.
- Agjencitë e energjetikës.
- Institutet kërkimore, universitetet dhe rrjetet për energjinë dhe teknologjitë me karbon të ulët.
- Furnizues publikë dhe privatë të energjisë.
- Shoqatat e SME-ve dhe operatorëve ekonomikë (tregu i energjetikës, ndërtesave, banesave, ESCO-ve etj.).
- Shoqatat e përdoruesve dhe të biznesit.

2.1.12.2. Parimet udhëzuese për përzgjedhjen e operacioneve

(Referencat: Pikat "b"/"iii", të nenit 8(2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Prioriteti i investimeve 4(c)	**Mbështetja e efikasitetit të energjisë, e menaxhimit sa më efikas të energjisë dhe e përdorimit të energjisë së rinovueshme në infrastrukturën publike, përfshirë ndërtesat publike dhe sektorin e banesave**

Çdo veprim do t'i nënshtrohet një kontrolli të pranueshmërisë për të siguruar se ai plotëson kriteret kryesore lidhur me objektivat e projektit, partneritetit të tyre, dimensionit transkombëtar dhe buxhetit. Në këtë fazë, aplikimet duhet të jenë në përputhje të plotë me prioritetet e investimit dhe me objektivat specifikë të cilëve ato u referohen.

Aplikimet e pranueshme do t'i nënshtrohen një kontrolli cilësie më të detajuar lidhur me objektivat e tyre, strategjinë e përdorur dhe mjetet në dispozicion.

Kriteret e cilësisë do të përfshijnë, në veçanti:

Koherencën e projektit me strategjinë e Programit, përmbajtjen e prioriteteve të investimeve dhe objektivave specifikë;

- Koherencën e projektit me politikat kombëtare dhe rajonale dhe masat e zbatuara për krijimin e sinergjive dhe për shmangien e mbivendosjeve;
- Plotësimin me projekte të tjera të BE-së, programet tematike dhe iniciativat;
- Plotësimin me iniciativat të tjera mesdhetare në sektorin në fjalë;
- Dimension transkombëtar të projektit me vërtetimin se partnerët ndajnë nevoja të përbashkëta dhe objektiva të përbashkët;
- Dimensionin inovativ të projekteve, ndikimin e tyre konkret në zhvillimin socioekonomik dhe efektet e tyre në periudhën afatmesme;
- Vëmendje kushtuar ndaj efekteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta mjedisore të projektit në periudhën afatmesme dhe afatgjate;
- Koherencën e partneritetit, rëndësinë dhe kompetencat e partnerëve në përputhje me

objektivat e projektit;

- Lidhjen e planit të financimit dhe të koherencës së buxhetit me objektivat e vendosur.

Një vëmendje të veçantë do t'i kushtohet koherencës se këtyre elementeve me kriteret e çdo thirrjeje për projekte. Në qoftë se është e nevojshme, mund të përfshihen kritere shtesë në termat e referencës në thirrjet për projekte, përfshirë dhe për çështjet mjedisore.

Për hartimin e projekteve të tyre, aplikantët duhet t'u referohen tri llojeve të "moduleve". Objektivi i këtyre moduleve është fokusimi i projekteve në llojet e aktiviteteve të identifikuara mirë që sjellin një kontribut konkret në përmbushjen e objektivave specifikë.

Një veprim mund të përfshijë një ose disa module në varësi të strategjisë së tij dhe objektivave kryesorë.

Përshkrimi i moduleve të ndryshme

Moduli 1. Një modul i dedikuar për hartimin e qasjeve të përbashkëta dhe hartimin e strategjive të përbashkëta, modeleve, rregullave dhe normave në nivel transnacional, analizave, gjendjen aktuale, shpërndarjen e informacionit dhe krijimin e rrjeteve. Projektet e fokusuara në këtë modul do të analizojnë një fushë të ndërhyrjes, do të plotësojnë të dhënat, rrjetet, referencat dhe do të përpunojnë metodologji, modele dhe strategji të përbashkëta.

Këto aktivitete mund të jenë objektivi kryesor i projektit apo të përbëjnë fazën e parë të një projekti më të gjerë që do të përdorin këto rrjete, modele dhe strategji për të nisur aktivitetet pilot ose për të nisur një proces më të gjerë të kapitalizimit, të shpërndarjes dhe të transferimit të përvojës dhe të rezultateve.

Moduli 2. Një modul i dedikuar për aktivitetet pilot ku partnerët e projektit do të kenë mundësinë për të testuar proceset, teknikat, modelet, me perspektivën e krijimit të zgjidhjeve të zbatueshme për një grup më të gjerë përdoruesish dhe territoresh. Aktivitetet pilot mund të krijohen kur të jenë identifikuar mirë konteksti, të dhënat dhe palët e interesuara dhe kur kushtet teknike dhe institucionale të jenë të favorshme. Në rast të reagimeve të dobëta, aktiviteti pilot mund të përfshijë edhe punën paraprake të analizës dhe zbatimin e aktivitetit pilot.

Moduli 3. Kur metodologjitë, praktikat, mjetet e ndërhyrjes janë testuar dhe zbatuar nga palët e interesuara në nivel lokal apo rajonal dhe ato paraqesin një interes të fortë për shpërndarjen më të gjerë në zonat përfituese MED, projektet mund të propozojnë kapitalizimin dhe shpërndarjen e aktiviteteve.

Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet transferimit të rezultateve në drejtim të programeve kombëtare dhe rajonale ERDF dhe përfshirjes së përdoruesve fundorë në proceset e shpërndarjes. Në këtë fazë, aplikantët inkurajohen që të përdorin rezultatet e projekteve të mëparshme (nga ETC-ja apo programe të tjera të BE-së) dhe të punojnë në rezultatet e moduleve të tjera.

Për të siguruar cilësi të lartë të rezultateve, objektivi përfundimtar nuk duhet të konsistojë vetëm në "përhapjen e informacionit". Do të jetë, gjithashtu, e nevojshme për të siguruar që mjetet, praktikat dhe metodologjitë janë marrë përsipër në mënyrë efektive nga të gjithë aktorët e interesuar dhe zbatohen në nivel lokal, rajonal, kombëtar apo ndërkombëtar sa më gjerësisht të jetë e mundur dhe pa pagesë.

2.1.12.3 PËRDORIMI I PLANIFIKUAR I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

Prioriteti i investimeve 4.c	**Mbështetja e efikasitetit të energjisë, menaxhimit sa më efikas të energjisë dhe e përdorimit të energjisë së rinovueshme në infrastrukturën publike, përfshirë ndërtesat publike dhe sektorin e banesave.**
Përdorimi i planifikuar i instrumenteve financiare	
Mundësia për realizimin dhe zbatimin e instrumenteve financiare do të diskutohet gjatë periudhës së zbatimit të Programit.	

2.1.12.4 PËRDORIMI I PLANIFIKUAR I PROJEKTEVE MADHORE

Nuk aplikohet

2.1.12.5 TREGUESIT E REZULTATEVE

Tabela 4. Treguesit e përgjithshëm dhe specifikë të rezultateve të Programit (sipas prioritetit të investimit)

ID	Indikatorët e rezultateve	Njësia matëse	Vlera e synuar (2023)	Burimi i të dhënave, 200 karaktere	Periudha e raportimit, 100
2.1.a	Numri i mjeteve të planifikimit në dispozicion, për monitorimin dhe për menaxhimin e konsumit të energjisë në ndërtesat publike	Mjete	5	**Sistemet e monitorimit të Programit**	Vjetor
2.1.b	Numri i strategjive në mbështetje të menaxhimit të konsumit energjetik për ndërtesat publike	Modele	5	**Sistemet e monitorimit të Programit**	Vjetor
2.1.c	Numri i pjesëmarrësve nga grupet e interesit në aktivitetet e organizuara për ngritjen e kapaciteteve për përdorimin efikas të energjisë në ndërtesat publike	Pjesëmarrës	570	**Sistemet e monitorimit të Programit**	Vjetor
2.1.d	Numri i rajoneve dhe i nënrajoneve të angazhuara (nëpërmjet statuteve, protokolleve, marrëveshjeve të bashkëpunimit) për zhvillimin e planeve/strategjive në fushën	Territore	176	**Sistemet e monitorimit të Programit**	Vjetor

2.1.13 Prioriteti i Investimeve 4e

PRIORITETI I INVESTIMEVE 4.e **Promovimi i strategjive me karbon të ulët për të gjitha llojet e territoreve, në veçanti për zonat urbane, duke përfshirë promovimin e lëvizshmërisë urbane multimodale të qëndrueshme dhe masa adaptuese të zbutura**

2.1.14. Objektivat specifikë 2.2 dhe 2.3

ID	**2.2**
Objektivi Specifik	Rritja e shpërndarjes së burimeve lokale të energjisë së rinovueshme në strategjitë dhe planet e miksit të energjisë në territore specifike të zonës MED.
	Objektivi specifik është nxitja e veprimtarive të politikëbërësve, në lidhje me rritjen e përfshirjes së burimeve lokale të energjisë në strategjitë dhe planet e tyre, duke marrë në konsideratë specifikat dhe diversitetin e territoreve MED.

Rezultatet e pritshme	Rritja e përfshirjes së burimeve lokale të energjisë së rinovueshme në territoret MED Për sa u përket burimeve të energjisë së rinovueshme, zonat MED, karakterizohen, nga njëra anë nga investime të mëdha për energjinë diellore ose të erës në disa shtete dhe nga ana tjetër një pavarësi e ulët e përgjithshme për energjinë e rajoneve MED. Rajonet tashmë përfitojnë nga një mbështetje e rëndësishme e nga programet rajonale dhe kombëtare ERDF dhe nga programe të tjera tematike për zhvillimin e infrastrukturës. Gjithsesi, prodhimi i energjisë në masë duhet të plotësohet me plane lokale për t'u afruar sa më shumë me nevojat specifike dhe kufizimet dhe për të siguruar një furnizim të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm në të gjitha territoret. Për këto arsye, Programi MED do të mbështesë projektet që do të kenë në fokus diversifikimin e prodhimit të energjisë së rinovueshme, që do të kenë parasysh specifikat e territoreve MED (ishujt, zonat bregdetare dhe rurale). Duke e ditur që programet kombëtare dhe rajonale do të përqendrohen në këtë fushë investimesh dhe aplikimesh të rregulloreve kombëtare (me prejardhje nga direktivat evropiane), Programi MED, do të veprojë në këtë sektor më një qasje specifike më në fokus ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen e ndërgjegjësimit, promovimin e shkëmbimit të përvojave transkombëtare dhe krijimi i rrjeteve në territore specifike (ishuj dhe zona rurale) që kanë të njëjtat sfida, veçori dhe oportunitete, sidomos në fushën e RES-së.

Rezultatet e pritura	**Ndryshimet kryesore të kërkuara** Për këtë objektiv specifik, ndryshimi kryesor i kërkuar është rritje e zhvillimit të burimeve lokale të energjisë së rinovueshme në strategjitë e miksit të energjisë dhe planet e territoreve të MED, si dhe forcimi i strategjive të tilla, duke marrë në konsideratë specifikat territoriale. Qasja për qytete "inteligjente" do të mbështetet veçanërisht lidhur me sistemet e menaxhimit të energjisë dhe përshtatjen midis prodhimit të energjisë dhe konsumit. Burimet e energjisë "blu" përbëjnë perspektiva të rëndësishme të zhvillimit, në nivel territorial dhe do të mbështeten në strategjitë e miksit të energjisë (veçanërisht në atë të biomasës dhe mikroalgave). Biomasa e pyjeve dhe bujqësisë (duke përfshirë mbetjet bujqësore) përbëjnë burime të rëndësishëm të energjisë së gjelbër, e cila do të zhvillohet në rajonet e MED. Projektet do të sigurojnë koherencë dhe plotësimin me programet rajonale dhe kombëtare ERDF dhe/ose plane të tjera përkatëse rajonale/lokale, duke marrë në konsideratë vazhdimin e veprimeve dhe, nëse është përkatëse, duke mbështetur transferimin e rezultateve nga programet MED te këto programe.

ID	2.3
Objektivi specifik	**Rritja e kapaciteteve për përdorimin e sistemeve ekzistuese të transporteve me karbon të ulët dhe lidhjet multimodale midis tyre.**
	Objektivi specifik i këtij prioriteti të investimeve është të rrisë përdorimin e sistemeve të qëndrueshme të transportit, duke hartuar plane të lidhjes dhe të lëvizshmërisë me karbon të ulët, duke zbatuar shërbimet hekurudhore dhe detare, si dhe aplikacionet për pasagjerët dhe mallrat në territoret e zonës MED-së. Veprimet do t'u kushtojnë një vëmendje të veçantë kategorive të ndryshme të përdoruesve fundorë (duke marrë në konsideratë nevojat specifike, ekonomike, sociale dhe situatat gjeografike).

ID	2.3
Rezultatet e pritura	**Rritja e kapaciteteve për përdorimin e sistemit të transportit me karbon të ulët në rajonet e MED-së** Dinamikat e ndryshme historike dhe ekonomike gjatë shekullit të kaluar dhe ndryshimet gjeografike orografike mund të konsiderohen si disa nga arsyet që kanë kontribuar në zhvillimin e çekuilibruar të sistemit të infrastrukturës dhe modaliteteve të transportit në brigjet e Mesdheut. Zhvendosja drejt sistemeve të transportit me karbon të ulët promovohet me përshtatjen e politikave të transportit, nxitjen e investimeve të mëdha dhe multimodale në infrastruktura të financuara nga BE-ja, autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale. Meqenëse zhvillimi i infrastrukturës dhe i sistemeve të transportit financohet kryesisht nga programe të tjera të KE-së, Programi MED do të shmangë dyanësinë dhe do të ndërhyjë në veçanti në çështjen e përdorimit dhe të qasjes në sistemet e transportit me karbon të ulët për kategoritë e ndryshme të popullsisë dhe në zhvillimin e veprimeve transkombëtare për të mbështetur shërbimet e transportit për pasagjerët multimodalë (transporti urban, hekurudhor/detar/pasagjerët turistikë). Për më tepër, ky Program do të fokusohet dhe në masa të buta që lidhen me hartimin e politikave të transportit, si dhe me procedurat e transportit, shpikjet teknologjike dhe organizative. Transporti ka një influencë të madhe në mjedisin ku jetojmë, në shëndetin e njerëzve (ndotja, zhurmat), e cila duhet marrë parasysh gjatë zhvillimit të zgjidhjeve të qëndrueshme inovative. Për këtë arsye, në zbatim të Direktivës 2008/50/KE mbi Cilësinë e Ajrit, mirëpriten plane për lëvizshmërinë e qëndrueshme urbane dhe rajonale. Përmirësimi i sistemit të transportit të mallrave dhe të pasagjerëve do të nxisë konkurrueshmërinë në sistemet tokësore dhe ekonomike të MED, si dhe në qytetet e MED-së. **Ndryshimet kryesore të kërkuara** Për këtë objektiv specifik, ndryshimi kryesor i kërkuar është rritja e përdoruesve fundorë nëpërmjet përmirësimit të eksesit dhe të përdorimit të sistemeve të qëndrueshme të transportit. Projektet mund të fokusohet në: - Analizën dhe promovimin e modeleve për shërbimet e qëndrueshme të transportit; - Lançimin e shërbimeve pilot të transportit; - Përshtatjen e masave, përmes planifikimit, zbatimit dhe promovimit të planeve të lidhjes dhe të lëvizshmërisë me karbon të ulët dhe shërbimeve e sistemeve elektronike të transportit; - Rritjen dhe promovimin e ngritjes së kapaciteteve dhe numrit të aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit. Projektet do të sigurojnë koherencë dhe komplementaritet me programet rajonale dhe kombëtare ERDF dhe/ose planet e tjera përkatëse rajonale/lokale, duke marrë parasysh vazhdimësinë e veprimeve dhe, nëse është përkatëse, duke mbështetur transferimin e rezultateve nga programet e MED-së te këto programe.

Tabela 3. Indikatorët e rezultateve specifike të Programit (sipas objektivit specifik)

Një (nëse është e mundur) dhe më shumë se dy nga rezultatet e treguesve duhet të përdoret për secilin objektiv specifik. Nevoja për indikator të tjerë duhet të jetë përjashtimore.

ID	Rezultatet e treguesve	Njësia matëse	Vlerat bazë	Viti bazë	Vlera e synuar	Burimi i të dhënave[64]	Shpeshtësia e raportimeve
IP 4.e SO 2.2 2.2.1	Shpërndarja e energjisë së rinovueshme nga burimet lokale në miksin e energjisë së ishujve dhe zonave rurale të MED-së	% e RES lokale në miksin e energjisë së ishujve	**7.24%**	**2014**	**19.77%**	Studimi i një shembulli të planeve të veprimit për energjinë e qëndrueshme në ishujt e MED-së	Dy herë gjatë periudhës së programimit **(2019/të dhënat e 2018-ës, 2023-shit/të dhënat e 2022-shit)**
IP 4.e SO 2.2 2.2.2	Shpërndarja e energjisë së rinovueshme nga burimet lokale në miksin e energjisë së ishujve dhe zonave rurale të MED-së	% e RES lokal në miksin e energjisë së ishujve	**7.28%**	**2014**	**12,89%**	Studimi i një shembulli të planeve të veprimit për energjinë e qëndrueshme në ishujt e MED-së	Dy herë gjatë periudhës së programimit **(2019/të dhënat e 2018-ës, 2023-shit/ të dhënat e 2022-shit)**
IP 4.e **SO 2.3 2.3.1**	Shpërndarja e planeve urbane të cilat përfshijnë veprime të lehta për transport me karbon të ulët dhe lidhjen multimodale	Plane që parashikojnë veprime të lehta të orientuara drejt trans-portit të qëndrue-shëm (%)	**23%**	**2014**	**47%**	Kërkime mbi transportin LC Shembuj të Planit të Veprimit për Energjinë e Qëndrueshme në qytetet e MED-së	Dy herë gjatë periudhës së programimit **(2019/të dhënat e 2018-ës, 2023-shit/të dhënat e 2022-shit)**

[64] Vlerat e synuara mund të jenë cilësore ose sasiore.

2.1.15 Veprimet që do të mbështeten sipas prioritetit të investimeve

2.1.15.1 Përshkrimi i llojeve dhe shembujve të veprimeve që do të mbështeten

Prioriteti i investimeve 4.e	**Promovimi i përdorimit të strategjive me karbon të ulët për të gjitha llojet e territoreve sidomos për zonat urbane, duke përfshirë promovimin e lëvizshmërisë multimodale dhe masa adaptuese të zbutura**

Llojet dhe shembuj të veprimeve dhe kontributet e pritshme në objektivat specifikë

Lista e mëposhtme e veprimeve të mundshme është vetëm një listë udhëzuese dhe mund të plotësohet me veprime të tjera që kontribuojnë në arritjen e objekteve specifike.

Objektiv specifik 2.2. Rritja e shpërndarjes së burimeve lokale energjisë së rinovueshme në strategjitë dhe planet e miksit të energjisë, në territoret specifike të MED-së

Për arritjen e këtij objektivi, aplikantëve u kërkohet që të zhvillojnë qasje territoriale, duke marrë në konsideratë politikat publike qe janë në zbatim, modelet dhe strategjitë e miksit të energjisë, si dhe specifikimet e zonave gjeografike dhe ndikimet potenciale të iniciativave të ardhshme mbi mjedisin. Kjo mund të arrihet duke forcuar masat ekzistuese të fokusuara në strategjitë e miksit të energjisë ose duke nxitur zbatimin e përqasjeve të tilla në territoret e MED-së. Duke qene se projektet e MED-së nuk mund të financojnë investime të mëdha, veprimet janë, në veçanti, përkatëse kur mbështesin proceset vendimmarrëse, eksplorojnë sistemet e miksit të energjisë, të përshtatura në specifikime territoriale dhe duke siguruar shpërndarjen e gjerë të njohurive dhe përvojave. Pavarësisht kësaj, projektet mund të integrojnë aktivitete dhe rezultate të cilat çojnë në tërheqjen e investimeve më të mëdha brenda kuadrit të iniciativave të tjera dhe kanaleve financuese të Programit MED (p.sh., Banka Evropiane e Investimeve, "Horizont 2020", programet rajonale dhe kombëtare).

Hartimi i qasjeve të përbashkëta dhe i strategjive në nivel transkombëtar:

- Përpunimi i modeleve, planeve dhe i strategjive të miksit të energjisë, të përshtatura në territoret e MED-së, duke përfshirë burimet lokale të energjisë së rinovueshme (dhe duke përfshirë vlerësimin mbi ndikimin mjedisor të miksit të energjisë);
- Zhvillimi i studimeve të fizibilitetit, duke përfshirë faktorët financiarë dhe ligjorë për përdorimin e burimeve lokale të energjisë së rinovueshme për llojet specifike të territoreve (dhe duke përfshirë vlerësimin mbi ndikimin mjedisor të miksit të energjisë);
- Realizimi i studimeve për rritjen e shfrytëzimit të burimeve lokale të energjisë së rinovueshme për ishujt;
- Mbështetja e sektorit privat (operatorët financiarë privatë, partneritetet financiare publike dhe private, ndërmarrjet), me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e instrumenteve financiare inovative dhe mjeteve për burimet e energjisë së rinovueshme;
- Përpunimi i planeve për disponueshmërinë e qëndrueshme të burimeve të energjisë së rinovueshme;
- Identifikimi i praktikave të mira që lidhen me optimizmin e miksit të energjisë lokale në fushën e Mesdheut;
- Hartimi i politikave publike.

Aktivitetet pilot

- **Testimi i fizibilitetit të strategjive të miksit të energjisë, duke përfshirë** burimet lokale energjisë së rinovueshme në zona specifike (zonat bregdetare, ishujt, zonat rurale);
- Testimi i politikave publike;
- Hartimi dhe testimi i koncepteve dhe i mjeteve për përdorimin e burimeve të energjisë të rinovueshme;
- Hartimi dhe testimi i zgjidhjeve për interkoneksione të përmirësuara dhe koordinim të rrjeteve të energjisë në nivel territorial që integrojnë burime të energjisë të rinovueshme;
- Zbatimi i praktikave të mira të lidhura me optimizmin e miksit të energjisë lokale në zonën e Mesdheut.

Aktivitete për transferimin, për shpërndarjen dhe për kapitalizmin

- Organizimi i eventeve specifike për rritjen e ndërgjegjësimin dhe për përmirësimin e kapaciteteve të qytetarëve, autoriteteve publike dhe bizneseve përkatëse mbi disponueshmërinë e burimeve lokale të energjisë së rinovueshme dhe përdorimin e tyre ne planet e miksit të energjisë (trajnime, seminare, shpërndarjen e synuar, evente);
- Rregullimi i një modeli ndërkufitar për kushtet lokale, me qëllim miratimin e një plani të ri të miksit të energjisë në rajonin MED;
- Forcimin e kapaciteteve të sektorit publik për zhvillimin dhe zbatimin e shërbimeve lokale inovative të energjisë, shtysave dhe skemave të financimit;

- Zbatimi dhe/ose përforcimi i politikave publike të orientuara drejt rritjes së kontributit të burime të energjisë të rinovueshme në nivel lokal;
- Riformulimi, plotësimi dhe përmirësimi i rezultateve, aktiviteteve dhe përfundimeve të arritura tashmë në projekte të mëparshme bashkëpunimi të miratuara nga Programi MED dhe/ose programe të tjera përkatëse (p.sh., *Intelligent Energy, ENPI CBC MED*).
- Përcaktimi i aspekteve lidhëse të qëndrueshmërisë pas përfundimit të projekteve, duke konsideruar si aspekte vendimtare, aspekte të tilla si: vazhdimësia dhe rritja e investimit, integrimi brenda veprimeve strategjike në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Transformimi i iniciativave pilot në projekte të një shkale më të lartë;
- Përmirësimi i dublikimeve në territore që kanë karakteristika të ngjashme me iniciativa të zhvilluara nëpërmjet projekteve të tjera.

Objektiv specifik 2.3. Rritja e kapaciteteve për të përdorur sistemet ekzistuese me karbon të ulët dhe lidhjet multimodale ndërmjet tyre

Për arritjen e këtij objektivi aktivitetet janë të fokusuara në përmirësimin e vendimmarrjes së mjeteve (analizave, modeleve, sistemeve planifikuese ...), kapacitetet për përfshirjen më të mirë të përdoruesve fundorë dhe promovimin e zgjidhjeve operacionale për autoritetet publike dhe palëve të interesuara. Duke qenë se Programi MED nuk mund të financojë investimet e mëdha, aktivitetet mbështesin përshtatjen e politikave të transportit dhe të mjeteve me një vëmendje të veçantë kushtuar mënyrës për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të përdoruesve fundorë.

Hartimi i qasjeve dhe i strategjive të përbashkëta në nivel transkombëtar

Identifikimi, etapat dhe përshtatja:
- Sistemet TIK për modelet e zgjuara të transportit me karbon të ulët, duke përdorur, p.sh., përqasjet e forumeve për kërkim dhe inovacion;
- Zgjidhje për të lehtësuar përdorimin e mjeteve të qëndrueshëm të transportit nga përdoruesit;
- Strategji dhe politika për të miratuar apo për të përmirësuar lidhjen dhe planet e lëvizshmërisë me sistemet e transportit me karbon të ulët;
- Planet/strategjitë/politikat/modelet e transportit për pasagjerët dhe për shërbimet e transportit të mallrave me një vizion transkombëtar, që synojnë zhvillimin e lëvizshmërisë konkrete multimodale dhe që i hapin rrugë investimeve të tjera më të mëdha;
- Shërbime dhe mjete për rritjen e kapaciteteve të autoriteteve publike në politikat e transportit me karbon të ulët;
- Shërbime pilote publike për transportin e pasagjerëve dhe/ose të mallrave me tren dhe/ose me anije në një perspektive multimodale.

Zhvillimi i studimeve/i analizave:

- Mbështetja e planeve të lidhjes, duke përdorur transportin me karbon të ulët brenda dhe midis ishujve dhe ndërmjet kontinenteve dhe ishujve;
- Lidhur me shërbimet ekzistuese apo potenciale të mallrave/pasagjerëve në zonën MED;
- Zhvillimi i metodologjive të përbashkëta për tarifat;
- Studime dhe modele biznesesh në mënyrë që të zhvillojnë kapacitetet financiare inxhinierike për livrimin e fondeve të ERDF-së dhe fondeve të tjera publike mbi burimet financiare private.

Aktivitetet pilot

Testimi, vlerësimi dhe tregimi i vlerës së shtuar dhe i transferimit të potencialit të:
- Studimeve të fizibilitetit dhe të planeve të biznesit për zhvillimin e kapaciteteve financiare inxhinerike për livrimin e fondeve të ERDF-së dhe fondeve të tjera publike për burimet financiare private;
- Strategjive dhe politikave për të miratuar apo për të përmirësuar planet lokale dhe rajonale të lëvizshmërisë;
- Shërbime dhe mjete për rritjen e kapaciteteve të autoriteteve publike në politikat e transportit me karbon të ulët;
- Sistemeve TIK për modelet e zgjuara të transportit me karbon të ulët, duke përdorur, p.sh., përqasjet e forumeve të kërkimit dhe inovacionit;
- Zgjidhjeve për të lehtësuar përdorimin e transportit të përshtatshëm nga përdoruesit fundorë;
- Modeleve për përmirësimin e lidhjeve multimodale ndërmjet sistemeve të transportit ndërmjet territoreve të MED-së;
- Shërbimeve publike pilot për transportin e pasagjerëve dhe/ose të mallrave me tren dhe/ose me anije në një perspektive multimodale;
- Planeve të lidhjeve që përdorin transportin me karbon të ulët brenda dhe midis ishujve dhe ndërmjet kontinenteve dhe ishujve.

Aktivitete për transferimin, për shpërndarjen dhe për kapitalizimin

- Transformimi i iniciativave pilot në projekte të një shkalle më të lartë. Efekti i levave.
- Riformulimi, plotësimi dhe përmirësimi i rezultateve, aktiviteteve dhe përfundimeve të arritura tashmë në projekte të mëparshme bashkëpunimi të miratuara nga Programi MED dhe/ose programe të tjera përkatëse (p.sh., programet tematike të Komisionit Evropian, Programet e Bashkëpunimit Territorial Evropian ...).
- Transferimi i modeleve të përmirësuara dhe sistemeve në territore të tjera apo sektorë përkatës, për të:
- Optimizuar lidhjet multimodale urbane dhe ato periferike;
- Promovuar shërbimet publike të optimizuara për pasagjerët dhe mallrat në zonën MED.
- Ngritja e kapaciteteve dhe rritja e ndërgjegjësimit drejt:
- Edukimit dhe informimit të qytetarëve për përdorimin e mjeteve të qëndrueshme të transportit;
- Aktorëve ekonomikë të MED-së mbi rolin strategjik të sistemeve të qëndrueshme të transportit për konkurrueshmerinë e tyre;
- Zbatimi i politikave publike për një transport me karbon të ulët ose përshtatja e planeve të veprimit nga autoritetet publike.

1. Identifikimi i grupeve kryesore të synuara (*listë joshteruese*)

- Autoritetet publike lokale, rajonale dhe kombëtare;
- Departamentet dhe agjencitë e energjisë;
- Departamentet dhe agjencitë e transportit;
- Përdoruesit fundorë dhe shoqëria civile për përdorimin e zgjidhjeve të qëndrueshme të transportit.

2. Territoret specifike të synuara

- Zonat bregdetare për zhvillimin potencial të zgjidhjeve të energjisë se rinovueshme dhe të nevojës për mbrojtjen e burimeve tokësore, detare, natyrore dhe kulturore;
- Ishujt dhe zonat rurale për zhvillimin potencial të zgjidhjeve lokale të miksit të energjisë;
- Zonat urbane;
- Zonat urbane duke përfshirë qendrat e qytetit, periferitë dhe zonat periferike për përdorimin e sistemeve të qëndrueshme të transportit;
- Territoret të cilat hasin vështirësi në lëvizje dhe/ose në akses dhe kërkojnë zhvillimin e multimodaleve dhe transportit të qëndrueshëm;
- Zona që mund të përfitojnë nga multimodalitetit si lidhjet det–bregdet–zonë e thellë.

3. Llojet e përfituesve (listë joshteruese)

- Autoritetet publike lokale, rajonale dhe kombëtare;
- Autoritetet lokale, rajonale dhe kombëtare dhe agjencitë kompetente të burimeve të energjisë;
- Agjencitë e energjisë;
- Autoritetet lokale, rajonale dhe kombëtare dhe agjencitë kompetente të transportit, të menaxhimit të lëvizshmërisë dhe të zhvillimit hapësinor;
- Institutet e kërkimit për energjinë, teknologjitë me karbon të ulët, çështjet e transportit dhe lëvizshmërisë
- Zhvillues dhe ofrues të sistemeve informative të transportit;
- Operatorët publikë dhe privatë;
- Organizatat dhe kompanitë private dhe publike të transportit;
- OJF-të;

2.1.15.2 Parimet udhëheqëse për përzgjedhjen e operacioneve

Prioriteti i investimeve 4.e	**Promovimi i përdorimit të strategjive me karbon të ulët për të gjitha llojet e territoreve, sidomos për zonat urbane, duke përfshirë promovimin e lëvizjes multimodale dhe masa përkatëse adaptuese të zbutura**

Çdo veprim do t'i nënshtrohet një kontrolli të pranueshmërisë për të siguruar se ai plotëson kriteret kryesore lidhur me objektivat e projektit, partneritetit të tyre, dimensionit transkombëtar dhe buxhetit. Në këtë fazë, aplikimet duhet të jenë në përputhje të plotë me prioritetet e investimit dhe me objektivat specifikë të cilëve ato u referohen.

Aplikimet e pranueshme do t'i nënshtrohen një kontrolli cilësie më të detajuar lidhur me objektivat e tyre, strategjinë e përdorur dhe mjetet në dispozicion.

Kriteret e cilësisë do të përfshijnë, në veçanti:

- Koherencën e projektit me strategjinë e Programit, përmbajtjen e prioriteteve të investimeve dhe objektivave specifikë;
- Koherencën e projektit me politikat kombëtare dhe rajonale dhe masat e zbatuara për krijimin e sinergjive dhe për shmangien e mbivendosjeve;
- Plotësimin me projekte të tjera të BE-së, programet tematike dhe iniciativat;
- Plotësimin me iniciativat të tjera mesdhetare në sektorin në fjalë;
- Dimension transkombëtar të projektit me vërtetimin se partnerët ndajnë nevoja të përbashkëta dhe objektiva të përbashkët;
- Dimensionin inovativ të projekteve, ndikimin e tyre konkret në zhvillimin socioekonomik dhe efektet e tyre në periudhën afatmesme;
- Vëmendje kushtuar ndaj efekteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta mjedisore të projektit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë;
- Koherencën e partneritetit, rëndësinë dhe kompetencat e partnerëve në përputhje me objektivat e projektit;
- Koherencën e aktiviteteve me objektivat e rezultatet;
- Lidhjen e planit të financimit dhe të koherencës së buxhetit me objektivat e vendosur.

Një vëmendje të veçantë do t'i kushtohet koherencës se këtyre elementeve me kriteret e çdo thirrjeje për projekte. Në qoftë se është e nevojshme, mund të përfshihen kritere shtesë në termat e referencës në thirrjet për projekte, përfshirë dhe për çështjet mjedisore.

Për hartimin e projekteve të tyre, aplikantët duhet t'u referohen tri llojeve të "moduleve". Objektivi i këtyre moduleve është fokusimi i projekteve në llojet e aktiviteteve të identifikuara mirë që sjellin një kontribut konkret në përmbushjen e objektivave specifikë.

Një veprim mund të përfshijë një ose disa module në varësi të strategjisë së tij dhe objektivave kryesorë.

Përshkrimi i moduleve të ndryshme

Moduli 1. Një modul i dedikuar për hartimin e qasjeve të përbashkëta dhe hartimin e strategjive të përbashkëta, modeleve, rregullave dhe normave në nivel transnacional, analizave, gjendjen aktuale, shpërndarjen e informacionit dhe krijimin e rrjeteve. Projektet e fokusuara në këtë modul do të analizojnë një fushë të ndërhyrjes, plotësojnë të dhënat, rrjetet, referencat dhe do të përpunojnë metodologji, modele dhe strategji të përbashkëta.

Këto aktivitete mund të jenë objektivi kryesor i projektit apo të përbëjnë fazën e parë të një projekti më të gjerë që do të përdorin këto rrjete, modele dhe strategji për të nisur aktivitetet pilot ose për të nisur një proces më të gjerë të kapitalizimit, shpërndarjes dhe transferimit të përvojës dhe rezultateve.

Moduli 2. Një modul i dedikuar për aktivitetet pilot ku partnerët e projektit do të kenë mundësinë për të testuar proceset, teknikat, modelet, me perspektivën e krijimit të zgjidhjeve të zbatueshme për një grup më të gjerë përdoruesish dhe territoresh. Aktivitetet pilot mund të krijohen kur të jenë identifikuar mirë konteksti, të dhënat dhe palët e interesuara dhe kur kushtet teknike dhe institucionale të jenë të favorshme. Në rast të reagimeve të dobëta, aktiviteti piloti mund të përfshijë edhe punën paraprake të analizës dhe zbatimin e aktivitetit pilot.

Moduli 3. Kur metodologjitë, praktikat, mjetet e ndërhyrjes janë testuar dhe zbatuar nga palët e interesuara në nivel lokal apo rajonal dhe ato paraqesin një interes të fortë për shpërndarjen më të gjerë në zonat përfituese MED, projektet mund të propozojnë kapitalizimin dhe shpërndarjen e aktiviteteve. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet transferimit të rezultateve në drejtim të programeve kombëtare dhe rajonale ERDF dhe përfshirjes së përdoruesve fundorë në proceset e shpërndarjes. Në këtë fazë, aplikantët inkurajohen që të përdorin rezultatet e projekteve të mëparshëm (nga ETC apo programe të tjera të BE-së) dhe të punojnë në rezultatet e moduleve të tjera.

Për të siguruar cilësi të lartë të rezultateve, objektivi përfundimtar nuk duhet të konsistojë vetëm në "përhapjen e informacionit". Do të jetë, gjithashtu, e nevojshme për të siguruar që mjetet, praktikat dhe metodologjitë janë marrë përsipër në mënyrë efektive nga të gjithë aktorët e interesuar dhe zbatohen në nivel lokal, rajonal, kombëtar apo ndërkombëtar sa më gjerësisht të jetë e mundur dhe pa pagesë.

2.1.15.3 Planifikimi për përdorimin e instrumenteve financiare

Prioriteti i investimeve 4.e	**Promovimi i përdorimit të strategjive me karbon të ulët për të gjitha llojet e territoreve, sidomos për zonat urbane, duke përfshirë nxitjen e lëvizjes multimodale dhe masa përkatëse adaptuese të zbutura.**
Përdorimi i planifikuar i instrumenteve financiare	
Mundësia e përpunimit dhe e zbatimit të instrumenteve financiare do të diskutohet gjatë zbatimit të Programit.	

2.1.15.5 Përdorimi i planifikuar i projekteve madhore

Nuk aplikohet

2.1.15.6 Indikatorët e rezultateve

Tabela 4. Rezultatet e përbashkëta të treguesve specifikë (për prioritet investimesh)

ID	Indikatorët e rezultateve	Njësia matëse	Vlera e synuar (2023)	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia e raportimit
2.2.a	Numri i mjeteve të planifikimit për zhvillimin e planeve të energjisë që përfshijnë RES lokale	Mjete	5	Mjetet e monitorimit	Vjetor
2.2.b	Popullsia e ishujve që mbulohet nga plani	Popullsia	**1.600.000 (15% e popullsisë)**	Mjetet e monitorimit	Vjetor
2.2.c	Popullsia e zonave rurale të mbuluara nga plani	Popullsia	**1.200.000 (5% e popullsisë)**	Mjetet e monitorimit	Vjetor
2.2.d	Numri i modeleve për të zhvilluar planet e veprimit, duke përfshirë dhe RES lokale në miksin e energjisë	Modele	**5**	Mjetet e monitorimit	Vjetor
2.2.e	Numri i rajoneve dhe i nënrajoneve të angazhuara (nëpërmjet kartave, protokolleve etj.) për rritjen e shpërndarjes së RES lokale në miksin e energjisë	Territore	192	Mjetet e monitorimit të Programit	Vjetor
2.3.a	Numri i instrumenteve të mundësuara për të mbështetur përdorimin e zgjedhjeve të transportit LC, duke përfshirë dhe ato multimodale	Instrumente	5	Mjetet e monitorimit të Programit	Vjetor
2.3.b	Numri i modeleve për zhvillimin e planit urban, duke përfshirë transportin me karbon të ulët dhe lidhjet me veprimet e buta multimodale	Modele	10	Mjetet e monitorimit të Programit	Vjetore
2.3.c	Popullsia e përfshirë në aktivitetet e rritjes së ndërgjegjësimit	Popullsia	300.000	Mjetet e monitorimit të Programit	Vjetor
2.3.d	Numri i zonave urbane të angazhuara (nëpërmjet kartave/ protokolleve, MM) në hartimin e planeve/strategjive urbane, duke përfshirë transportin me karbon të ulët dhe veprimet e buta të lidhjes multimodale	Territore	80	Mjetet e monitorimit të Programit	Vjetor

2.1.16 Aksi prioritar 3

ID	Aksi prioritar 3
	Mbrojtja dhe promovimi i burimeve natyrore dhe kulturore të Mesdheut.
	Aksi prioritar 3 ka për qëllim të zvogëlojë ndikimin potencial të aktiviteteve njerëzore mbi trashëgiminë mjedisore dhe kulturore dhe siguron një mbrojtje më të mirë të burimeve natyrore. Ky aks i kushton një vëmendje të veçantë zonave detare dhe bregdetare dhe menaxhimit të ujërave, të cilat përfaqësojnë sfidat kryesore në rajonin e Mesdheut.

- I gjithë aksi prioritar do të zbatohet vetëm nëpërmjet *instrumenteve financiare*.
- I gjithë aksi prioritar do të zbatohet vetëm nëpërmjet *instrumenteve financiare të ngritura në nivelin e BE-së.*
- I gjithë aksi prioritar do të zbatohet nëpërmjet metodës së *përfshirjes së komunitetit në nivel lokal.*

2.1.17 Arsyetimi për krijimin e një aksi prioritar, i cili do të mbulojë më shumë se një objektiv tematik

Nuk aplikohet

2.1.18 Fondi dhe baza e përllogaritjes për mbështetjen nga Unioni

Fondi	ERDF
Baza e përllogaritjes për mbështetjen nga Unioni (publike ose totale)	**76.269.660 €**

2.1.19 Prioriteti i investimeve 6.c

Prioriteti i investimeve 6.c

Ruajtja, mbrojtja, promovimi dhe zhvillimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore

2.1.20 Objektivi specifik 3.1

ID	3.1
Objektivi Specifik	Nxitja e zhvillimit të turizmit detar dhe bregdetar të qëndrueshëm në zonat e MED-së.
	Objektivi specifik ka të bëjë me përmirësimin e hartimit të politikave dhe rritjen e koordinimit të strategjive midis territoreve në nivel ndërrajonal dhe transkombëtar, në lidhje me zhvillimin e turizmit bregdetar dhe detar të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm, në linjë me menaxhimin e integruar të zonave bregdetare dhe parimet e planifikimit hapësinor detar, përmes bashkëpunimit dhe planifikimit të përbashkët.
Rezultatet e Pritura	Përmirësim të bashkëpunimi dhe planifikim të përbashkët për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm bregdetar dhe detar. Rajonet e MED-së janë përballur me ndryshime të shumta demografike, ekonomike, urbanistike, si dhe nga një sërë aktivitetesh socioekonomike, duke përfshirë këtu dhe turizmin masiv dhe urbanizimin bregdetar. Megjithatë, tendencat e kohëve të fundit tregojnë se turizmi mund të konsiderohet si një sektor pionier në zbatimin e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm. Në këtë kontekst, zhvillimi i qëndrueshëm i aplikuar për turizmin nuk ka për synim vetëm përdorimin optimal të burimeve mjedisore për ruajtjen e proceseve ekologjike dhe të biodiversitetit, por edhe respektimin e autenticitetit sociokulturor të komuniteteve pritëse, për të siguruar përfitime socio-ekonomike për të gjitha palët e interesuara. Një nga sfidat kryesore është përmirësimi i bashkëpunimit, i planifikimit të përbashkët dhe të integruar për të menaxhuar më mirë interesat konfliktuale (zhvillimi ekonomik, turizmi, shfrytëzimi i burimeve të pakta, ndryshimet mjedisore ...), për të rritur zhvillimin e turizmit si një aset për qëndrueshmërinë e rajoneve MED, në të tri aspektet e qëndrueshmërisë (mjedisor, social dhe ekonomik). Programi MED do t'i kushtojë një vëmendje të veçantë mënyrës se si zhvillohen aktivitetet turistike, si strategjitë dhe planet e zhvillimit mund të përshtaten dhe të përmirësohen për të reduktuar ose për të menaxhuar më mirë ndikimin e aktiviteteve të turizmit në mjedis (përshtatjen e aktiviteteve, sezonalitetit, shfrytëzimit të tokës, menaxhimin e ujit, menaxhimin e energjisë etj.). Zhvillimi i aktiviteteve në respekt të burimeve natyrore dhe kulturore duhet të marrë në konsideratë ndryshimet e mjedisit, si: reduktimin e burimeve ujore, rrezikun e thatësirës ose të përmbytjeve, erozioni i tokës dhe ai bregdetar, ngjarjet ekstreme të motit që lidhen drejtpërsëdrejti me zhvillimin ekonomik dhe urbanizimin dhe që ndikojnë drejtpërsëdrejti

	në trashëgiminë natyrore dhe kulturore (përmirësimin e vëzhgimit, sistemet informative dhe të alarmit, përshtatjen e mjeteve të planifikimit, zvogëlimin e konfliktit të shfrytëzimit, mjetet e menaxhimit të tokës, menaxhimin detar dhe bregdetar ...). Objektivi për sigurimin dhe zhvillimin e turizmit bregdetar dhe detar do ndiqet duke u kushtuar një vëmendje të fortë ndryshimeve mjedisore dhe ndikimit të këtyre aktiviteteve në trashëgiminë kulturore dhe natyrore, duke marrë në konsideratë menaxhimin e integruar të zonave bregdetare dhe parimet e planifikimit hapësinor detar. **Ndryshimet kryesore të kërkuara** Për këtë objektiv specifik, ndryshimi kryesor i pritshëm është përmirësimi i strategjive dhe i politikave të bashkëpunimit dhe të planifikimit të përbashkët për një zhvillim më të qëndrueshëm bregdetar. Ajo përfshin përmirësimin e Menaxhimit të Integruar të Zonave Bregdetare (MIZB) dhe të Planifikimit Hapësinor Detar (PHD), përshtatjen e politikave publike, aktiviteteve ekonomike dhe mjeteve të planifikimit, bashkëpunim më të mirë mes palëve të interesuara, koordinimin e veprimeve ndërmjet autoriteteve publike të territoreve të ndryshme MED, një rritje e bashkëpunimit ndërrajonal dhe transkombëtar dhe planeve të veprimit, rritja e numrit të rajoneve të përfshira në strategji të tilla.

Tabela 3. Rezultatet e treguesve specifikë të Programit (*sipas objektivit specifik*)

Një (nëse është e mundur) dhe jo më shumë se dy rezultate indikatorësh duhen të përdoren për çdo objektiv specifik. Nevoja për më shumë indikatorë duhet të jetë përjashtimore.

ID	Rezultatet e treguesve	Njësia matëse	Vlera e synuar	Viti bazë	Vlera e synuar[65] (2023)	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia e raportimeve
IP 6.C SO 3.1 3.1.1	Niveli i qëndruesh-mërisë së turizmit në rajonet bregdetare të MED	(%)	26.7%	2014	35.8%	Analiza statistikore dhe krahasuese të bazuara në të dhëna mjedisore, sociale dhe ekonomike të cilat lidhen me turizmin.	Dy herë gjatë periudhës së programimit **(2019/ të dhënat e 2018-ës, 2023-ës/të dhënat e 2022-shit)**

[65] Vlera e synuar mund të jetë sasiore ose cilësore.

2.1.21 Veprimet që do të mbështeten nën prioritetin e investimeve

2.1.21.1 Përshkrim i llojit dhe shembujve të veprimeve që do të mbështeten

Prioriteti i investimit 6.c	Ruajtja, mbrojtja, promovimi dhe zhvillimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore

1. Llojet dhe shembuj të veprimeve dhe kontributi i pritshëm për objektivin specifik

Lista e veprimeve të mundshme në vijim është vetëm një listë indikative dhe mund të plotësohet me veprime të tjera të rëndësishme për arritjen e qëllimeve të objektivave specifikë.

Objektivi Specifik 3.1. Nxitja e zhvillimit të një turizmi të qëndrueshëm detar dhe bregdetar në zonat e Programit MED

Për të arritur këtë objektiv, një vëmendje e veçantë i kushtohet përfshirjes dhe bashkëpunimit me kapacitetet e autoriteteve publike, në lidhje me turizmin e qëndrueshëm dhe menaxhimin e integruar. Veprimet do të kontribuojnë në përmirësimin e njohurive dhe të kapaciteteve vendimmarrëse, duke përfshirë një përdorim më të mirë të mjeteve të vëzhgimit, të monitorimit dhe të planifikimit. Një bashkëpunim i ngushtë midis aktorëve është thelbësor për gjenerimin e efekteve kumulative në nivel transkombëtar.

Projektimi i strategjive dhe i qasjeve të përbashkëta në nivel transkombëtar

- Kryerja e studimeve dhe e analizave, për:

- Vlerësimin e gjendjes së brigjeve të Mesdheut;

- Zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm dhe të larmishëm detar dhe bregdetar, duke integruar parimet e Menaxhimit të Integruar të Zonave Bregdetare (MZIB) dhe të Planifikimit Hapësinor Detar (PHD).

- Identifikimi, etapat, hartimi dhe adaptimi:

- Mjete, shërbime, politika, plane, modele që trajtojnë çështjet e konkurrueshmërisë, sezonalitetit, të diversifikimit të produkteve, të lidhjes, të përmirësimit të infrastrukturës dhe të aftësive;

- Plane dhe modele për menaxhimin e destinacioneve turistike bregdetare, duke integruar parimet e Menaxhimit të Integruar të Zonave Bregdetare dhe të Planifikimit Hapësinor Detar;

- Strategji inovative dhe të integruara për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit;

- Mekanizma të cilët favorizojnë bashkëpunimin dhe krijimin e rrjeteve midis destinacioneve turistike;

- Mbledhja e të dhënave dhe monitorimi i treguesve të cilët lidhen me turizmin e qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm në zonat MED, në përputhje me mjetet ekzistuese;

- Përmirësimi i zbatimit të strategjive dhe i mjeteve për të marrë në konsideratë ndikimet negative mbi burimet natyrore dhe trashëgiminë kulturore në zhvillimin e strategjive të turizmit;

- Zhvillimi i planeve për përmirësimin e menaxhimit të destinacioneve turistike detare dhe bregdetare, në mënyrë që të parandalohen ndikimet negative te burimet natyrore dhe trashëgimia kulturore.

Aktivitete pilot

Testimi, vlerësimi dhe tregimi i vlerës së tyre të shtuar dhe i potencialit të transferimit të:

- Mjeteve, shërbimeve, politikave, planeve, modeleve që trajtojnë çështjet e konkurrencës, sezonalitetit, diversifikimit të produkteve, lidhjes, përmirësimin e infrastrukturës dhe të aftësive;

- Planeve dhe modeleve për menaxhimin e destinacioneve turistike bregdetare, duke integruar parimet e Menaxhimit të Integruar të Zonave Bregdetare dhe të Planifikimit Hapësinor Detar;

- Strategjive inovative dhe të integruara për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm;

- Mekanizmat që favorizojnë bashkëpunimin dhe krijimin e rrjeteve mes destinacioneve turistike;

- Mjeteve të vlerësimit, standardeve dhe sistemeve të përbashkëta, në lidhje me qëndrueshmërinë e destinacioneve turistike.

Aktivitete për transferimin, për shpërndarjen dhe për kapitalizimin

- Transformimi i iniciativave pilot në projekte të një shkallë më të lartë. Efekti i levave.

- Riformulimi, plotësimi dhe përmirësimi i rezultateve, i aktiviteteve dhe i përfundimeve të arritura tashmë në projekte të mëparshme bashkëpunimi, të miratuara nga Programi MED dhe/ose programe të tjera përkatëse (p.sh., programet tematike të Komisionit Evropian, programet e bashkëpunimit territorial evropian ...).

- Zbatimi i politikave publike për një transport me karbon të ulët ose përshtatja e planeve të veprimit nga autoritetet publike.

- Transferimi i sistemeve ose i proceseve të përmirësuara transkombëtare për territoret e tjera apo sektorët përkatës.

- Rajonet e angazhuara (përtej partneritetit të drejtpërdrejtë), për të forcuar lidhjet dhe bashkëpunimin në lidhje me turizmit e qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm, MIZB dhe PHD.

- Krijimi i sinergjive me organizata të tjera, rrjete dhe programe për veprime plotësuese dhe të koordinuara drejt zbatimit efektiv të protokollit për MIZB-në dhe të direktivës për PHD-në.

- Përmirësimi i mekanizmave të qeverisjes drejt MZIB-së dhe PHD-së, për një zhvillim më të mirë të turizmit të qëndrueshëm bregdetar dhe detar.
- Lehtësimi i integrimit të parimeve të MZIB-së, i objektivave dhe i veprimeve që lidhen me turizmin në instrumente dhe korniza të politikave rajonale dhe kombëtare.
- Ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin e:

- Autoriteteve publike;
- Palëve të interesuara të destinacioneve turistike;
- Operatorëve ekonomikë.

2. Identifikimi i grupeve kryesore të synuara (listë joshteruese)

- Autoritetet publike lokale, rajonale dhe kombëtare;
- Departamentet e mjedisit, të zhvillimit ekonomik, të planifikimit, të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të turizmit të autoriteteve lokale, kombëtare dhe rajonale;
- Agjencitë e mjedisit;
- Agjencitë dhe organizatat turistike;
- Universitetet dhe qendrat kërkimore;
- Operatorët ekonomikë;
- Organizatat joqeveritare (OJQ)/qytetarët/turistët dhe përdoruesit fundorë.

3. Territoret specifike të synuara

Zonat bregdetare për brishtësinë e tyre që përballen me aktivitetet e njeriut; rëndësia e trashëgimisë së tyre kulturore dhe natyrore dhe atraksionin e tyre për aktivitetet sezonale.

4. Llojet e përfituesve (listë joshteruese)

- Autoritetet publike lokale, rajonale dhe kombëtare;
- Departamentet e mjedisit, të zhvillimit ekonomik, të planifikimit, të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të turizmit të autoriteteve lokale, kombëtare dhe rajonale;
- Agjencitë rajonale të zhvillimit;
- Agjencitë e mjedisit;
- Organet ndërmjetësuese të përfshira në proceset e zhvillimit territorial;
- Agjencitë dhe organizatat turistike;
- Universitetet dhe qendrat kërkimore;
- Operatorët ekonomikë.

2.1.21.2 Parimet udhëheqëse për përzgjedhjen e projekteve

Prioriteti i investimeve 6.c	**Ruajtja, mbrojtja, promovimi dhe zhvillimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore**

Çdo veprim do t'i nënshtrohet një kontrolli të pranueshmërisë për të siguruar se ai plotëson kriteret kryesore lidhur me objektivat e projektit, partneritetit të tyre, dimensionit transkombëtar dhe buxhetit. Në këtë fazë, aplikimet duhet të jenë në përputhje të plotë me prioritetet e investimit dhe me objektivat specifikë të cilëve ato u referohen.

Aplikimet e pranueshme do t'i nënshtrohen një kontrolli cilësie më të detajuar lidhur me objektivat e tyre, strategjinë e përdorur dhe mjetet në dispozicion.

Kriteret e cilësisë do të përfshijnë, në veçanti:

- Koherencën e projektit me strategjinë e Programit, përmbajtjen e prioriteteve të investimeve dhe objektivave specifikë;
- Koherencën e projektit me politikat kombëtare dhe rajonale dhe masat e zbatuara për krijimin e sinergjive dhe për shmangien e mbivendosjeve;
- Plotësimin me projekte të tjera të BE-së, programet tematike dhe iniciativat;
- Plotësimin me iniciativat të tjera mesdhetare në sektorin në fjalë;
- Dimension transkombëtar të projektit me vërtetimin se partnerët ndajnë nevoja të përbashkëta dhe objektiva të përbashkët;
- Dimensionin inovativ të projekteve, ndikimin e tyre konkret në zhvillimin socioekonomik dhe efektet e tyre në periudhën afatmesme;
- Vëmendje kushtuar ndaj efekteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta mjedisore të projektit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë;
- Koherencën e partneritetit, rëndësinë dhe kompetencat e partnerëve, në përputhje me objektivat e projektit;

- Koherencën e aktiviteteve me objektivat e rezultatet;
- Lidhjen e planit të financimit dhe të koherencës së buxhetit me objektivat e vendosur.

Një vëmendje të veçantë do t'i kushtohet koherencës se këtyre elementeve me kriteret e çdo thirrjeje për projekte. Në qoftë se është e nevojshme, mund të përfshihen kritere shtesë në termat e referencës në thirrjet për projekte, përfshirë dhe për çështjet mjedisore.

Për hartimin e projekteve të tyre, aplikuesit duhet t'u referohen tri llojeve të "moduleve". Objektivi i këtyre moduleve është fokusimi i projekteve në llojet e aktiviteteve të identifikuara mirë që sjellin një kontribut konkret në përmbushjen e objektivave specifikë.

Një veprim mund të përfshijë një ose disa module në varësi të strategjisë së tij dhe objektivave kryesorë.

Përshkrimi i moduleve të ndryshme

Moduli 1. Një modul i dedikuar për hartimin e qasjeve të përbashkëta dhe për hartimin e strategjive të përbashkëta, modeleve, rregullave dhe normave në nivel transnacional, analizave, gjendjen aktuale, shpërndarjen e informacionit dhe krijimin e rrjeteve. Projektet e fokusuara në këtë modul do të analizojnë një fushë të ndërhyrjes, do të plotësojnë të dhënat, rrjetet, referencat dhe do të përpunojnë metodologji, modele dhe strategji të përbashkëta.

Këto aktivitete mund të jenë objektivi kryesor i projektit apo të përbëjnë fazën e parë të një projekti më të gjerë që do të përdorin këto rrjete, modele dhe strategji për të nisur aktivitetet pilot ose për të nisur një proces më të gjerë të kapitalizimit, stë hpërndarjes dhe transferimit të përvojës dhe të rezultateve.

Moduli 2. Një modul i dedikuar për aktivitetet pilot ku partnerët e projektit do të kenë mundësinë për të testuar proceset, teknikat, modelet, me perspektivën e krijimit të zgjidhjeve të zbatueshme për një grup më të gjerë përdoruesish dhe territoresh. Aktivitetet pilot mund të krijohen kur të jenë identifikuar mirë konteksti, të dhënat dhe palët e interesuara dhe kur kushtet teknike dhe institucionale të jenë të favorshme. Në rast të reagimeve të dobëta, aktiviteti piloti mund të përfshijë edhe punën paraprake të analizës dhe zbatimin e aktivitetit pilot.

Moduli 3. Kur metodologjitë, praktikat, mjetet e ndërhyrjes janë testuar dhe zbatuar nga palët e interesuara në nivel lokal apo rajonal dhe ato paraqesin një interes të fortë për shpërndarjen më të gjerë në zonat përfituese MED, projektet mund të propozojnë kapitalizimin dhe shpërndarjen e aktiviteteve. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet transferimit të rezultateve në drejtim të programeve kombëtare dhe rajonale ERDF dhe përfshirjes së përdoruesve fundorë në proceset e shpërndarjes. Në këtë fazë, aplikantët inkurajohen që të përdorin rezultatet e projekteve të mëparshme (nga ETC-ja apo programe të tjera të BE-së) dhe të punojnë në rezultatet e moduleve të tjera.

Për të siguruar cilësi të lartë të rezultateve, objektivi përfundimtar nuk duhet të konsistojë vetëm në "përhapjen e informacionit". Do të jetë gjithashtu e nevojshme për të siguruar që mjetet, praktikat dhe metodologjitë janë marrë përsipër në mënyrë efektive nga të gjithë aktorët e interesuar dhe zbatohen në nivel lokal, rajonal, kombëtar apo ndërkombëtar sa më gjerësisht të jetë e mundur dhe pa pagesë.

2.1.21.3 Përdorimi i planifikuar i instrumenteve financiare

Prioriteti i investimeve 6.c	**Ruajtja, mbrojtja, promovimi dhe zhvillimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore**
Përdorimi i planifikuar i instrumenteve financiare	
Mundësia e përpunimit dhe e zbatimit të instrumenteve financiare do të diskutohet gjatë zbatimit të Programit	

2.1.21.4 Përdorimi i planifikuar i projekteve madhore

Nuk aplikohet

2.1.21.5 Treguesit e të dhënave

Tabela 4. Treguesit e rezultateve të përbashkëta dhe specifike të Programit (*sipas prioritetit të investimeve*)

ID	Indikatorët e rezultateve	Njësia matëse	Vlera e synuar (2023)	Burimi i të dhënave, 200 karaktere	Shpeshtësia e raportimeve, 100 karaktere
3.1.a	Numri i instrumenteve të mundësuara për të rritur zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm	Instrumente	17	Mjetet e monitorimit të Programit	Vjetor

3.1.b	Numri i destinacioneve të turistëve që mbulohen nga një mjet vlerësimi i turizmit të qëndrueshëm	Destinacione turistike	108	Mjetet e monitorimit të Programit	Vjetor
3.1.c	Numri i strategjive që aplikojnë kriteret e menaxhimit të turizmit të qëndrueshëm	Strategji	11	Mjetet e monitorimit të Programit	Vjetor
3.1.d	Numri i rajoneve dhe nënrajoneve të angazhuara (nëpërmjet kartave, protokolleve etj.) në zbatimin e planeve të turizmit të qëndrueshëm	Territore	144	Mjetet e monitorimit të Programit	Vjetor

2.1.22 Prioriteti i investimeve 6.d

Prioriteti i investimeve 6.d
Ruajtja dhe ripërtëritja e biodiversitetit dhe tokës, si dhe promovimi i shërbimeve të ekosistemit edhe nëpërmjet "Natyra 2000" dhe infrastrukturës së gjelbër

2.1.23 Objektivi specifik 3.2

ID	3.2
Objektivi specifik	Ruajtja e biodiversitetit dhe e ekosistemit natyror nëpërmjet fuqizimit të menaxhimit dhe krijimit të rrjeteve të zonave të mbrojtura.
	Objektivi specifik ka të bëjë me fuqizimin e kapaciteteve për të përshtatur dhe për të përmirësuar masat mbrojtëse, në mënyrë që të ruhet ekosistemi detar dhe biodiversiteti i natyrës bregdetare. Ai përfshin një integrim më të mirë të zonave të mbrojtura në strategjitë për zhvillimin rajonal dhe një bashkëpunim më intensiv midis rajoneve të MED-së (shkëmbimi i informacionit, strategjive, rregulloreve ...). Kjo do të realizohet në bashkërendim të ngushtë më zbatimin e Direktivës Kuadër të BE-së për Strategjinë Detare dhe në linjë me Konventën e Barcelonës.

Rezultatet e pritshme	**Ruajtja e biodiversitetit të ekosistemeve nëpërmjet integrimit më të mirë të zonave të mbrojtura në strategjitë e zhvillimit të territoreve** Në rajonet e MED-së, ekosistemet dhe biodiversiteti përfaqësojnë një dimension kyç të cilësisë së jetës, atraksionit territorial, të furnizimit me ujë dhe ushqim dhe të luftës kundër ndotjes. Burimet natyrore në këto rajone janë shumë të vlefshme dhe përbëjnë një motor të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik. Megjithatë ato janë përballur me një presion të fortë dhe konflikt në shfrytëzim për shkak të procesit të urbanizimit, aktiviteteve bujqësore dhe industriale, transportit etj. Masat mbrojtëse duhet të jenë të ndërlidhura dhe të prirura për të marrë në konsideratë këto ndryshime. Nëse zonat e mbrojtura përcaktohen në shumicën e rajoneve MED, ekosistemet dhe biodiversiteti, për pasojë, do të zhvillohen dhe masat mbrojtëse nuk u përgjigjen të gjitha nevojave të vërejtura në nivel territorial. Në zonën e Mesdheut, mund të vërehet, në veçanti, një presion të madh mbi cilësinë e ujit (lumenj, dete, mbetje detare), me efekte të drejtpërdrejtë mbi biodiversitetin. Speciet invazive paraqesin, gjithashtu, një rrezik të veçantë, si pasojë e ndryshimit të klimës. Menaxhimi i integruar i mjedisit kërkon një qasje gjithëpërfshirëse ndaj burimeve natyrore, planifikim dhe menaxhim, duke përfshirë nivele të ndryshme të autoriteteve (lokale, rajonale dhe kombëtare). Programi MED do të mbështesë ngritjen e mjeteve dhe të metodologjive të përbashkëta, shpërndarjen e njohurive dhe të të dhënave, forcimin e rrjeteve ndërmjet zonave të mbrojtura dhe, gjithashtu, përkufizimin e përgjigjeve të përbashkëta në lidhje me strategjitë, strukturat menaxhuese dhe mekanizmave të qeverisjes. Ai do të sigurojë që ekosistemet MED janë marrë më mirë në konsideratë në politikat publike ekzistuese. **Ndryshimet kryesore të kërkuara** Për këtë objektiv specifik, ndryshimi kryesor i kërkuar është forcimi i menaxhimit dhe i bashkëpunimit në mes të zonave të mbrojtura, në mënyrë që të rrisin kapacitetet e tyre për të

	përmirësuar, për shembull, menaxhimin e ujërave, luftën kundër specieve invazive dhe monitorimin e aktiviteteve të peshkimit dhe turizmit. Rezoluta e Kartës së Bolonjës dhe, në veçanti, nevoja për të përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet partnerëve rajonalë në zonat bregdetare të Mesdheut, do të merret në konsideratë. (*Karta e rajoneve evropiane për promovimin e një kuadri të përbashkët për veprimet strategjike që synojnë mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave bregdetare të Mesdheut - Bruksel 2012.*) Programi do të mbështesë, në veçanti, bashkëpunimin më intensiv mes rajoneve të Mesdheut, me përshtatjen dhe zgjerimin e zonave të mbrojtura sipas nevojës. Kjo përfshin mbrojtjen e shërbimeve të ekosistemit, reduktimin e konflikteve të shfrytëzimit, me një fokus të veçantë në zonat bregdetare, detare dhe ligatinave. Bashkëpunimi duhet të përmirësohet, në veçanti, në nivel ndërkombëtar me një shpërndarje më efikase të njohurive dhe të koordinimit më të mirë të politikave dhe qasjeve ndërdisiplinore që synojnë të përmirësojnë ndërgjegjësimin dhe mbrojtjen e zonave të brishta, habitateve natyrore dhe specieve.

Tabela 3. Indikatorët specifikë të rezultateve të Programit *(sipas objektivave specifikë)*

Një (nëse është e mundur) dhe jo më shumë se dy indikatorë rezultatesh do të përdoren për çdo objektiv specifik. Nevoja për më shumë indikatorë duhet të jetë në raste të veçanta.

ID	Indikatorët e rezultateve	Njësia matëse	Vlera bazë	Viti bazë	Vlera e synuar[66] (2023)	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia e raportimit
IP 6.d OS 3.2 3.2.1	Ndarja e zonave të mbrojtura që plotësojnë qëllimet dhe objektivat e tyre të ruajtjes (në saje të menaxhimit të përmirësuar të tyre)	Toka bazuar te zonat e "Natura 2000" (%)	73,5%	2014	85%	Përpilimi i të dhënave nga një përzgjedhje e treguesve të bazës së të dhënave EEA Përzgjedhja dhe seleksionimi i një modeli të AP-së	Dy herë gjatë periudhës së programimit (2019/të dhënat e 2018-ës, 2023-shit/të dhënat e 2022-shit)
IP 6.d OS 3.2 3.2.2	Ndarja e zonave të mbrojtura që plotësojnë qëllimet dhe objektivat e tyre të ruajtjes (në saje të menaxhimit të përmirësuar të tyre)	Zonat e mbrojtura detare (%)	65%	2012	80%	Përpilimi i të dhënave nga një përzgjedhje të treguesve të bazës së të dhënave MEDPAN	Dy herë gjatë periudhës së programimit (2019/të dhënat e 2018-ës, 2023-shit /të dhënat e 2022-shit)

2.1.24 Veprime që do të mbështeten nën prioritetin e investimeve

2.1.24.1 Përshkrimi i llojeve dhe modeleve të veprimeve që do të mbështeten

Prioriteti i investimeve 6.d	Mbrojtja, ripërtëritja e biodiversitetit, të tokës dhe promovimi i shërbimeve të ekosistemit, përfshirë përmes "Natura 2000" dhe infrastrukturës së gjelbër
1. Llojet dhe shembuj të veprimeve dhe kontributi i pritshëm për objektivat specifikë Lista e veprimeve të mundshme në vijim është vetëm një listë indikative dhe mund të plotësohet me veprime të tjera të rëndësishme për arritjen e qëllimeve të objektivave specifikë. *Objektivi specifik 3.2.* Ruajtja e biodiversitetit dhe e ekosistemeve natyrore përmes fuqizimit të menaxhimit dhe të rrjetëzimit të zonave të mbrojtura Më qëllim arritjen e këtij objektivi, veprimet janë të fokusuara veçanërisht në sistemet e qeverisjes dhe të menaxhimit të zonave të mbrojtura, duke përfshirë përmirësimin e njohurive, kompetencat, vëzhgimin dhe monitorimin e kapaciteteve. Veprimet do të kontribuojnë në përmirësimin e bashkëpunimit midis këtyre zonave me përfshirjen e palëve të interesuara lokale.	

[66] Vlera e synuar mund të jetë cilësore ose sasiore.

Një fokus i veçantë i është dhënë *site*-ve të shumta të "Natura 2000" të zonave të Programit MED, si tokësore ashtu dhe detare.

Projektimi i qasjeve dhe i strategjive të përbashkëta në nivel transkombëtar

- Studimi dhe hartëzimi i kategorive të caktuara të ekosistemeve dhe të kërcënimeve kryesore ndaj tyre në mënyrë që të përmirësojnë njohuritë, menaxhimin dhe mbrojtjen e tyre;
- Zhvillimi i shërbimeve informative;
- Zhvillimi i planeve mbrojtëse;
- Krijimi apo zhvillimi i rrjeteve të ekspertëve për të mbështetur autoritetet publike në proceset e vendimmarrjes;
- Hartimi i strategjive të integruara dhe i mjeteve për menaxhimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe shumë të vlefshme (biodiversitete, peizazhe, ekosisteme etj.);
- Hartimi i politikave publike;
- Rezoluta e monitorimit të konflikteve përmes rritjes së shfrytëzimeve të shumta ekonomike dhe sociale të zonave të mbrojtura bregdetare;
- Promovimi i dokumenteve, i protokolleve dhe i MM-ve të përbashkëta, në zbatimin e strategjive të menaxhimit për një menaxhim të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura;
- Adresimi i ndotjes ose i dëmtimeve të habitateve të mbrojtura natyrore (duke përfshirë menaxhimin e ujit dhe të mbetjeve);
- Hartimi i strategjive dhe i veprimeve të integruara transkufitare për të ruajtur ekosistemet natyrore.

Aktivitete pilot

- Testimi i mjeteve dhe i shërbimeve të reja;
- Testimi i politikave publike;
- Testimi i teknologjive dhe i mjeteve inovative, duke lehtësuar menaxhimin efektiv të integruar mjedisor (p.sh., teknologjitë e rehabilitimit, mjetet monitoruese ...);
- Testimi i mekanizmave dhe i mjeteve financiare për zonat e mbrojtura;
- Testimi i burimit të planeve të menaxhimit rajonale dhe ndërkufitare.

Aktivitete për transferimin, për shpërndarjen dhe për kapitalizimin

- Rritja e ndërgjegjësimit të popullsisë rreth zonave të mbrojtura dhe risku i ndërmjetësimit të konfliktit të përdoruesve;
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe përfshirja e vendimmarrësve publikë për reduktimin e presionit në zonat e mbrojtura;
- Trajnimi i aktorëve lokalë dhe organizimi i transferimit të njohurive për të komunikuar rreth zonave që duhen mbrojtur;
- Zgjerimi i planeve të mbrojtjes në zonat e reja;
- Rrjete nxitëse për zhvillimin e strategjive;
- Zbatimi i politikave publike;
- Zbatimi i projekteve për ngritjen e kapaciteteve;
- Transferimi i njohurive shkencore te vendimmarrësit;
- Transferimi dhe shkëmbimi i praktikave të mira.

2. Identifikimi i grupeve kryesore të synuara (listë joshteruese)

- Vendimmarrësit, departamenti i mjedisit, departamentet e zhvillimit ekonomik të autoriteteve lokale, rajonale dhe kombëtare;
- Agjencitë e mjedisit;
- Organizatat menaxhuese të zonave të mbrojtura;
- Pronarët e tokave dhe përdoruesit e tokave;
- Operatorët ekonomikë;
- Shoqatat e komuniteteve lokale/konsumatorëve/qytetarëve.

3. Territoret specifike të synuara

- Zonat tokësore, bregdetare, detare dhe ishujt për rëndësinë e biodiversitetit dhe të ekosistemeve të tyre dhe brishtësia e tyre përballë ndikimit njerëzor.

4. Llojet e përfituesve (listë joshteruese)

- Departamentet e mjedisit të autoriteteve lokale, rajonale dhe kombëtare;
- Agjencitë e mjedisit;
- Agjencitë e zhvillimit rajonal;
- Organizatat menaxhuese të zonave të mbrojtura;

- Strukturat e ndërmjetme të përfshira në proceset e zhvillimit territorial;
- Qendrat kërkimore;
- Operatorët ekonomikë;
- Shoqatat e komuniteteve lokale.

2.1.24.2 Parimet udhëzuese për përzgjedhjen e projekteve

Prioriteti i investimeve 6.d	**Mbrojtja, ripërtëritja e biodiversitetit, e dheut dhe promovimi i shërbimeve të ekosistemit, përfshirë përmes "Natura 2000" dhe infrastrukturës së gjelbër**

Çdo veprim do t'i nënshtrohet një kontrolli të pranueshmërisë për të siguruar se ai plotëson kriteret kryesore, lidhur me objektivat e projektit, partneritetit të tyre, dimensionit transkombëtar dhe buxhetit. Në këtë fazë, aplikimet duhet të jenë në përputhje të plotë me prioritetet e investimit dhe me objektivat specifikë të cilëve ato u referohen.

Aplikimet e pranueshme do t'i nënshtrohen një kontrolli cilësie më të detajuar lidhur me objektivat e tyre, strategjinë e përdorur dhe mjetet në dispozicion.

Kriteret e cilësisë do të përfshijnë, në veçanti:

- Koherencën e projektit me strategjinë e Programit, përmbajtjen e prioriteteve të investimeve dhe objektivave specifikë;
- Koherencën e projektit me politikat kombëtare dhe rajonale dhe masat e zbatuara për krijimin e sinergjive dhe për shmangien e mbivendosjeve;
- Plotësimin me projekte të tjera të BE-së, programet tematike dhe iniciativat;
- Plotësimin me iniciativat të tjera Mesdhetare në sektorin në fjalë;
- Dimension transkombëtar të projektit me vërtetimin se partnerët ndajnë nevoja të përbashkëta dhe objektiva të përbashkët;
- Dimensionin inovativ të projekteve, ndikimin e tyre konkret në zhvillimin socioekonomik dhe efektet e tyre në periudhën afatmesme;
- Vëmendje kushtuar ndaj efekteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta mjedisore të projektit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë;
- Koherencën e partneritetit, rëndësinë dhe kompetencat e partnerëve, në përputhje me objektivat e projektit;
- Koherencën e aktiviteteve me objektivat e rezultatet;
- Lidhjen e planit të financimit dhe të koherencës së buxhetit me objektivat e vendosur.

Një vëmendje të veçantë do t'i kushtohet koherencës se këtyre elementeve me kriteret e çdo thirrjeje për projekte. Në qoftë se është e nevojshme, mund të përfshihen kritere shtesë në termat e referencës në thirrjet për projekte, përfshirë dhe për çështjet mjedisore.

Për hartimin e projekteve të tyre, aplikuesit duhet t'u referohen tri llojeve të "moduleve". Objektivi i këtyre moduleve është fokusimi i projekteve në llojet e aktiviteteve të identifikuara mirë që sjellin një kontribut konkret në përmbushjen e objektivave specifikë.

Një veprim mund të përfshijë një ose disa module në varësi të strategjisë së tij dhe objektivave kryesorë.

Përshkrimi i moduleve të ndryshme

Moduli 1. Një modul i dedikuar për hartimin e qasjeve të përbashkëta dhe hartimin e strategjive të përbashkëta, modeleve, rregullave dhe normave në nivel transkombëtar, analizave, gjendjen aktuale, shpërndarjen e informacionit dhe krijimin e rrjeteve. Projektet e fokusuara në këtë modul do të analizojnë një fushë të ndërhyrjes, do të plotësojnë të dhënat, rrjetet, referencat dhe do të përpunojnë metodologji, modele dhe strategji të përbashkëta.

Këto aktivitete mund të jenë objektivi kryesor i projektit apo të përbëjnë fazën e parë të një projekti më të gjerë që do të përdorin këto rrjete, modele dhe strategji për të nisur aktivitetet pilot ose për të nisur një proces më të gjerë të kapitalizimit, shpërndarjes dhe transferimit të përvojës dhe rezultateve.

Moduli 2. Një modul i dedikuar për aktivitetet pilot ku partnerët e projektit do të kenë mundësinë për të testuar proceset, teknikat, modelet, me perspektivën e krijimit të zgjidhjeve të zbatueshme për një grup më të gjerë përdoruesish dhe territoresh. Aktivitetet pilot mund të krijohen kur të jenë identifikuar mirë konteksti, të dhënat dhe palët e interesuara dhe kur kushtet teknike dhe institucionale të jenë të favorshme. Në rast të reagimeve të dobëta, aktiviteti piloti mund të përfshijë edhe punën paraprake të analizës dhe zbatimin e aktivitetit pilot.

Moduli 3. Kur metodologjitë, praktikat, mjetet e ndërhyrjes janë testuar dhe zbatuar nga palët e interesuara

në nivel lokal apo rajonal dhe ato paraqesin një interes të fortë për shpërndarjen më të gjerë në zonat përfituese MED, projektet mund të propozojnë kapitalizimin dhe shpërndarjen e aktiviteteve. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet transferimit të rezultateve në drejtim të programeve kombëtare dhe rajonale ERDF dhe përfshirjes së përdoruesve fundorë në proceset e shpërndarjes. Në këtë fazë, aplikantët inkurajohen që të përdorin rezultatet e projekteve të mëparshëm (nga ETC apo programe të tjera të BE-së) dhe të punojnë në rezultatet e moduleve të tjera. Për të siguruar cilësi të lartë të rezultateve, objektivi përfundimtar nuk duhet të konsistojë vetëm në "përhapjen e informacionit". Do të jetë, gjithashtu, e nevojshme për të siguruar që mjetet, praktikat dhe metodologjitë janë marrë përsipër në mënyrë efektive nga të gjithë aktorët e interesuar dhe të zbatohen në nivel lokal, rajonal, kombëtar apo ndërkombëtar sa më gjerësisht të jetë e mundur dhe pa pagesë.

2.1.24.3 Përdorimi i planifikuar i instrumenteve financiare

Prioriteti i Investimeve 6.d	**Mbrojtja, ripërtëritja e biodiversitetit, e tokës dhe promovimi i shërbimeve të ekosistemit, përfshirë përmes "Natura 2000" dhe infrastrukturës së gjelbër**
Planifikimi i përdorimit të instrumenteve financiare	
Mundësia e hartimin dhe e zbatimit të instrumenteve financiare do të diskutohet gjatë zbatimit të Programit.	

2.1.24.4 Përdorimi i planifikuar i projekteve madhore

Nuk aplikohet

2.1.24.5 Treguesit e rezultateve

Tabela 4. Treguesit e përbashkët dhe specifikë të Programit, të rezultateve (*sipas prioritetit të investimit*)

ID	Treguesit	Njësia matëse	Vlera e synuar (2023)	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia e raportimeve
3.2.a	Numri i planeve të përbashkëta të qeverisë	Planet	36	Mjetet	Vjetor
3.2.b	Sipërfaqja e habitateve, e cila synon arritjen e një statusi më të mirë konservimi	Hektarë	1.250.000	Mjete	Vjetor
3.2.c	Numri i zonave të mbrojtura të angazhuara në zbatimin e strategjive të menaxhimit	Zonat e mbrojtura	50	Mjetet	Vjetor

2.1.25 Aksi prioritar 4

ID	**Aksi prioritar 4**
	Përmirësimi i qeverisjes në Mesdhe
	Aksi prioritar 4 synon të kontribuojë për një dialog në strategjitë makrorajonale dhe në basenet e detit në Mesdhe dhe gjenerimin e bashkëpunimit dhe rritjen e konsensusit ndërmjet rajoneve të Mesdheut dhe vendeve pjesëmarrëse për çështjet ku mungojnë marrëveshjet e përbashkëta dhe planet e veprimit.

- I gjithë aksi prioritar do të zbatohet vetëm nëpërmjet *instrumenteve financiare*;
- I gjithë aksi prioritar do të zbatohet vetëm nëpërmjet *instrumenteve financiare të ngritura në nivelin e BE-së*;
- I gjithë aksi prioritar do të zbatohet nëpërmjet *metodës së përfshirjes të komunitetit në nivel lokal.*

2.1.26 Arsyetimi për krijimin e një aksi prioritar, i cili do të mbulojë më shumë se një objektiv tematik

Nuk aplikohet

2.1.27 Fondi dhe baza e llogaritjes për mbështetjen e Unionit

Fondi	ERDF
Baza e përllogaritjes (totali i shpenzimeve të pranueshme ose shpenzime publike të pranueshme)	**17.945.801 €**

2.1.28 Prioriteti i investimeve 11

Prioriteti i investimeve 11
Përmirësimi i qeverisjes në vendet e Mesdheut

2.1.29 Objektivi specifik 4.1

ID	4.1
Objektivi specifik	Mbështetje për procesin e forcimit dhe të zhvillimit të kornizave shumëpalëshe koordinuese në Mesdhe për të përballuar sfidat e përbashkëta. Ndërsa Programi MED synon të përfitojë dhe të kontribuojë në kuadër të kornizave makrorajonale ekzistuese dhe strategjive për zhvillimin e të ardhmes, përzgjedhja e projekteve specifike mund të lehtësojë mjetet dhe mekanizmat e përshtatshëm për të lehtësuar zbatimin e një qeverisjeje më të mirë dhe integrim tematik në Mesdhe. Ky objektiv do të arrihet nëpërmjet një platforme, "Projekti, platforma e autoriteteve kombëtare", të programuar nën aksin 4, si dhe nëpërmjet financimit të projekteve specifike që burojnë nga puna e grupeve të punës ndërqeveritare dhe në kuadër të iniciativës për platformën.

Rezultatet e pritshme	*Forcimi i kapaciteteve për koordinim shumëpalësh në Mesdhe;* Zona e Mesdheut është një nga zonat më heterogjene e bashkëpunimit të BE-së. Konteksti gjeografik, ekonomik edhe politik mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme nga një rajon në tjetrin dhe zbatimi i planeve të përbashkëta të veprimit në zonën e përgjithshme në sektorët kyç siç është siguria detare, transporti, energjia apo ndotja e cila është sfiduese. **Ndryshimet kryesore të kërkuara** Për këtë objektiv specifik, ndryshimi kryesor i kërkuar është ngritja e një procesi qeverisës midis të gjitha vendeve pjesëmarrëse. Kjo do të marrë në konsideratë iniciativat e bashkëpunimit, tashmë të ndërmarra ose të testuara në fusha të ndryshme të ndërhyrjes së Programit MED. Një vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet çështjeve ekonomike dhe mjedisore, me promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm të Mesdheut (aksi 2 dhe 3 të PB-së). Rezultati kryesor do të jetë përgatitja e masave të planifikuara të bashkëpunimit mes vendeve pjesëmarrëse. Ai do të përfshijë proceset e diskutimit dhe të shkëmbimit, platformat shumëpalëshe të bashkëpunimit, si dhe përcaktimin e objektivave, të një strategjie dhe të planit të veprimit për zbatimin e masave të përbashkëta. Mundësitë për t'u lidhur me programet e integruara, që janë zbatuar në rajonet e Mesdheut janë me rëndësi jetike. Programi MED mund të kontribuojë në zhvillimin e një strategjie të Mesdheut për arritjen e një statusi të përmirësuar mjedisor të detit dhe një plan shumëpalësh të veprimit për të gjithë rajonin dhe/ose për secilin nënrajon të saj (Adriatiko-Jonian, Mesdheu Perëndimor dhe Lindor) në bashkërendim të ngushtë me zbatimin e Direktivës Kuadër të BE-së për Strategji Detare dhe në bashkëpunim me Konventën e Barcelonës, me H2020 dhe iniciativën e ndotjes për MED. Programi nuk do të mbështesë në mënyrë të drejtpërdrejtë qeverisjen e strategjisë makrorajonale Adriatiko-Jonian, por mund të kontribuojë në zbatimin e projekteve përkatëse në koordinimin me Programin transkombëtar Adriatiko-Jonian. Programi MED mund të mbështesë projekte që zbatojnë planin e veprimit EUSAIR, ku ndahen objektivat e përbashkët me katër komponentët kryesorë të kësaj strategjie: 1. rritja blu; 2. lidhja e rajonit; 3. cilësia e mjedisit; 4. turizmi i qëndrueshëm.

Tabela 3. Indikatorët e rezultateve specifike të Programit *(sipas objektivit specifik)*

Një (nëse është e mundur) dhe më shumë se dy nga rezultatet e treguesve duhet të përdoret për secilin objektiv specifik. Nevoja për indikator të tjerë duhet të jetë përjashtimore.

ID	Rezultatet e treguesve	Njësia matëse	Vlera bazë	Viti bazë	Vlera e synuar (2023) 100 karaktere maks.	Burimi i të dhënave[67]	Shpeshtësia e raportimeve
IP 4.e SO 2.2 2.2.1	Numri i planeve të përbashkëta tematike të veprimit që mundësojnë zbatimin e veprimeve strategjike të koordinuara[68]	Plane të përbashkëta veprimi (numër)	**7**	**2014**	**10**	Studim: Renditja dhe klasifikimi i strategjive dhe planeve të përbashkëta ekzistuese të integruara të veprimit	Dy herë gjatë periudhës së programimit **(2019/të dhënat e 2018-ës, 2023-shit/të dhënat e 2022-shit)**

[67] Vlerat e synuara mund të jenë cilësore ose sasiore.

[68] Të tilla si: ulja e ndotjes së brigjeve, lufta kundër ndotjes së detit, menaxhimi i mbetjeve, plane të integruara të menaxhimit të zonave bregdetare, planifikimi hapësinor detar.

2.1.30 Veprimet që do të mbështeten nën prioritetin e investimeve

2.1.30.1 Përshkrimi i llojit dhe shembuj të veprimeve që do të mbështeten

Prioriteti i investimeve 11	Përmirësimi i qeverisjes në vendet e Mesdheut

Lloje dhe shembuj të veprimeve, pritet kontributi i objektivave specifikë

Lista e mëposhtme e veprimeve të mundshme është vetëm një listë treguese dhe mund të plotësohet me veprime të tjera përkatëse kontribuar në qëllimet objektivin specifik. Objektivi specifik 4.1, "Për të mbështetur procesin e forcimit dhe të zhvillimit të kornizave shumëpalëshe koordinuese në Mesdhe për përgjigjet e përbashkëta ndaj sfidave të përbashkëta".

Menaxhimi i njohurive:

- Studimet, diagnoza, analiza konteksti;
- Proceset e konsultimit.

Rrjetëzimi dhe hartimi i strategjive

- Takime, takime pune, seminare mes aktorëve (grupet e punës);
- Koordinimi në nivel rajonal dhe nënrajonal të programeve dhe programeve të vëzhgimit dhe monitorimit të masave të BE-MS për mjedisin detar;
- Mbështetje për bashkëpunim strategjik të basenit makrorajonale;
- Hartimi i qasjeve të integruara për problemet e përbashkëta;
- Ndarja e mjeteve që lehtësojnë koordinimin midis autoriteteve;
- Kontribut për koordinim më të mirë mes strategjive ekzistuese dhe atyre të reja.

Identifikimi i grupeve kryesore të synuara (lista jo të plota)

- Vendimmarrësit/politikanët;
- Autoritetet kombëtare dhe rajonale;
- Aktorët socioekonomikë të shqetësuar nga fushat kryesore të ndërhyrjes (siguria detare, transporti, energjia, ndotja);
- Operatorët ekonomikë.

Territore të shënjestruara

- Të cilat do të përcaktohen sipas nevojave të fushave kryesore të ndërhyrjes. Të gjitha territoret e Programit MED janë të shqetësuar nga ky prioritet investimesh.

Llojet e përfituesve (listë joshteruese)

- Autoritetet evropiane, kombëtare, rajonale (dhe lokale);
- Qendrat kërkimore;
- Vendimmarrësit/politikanët.

2.1.30.2 Udhëzuesi për përzgjedhjen e veprimeve

Prioriteti i investimeve 11	Nxitja e qeverisjes në vendet e Mesdheut

Çdo veprim do t'i nënshtrohet një kontrolli të provueshmërisë për të siguruar se ai plotëson kriteret kryesore lidhur me objektivat e projektit, partneritetit të tyre, dimensionit transnacional dhe buxhetit. Në këtë fazë, aplikimet duhet të jenë në përputhje të plotë me prioritetet e investimit dhe me objektivat specifikë të cilëve ato u referohen.

Aplikimet e pranueshme do t'i nënshtrohen një kontrolli cilësie më të detajuar lidhur me objektivat e tyre, strategjinë e përdorur dhe mjetet në dispozicion.

Kriteret e cilësisë do të përfshijnë, në veçanti:

- Koherencën e projektit me strategjinë e Programit, përmbajtjen e prioriteteve të investimeve dhe objektivave specifikë.
- Koherencën e projektit me politikat kombëtare dhe rajonale dhe masat e zbatuara për krijimin e sinergjive dhe për shmangien e mbivendosjeve;
- Plotësimin me projekte të tjera të BE-së, programet tematike dhe iniciativat;
- Plotësimin me iniciativat të tjera Mesdhetare në sektorin në fjalë;
- Dimension transkombëtar të projektit me vërtetimin se partnerët ndajnë nevoja të përbashkëta dhe objektiva të përbashkët;
- Dimensionin inovativ të projekteve, ndikimin e tyre konkret në zhvillimin socioekonomik dhe efektet e tyre në periudhën afatmesme;
- Vëmendje kushtuar ndaj efekteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta mjedisore të projektit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë;
- Koherencën e partneritetit, rëndësinë dhe kompetencat e partnerëve, në përputhje me objektivat e projektit;
- Koherencën e aktiviteteve me objektivat e rezultatet;

- Lidhjen e planit të financimit dhe koherencës së buxhetit me objektivat e vendosur.

Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet koherencën e këtyre elementeve me kërkesat e çdo thirrjeje për projektin. Kur, kërkesat shtesë përkatëse do të përfshihen në termat e referencës së thirrjeve për projekte, duke përfshirë edhe për çështjet e mjedisit.

Për hartimin e projekteve të tyre, aplikantët duhet t'u referohen dy llojeve të moduleve të përcaktuara për aksin prioritar 4. Objektivi i këtyre moduleve është që të fokusojë projektet në lloje të mirëpërcaktuara të aktiviteteve për të sjellë kontribut konkret në sigurimin e objektivit specifik.

Një veprim mund të përfshijë një ose disa module në varësi të strategjisë së tij dhe objektivave kryesorë.

Përshkrimi i moduleve të ndryshme

Moduli 1. Një modul i dedikuar për menaxhimin e njohurive me hartimin e studimeve, analizimin e kontekseve dhe nisjen e proceseve të konsultimit. Këto aktivitete kanë për qëllim përmirësimin e njohurive, në lidhje me fusha e mëdha të ndërhyrjes dhe për të përmirësuar të kuptuarit e përbashkët të kontekstit, sfidave dhe perspektivave të Mesdheut.

Këto aktivitete mund të përbëjnë objektivin kryesor të projektit apo fazën e parë të një projekti më të gjerë, i cili do të përdorë këto rezultate për të ndihmuar rrjetëzimin dhe hartimin e strategjive mes aktorëve kyç të Mesdheut.

Moduli 2. Kur informacioni në lidhje me një fushë të ndërhyrjes është i mirëpunuar dhe është ndarë në nivel transkombëtar, projektet mund të ndërtojnë strategji mes aktorëve kyç nëpërmjet procedurave shumëniveleshe të pjesëmarrjes, në mënyrë që të arrijnë marrëveshje të përbashkëta dhe të hartojnë strategji për ndërhyrje të koordinuara në nivel të Mesdheut.

Procesi i përgjithshëm i përzgjedhjes së projekteve të MED-së përshkruhet në seksionin 5.1.3.b të PB-së, "Organizimi i vlerësimit dhe i përzgjedhjes së operacioneve".

2.1.30.3 PLANIFIKIMI I PËRDORIMIT TË INSTRUMENTEVE FINANCIARE

Kur aplikohet

Prioriteti i investimit 11	**Përmirësimi i qeverisjes në Mesdhe**
Planifikimi i përdorimit të instrumenteve financiare	
Mundësia për hartimin dhe zbatimin e instrumenteve financiare do të debatohet gjatë zbatimit të Programit.	

2.1.30.4 Planifikimi i përdorimit të projekteve të mëdha

Nuk aplikohet

2.1.30.5 Treguesit

Tabela 4. Treguesit e zakonshëm dhe specifikë të Programit (sipas prioriteteve të investimeve)

ID	**Treguesit**	**Njësia matëse**	**Vlera e synuar (2023)**	**Burimi i të dhënave, 200 karaktere maksimumi**	**Shpeshtësia e raportimeve, 100 karaktere maksimumi**
4.1.a	Numri i aktorëve (strukturave) të përfshirë në iniciativë të financuara (sipas kategorive, duke përfaqësuar sektorin publik dhe atë privat)	Organizata	1.200	Mjetet e monitorimit të Programit	Vjetor

2.1.31. Kuadri i performancës

Tabela 5. Kuadri i performancës sipas akseve prioritare

Aksi prioritar	Treguesi ose tipi	ID	Treguesi ose hapat kyç të zbatimit, maks. 255 karaktere	Njësia matëse, sipas rastit	Piketat për 2023	Objektivi final (2023)	Burimi i të dhënave	Shpjegimi i rëndësisë së treguesit, sipas rastit
1	Numri i instrumenteve operacionale për të favorizuar SME-të	1.1.a	Instrumente operacionale: Mjetet dhe shërbimet e krijuara në mënyrë efektive apo të përshtatura nga ato ekzistueset, zbatuar dhe vlerësuar në grupe dhe rrjete mbështetëse, me përfitim të matshëm për SME-të, të synuara në veprimet mbështetëse.	Instrumentet	8	44	Mjetet e monitorimit të Programit	Instrumentet kanë për qëllim sigurimin e aktorëve të grupimeve dhe rrjeteve me mjete mbështetëse për të rritur njohuritë, aftësitë dhe kapacitetet për të zhvilluar aktivitetet në nivel transkombëtar. Prandaj grupet dhe rrjetet duhet të fuqizohen në nivel transkombëtar në saje të këtyre instrumenteve.
1	Shpenzimet e deklaruara në KE	1	Shpenzimet e deklaruara në KE për aksin 1	Euro	12.667.625	84.450.833	Mjetet e monitorimit të Programit	Shpenzimet e deklaruara në KE llogariten duke u bazuar në numrin e projekteve nën zbatim në fund të 2018-ës dhe 2023-shit.
Aksi prioritar	**Treguesi ose tipi**	**ID**	**Treguesi ose hapat kyç të zbatimit, maks. 255 karaktere**	**Njësia matëse, sipas rastit**	**Objektivat për vitin 2023**	**Objektivi final (2023)**	**Burimi i të dhënave**	**Shpjegimi i rëndësisë së treguesit, sipas rastit**
2	Numri i mjeteve të planifikuara në dispozicion për të monitoruar dhe për menaxhuar konsumin e energjisë në ndërtesat publike.	2.1.a	Mjetet e planifikimit në dispozicion: Mjetet e planifikimit të përfshijnë veprime specifike dhe në shënjestër plane, IT zgjidhjeve lejuar mbledhjen e të dhënave për auditimin dhe vlerësimin, rrjetet e vlerësimit, monitorimit dhe mjetet e menaxhimit për autoritetet publike, menaxherët e ndërtimit dhe përdoruesit, udhëzon dhe mbështet tjera informative	Mjetet	3	5	Mjetet e monitorimit të Programit	Rritja e kapaciteteve të pronarëve dhe të menaxherëve të ndërtimit kërkon sigurimin e tyre me mjetet e nevojshme për të zhvilluar dhe zbatuar praktikat e efikasitetit të energjisë për rezervat e tyre të ndërtimit. Prandaj, mjetet e planifikimit janë thelbësore për të arritur rezultatin e pritur të këtij objektivi.
2	Numri i mjeteve të planifikuara për zhvillimin e planeve të energjisë, përfshi	2.2.a	Mjeti i planifikuar: Mjetet planifikuese janë një pjesë e planeve të veprimit dhe mund të trajtojnë vlerësimin,	Mjetet	3	5	Mjetet e monitorimit të Programit	Rritja e përfshirjes së burimeve lokale të energjisë së rinovueshme në strategjitë e kombinuara të energjisë kërkon mjete të përshtatshme të planifikimit për të mbështetur zhvillimin e

	burimet e rinovueshme të energjisë lokale (RES).		auditimin, trajnimin, dokumente të menaxhimit ose mjetet e IT-së.					suksesshëm të modeleve/planeve/strategjive të përshtatura për territore specifike. Për shkak të karakteristikave të tij transkombëtare (jo infrastrukturat), MED nuk mund të sigurojë drejtpërdrejt rritjen e përdorimit të RES-ve lokale, por mund të mbështesë hartimin e strategjive të synuara për këtë qëllim.
Aksi prioritar	**Treguesi ose tipi**	**ID**	**Treguesi ose hapat kyç të zbatimit, max. 255 karaktere**	**Njësia matëse, sipas rastit**	**Piketat për 2023**	**Objektivi final (2023)**	**Burimi i të dhënave**	**Shpjegimi i rëndësisë së treguesit, sipas rastit**
2	Numri i instrumenteve në dispozicion për të nxitur përdorimin e zgjidhjeve të transportit LC, duke përfshirë edhe ato multimodale.	**2.3.a**	Instrumentet: Mjetet dhe shërbimet e krijuara ose të adaptuara nga ato ekzistueset për përdoruesit dhe menaxherët e transportit (informacioni për trafikun, sistemet informatike të integruara në transportet publike, mjetet e menaxhimit për makinat që jepen me qira ...).	Instrumentet	3	5	Mjetet e monitorimit të Programit	Zgjerimi i kapaciteteve për përdorimin e sistemeve të transportit me emetim të ulët të karbonit kërkon instrumente të përshtatura për t'u ofruar përdoruesve informacion dhe zgjidhje që do të nxisin dhe do të lehtësojnë përdorimin e zgjidhjeve LC. Prandaj, zhvillimi ose vënia në dispozicion e instrumenteve të përdorshme (mjetet dhe shërbimet) janë thelbësore për të arritur rezultatin e pritshëm të këtij objektivi.
2	Shpenzimet e deklaruara në KE	**2**	Shpenzimet e deklaruara në KE për aksin 2	Euro	7.917.266	52.781.771	Mjetet e monitorimit të Programit	Shpenzimet e deklaruara në KE llogariten duke u bazuar në numrin e projekteve nën zbatim në fund të 2018-ës dhe 2023-shit.
3	Numri i instrumenteve në dispozicion për të rritur zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm.	**3.1.a**	Instrumentet: Mjetet dhe shërbimet e krijuara ose të përshtatura nga ato ekzistueset për të lehtësuar zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm.	Instrumentet	10	17	Mjetet e monitorimit të Programit.	Rritja e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm kërkon instrumente të përshtatshme për t'u siguruar autoriteteve publike dhe aktorëve të destinacioneve turistike informacion dhe zgjidhje që do të nxisin dhe do të lehtësojnë zhvillimin e zgjidhjeve për një rritje të turizmit të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm, të integruar në një strategji menaxhimi më të gjerë. Prandaj, zhvillimi ose vënia në dispozicion e instrumenteve të përdorshme (mjetet dhe shërbimet) janë thelbësore për të arritur rezultatin e pritshëm të këtij objektivi.
	Numri i planeve të përbashkëta qeverisëse		Plani i qeverisjes: Caktimi i roleve, përgjegjësive dhe proceseve për të përfshirë aktorët përkatës në qëllimet e	Planet			Mjetet e monitorimit të programit	Ruajtja e biodiversitetit të ekosistemeve nëpërmjet integrimit më të mirë të zonave të mbrojtura në strategjitë e zhvillimit territorial kërkon zhvillimin e planeve përkatëse të

3		**3.2.a**	ruajtjes (objektivat dhe kuadri ligjor, kushtet e palëve të interesuara për pjesëmarrje në organet menaxhuese, procedurat e menaxhimit të konflikteve, aktivitetet e qeverisjes dhe raportimi ...).		18	36		qeverisjes në të cilin palët e interesuara tashmë përgjegjëse mund të marrin pjesë dhe të përmirësojnë proceset e tyre menaxhuese për rezultate më të mira. Prandaj, zhvillimi i planeve të qeverisjes është vendimtar për të arritur rezultatin e pritur të këtij objektivi.
3	Shpenzimet e deklaruara në KE	**3**	Shpenzimet e deklaruara në KE për aksin 3	Euro	13.459.352	89.729.012	Mjetet e monitorimit të programit	Shpenzimet e deklaruara në KE llogariten duke u bazuar në numrin e projekteve nën zbatim në fund të 2018-ës dhe 2023-shit.
4	Numri i palëve të interesuara (strukturave) të përfshira në iniciativat e mbështetura (sipas kategorive që përfaqësojnë palët e interesuara publike dhe private)	**4.1.a**	Palët e interesuara: Strukturat e përfshira në iniciativat mbështetëse, të renditura sipas statusit publik ose privat.	Organizatat	200	1.200	Mjetet e monitorimit të programit	Rritja e kapaciteteve për koordinimin shumëpalësh kërkon mundësimin e palëve të interesuara që të marrin pjesë në proces në një mënyrë të përshtatshme. Prandaj, përfshirja e strukturave përkatëse publike dhe private në iniciativat është vendimtare për të arritur objektivin e prioritetit.
4	Shpenzimet e deklaruara në KE	**4**	Shpenzimet e deklaruara në KE për aksin 4	Euro	3.166.906	21.112.708	Mjetet e monitorimit të Programit	Shpenzimet e deklaruara në KE llogariten duke u bazuar në numrin e projekteve nën zbatim në fund të 2018-ës dhe 2023-shit.

Informacion shtesë cilësor për krijimin e kuadrit të performancës (jo i detyrueshëm).

2.1.32 Kategoritë e ndërhyrjes

(Referenca: Pika "b"/"vii" e nenit 8(2) e Rregullores (BE) nr. 1299/2013

Tabelat 6–9. Kategoritë e ndërhyrjes

Tabela 6. Dimensioni 1. Fusha e ndërhyrjes

Aksi prioritar	Kodi	Shuma në €
1	060 Aktivitetet e kërkimit dhe të inovacionit në qendrat kërkimore publike dhe qendrat e kompetencës, përfshi krijimin e rrjeteve	7 477 706 €
	061 Aktivitetet e kërkimit dhe të inovacionit në qendrat kërkimore private, përfshi krijimin e rrjeteve	6 879 489 €
	062 Transferimi i teknologjisë dhe bashkëpunimi universitet–ndërmarrje, kryesisht duke përfituar SMS-të	7 776 814 €
	063 Mbështetja nga grupet dhe rrjetet e biznesit, në radhë të parë përfitojnë SMS-të	7 776 814 €
	064 Proceset e kërkimit dhe inovacionit në SMS-të (përfshi skemat kupon, proceset, dizajnin, shërbimin dhe inovacionin social	7 477 706 €
	065 Infrastruktura e kërkimit dhe e inovacionit, proceset, transferimi i teknologjisë dhe bashkëpunimi në ndërmarrjet, duke u fokusuar në ekonomi me emetim të ulët të karbonit dhe në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike	7 477 706 €
	067 Zhvillimi i biznesit të SME-ve, mbështetje për sipërmarrjen dhe inkubacionin (përfshi mbështetjen për kompanitë e reja	7 477 706 €
	073 Mbështetje për ndërmarrjet sociale (SME-të)	7 477 706 €
	078 Shërbimet e-qeveritare dhe aplikimet (duke përfshirë e-Prokurimi, masat TIK që mbështesin reformën e administratës publike, siguria kibernetike, masat për besimin dhe privatësinë, e-Drejtësia dhe e-Demokracia	7 477 706 €
	079 Qasje/ose akses në informacionin e sektorit publik (duke përfshirë të dhëna të hapura/ose të papenguara në e-Kultura, bibliotekat digjiitale, e-Përmbajtja dhe e-Turizmi)	7 477 706 €
2	009 Energjia e rinovueshme: era	4 673 567 €
	010 Energjia e rinovueshme: diellore	4 673 567 €
	011 Energjia e rinovueshme: e biomasës	5 140 923 €
	012 Energji të tjera të rinovueshme (përfshi energjinë hidroelektrike, gjeotermale dhe detare) dhe integrimin e energjisë së rinovueshme (përfshi ruajtjen, mundësinë për gazin dhe infrastrukturën e rinovueshme të hidrogjenit)	4 206 207 €
	013 Renovimi i efikasitetit të energjisë së infrastrukturës publike, projektet demonstruese dhe masat mbështetëse	12 151 273 €
	043 Infrastruktura e pastër urbane e transportit dhe promovimi (duke përfshirë pajisjet dhe inventarin e hekurudhës)	7 945 063 €

Aksi Prioritar	Kodi	Shuma në €
2	044 Sistemet inteligjente të transportit (përfshi futjen e menaxhimit të kërkesës, sistemet e pagesës (taksa e kalimit), monitorimi IT, sistemet e kontrollit dhe informacionit)	7 945 063 €
	023 Masat mjedisore që synojnë reduktimin dhe/ose për të shmangur emetimet e gazit (përfshi trajtimin dhe deponimin e gazit metan dhe kompostimin)	5 378 805 €
	085 Mbrojtja dhe përmirësimi i biodiversitetit, mbrojtja e natyrës dhe infrastruktura e gjelbër	18 027 347 €
	086 Mbrojtja, restaurimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i *site*-ve "Natura 2000"	18 019 404 €
	091 Zhvillimi dhe promovimi i potencialeve turistike të zonave natyrore	12 608 814 €
	092 Mbrojtja, zhvillimi dhe promovimi i aseteve turistike publike	12 608 814 €
	094 Mbrojtja, zhvillimi dhe promovimi i aseteve të trashëgimisë kulturore dhe publike	12 807 442 €
4	096 Kapacitetet institucionale të administratës publike dhe shërbimet publike që lidhen me zbatimin e Fondit Evropian për Zhvillimin Rajonal (ERDF) apo veprimet që mbështesin nismat e kapaciteteve institucionale të Fondit Social Evropian (ESF)	9 347 132 €
	119 Investimi në kapacitetet institucionale dhe në efikasitetin e administratës publike dhe shërbimet publike në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal me synimin te reformat, rregullimin më të mirë, si dhe qeverisjen e mirë	9 347 131 €
5	121 Përgatitja, zbatimi, monitorimi dhe inspektimi	12 862 319 €
	122 Vlerësimi dhe studimet	408 349 €
	123 Informimi dhe komunikimi	750 029 €

Tabela 7. Dimensioni 2. Forma e financimit

Aksi prioritar	Kodi	Shuma në €
1	01 Grant jo i shlyeshëm	74 777 059 €
2	01 Grant jo i shlyeshëm	46 735 663 €
3	01 Grant jo i shlyeshëm	79 450 626 €
4	01 Grant jo i shlyeshëm	18 694 263 €
5	01 Grant jo i shlyeshëm	14 020 697 €

Tabela 8. Dimensioni 3: Lloji i territorit

Aksi prioritar	Kodi	Shuma në €
1	01 Zona të mëdha urbane (me dendësi popullsie > 50 000 njerëz)	33 649 677 €
	02 Zona të vogla urbane (me dendësi të ndërmjetme > 5 000 njerëz)	33 649 677 €
	03 Zonat rurale (në dendësi të ulët të popullsisë)	7 477 705 €
2	01 Zona të mëdha urbane (me dendësi popullsie > 50 000 njerëz)	16 357 482 €
	02 Zona të vogla urbane (me dendësi të ndërmjetme > 5 000 njerëz)	16 357 482 €
	03 Zonat rurale (në dendësi të ulët të popullsisë)	14 020 699 €
3	01 Zona të mëdha urbane (me dendësi popullsie > 50 000 njerëz)	19 862 657 €
	02 Zona të vogla urbane (me dendësi të ndërmjetme > 5 000 njerëz)	19 862 657 €
	03 Zonat rurale (në dendësi të ulët të popullsisë)	39 725 312 €
4	04 Zona makrorajonale e bashkëpunimit	18 694 263 €

5	07 Jo i zbatueshëm	14 020 697 €

Tabela 9. Dimensioni 6. Mekanizmat për shpërndarjen territoriale

Aksi prioritar	Kodi	Shuma në €
1	07 Jo i zbatueshëm	74 777 059 €
2	02 Qasjet e tjera të integruara në zhvillimin e qëndrueshëm urban	32 714 964 €
	05 Qasjet e tjera të integruara në zhvillimin e qëndrueshëm urban/rural	14 020 699 €
3	04 Qasjet e tjera të integruara në zhvillimin e qëndrueshëm urban	39 725 313 €
	05 Qasjet e tjera të integruara në zhvillimin e qëndrueshëm urban/rural	39 725 313 €
4	07 Jo i zbatueshëm	18 694 263 €
5	07 Jo i zbatueshëm	14 020 697 €

2.1.33. Përmbledhje mbi përdorimin e asistencës teknike të planifikuar

(Referenca: Pika "b"/"vi", e nenit 8 (2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

AKSI PRIORITAR	ASISTENCA TEKNIKE
Nuk ka asnjë veprim të përcaktuar për përmirësimin e kapaciteteve të zbatimit vetëm të një aksi prioritar specifik. Veprimet e asistencës teknike kanë lidhje me të gjitha akset prioritare dhe shtjellohen në seksionin 2.B	

2.2 Përshkrimi i aksit prioritar për asistencën teknike

2.2.1 Aksi prioritar 5

ID	AKSI PRIORITAR 5
Titulli	**Asistenca teknike**

2.2.2. Financimi dhe skenari bazë i kontributit të BE-së

Fondi	ERDF
Baza e përllogaritjes (shpenzimet totale të pranueshme ose shpenzimet publike të pranueshme)	**13 459 351 euro**

2.2.3. Objektivat specifikë dhe rezultatet e pritshme

(Referenca: Pikat "c"/"i" dhe "ii", të nenit 8 (2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Objektivi specifik (përsëritet për çdo objektiv specifik)

ID	5.1
Objektivi specifik	**Zbatimi me efikasitet i programit të bashkëpunimit**

Rezultatet e pritshme[69]	Një menaxhim i qëndrueshëm i programit të bashkëpunimit është parakusht për zbatimin e tij efektiv. Rezultati që pritet në kuadër të këtij objektivi specifik është i lidhur drejtpërdrejt me nevojën për të siguruar menaxhim të përshtatshëm dhe mjedis të kontrollit të programit, siç përcaktohet në seksionin 5.3, që garanton se të gjithë hapat e zbatimit të programit (duke përfshirë lançimin e thirrjeve, kontraktimin, monitorimin e operacioneve dhe arritjet e programit, rimbursimin e shpenzimeve etj.) janë ekzekutuar në kohë. **Ndryshimet kryesore të kërkuara** Vlerësimi i programit MED 2007–2013 tregon se zbatimi i programit mund të përmirësohej dhe barra administrative të reduktohej. Prandaj, ndryshimi i nxitur nga programi i referohet kryesisht përmirësimit të mëtejshëm dhe lehtësimit të procedurave administrative për zbatimin më të shpejtë dhe më efikas të programit, si edhe përmirësimit të mbështetjes për përfituesit në mënyrë që ata të aplikojnë në kushte më të mira dhe të paraqesin projekte më të synuara dhe të cilësisë më të mirë

ID	5.2

[69] Kërkohet vetëm kur kontributi i Unionit për asistencë teknike në programin e bashkëpunimit i tejkalon 15 milionë euro.

Objektivi specifik	**Përmirësimi i mbështetjes ndaj aplikantëve dhe ndaj përfituesve dhe forcimi i përfshirjes së partnerëve përkatës në zbatimin e programit**

Rezultatet e pritshme[70]	Përveç menaxhimit të shëndoshë të programit edhe kapaciteti i aplikuesve dhe i përfituesve për të marrë pjesë në program është një aspekt kyç i zbatimit të tij të suksesshëm. Analiza e programit MED 2007–2013 tregon një numër shumë të lartë të aplikimeve për projekte, numrin e kufizuar të projekteve të përzgjedhura, nevojën e informimit dhe të monitorimin e aplikantëve përballë kërkesave të rritura nga rregulloret dhe programet. Për periudhën 2014–2020, objektivat e menaxhimit të shëndoshë, efikasiteti dhe vëmendja e treguar ndaj rezultateve të projekteve imponojnë për të forcuar mbështetjen për përgatitjen e aplikimit dhe zbatimit të projekteve. **Ndryshimet kryesore të kërkuara** Kërkesa për ndryshimin kryesor është përmirësimi i cilësisë së projekteve, që nënkupton aplikime më të pakta në numër që u korrespondojnë më mirë kërkesave të programit. Ky ndryshim do të kërkojë një përshtatje të thirrjeve për projekte (thirrjet e synuara, thirrjet strategjike ...), procedurat e thjeshtuara dhe mbështetje më të synuar për aplikantët dhe përfituesit (mobilizimi i Sekretariatit të Përbashkët, informimi, frymëzimi/gjallërimi, mobilizimi i pikave kombëtare të kontaktit ...).

2.2.4 Treguesit e rezultateve

Nuk janë përkatës meqenëse kontributi i BE-së për asistencën teknike në programin MED të bashkëpunimit nuk i tejkalon 15 milionë euro.

2.2.5 Veprimet që do të mbështeten dhe kontributi i tyre i pritshëm në objektivin specifik

2.2.5.1 Përshkrimi i veprimeve që do të mbështeten dhe kontributi i tyre i pritshëm në objektivat specifikë

(Referenca: Pika "c"/"iii" e nenit 8(2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Aksi prioritar 5	**Asistenca teknike**

1. Lloji dhe shembuj të veprimeve dhe kontributi i pritshëm për objektivat specifikë

Lista e mëposhtme e veprimeve të mundshme është vetëm një listë indikative dhe mund të plotësohet me veprime të tjera përkatëse që kontribuojnë në qëllimet e objektivit specifik.

Objektivi specifik 5.1. **Veprimet për zbatimin në mënyrë efektive të programit të bashkëpunimit**

Veprimet nën objektivin specifik 5.1 synojnë përgatitjen, menaxhimin, monitorimin, vlerësimin, informimin, komunikim, detyrat e kontrollit dhe auditimit të programit. Veprimet që i referohen këtij objektivi specifik, gjithashtu, adresojnë uljen e barrës administrative për përfituesit.

Veprimet indikative të mbështetura nën objektivin specifik 5.1 janë të renditura më poshtë dhe u referohen parimeve dhe detyrave të shtjelluara në seksionet 5.3 dhe 7:

- Ngritja dhe menaxhimi i një Sekretariati të Përbashkët që mbështet autoritetin menaxhues dhe ndihmon në zbatimin e menaxhimit të përditshëm të programit;
- Përgatitja dhe zbatimi i thirrjeve për propozime, përfshi zhvillimin e dokumenteve udhëzuese që përcaktojnë kushtet për mbështetjen e operacioneve;
- Krijimi dhe zbatimi i procedurave për vlerësimin e cilësisë, monitorimi dhe kontrolli i operacioneve të zbatuara në kuadër të programit të bashkëpunimit, duke përdorur edhe ekspertë të jashtëm kur është e nevojshme dhe duke kontribuar në uljen e barrës administrative për përfituesit;
- Mbledhja e të dhënave në lidhje me progresin e programit në arritjen e objektivave të tij, si dhe të dhënat financiare dhe të dhënat që lidhen me indikatorët dhe piketat dhe raportimin në Komitetin e monitorimit dhe Komisionit Evropian;
- Hartimi dhe zbatimi i strategjisë së komunikimit të programit, përfshi krijimin dhe zbatimin e masave të informimit dhe komunikimit, si edhe mjetet;
- Hartimi dhe zbatimi i planit të vlerësimit të programit;
- Krijimi, drejtimi dhe mirëmbajtja e sistemit të kompjuterizuar për të regjistruar dhe për të ruajtur të dhënat për çdo operacion të nevojshëm për monitorimin, për vlerësimin, për menaxhimin financiar, për verifikimin dhe për auditimin, në përputhje me kërkesat e zbatueshme të shkëmbimit të të dhënave elektronike dhe që kontribuojnë në uljen e barrës administrative për përfituesit;
- Ngritja e një rrjeti të kontrollorëve financiarë kombëtarë, i koordinuar nga Sekretariati i Përbashkët, me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe praktikave më të mira në nivel transkombëtar;

[70] Kërkohet vetëm kur kontributi i Unionit për asistencë teknike në programin e bashkëpunimit i tejkalon 15 milionë euro.

- Krijimi dhe ekzekutimi i auditimeve për sistemin e menaxhimit dhe të kontrollit të programit dhe për operacionet.

Objektivi specifik 5.2. Veprimet për të mbështetur aplikantët dhe përfituesit dhe për të forcuar përfshirjen e partnerëve përkatës në zbatimin e programit

Veprimet nën objektivin specifik 5.2 synojnë përforcimin e kapaciteteve të aplikuesve dhe të përfituesve për të aplikuar për dhe përdorimin e fondeve, për t'u përfshirë në program dhe për të shkëmbyer praktikat e mira mes partnerëve.

Veprimet indikative të mbështetura nën objektivin specifik 5.1 janë të renditura më poshtë dhe u referohen parimeve dhe detyrave të shtjelluara në seksionet 5.3 dhe 7:

- Hartimi i dokumenteve të informimit për aplikantët dhe përfituesit për të udhëhequr ata në përgatitjen e aplikimeve dhe zbatimin, vlerësimin, kontrollin dhe komunikimin e operacioneve të miratuara;
- Organizimi i konsultimeve, informimit, trajnimit dhe shkëmbimit të eventeve për të forcuar kapacitetet e aplikantëve për të paraqitur drejtpërdrejt aplikimet që kontribuojnë në objektivat specifikë të programit dhe rezultatet e pritura;
- Organizimi i trajnimeve mbi çështje specifike të zbatimit, si për projektin dhe menaxhimin financiar, raportimin, kontrollin, auditimin, komunikimin dhe rrjetet për forcimin e kapaciteteve të përfituesve për të zbatuar operacionet e miratuara;
- Zhvillimi i informacionit dhe shkëmbimi i mjeteve (p.sh., dokumentet analitike, takimet bilaterale, eventet e synuara etj.), si dhe organizimi i eventeve transkombëtare dhe kombëtare për të forcuar përfshirjen e partnerëve përkatës në zbatimin e programit (përfshi edhe autoritetet e përfshira në zhvillimin ose zbatimin e strategjive makrorajonale, organet e përbashkëta ligjore që veprojnë në zonë (EGTC ...) dhe organizatat ombrellë në nivel transkombëtar/BE-së);
- Ngritja dhe menaxhimi i rrjetit të pikave kombëtare të kontaktit, që mbështesin Sekretariatin e Përbashkët, në zbatimin e detyrave në nivel kombëtar lidhur me zbatimin e programit;
- Kryerja e studimeve, raporteve dhe sondazheve për çështjet strategjike në lidhje me programin që mund të kontribuojnë në qëndrueshmërinë dhe përftimi i rezultateve dhe i arritjeve në politikat, strategjitë, investimet apo që janë me interes publik, duke shfrytëzuar ekspertët kur është e nevojshme.

Veprimet e asistencës teknike zbatohen nga të gjitha autoritetet e përfshira në menaxhimin e programit, të renditura në seksionin 5.3.

2.2.5.2. TREGUESIT E REZULTATEVE

(Referenca: Pikat "c"/"iv", të nenit 8 (2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Tabela 11. Indikatorët e rezultateve (sipas aksit prioritar)

ID	Indikatori	Njësia matëse	Vlera e synuar (2023) (opsionale)	Burimi i të dhënave
5.a	Krijimi i Sekretariatit të Përbashkët Teknik	nr.	1	Vëzhgim
5.b	Lançimi dhe mbyllja me sukses e thirrjeve për propozime	nr.	--	Vëzhgim
5.c	Miratimi i operacioneve pas thirrjeve për propozime	nr.	140	Sistemi i Monitorimit
5.d	Monitorimi i raporteve periodike për progresin e operacioneve (dhe të paguar)	nr.	600	Sistemi i e-Monitorimit të Programit
5.e	Zhvillimi i masave dhe i mjeteve të informacionit dhe komunikimit	nr.	--	Vëzhgim
5.f	Zbatimi i vlerësimeve të programit të pavarur (*ex-ante* dhe gjatë zbatimit të programit)	nr.	2	Vëzhgim
5.g	Zhvillimi dhe zbatimi i Sistemit të e-Monitorimit të Programit	nr.	1	Vëzhgim
5.h	Krijimi i rrjetit të kontrollorëve kombëtarë	nr.	1	Vëzhgim
5.i	Auditimet për menaxhimin e programit dhe të të sistemit të kontrollit dhe për operacionet	nr.	--	Sistemi i e-Monitorimit të Programit
5.j	Adresimi i dokumenteve të informacionit te aplikantët dhe përfituesit	nr.	--	Vëzhgim

5.k	Organizimi i konsultimeve, informacioneve, trajnimeve dhe shkëmbimi i seminareve për aplikantët dhe përfituesit	nr.	--	Vëzhgim
5.l	Krijimi i pikave të kontakteve kombëtare	nr.	10	Vëzhgim
5.m	Studime, raporte dhe sondazhe mbi çështje strategjike në lidhje me programin	nr.	--	Vëzhgim

2.2.6. Kategoritë e ndërhyrjes

Kategoritë përkatëse të ndërhyrjes, bazuar në nomenklaturën e miratuar nga Komisioni dhe ndarja indikative e financimit të BE-së.

Tabela 12–14. Kategoritë e ndërhyrjes

Tabela 12. Dimensioni 1. Fusha e ndërhyrjes

Aksi prioritar	Kodi	Shuma në euro
5	121: Përgatitja, monitorimi dhe inspektimi i zbatimit	12 862 319 €
5	122: Vlerësimi dhe studimet	408 349 €
5	123: Informimi dhe komunikimi	750 029 €

Tabela 13. Dimensioni 2. Forma e financimit

Aksi prioritar	Kodi	Shuma në euro
5	01: Grant jo i riparueshëm	14 020 697 €

Tabela 14. Dimensioni 2. Lloji i territorit

Aksi prioritar	Kodi	Shuma në euro
5	07: Jo i zbatueshëm	14 020 697 €

SEKSIONI 3

PLANI I FINANCIMIT

(Referenca: Pika "d" e nenit 8 (2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

3.1. Shuma e financimit nga ERDF-ja

(Referenca: Pika "d" e nenit 8 (2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Tabela 15

	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	TOTAL
ERDF	**0**	27 372 869	23 200 743	42 155 613	42 998 724	43 858 699	44 735 877	224 322 525
Shumat IPA (kur aplikohen)	**0**	1 141 636	967 630	1 758 177	1 793 341	1 829 208	1 865 791	9 355 783
Shumat ENI (kur aplikohen)			0	0	0	0	0	0
Total	**0**	**28 514 505**	**24 168 373**	**43 913 790**	**44 792 065**	**45 687 907**	**46 601 668**	**233 678 308**

3.1.1. Shuma e përgjithshme e financimit nga ERDF-ja dhe bashkëfinancimi kombëtar

(Referenca: Pika "d" e nenit 8 (2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Aksi prioritar	Fondi	Baza për përllogaritjen e kontributit të Unionit	Kontributi i Unionit (a)	Kontributi kombëtar	Ndarja indikative e kontributit kombëtar		Financimi i përgjithshëm (e) = (a) + (b) (2)	Përqindja e bashkëfinan-cimit (f) = (a)/(e)	Për më shumë informacion	
					Financimi publik kombëtar (c)	Financimi privat kombëtar (1) (d)			Kontributet nga vendet e treta	Kontributet e BEI
Aksi prioritar 1	ERDF (mundësisht duke përfshirë shumat e transferuara nga IPA-ja dhe ENI-ja)		71 783 208	12 667 625	10 134 100	2 533 525	84 450 833	85%		
	IPA		2 993 851	528 327	528 327	0	3 522 178	85%		
Aksi prioritar 2	ERDF (mundësisht duke përfshirë shumat e transferuara nga IPA-ja dhe ENI-ja)[71]		44 864 505	7 917 266	7 125 539	791 727	52 781 771	85%		
	IPA		1 871 158	330 205	330 205	0	2 201 363	85%		
Aksi prioritar 3	ERDF (mundësisht duke përfshirë shumat e transferuara nga IPA-ja dhe ENI-ja)[72]		76 269 660	13 459 352	12 651 791	807 561	89 729 012	85%		
	IPA		3 180 966	561 347	561 347	0	3 742 313	85%		
Aksi prioritar 4	ERDF (mundësisht duke përfshirë shumat e transferuara nga IPA-ja dhe ENI-ja)[73]		17 945 801	3 166 907	3 166 907	0	21 112 708	85%		
	IPA		748 462	132 082	132 082	0	880 544	85%		
Aksi prioritar 5	ERDF (mundësisht duke përfshirë		13 459 351	3 364 839	3 364 839	0	16 824 190	80%		

[71] Përfaqëson shumat e transferuara nga ENI-ja dhe IPA-ja, varet nga mundësia e përzgjedhur e menaxhimit, cfr. fisha nr. 28 për elementet që lidhen me integrimin e propozuar të alokimeve, sipas instrumenteve të jashtme të financimit në programet ETC.

[72] Përfaqëson shumat e transferuara nga ENI-ja dhe IPA-ja, varet nga mundësia e përzgjedhur e menaxhimit, cfr. fisha nr. 28 për elementet që lidhen me integrimin e propozuar të alokimeve, sipas instrumenteve të jashtme të financimit në programet ETC.

[73] Përfaqëson shumat e transferuara nga ENI-ja dhe IPA-ja, varet nga mundësia e përzgjedhur e menaxhimit, cfr. fisha nr. 28 për elementet që lidhen me integrimin e propozuar të alokimeve, sipas instrumenteve të jashtme të financimit në programet ETC.

	shumat e transferuara nga IPA-ja dhe ENI-ja)									
	IPA		561 346	99 062	99 062	0	660 408	85%		
Total	ERDF		224 322 525	40 575 989	36 443 176	4 132 813	264 898 514	84.68%		
	IPA		9 355 783	1 651 023	1 651 023	0	11 006 806	85%		
TOTAL	Totali i të gjitha fondeve		**233 678 308**	**42 227 012**	**38 094 199**	**4 132 813**	**275 905 320**	**84.70%**		

1. Për t'u plotësuar vetëm kur akset prioritare të shprehen në kosto totale.
2. Kjo shkallë mund të vërtitet rreth numrit më të afërt të përgjithshëm në tabelë. Shkalla fikse e përdorur për të rimbursuar pagesat është shkalla "f".

3.1.2. Ndarja sipas aksit prioritar dhe objektivit tematik

(Referenca: Pika ("d"/"ii" e nenit 8 (2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Tabela 17

Aksi prioritar	Objektivi tematik	Kontributi i Unionit	Kontributi kombëtar	Financimi i përgjithshëm
Aksi prioritar 1	Objektivi tematik 1	71 783 208	12 667 625	84 450 833
Aksi prioritar 2	Objektivi tematik 2	44 864 505	7 917 266	52 781 771
Aksi prioritar 3	Objektivi tematik 3	76 269 660	13 459 352	89 729 012
Aksi prioritar 4	Objektivi tematik 4	17 945 801	3 166 907	21 112 708
Aksi prioritar 5	Objektivi tematik 5	13 459 351	3 364 829	16 824 190
TOTALI		**224 322 525**	**40 575 989**	**264 898 514**

Tabela 18. Shuma indikative e mbështetjes/financimit që do të përdoret për objektivat e ndryshimit të klimës

(Referenca: neni 27(6) i Rregullores (BE) Nr. 1303/2013)[74]

Aksi prioritar	Shuma indikative e kontributit që do të përdoret për objektivat që lidhen me ndryshimet klimatike (euro)	Ndarja e alokimeve totale për programin (%)
Aksi prioritar 1	7 178 321.00 euro	3.07%
Aksi prioritar 2	35 712 145.80 euro	15.28%
Aksi prioritar 3	19 004 872.40 euro	8.13%
Aksi prioritar 4	00.00 euro	0.00%
TOTAL	**61 855 339.20 euro**	**26.49%**

SEKSIONI 4
QASJE E INTEGRUAR PËR ZHVILLIMIN TERRITORIAL

(Referenca: Neni 8 (3) i Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Programi MED mbështetet mbi një qasje të integruar detare dhe kërkon të gjejë përgjigje adekuate ndaj sfidave të përbashkëta transkombëtare. Siç identifikohet në seksionin 2, ndonëse zona MED duhet të luftojë kundër presionit në rritje të aktiviteteve njerëzore dhe ndryshimeve klimatike, ajo duhet, gjithashtu, të përmirësojë konkurrueshmërinë e saj dhe menaxhimin e qëndrueshëm të qyteteve të saj, zonat bregdetare dhe detare për të zhvilluar potencialin e saj të lartë ekonomik, social dhe mjedisor. Bashkëpunimi dhe qasja territoriale janë mjetet e duhura për të kontribuar në objektivat specifikë të përcaktuara nga Programi, si një reagim transkombëtar ndaj këtyre sfidave që kërkojnë një përshtatje të politikave publike dhe sjelljeve të të gjithë aktorëve për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë.

Prandaj, aksionet e financuara sipas objektivave të ndryshëm tematikë zhvillohen në kuadër të qasjes së integruar detare, duke pasur parasysh menaxhimin e integruar të zonës bregdetare dhe planifikimin detar hapësinor, si çështjeve të ndërlidhura për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm, për të nxitur një përdorim më efikas të burimeve dhe për të menaxhuar konfliktet ndërmjet palëve të interesuara.

Më konkretisht, nga pikëpamja territoriale dhe gjeografike, programi u kushton një vëmendje të veçantë katër llojeve të zonave që përfaqësojnë sfida të rëndësishme për shkak të burimeve të tyre, potencialit të tyre të zhvillimit ose vështirësive ekonomike me të cilat ata ballafaqohen.

Zonat bregdetare

Zonat bregdetare paraqesin një shtrirje të madhe në zonën MED me nivel të lartë atraksioni, përqendrim shumë të rëndësishëm të aktiviteteve njerëzore dhe brishtësi të burimeve natyrore dhe kulturore. Për programin MED, çështja kyçe konsiston për të kuptuar dhe për të menaxhuar ekuilibrin mes zhvillimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve, përfshi lidhjet midis zonave bregdetare dhe zonave të thella. Prioritetet e përcaktuara për zhvillimin ekonomik, menaxhimin e presionit antropik dhe pasojat e ndryshimeve klimatike do të adresojnë sfidat.

Zonat urbane

Në rajonet e Mesdheut, zonat bregdetare ku përqendrohen qendra të mëdha urbane përfaqësojnë sfida shumë të rëndësishme në lidhje me zhvillimin ekonomik, cilësinë e jetës dhe përdorimin e resurseve. Për periudhën 2014– 2020, programi MED do të vërë theksin në zonat urbane, sidomos në lidhje me perspektivat e zhvillimit të ulët të karbonit (të eficiencës së energjisë dhe energjia e rinovueshme) dhe

[74] Tabela është gjeneruar automatikisht bazuar në tabelat sipas kategorive të ndërhyrjes, të përfshira nën secilin aks prioritar.

sistemet e transportit të qëndrueshëm, duke përfshirë ndërlidhjen ndërmjet zonave urbane dhe rurale. Zonat urbane do të përfitojnë edhe nga aksi prioritar 1, pasi ka një përqendrim të lartë të aktorëve të inovacionit dhe institucioneve në qytete.

Ishujt

Ishujt mbulojnë rreth 4% të Detit Mesdhe. Ata përfaqësojnë një dimension të madh ekonomik, mjedisor dhe kulturor të zonës së Mesdheut. Ata gjenden si në udhëkryqin e akseve kryesore të komunikimit edhe në një situatë të izolimit gjeografik. Ishujve të Mesdheut, gjithashtu, u mungojnë agjendat e zhvillimit të përbashkët dhe forumet e diskutimit/të shkëmbimeve. Për programin MED do të merren parasysh specifikat e tyre në lidhje me perspektivat e zhvillimit ekonomik, promovimi i zgjidhjeve të energjisë së rinovueshme dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe kulturore (ekosistemet, menaxhimi i ujit ...) dhe në të gjitha fushat e tjera me interes të mbuluara nga programi.

Zonat e largëta dhe me densitet të ulët

Në rajonet e Mesdheut, shumë zona në brendësi, nganjëherë në afërsi të bregdetit, mund të jenë mjaft të izoluara dhe karakterizohen nga aktivitetet rurale dhe një dendësi të ulët të popullsisë. Për këto zona, turizmi dhe bujqësia përfaqësojnë aktivitetet thelbësore ekonomike që ndonjëherë janë të kërcënuara nga ndryshimi demografik dhe efektet e ndryshimeve klimatike. Për programin MED do të merren parasysh këto zona, veçanërisht në lidhje me nevojën për të zhvilluar ose për të mbajtur aktivitete (agrobiznesi dhe turizmi) dhe duke menaxhuar më të mirë burimet natyrore (menaxhimin e ujit, zgjidhjet e energjisë së rinovueshme).

4.1. Strategjia e zhvillimit lokal e udhëhequr nga komuniteti (CLLD)

Jo përkatëse

4.2. Veprimet e integruara për zhvillimin e qëndrueshëm urban

(Referenca: Pika "b" e nenit 8 (3) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Nuk janë identifikuar zona të veçanta urbane për zbatimin e zhvillimit të qëndrueshëm urban. Partnerët e të gjitha zonave urbane të vendosur në rajonet e pranueshme për programin MED mund të marrin pjesë në projektet MED, duke zbatuar rekomandimet e dhëna në akset e ndryshme prioritare dhe në thirrjet për projekte.

4.3. Investimet e Integruara Territoriale (IIT)

(Referenca: Pika "c" e nenit 8 (3)të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Megjithëse fokusi në zonat urbane apo fusha të tjera të veçanta konsiderohet si i rëndësishëm nga vendet pjesëmarrëse të programit, sistemi i Investimeve të Integruara Territoriale (IIT) nuk është plotësisht i përshtatshëm për bashkëpunimin transkombëtar për arsyet e mëposhtme:

- Programi MED nuk është investim i orientuar edhe nëse mund të mbështesë përgatitjen e investimeve të mëdha.
- Kjo do të kërkonte identifikimin e zonave të veçanta të ndërhyrjes në zonën e përgjithshme MED, e cila është shumë komplekse dhe konsumon kohë për përgatitjen e një PB transkombëtar.
- Zonat e përzgjedhura do të mbulojnë vetëm një pjesë të rajoneve të pranueshme apo vendeve të pranueshme.
- ITI-ja duhet të zbatohet nga organet e mbështetura nga të paktën dy vende të ndryshme. Krijimi i organeve të tilla do të jetë mjaft sfidues në nivel transkombëtar, veçanërisht për shkak se mesatarja e partneritetit transkombëtar është e përbërë nga 10–12 partnerë që vijnë nga disa vende të ndryshme.
- Për këtë arsye, si dhe duke marrë parasysh faktin se zhvillimi i integruar territorial konsiderohet një mënyrë kombinuese për çdo aks prioritar, programi nuk do të përdorë Investimet e Integruara Territoriale për periudhën 2014–2020.

4.4. Kontributi i ndërhyrjeve të planifikuara për strategjitë makrorajonale dhe baseneve të detit

(Referenca: Pika "d" e nenit 8(3) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Zona e Mesdheut përbëhet nga zona krejt të ndryshme gjeografike me prioritete zhvillimore të ndryshme, kontekste politike dhe social-ekonomike. Ky është rasti ndërmjet bregut verior dhe jugor të Mesdheut, por edhe nga lindorja në pjesën perëndimore të Detit ku konteksti i fragmentuar gjeografik nxit për zbatimin e strategjive të bashkëpunimit nënrajonal dhe marrëveshjeve.

Në të vërtetë, zona MED përfshin vende dhe rajone që janë pjesë e strategjive të ndryshme makrorajonale dhe basenit të detit (Strategjia e BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe të Jonit, Strategjia e BE-së për Rajonin e Danubit dhe Strategjia e Atlantikut).

Iniciativat ndërkombëtare tregojnë vështirësinë për të zhvilluar strategjitë e përbashkëta dhe për të arritur konsensus në fusha që paraqesin interes të madh ndërkombëtar, si: transportet, siguria detare, ndotja e detit, menaxhimi bregdetar etj.

Nëse krijimi i një strategjie të madhe të zhvillimit të integruar të Mesdheut ose "strategjia makrorajonale" përballet me vështirësi të rëndësishme, progresi bëhet megjithatë përmes qasjeve tematike, siç tregohet me politikën e integruar detare të BE-së.

Në Mesdhe, konsensusi duhet të arrihet në atë mënyrë që të menaxhohen sa më mirë aktivitetet detare, mbrojtja e mjedisit detar dhe trashëgimisë detare ose për të parandaluar dhe për të luftuar ndotjen detare (ndër të tjera).

Programi MED përbën një kuadër të përshtatshëm për të promovuar mundësitë e bashkëpunimit në fusha me interes për autoritetet lokale, rajonale dhe kombëtare.

Për periudhën 2014–2020, programi propozon të kapë mundësinë e dhënë nga Komisioni për t'i nisur aktivitetet përmes objektivit tematik 11 (rritjen e kapaciteteve institucionale dhe administratë publike eficiente) me objektivin specifik për të mbështetur procesin e zhvillimit të kornizave shumëpalëshe koordinuese në zonën e Mesdheut, duke përfshirë edhe mundësinë për të kontribuar në drejtim të zbatimit të strategjive përkatëse makrorajonale dhe basenit të detit.

Në fillim të 2014–2020, ne, megjithatë mund të vërejmë se situata nuk është plotësisht e "pjekur" për zbatimin e projekteve ambicioze të bashkëpunimit në nivel mesdhetar.

Në nivelin nënrajonal, rajoni makro-Adriatik/Jon është në fillimet e tij dhe bashkëpunimi do të duhet të hulumtohet gjatë jetës së programit. Me programin MED, lidhja do të zhvillohet veçanërisht në lidhje me rritjen e blusë, mbrojtjen dhe cilësinë e mjedisit dhe atraksionin rajonal që përbëjnë sfidat kryesore edhe për programin MED. Programi MED mund të krijojë sinergji dhe projektet financiare EUSAIR, nëse ato janë në përputhje me prioritetet e MED CP-së.

Gjatë jetës së programit MED do të dalë mundësia për të shqyrtuar mundësitë e bashkëpunimit dhe për të mbështetur aktivitetet në fushat e përbashkëta të ndërhyrjes për vendet e përfshira në program.

Për programin MED, promovimi për zhvillimin e bashkëpunimit strategjik në Mesdhe kërkon forcimin e bashkëpunimit transkombëtar, strategjitë dhe marrëveshjet politike mbi çështjet që përbëjnë fushat kryesore të ndërhyrjes për periudhën 2014–2020 (risi, energjia dhe reduktimi i emisionit të GHG-së, reduktimin e ndotjes, mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore). Objektivi është që të ofrojë mbështetje për kushtet për krijimin e një strategjie më të gjerë, që përfundimisht mbulon tërë hapësirën e programit, me nënzonat e tilla si: rajoni makro-Adriatik/Jon, zonat perëndimore dhe lindore të Mesdheut.

SEKSIONI 5
ZBATIMI I DISPOZITAVE PËR PROGRAMIN E BASHKËPUNIMIT
(Referenca: Neni 8(4) i Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

5.1 Autoritetet dhe organet përkatëse

(Referenca: Neni 8(4) i Rregullores (BE) nr. 1299/2013

Tabela 21. Autoritetet e programit

(Referenca: Pika "a"/ "i" e nenit 8(4) e rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Autoriteti/organi	Emri i autoritetit/organit dhe departamentit apo njësisë	Drejtues i autoritetit/organit (pozicioni ose posti)
Autoriteti i menaxhimit	Region Provence-Alpes-Cote-d'Azur 27, Place Jules Guesde 13481 Marseille Cedex 20 France	Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm që përgjigjet për Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Çështjet Evropiane
Autoriteti i certifikimit	Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm për certifikimin dhe Pagesat Drejtoria e Përgjithshme e Fondeve Evropiane Ministria e Financave dhe Administratës Publike Paseo de la Castellana 162 28071 Madrid SPAIN	Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm për certifikimin dhe pagesat
Autoriteti i auditimit	Komisioni Ndërministror për Koordinimin e kontrolleve dhe veprimeve të bashkëfinancuara nga Fondet Evropiane (CICC)	Presidenti i CICC

	5 Place des Vins de France 75012 Paris, France	

Organi te i cili do bëhet pagesa nga ana e Komisionit është:

- Autoriteti certifikues.

Tabela 22. Institucioni ose institucionet përgjegjëse për kontrollin dhe auditimin

Referenca: Pikat "a"/"ii" dhe "iii", të nenit 8(4) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013

Autoriteti/organi	Emërtimi i autoritetit/institucionit dhe drejtorisë ose sektorit	Shefi i autoritetit/institucionit (pozicioni i punës)
Organi ose organet e kontrollit	Secili Shtet Anëtar dhe Shtet Partner, duhet të caktojë autoritetin ose personin përgjegjës për vërtetimet sipas nenit 125(4)(a) të Rregullores BE nr. 133/2013 (CPR) dhe nenit 23(4) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013 (ETC), në lidhje me përfituesit në territorin e tyre. Këto autoritete janë të vendosura në secilin shtet anëtar dhe shtet partner.	Autoritetet kombëtare përgjegjëse për sistemet e kontrollit të centralizuara dhe të decentralizuara ende nuk janë të njohura, pasi janë në fazë përcaktimi. Informacione të detajuara do të jepen gjatë procedurës së emërtimit.
Organi ose organet audituese përgjegjëse për kryerjen e detyrave të auditimit	Autoriteti auditues do të mbështetet nga një grup auditorësh. Secili Shtet anëtar dhe shtet partner do të caktojë një autoritet ose një person përgjegjës për çështjet e auditimit të parashikuara nga neni 127 i Rregullores BE, nr. 1303/2013 (CPR). Këto autoritete janë të vendosura në secilin Shtet anëtar dhe shtet partner.	Autoritetet kombëtare përgjegjëse për auditimin, pjesëmarrëse në grupin e auditorëve, ende nuk janë të njohura, pasi janë në fazë përcaktimi. Informacione të detajuara do të jepen gjatë procedurës së emërtimit.

5.2 Procedura për ngritjen e Sekretariatit Teknik

(Referenca: pika "a"/"iv" e nenit 8(4) Rregullores (BE) nr. 1399/2013)

Për periudhën 2014–2020, Sekretariati Teknik është vendosur në vazhdimësi me periudhën e mëparshme, po ashtu Autoriteti Menaxhues do të jetë i njëjti.

Është i caktuar në Rajonin e *Provence-Alpes-Cote d'Azur*.

Sekretariati Teknik përbëhet nga disa njësi përgjegjëse për monitorimin financiar, monitorimin në nivel projekti dhe aktivitete lidhur me komunikimin dhe kapitalizimin. Secila njësi ka një person reference dhe i gjithë grupi kryesohet nga një koordinator.

Shtetet anëtare dhe shtetet partnere konsultohen para se të ngrihet Sekretariat i Përbashkët, gjithashtu konsultohen edhe në lidhje me rekrutimin e secilit anëtar të ri të stafit.

5.3 Përshkrimi i shkurtër i veprimtarive të menaxhimit dhe kontrollit

(Referenca: Pika "a"/"iv" e nenit 8(4) Rregullores (BE) nr. 1399/2013)

5.3.1 Struktura e përbashkët e zbatimit dhe ndarja e funksioneve midis njësive të ndryshme.

Parimet e përgjithshme për veprimtaritë e menaxhimit dhe të kontrollit janë të përcaktuara në nenin 72 të Rregullores së Përbashkët.

Mbështetur në nenin 125 të dispozitave të Rregullores së Përbashkët, autoriteti menaxhues, ka përgjegjësinë e menaxhimit të programit të bashkëpunimit, sipas parimit të menaxhimit financiar të shëndoshë. Kjo përfshin mbështetjen e aktiviteteve të Komitetit të monitorimit dhe përcjelljen e informacioneve të nevojshme për zbatimin e funksioneve të tij, në veçanti e të dhënave lidhur me progresin e programit të bashkëpunimit në lidhje me arritjen e objektivave, të dhënave financiare dhe të dhënave mbi indikatorët dhe hapave që duhet të ndiqen.

Mbështetur në nenin 47 të Rregullores së Përbashkët, shtetet anëtare duhet të themelojnë një komitet për monitorimin e zbatimit të programit, në marrëveshje me autoritetin menaxhues. Komiteti i monitorimit duhet të hartojë dhe të adaptojë rregullat e tij mbi procedurat.

Komiteti i monitorimit drejtohet nga një përfaqësues i njërit prej shteteve anëtare të programit ose nga autoriteti menaxhues. Komiteti i monitorimit, pas caktimit të tij, duhet të emërojë drejtuesin e tij në bazë vjetore. Drejtuesi ka një zëvendësues nga një tjetër Shtet Anëtar, i cili në vitin pasardhës do të jetë drejtuesi i Komitetit.

Komiteti i monitorimit duhet të mblidhet të paktën një herë në vit dhe shqyrton zbatimin dhe progresin e programit nëpërmjet objektivave të arritur. Analizon në detaje të gjitha çështjet që mund të ndikojnë në performancën pozitive të programit dhe vendos mbi secilin ndryshim të propozuar nga autoriteti menaxhues mbi programin. Komiteti i monitorimit mund të ngrejë grupe pune të posaçme.

Pa shkelur rregullat e pranueshmërisë ekzistuese ose të mbështetura në nenet 64 dhe 65 të Rregullores të Përbashkët nr. 1303/2013, Komiteti i monitorimit cakton rregullat e përgjithshme për pranueshmërinë lidhur me programin e bashkëpunimit.

Takimet e Komitetit monitorues dhe vendimet e marra, përgatiten në bashkëpunim me autoritetin menaxhues, autoritetet kombëtare përgjegjëse për programin në vendet pjesëmarrëse dhe drejtuesin e programit. Vendimet merren me konsensus të shprehur nga secili delegacion kombëtar, më një votë për secilin vend pjesëmarrës. Në rast se do të jetë e nevojshme, vendimet do të merren mbas një procedure me shkrim (gjithashtu edhe këto me konsensus) midis shteteve pjesëmarrëse, bazuar në kushtet e caktuara nga rregullat e procedurës.

Komiteti i monitorimit, duhet të themelojë një komitet vlerësimi që do të veprojë nën përgjegjësinë e tij për përzgjedhjen e veprimtarive (neni 12 i Rregullores ETC).

Bazuar në nenin 23 të Rregullores ETC, Sekretariat i Përbashkët, asiston autoritetin menaxhues gjatë zbatimit të funksioneve të tij. Sekretariati i Përbashkët u jep informacione përfituesve potencialë lidhur me mundësitë e financimit të programit MED dhe i mbështet ata gjatë zbatimit të veprimtarive. Sekretariati i Përbashkët krijon dhe mban kontakte me partnerët kryesorë dhe partnerët e tyre.

Në veçanti, Sekretariati i Përbashkët, siguron koordinimin, ndjekjen e ecurisë dhe promovimin e aktiviteteve në nivel transkombëtar dhe jep mbështetje teknike lidhur me përgatitjen e takimeve dhe eventeve në nivel program dhe projekti (komitetet e monitorimit, konferencat transkombëtare dhe grupet e punës transkombëtare, seminaret e partnerëve kryesorë, tematika të tjera specifike të takimeve).

Sekretariati i Përbashkët lehtëson, vlerëson dhe siguron që përzgjedhja e projekteve të bëhet në mënyrë të barabartë dhe transparente. Grumbullon të dhënat financiare, fizike dhe statistike të nevojshme për monitorimin e programit, si edhe për vlerësimet e ndërmjetme dhe përfundimtare. Vërteton kërkesat lidhur me pagesat e partnerëve kryesorë.

Sekretariati i Përbashkët, gjithashtu, ka si detyrë zbatimin e sistemit të informimit i cili është aktiv dhe i disponueshëm për operatorët dhe publikun për zbatimin e programit: kalendari, progresi, kontaktet, detajet telefonike, *web*-i.

Në brendësi të secilit shtet pjesëmarrës, program MED duhet të ndërmerret nëpërmjet dy funksioneve specifike:

- Një funksion rregullues, lidhur me përgjegjësitë e secilit vend pjesëmarrës për monitorimin dhe kontrollin e aktiviteteve, procedurave dhe shpenzimeve të partnerëve të projekteve në secilin vend pjesëmarrës.
- Një funksion koordinimi të zbatimit të programit në territorin kombëtar dhe një mbështetje për nxitjen e përgjithshme të programit në lidhje me autoritetin menaxhues dhe Sekretarin e Përbashkët të cilëve i kanë besuar menaxhimin.

Secili vend pjesëmarrës mund të organizojë lirisht autoritetin e tij kombëtar dhe ka mundësinë për të parashikuar autoritete mbështetëse, si p.sh., komitete kombëtare me funksion konsultimi.

Bashkëfinancimi kombëtar për veprimtaritë duhet të parashikohet sipas mekanizmave kombëtarë përkatës të shteteve të mbuluara nga Programi i Bashkëpunimit. Një dëshmi e qartë e këtyre mekanizmave do të pasqyrohet kur Programi të vleftësohet nga Komisioni i BE-së.

Për të siguruar hapësirën transkombëtare të programit dhe për të mbështetur vizibilitetin e projekteve, secili Shtet Anëtar do të caktojë Pikat Kombëtare të Kontaktit (NCP) në përputhje me sistemi e tij të administrimit. Pikat Kombëtare të Kontaktit, mund të jenë individë ose autoritete administrimi. Do të jenë në kontakt të drejtpërdrejtë me grupet kombëtare të interesit dhe do të sigurojnë informacione mbi programin, thirrjet për projektpropozime dhe mbi kërkesat administrative për paraqitjen e aplikimeve. Pikat Kombëtare të Kontaktit koordinohen nga autoritetet kombëtare përkatëse. Gjithashtu duhet të caktohen strukturat e decentralizuara të Programit për mbështetjen e zbatimit të vetë programit.

Bazuar në nenin 126 e Rregullores së Përbashkët (CPR), autoriteti i certifikimit është përgjegjës për hartimin dhe paraqitjen pranë Komisionit, të aplikimeve për pagesa dhe certifikimit që këto rezultate (shpenzime), nga sisteme të sigurta kontabël, bazohen në dokumente mbështetëse të vërtetueshme dhe u janë nënshtruar verifikimeve të autoritetit menaxhues.

Autoriteti i certifikimit, gjithashtu, është i përgjegjshëm për përgatitjen e planeve vjetore të shpenzimeve, nëpërmjet certifikimit të plotësisë, saktësisë dhe vërtetësisë së llogarive vjetore dhe që shpenzimet e përfshira në këto përllogaritje janë kryer në përputhje me rregullat kombëtare dhe evropiane në fuqi dhe, gjithashtu, mbi bazën e veprimtarive të përzgjedhura për financim, sipas kritereve që i aplikohen programit të bashkëpunimit dhe në përputhje me rregullat kombëtare dhe të BE-së.

Bazuar në nenin 127 të Rregullores së Përbashkët (CPR), Autoriteti Auditues siguron që kontrollet e auditit të kryhen mbi sistemet e menaxhimit dhe të kontrollit, mbi një model të përshtatshëm veprimtarish dhe mbi llogaritë vjetore. Ky jep një opinion auditi mbi llogaritë vjetore për vitin e mëparshëm dhe një raport vjetor kontrolli në të cilin të pasqyrohen gjetjet e auditimit mbi veprimtaritë e vitit të mëparshëm.

Autoriteti auditues (CICC) është një komision raportues ndërministror. Ky autoritet nuk u raporton ministrive menaxhuese të fondeve të ndryshme, por Kryeministrit, i cili cakton edhe anëtarët e tij. Ky organ, merr vendime në mënyrë kolektive, në lidhje me tematikat e juridiksionit të tij; ai përbëhet, për dy të tretat e tij, nga anëtarë të inspektorateve të përgjithshme të ministrive, të pavarur sipas statusit dhe traditës.

Për programin MED, autoriteti auditues, mbështetet nga një grup audituesish, përbërë nga një përfaqësues për secilin shtet pjesëmarrës në program.

Përfaqësuesit e shteteve pjesëmarrëse në grupin e auditorëve nuk duhet të përfshihen në asnjë menaxhim ose aktivitet tjetër certifikues të programit MED. Është e detyrueshme që secili prej tyre të ketë një certifikatë pavarësie.

5.3.2 Organizimi i vlerësimit dhe përzgjedhjes së veprimtarive

Për periudhën 2014–2020 do të aplikohen parime të përgjithshme për tipologjitë e ndryshme të thirrjeve për propozime (p.sh., thirrje tematike, thirrje të synuara dhe thirrje strategjike për projekte). Për secilën thirrje do të specifikohen modalitetet përkatëse.

Për secilën tipologji thirrjeje, Sekretariati i Përbashkët do të procedojë më një kontroll mbi lejueshmërinë dhe më pas do të bëjë vlerësimin e cilësisë së aplikimeve.

Procesi i përzgjedhjes

1. Sekretariati i Përbashkët kontrollon kriteret e pranueshmërisë së aplikimit. Propozimet që nuk janë të lejueshme do të shkualifikohen me vendim të Komitetit të Monitorimit.
2. Sekretariati i Përbashkët kryen një kontroll mbi cilësinë e aplikimit. Ky i fundit i paraqet Komitetit të monitorimit listën e aplikimeve të lejueshme me vlerësimet përkatëse.
3. Komiteti i monitorimit procedon me përzgjedhjen e projekteve.
4. Autoriteti menaxhues informon secilin aplikant mbi rezultatet e procesit të përzgjedhjes.

Sekretariati i Përbashkët dhe Komiteti i monitorimit mund të kërkojnë mbështetjen e ekspertëve të jashtëm gjatë fazës së përzgjedhjes.

Në raste specifike, të kërkuara nga Komiteti i monitorimit, partnerët e projekteve mund të ftohen të prezantojnë projektin e tyre pranë Komitetit të monitorimit në takimin e programimit.

Vlerësimi i aplikimeve nga Sekretariati i Përbashkët dhe përzgjedhja e projekteve nga Komiteti i monitorimit, kryhet mbi bazën e kritereve objektive të saktësuara në **Modelin e vlerësimit, të miratuar nga Komiteti i monitorimit** dhe i shpjeguar në "Guidën e zbatimit të programit të bashkëpunimit MED".

Këto kritere janë përcaktuar sipas udhëzimeve strategjike të programit MED dhe dëshirës për të promovuar projekte transkombëtare të fokusuara dhe efikase (objektivat përkatës, rezultatet dhe aktivitetet, grupet e interesit, fuqia e partneriteteve, përfshirja e aktorëve kyç, qëndrueshmëria ...).

Mbështetur në Rregulloren BE 1299/2013, veprimtaritë e përzgjedhura në kuadër të bashkëpunimit transkombëtar, duhet të përfshijnë përfitues nga të paktën dy vende pjesëmarrëse dhe nga të cilët, të paktën njëri duhet të jetë nga një Shtet Anëtar.

Pas përzgjedhjes së projekteve nga Komiteti i monitorimit, autoriteti menaxhues dhe partnerët kryesorë, do të nënshkruajnë një **Kontratë financimi (subvencionimi)** individuale për secilin projekt. Kontrata përfshin, gjithashtu, fonde të mundshme IPA të alokuara për veprimtarinë.

Edhe në rast se fondet IPA nuk do të jenë të disponueshme, nuk do të ketë pasoja mbi miratimin e partnerëve ERDF në të njëjtin projekt; projekti do të zbatohet nga partnerët ERDF pa partnerët IPA, në rast se këto fonde nuk do të jenë të disponueshme.

Procesi i përzgjedhjes së projekteve do të përcaktohet më në detaje për secilën thirrje për projektpropozime dhe në guidën e zbatimit.

5.3.3 Aktivitete për vërtetimet mbi menaxhimin dhe kontrollet përkatëse mbi cilësinë

Për sa i përket menaxhimit financiar dhe kontrollit të programit të bashkëpunimit, **secili Shtet pjesëmarrës në program** duhet të vërtetojë që produktet e bashkëfinancuara dhe shërbimet janë dorëzuar dhe që shpenzimet e deklaruara nga përfituesit janë paguar dhe që përputhen me ligjin e BE-së dhe atë kombëtar në fuqi, si edhe me programin e bashkëpunimit dhe rregullat për financimin e veprimtarive (neni 25(4) Rregullorja CTE).

Secili Shtet Anëtar dhe shtet partner, duhet të caktojë organin ose personin përgjegjës për kryerjen e këtyre vërtetimeve mbi përfituesit në territorin e tyre (kontrollor/ët).

Për programin MED, këto vërtetime do të kryhen nga kontrollorët e caktuar në bazë të sistemeve të kontrollit për secilin shtet pjesëmarrës.

Kontrollorët e caktuar (të brendshëm ose të jashtëm) duhet të jenë plotësisht të pavarur nga përfituesit e kontrolluar.

Shtetet anëtare dhe partnere duhet të sigurojnë që sistemet e tyre të menaxhimit dhe të kontrollit të jenë ngritur mbi bazën e dispozitave të rregulloreve të BE-së dhe që sistemet të funksionojnë në mënyrë efektive.

Autoriteti menaxhues duhet të sigurojë që shpenzimet e secilit përfitues pjesëmarrës në veprimtari, të jenë vërtetuar nga një kontrollor i caktuar.

Për lehtësimin e procedurave administrative dhe për përmirësimin e menaxhimit të programit, autoriteti menaxhues promovon disa aktivitete për harmonizimin dhe për koordinimin midis sistemeve kombëtare të kontrollit, nëpërmjet vendosjes së një rrjeti personash të ngarkuar për kontrollin e nivelit të parë.

Në vijim të këtyre vërtetimeve, Sekretariati i Përbashkët merr nga secili projekt, progresraportin e rregullt të plotësuar nga partneri kryesor, shoqëruar me kërkesën për pagesë.

Për të gjitha kërkesat për pagesë, Sekretariat i Përbashkët:

- Vërteton përputhshmërinë midis produkteve/rezultateve dhe kontratës së financimit të miratuar, për sa u përket shpenzimeve, burimeve dhe lejueshmërisë së shpenzimeve;
- Vërteton nëse shpenzimet e deklaruara nga përfituesit janë reale nëpërmjet kopjeve të certifikatave të marra nga secili partner dhe nga një listë e dokumentacionit mbështetës për shpenzimet;
- Siguron produktet/rezultatet materiale (fizike) nga disa elemente bashkëlidhur me progresraportet;
- Vërteton nëse janë respektuar kërkesat për vizibilitetin e fondeve të BE-së (foto, mjetet e komunikimit, artikuj në gazeta etj.).

Në nivel programi, autoriteti menaxhues:

- Kontrollon saktësinë e kërkesave për pagesë të paraqitura dhe përcakton vlerën e shumës së subvencionit që duhet paguar bazuar në parashikimet e kontratës së financimit (përqindjen e bashkëfinancimit dhe vlerën maksimale të subvencionimit) dhe bazuar, gjithashtu, në vlerën totale të shpenzimeve të vërtetuara dhe certifikuara;
- Vleftëson dhe i transmeton autoritetit certifikues, kërkesën për pagesë, pas verifikimit;
- Kontrollon veprimtaritë e ndjekjes së rasteve problematike në rast parregullsish;
- Siguron menaxhimin financiar të shëndoshë dhe kryen kontrolle në terren mbi bazën e një ushtrimi demonstrues.

Vërtetimet në terren

Vërtetimet në terren do të zbatohen nga autoriteti menaxhues/Sekretariati i Përbashkët në nivel përfituesi. Frekuenca dhe mbulimi që do të kenë këto kontrolle do të jetë proporcional me vlerën e mbështetjes publike në një veprimtari dhe të nivelit të riskut që do të identifikohet, gjithashtu, nga kontrollet e autoritetit auditues mbi sistemin e menaxhimit dhe të kontrollit si një i tërë. Autoriteti Menaxhues harton dhe, pas miratimit nga Komiteti i monitorimit, aplikon kriteret për të vendosur frekuencën e kontrolleve.

Koordinimi midis anëtarëve të grupit të audituesve

Për programin MED, Autoriteti i auditimit asistohet nga grupi i audituesve, i përbërë nga një përfaqësues nga secili Shtet Anëtar dhe partner që merr pjesë në program dhe kryen funksionet e parashikuara në nenin 127 të Rregullores së Dispozitave të Përbashkëta (CPR).

Secili shtet pjesëmarrës është përgjegjës për auditimet e kryera në territorin e tij. Çdo përfaqësues nga

secili shtet pjesëmarrës është përgjegjës për sigurimin e elementeve faktike, në lidhje me shpenzimet në territorin e tij, të cilat kërkohen nga Autoriteti i auditimit për të kryer vlerësimin e tij.

Grupi i audituesve harton rregullat e veta të procedurës dhe kryesohet nga Autoriteti i auditimit.

Audituesit janë funksionalisht të pavarur nga kontrolluesit të cilët kryejnë verifikime sipas nenit 23 të Rregullores së Bashkëpunimit Evropian Territorial (ETC).

5.3.5 Procedura për nënshkrimin e dokumentit të dhënies së grantit dhe kontratës së subvencionimit

Pas vendimit të Komitetit të monitorimit, autoriteti menaxhues do të përdorë një formë standarde të kontratës së subvencionit, e cila është miratuar nga Komiteti i monitorimit dhe parashtron hollësi të mëtejshme në lidhje me përgjegjësitë dhe detyrimet e përfituesve. Kontrata e subvencionit nënshkruhet nga autoriteti menaxhues dhe përfituesi kryesor i projektit.

Zgjidhja e ankesave

Procedurat që janë në funksionim për zgjidhjen e ankesave, diferencohen sipas objektit të ankesës.

Ankesat në lidhje me *vlerësimin dhe përzgjedhjen*: Aplikantët kryesorë të projektit do të informohen me shkrim për arsyet pse një kërkesë/aplikim nuk është e pranueshme ose nuk është miratuar, duke dhënë detaje mbi arsyen e moskualifikimit /miratimit. Çdo ankesë në lidhje me vlerësimin paraqitet nga kërkuesi/aplikanti kryesor tek AM/SP i cili, në bashkëpunim me KM-në, do të shqyrtojë dhe do të japë qëndrimin e tij në lidhje me vlerën e ankesës.

Ankesat lidhur me *vendimet e marra* nga AM/SP-ja: Çdo ankesë në lidhje me vendimet e marra nga AM/SP-ja, në bazë të kontratës së subvencionit ose vendimeve të KM-së dorëzohet nga aplikanti/përfituesi i projektit tek AM/SP-ja që do të ekzaminojë dhe do të japë në kohën e duhur një përgjigje (në bashkëpunim me KM-në nëse është e nevojshme). Kur gjykatat, prokuroritë publike apo institucionet e tjera kombëtare janë kompetente në lidhje me objektin e ankesës, parashtruesi i kërkesës /përfituesi ka të drejtën t'u drejtohet edhe këtyre autoriteteve në Francë, ku AM/SP-të kanë vendndodhjen.

Ankesat që kanë të bëjnë me kontrollin e nivelit të parë dhe të dytë duhet të paraqiten kundër autoritetit përgjegjës kombëtar, në përputhje me rregullat kombëtare në fuqi.

Informacione të mëtejshme mbi procedurën për parashtrimin e ankesave do të përcaktohen në dokumentet përkatëse të programit dhe komunikohen tek aplikantët dhe përfituesit. Këto procedura do të jenë në përputhje me adresimet dhe udhëzimet nga KE-ja, si edhe me dispozitat kombëtare për këtë çështje.

Modeli i procedurës së ankesës propozuar nga INTERACT-i do të përdoret dhe miratohet kur është e nevojshme.

5.4 Shpërndarja e detyrimeve midis vendeve pjesëmarrëse në rast të korrigjimeve financiare të vendosura nga autoriteti menaxhues ose Komisioni

Rimbursimi i pagesave nga përfituesit

Rekomandimet dhe masat korrigjuese mund të rezultojnë nga çdo lloj kontrolli i zbatuar (kontrollet nga ana e autoritetit menaxhues, shteteve anëtare dhe shteteve partnere, nga autoriteti certifikues, auditimet e sistemit dhe të operacioneve, auditimet nga Komisioni Evropian dhe nga ana e Gjykatës Evropiane të Llogarive).

Sipas nenit 27 të rregullores ETC, autoriteti menaxhues siguron që çdo shumë e paguar si rezultat i ndonjë parregullsie rimbursohet nga projekti nëpërmjet përfituesit kryesor. Përfituesit i shlyejnë përfituesit kryesor çdo shumë të paguar padrejtësisht.

Nëse përfituesi kryesor nuk ka sukses në sigurimin e shlyerjes nga përfituesit e tjerë apo nëse autoriteti menaxhues nuk ka sukses në sigurimin nga përfituesi kryesor ose përfituesi i vetëm, shteti pjesëmarrës në territorin e të cilit përfituesi në fjalë është vendosur i rimburson autoritetit menaxhues shumën e paguar tepër/ose padrejtësisht për atë përfitues.

Detajet për procedurën do të përfshihen në përshkrimin e sistemit të menaxhimit dhe të kontrollit që do të themelohet në përputhje me nenin 72 të Rregullores (KE) nr. 1303/2013 (CPR).

Paralelisht me/ose pas rimbursimit të shumës së pariparueshme nga shteti pjesëmarrës tek autoriteti menaxhues, shteti pjesëmarrës ka të drejtën të sigurojë pagesën/shlyerjen nga përfituesi që ndodhet në territorin e tij, nëse është e nevojshme me anë të veprimit juridik. Për këtë qëllim, autoriteti menaxhues dhe përfituesi kryesor caktojnë të drejtat e tyre që rrjedhin nga kontrata e subvencionit dhe marrëveshja

e partneritetit me shtetin pjesëmarrës në fjalë.

Autoriteti menaxhues është përgjegjës për rimbursimin e shumave në fjalë për buxhetin e përgjithshëm të Unionit në përputhje me shpërndarjen e detyrimeve midis shteteve pjesëmarrëse siç përcaktohet në programin e bashkëpunimit dhe në nenin 27 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013 (ETC).

Në rast të parregullsive të zbuluara nga Gjykata e Audituesve ose nga Komisioni Evropian, çka rezulton në shpenzime që konsiderohen të papranueshme dhe me korrigjime financiare, duke qenë subjekt i një vendimi të KE-së, në bazë të neneve 144 deri 147 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 (CPR), pasojat financiare për shtetet pjesëmarrëse janë të përcaktuara në seksionin e "*detyrimeve dhe të parregullsive*" më poshtë. Çdo shkëmbim që lidhet me korrespondencën ndërmjet KE-së dhe shteteve anëtare do të kopjohet për Autoritetin Menaxhues/Sekretariatin e Përbashkët. Ky i fundit do të informojë autoritetin certifikues, autoritetin e auditimit dhe grupin e audituesve.

Shpërndarja e detyrimeve midis shteteve pjesëmarrëse

Shteti pjesëmarrës do të mbajë përgjegjësi në lidhje me përdorimin e programit ERDF dhe fondeve të IPA-së si më poshtë:

- Për shpenzimet e lidhura me partnerët e projektit që janë vendosur në territorin e tij, përgjegjësia do të mbahet në mënyrë individuale nga secili shtet pjesëmarrës;
- Në rastin e një parregullsie sistematike apo korrigjimi financiar (ky i fundit i ndërmarrë nga KE-ja), shtetet pjesëmarrëse do të mbajnë pasojat financiare në raport me parregullsinë përkatëse zbuluar në territorin e shtetit pjesëmarrës përkatës. Kur parregullsia ose korrigjimi financiar nuk mund të lidhet me një territor specifik të shtetit pjesëmarrës, shteti pjesëmarrës është përgjegjës në përpjesëtim me kontributin e ERDF/IPA-së paguar partnerëve të përfshirë kombëtarë përkatës të projektit.

5.5 Përdorimi i euros

(Referenca: Neni 28 i Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Në përputhje me nenin 28(b) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013, shpenzimet e kryera në një monedhë të ndryshme nga euroja konvertohen në euro nga përfituesit në muajin gjatë të cilit shpenzimet janë paraqitur për verifikim te kontrolluesi në përputhje me nenin 23 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013.

Konvertimi verifikohet nga kontrolluesi në shtetin pjesëmarrës në të cilën përfituesi është e vendosur.

5.6 Përfshirja e partnerëve

(Referenca: Pika "c" e nenit 8(4) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Veprimet e ndërmarra për të përfshirë partnerët në përgatitjen e programit të bashkëpunimit, si dhe rolin e këtyre partnerëve në përgatitjen dhe zbatimin e programit të bashkëpunimit, përfshi edhe përfshirjen e tyre në Komitetin monitorues (autoritetet rajonale dhe lokale, organet kompetente urbane dhe të tjera publike, partnerët ekonomikë dhe socialë, organet përkatëse që përfaqësojnë shoqërinë civile (përfshi edhe partnerët e mjedisit), organizatat joqeveritare dhe organet përgjegjëse për promovimin e përfshirjes sociale, barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin).

5.6.1 Përmbledhje e procesit të përgatitjes së programit të bashkëpunimit

Programi i Bashkëpunimit (PB) është përpunuar pas Kodit të Sjelljes të Komisionit të BE-së.

Procesi i përgatitjes së PB-ë u zhvillua gjatë 2 viteve, duke filluar në maj të vitit 2012, me ngritjen e një Task-Force për përgatitjen e PB-së dhe u mbyll në shtator të vitit 2014, me paraqitjen për miratimin e KE-së të draftit përfundimtar të PB-së, të miratuar nga ana e shtetit pjesëmarrës.

Task-Forca e Përbashkët është ngritur përmes procedurës me shkrim, më 29 shkurt 2012, nga shtetet pjesëmarrëse të MED-së për të udhëhequr procesin e përgatitjes së programit të ardhshëm. Gjatë takimit të tij të parë të mbajtur më 10 maj 2012 në Marsejë, u miratuan rregullat e brendshme të procedurës për ngritjen e misionit, procesi i vendimmarrjes dhe përbërja e Task-Forcës (maks. 3 persona për Shtet Anëtar, përfshi një përfaqësues nga Pikat e Kontaktit Kombëtar dhe të autoriteteve rajonale, përfaqësues i KE-së, i AM-së dhe i SP-së).

SP MED-ja ka përcaktuar rolin e Sekretariatit të Task-Forcës, takimi i të cilit është koordinuar nga një moderator i jashtëm, i zgjedhur nëpërmjet një tenderi publik, në kuadër të Asistencës Teknike të MED-OP 2007–2013 dhe në krye të hartimit të dokumentit PB.

Për të siguruar një koherencë të përgjithshme të përmbajtjes PB me kuadrin rregullator evropian, plani grafik indikativ i procesit të programimit është përditësuar vazhdimisht, duke marrë parasysh zhvillimin e draftrregullores së BE-së dhe proceset konsultative.

Task-Forca lançoi thirrjen për aplikime në drejtim të institucioneve të gatshme për të vepruar si AM të ardhshëm: procedura u mbyll në mars 2013, me caktimin e rajonit PACA, si AM të MED PB 2014–

2020.

Task-Forca vendosi të kontraktojë disa ekspertë të jashtëm për kryerjen e detyrave të specializuara që kanë të bëjnë me përgatitjen e PB-së, të tilla si procesi i moderimit dhe i hartimit (siç përmendet më lart), diagnoza dhe analiza SWOT, analiza *ex-ante*, përpunimi i sistemit të treguesve të programit dhe vlerësimi strategjik mjedisor.

Task-Forca ngriti një grup pune të kufizuar të autorizuar për të shoqëruar përgatitjen e sistemit tregues/ose indikator. Anëtarët e tij janë emëruar nga shtetet pjesëmarrëse midis ekspertëve të tyre kombëtarë. Ky grup pune mbledh 4 përfaqësues të SHA-së plus AM-në dhe SP-në. Një numër total prej 12 takimesh të Task-Forcës u zhvilluan gjatë gjithë procesit të përgatitjes.

Pjesa më e madhe e dokumenteve janë shpërndarë në të dy gjuhët zyrtare të Programit (anglisht dhe frëngjisht).

Përshkrimi i përfshirjes së partnerëve

Për përgatitjen e programit MED, partnerët janë përfshirë përmes proceseve të konsultimit të zbatuara në secilin shtet pjesëmarrës dhe nëpërmjet konsultimeve nisur në nivel programi.

Hapi i parë i konsultimeve kombëtare u mbyll në qershor 2013. Rezultatet e konsultimeve kombëtare janë sintetizuar dhe paraqitur në Task-Force.

Pas konsultimeve kombëtare, programi MED lançoi në faqen e tij të internetit konsultimin e tij publik *online* për prioritetet e programit ndërmjet datave 7 tetor dhe 22 nëntor 2013, rezultatet e të cilit u paraqitën në Task-Force, më 12 dhjetor 2013.

Në periudhën shkurt–prill 2014, u arrit, gjithashtu, konsultimi i autoritetit të mjedisit dhe të shteteve pjesëmarrëse në lidhje me ndikimin e programit në mjedis.

Përzgjedhja e partnerëve

Sipas Kodit Evropian për Partneritetin, një përfaqësues i partneritetit i zonës përfituese ka qenë i përfshirë në përgatitjen e PB-së, duke përfshirë: a) autoritetet përkatëse kombëtare, rajonale, lokale, urbane dhe autoritete të tjera publike; b) partnerët ekonomikë dhe socialë; dhe c) organe që përfaqësojnë shoqërinë civile, përfshi partnerët mjedisorë, organizatat joqeveritare dhe organet përgjegjëse për promovimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.

Konsultimet në kuadër të programit të MED-së kanë ndjekur "Parimet e përgjithshme dhe standardet minimale për konsultim të palëve të interesuara nga Komisioni[75]". Kështu, programi ka siguruar se parimet e transparencës dhe llogaridhënies, efektshmërisë dhe koherencës janë aplikuar kur ka konsultuar aktorët e saj.

Ka tre lloj aktorësh që do të konsultohen: a) aktorët e përfshirë në listat kombëtare/rajonale të ofruara nga shteti pjesëmarrës; b) partnerët e projektit MED; dhe c) grupet e synuara të programit që kanë mundësinë për t'u lidhur me faqet e internetit (program, rajone, shtet).

Njoftimi për anketën është dërguar me *e-mail* për 6693 adresa (2832 nga listat e shtetit pjesëmarrës dhe 3861 nga listat e Programit), nga të cilat 6655 e kanë marrë *e-mail*-in të paktën një herë. Programi ka respektuar një përfaqësim proporcional të të gjitha shteteve anëtare në ftesat e dërguara me *e-mail*.

Lista e partnerëve të përfshirë në procesin e konsultimit

Të dhëna të përgjithshme statistikore

1051 persona kanë akses në faqen e internetit të anketës. 444 persona filluan t'i përgjigjen anketës, 279 prej të cilëve e përfunduan atë. Ata përfaqësojnë 389 struktura të ndryshme.

Përfaqësimi

Shkalla e kontribuuesve për shtet pjesëmarrës të Programit në krahasim me shkallën e banorëve në nivel Programi tregon se të gjitha vendet janë përfaqësuar në mënyrë disi të barabartë. Megjithatë, ne mund të vërejmë se Italia dhe Greqia janë disi të nënpërfaqësuara, ndërsa Kroacia dhe Qiproja janë mbipërfaqësuara.

Llojet e strukturave të përfaqësuara

Strukturat më të përfaqësuara janë:

- Autoritetet rajonale;
- Universitete/qendra kërkimore/qendra tek-nologjike/park shkencor;
- Autoritetet lokale.

[75] Drejt një kulture të përforcuar të konsultimit dhe dialogut - Parimet e përgjithshme dhe standardet minimale për konsultim të palëve të interesuara nga Komisioni, Bruksel, 2002/12/11 COM (2002) 704 përfundimtare.

Vlen të theksohet se 7.4% përfaqësonin ndërmarrjet/SME-të dhe operatorët ekonomikë, çka është një rezultat i rëndësishëm nëse krahasohet me pjesëmarrjen e ulët të këtij lloji strukturash në Programin MED 2007–2013.

Fusha e ekspertizës

Të gjitha fushat e ekspertizës janë përfaqësuar. Megjithatë më të përfaqësuarat:

- Arsimi dhe trajnimi;
- Efikasiteti i energjisë;
- Qeverisja dhe partneriteti;
- Bashkëpunimi institucional dhe rrjetet e bashkëpunimit;
- Planifikimi dhe zhvillimi rajonal;
- Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore.

Veprimi i ndërmarrë për të lehtësuar pjesëmarrjen e partnerëve

Programi MED i ka informuar partnerët në lidhje me nisjen e procesit të konsultimit në faqen e tij dhe autoritetet kombëtare kanë informuar organet përkatëse, autoritetet dhe partnerët në vendet e tyre përkatëse.

Aktorët e përfshirë në listat e ofruara nga vendet pjesëmarrëse, partnerët e projektit, abonentët e buletinit MED dhe instancat e programit janë ftuar për t'iu përgjigjur anketës nëpërmjet një *e-mail*-i. *E-mail*-i përfshinte një shënim të shkurtër shpjegues dhe *link*-un në faqen e internetit të Programit për akses në konsultim. Disa kujtesa janë dërguar gjatë periudhës së konsultimit.

Vlera kryesore e shtuar e partneritetit në përgatitjen e programit të bashkëpunimit

Në përgatitjen e programit të bashkëpunimit, vlera kryesore e shtuar e partnerëve është të sigurojë informacion të detajuar mbi nevojat dhe prioritetet në nivel territorial për një gamë të gjerë të institucioneve dhe organeve. Veçanërisht, partnerët e identifikuar në anketë konsideruan si më të rëndësishme objektivat tematikë dhe prioritetet e investimeve të propozuara nga rregullorja dhe të parapërzgjedhura nga Task-Forca e programit MED. Kjo gjë ka ndihmuar për të nxjerrë në pah përparësitë dhe për të renditur çështjet që duhet të merren parasysh në strategjinë e programit.

Partnerët, gjithashtu, ndihmuan për të identifikuar më mirë llojet e veprimeve dhe veprimeve që duhet të mbështeten në secilin prioritet të investimeve. Kjo ishte e nevojshme për të propozuar lloje të veprimeve operacionale dhe të bazuara në nevojë, të afta për të gjeneruar rezultate konkrete dhe të matshme.

Rezultatet kryesore të konsultimit me partnerët

Rezultati kryesor i konsultimit është renditja e temave nga më të rëndësishmit te më pak të rëndësishmit për zbatimin e programit MED 2014–2020. Rezultati është si më poshtë:

- Forcimi i kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit;
- Efikasiteti i energjisë, menaxhimi i zgjuar i energjisë dhe përdorimi i energjisë së rinovueshme;
- Rritja e kapaciteteve institucionale dhe qeverisjes (bashkëpunimi makrorajonal);
- Trashëgimia kulturore dhe natyrore;
- Promovimi i përshtatjes së ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut;
- Mbrojtja e biodiversitetit, tokës dhe ekosistemeve;
- Promovimi i transporteve të qëndrueshme;
- Promovimi i strategjive të zhvillimit të karbonit të ulët.

Për temat e ndryshme, mund të vërehet konvergjenca kryesore me propozimin e programeve të bashkëpunimit dhe disa divergjenca të renditura dhe të shpjeguara më poshtë.

Zgjedhja e temave të ndërhyrjes

CP. Partnerët përmendin kërkimin dhe inovacionin si prioritetin kryesor për zonën MED që është edhe prioriteti i parë për MED CP-në.

Eficienca e energjisë dhe e energjisë së rinovueshme konsiderohen si prioritet i dytë nga partnerët. Megjithatë edhe pse këto çështje janë me rëndësi strategjike, atyre u jepet më pak rëndësi në CP. Arsyeja është se ato tashmë mbështeten fuqimisht nga programet kombëtare dhe rajonale dhe se programi MED duhet të ndërhyjë vetëm në mënyrë plotësuese me fokus të veçantë në strategjitë, ngritjen e kapaciteteve dhe ndryshimin e praktikave për shembull.

Kapacitetet institucionale dhe qeverisja (në lidhje me krijimin e strategjive makrorajonale) konsiderohen si çështje kyçe nga ana e partnerëve (zgjedhja e tretë). Kjo konsiderohet edhe si një

preokupim i madh nga ana e autoriteteve të programit, por pyetjet ngrihen në lidhje me metodologjinë që duhet të përdoret për të përmirësuar bashkëpunimin transkombëtar për çështje që janë më tepër se politike. Me organizimin e makrorajonit Adriatik/Jon dhe duke marrë parasysh progresin që mund të bëhet në bashkëpunimin transkombëtar në nivel Mesdheu, ishte e rëndësishme të integrohej kjo çështje në prioritetet e programit. Megjithatë, kjo mund të bëhet vetëm në mënyrë të kufizuar duke marrë parasysh kushtet e rëndësishme institucionale dhe politike që duhet të plotësohen për të përparuar në këtë drejtim (duke mos u varur nga autoritetet e programit).

Partnerët rendisin "mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore", "ndryshimet klimatike dhe parandalimin e rrezikut dhe "biodiversitetin" në pozicionet 4, 5 dhe 6, përkatësisht. Për programin MED, çështjet e mjedisit përfaqësojnë preokupimin dytë më të rëndësishëm me kërkimin dhe inovacionin. Këto tema janë të ndërlidhura ngushtë dhe përbëjnë një potencial të rëndësishëm të projekteve të bashkëpunimit transkombëtar.

Transportet e qëndrueshme dhe promovimi i strategjive të zhvillimit të karbonit të ulët konsiderohen si më pak të rëndësishme nga partnerët (pozicionet shtatë dhe tetë). Për sa i përket transportit, ai është koherent me përfshirje të kufizuar të partnerëve në këtë çështje ndërmjet viteve 2007-ës dhe 2013-ës. Për periudhën 2014–2020, nevojat në fushën e transporteve të qëndrueshme janë shumë të ndryshme nga njëri shtet pjesëmarrës tek tjetri, çka justifikon ndërhyrjen e programit MED (por në një mënyrë të kufizuar) për të ndarë përvojat në nivel transkombëtar.

Për sa u përket strategjive të zhvillimit të karbonit të ulët, çështja është mbuluar kryesisht nga efikasiteti i energjisë, energjia e rinovueshme dhe transporti i qëndrueshëm përmendur tashmë.

Zgjedhja e veprimeve prioritare

Në mënyrë të përgjithshme, llojet e veprimeve të sugjeruara nga partnerët për secilën fushë të ndërhyrjes janë koherente me ato të zhvilluara në programin për bashkëpunim (rrjete, ndërtimi i strategjisë, adaptimi dhe shkëmbimi i mjeteve inovative, zbatimi i sistemeve të përbashkëta, transferimi i praktikave etj.). Me konsultimin, vërejmë se partnerët theksojnë në veçanti veprimet e dedikuara për të ndryshuar praktikat dhe sjelljet, veçanërisht në fushat e energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit. Mund të përmendim, gjithashtu, rëndësinë që i jepet ngritjes së kapaciteteve të autoriteteve publike në fusha të ndryshme të ndërhyrjes dhe të përmirësimit të aftësive dhe njohurive për institucionet dhe individët si përfituesit përfundimtarë.

5.6.2. Përshkrimi i përfshirjes së partnerëve në zbatimin e programit të bashkëpunimit dhe përfshirjes në Komitetin monitorues

Gjatë zbatimit të programit, partnerët do të ftohen të marrin pjesë në takime pune dhe seminare për përgatitjen e thirrjeve. Këto evente do të bazohen në shkëmbimin dhe proceset e konsultimit për të mbledhur opinione dhe propozime për hartimin e termave të referencës dhe lançimin e thirrjeve (rezultatet ekzistuese, gjendjen e artit, nismat në vazhdimësi etj.).

Programi do t'i kushtojë vëmendje të veçantë pjesëmarrjes së aktorëve të mëposhtëm:

- Komitetet kombëtare si organe konsultative shumëniveëlshe dhe ndërsektoriale, kur ekzistojnë,
- Partnerët socialë të jenë të përfshirë si duhet;
- Pjesëmarrja e shoqërisë civile dhe përdoruesve përfundimtarë të forcohet;
- Për të zhvilluar më tej dhe për të shfrytëzuar më mirë (përfshi shpërndarjen efektive të njohurive të zhvilluara) rrjetet ekzistuese që përfshijnë qytetarë, biznes, OJQ-të dhe partnerë të tjerë;
- Partneritetet me organet e specializuara në mosdiskriminim do të integrohen në planifikimin e politikave.

Rregullat e prokurimit publik

Pjesët e aktiviteteve në një operacion mund të nënkontraktohen te subjektet e treta nga LP-të ose PPS-së.

Kur shpenzohen fonde ERDF me anë të kontratave publike/koncesione, subjektet kontraktuese do të duhet të respektojnë rregullat e prokurimit publik të BE-së dhe në veçanti:

i) Direktivat 2004/18/KE dhe 2004/17/KE;

ii) Direktivat 2014/23/KE, 2014/24/BE dhe 2014/25 sapo të përafrohen në legjislacionin kombëtar,;

iii) Direktiva 89/665/KEE; dhe

iv) Parimet e përgjithshme të prokurimeve publike që rrjedhin nga Traktati mbi funksionimin e BE-së.

Kur shpenzohen fondet ERDF, rregullat për prokurimin janë të detyrueshme. Organet private, organizatat joqeveritare dhe organizatat ndërkombëtare duhet të respektojnë frymën e rregullave të

prokurimit publik.

Në lidhje me subjektet kontraktuese të Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Malit të Zi, ato duhet të respektojnë detyrimet e prokurimit publik të ndërmarra në bazë të Marrëveshjes përkatëse të Stabilizim-Asociimit me BE-në.

SEKSIONI 6
KOORDINIMI

6.1. Koordinimi me fondet e tjera ESI (ERDF, ESF, fondi i kohezionit, EAFRD, EMFF), që marrin pjesë në programe në kuadër të objektivit të investimeve për zhvillim dhe vende pune

Programi MED-së i bashkëpunimit transkombëtar është një nga mjetet e ndërhyrjes së BE-së që zbatohen në rajonet e Mesdheut. Për hartimin e tij ka qenë e nevojshme të merren parasysh rezultatet e konsultimeve kombëtare, ku projektimi i programeve rajonale dhe kombëtare në kuadër të objektivit të investimeve për zhvillim dhe vende pune përfaqësonte një pjesë të madhe (angazhimi në programet rajonale dhe kombëtare ERDF të përqendrojë 80% të fondeve në nivel kombëtar për dy ose më shumë nga objektivat tematikë të përcaktuar në pikën 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 9 të Rregullores së Përbashkët, specifikisht me 20% dedikuar objektivit tematik 4).

Për hartimin e programit MED, zgjedhja e objektivave tematikë, prioritetet e investimit dhe objektivat specifikë morën parasysh prioritetet e theksuara në marrëveshjet e partneritetit të vendeve përkatëse të përfshira në program dhe sfidat kryesore të ngritura në programet rajonale dhe kombëtare të objektivit të investimeve për zhvillim dhe vende pune. Objektivi i programit MED është të mbështesë veprimet plotësuese dhe të shmangë mbivendosjen në akset e ndryshme prioritare:

Aksi 1. Kërkimi dhe inovacioni është një preokupim i madh i programeve rajonale dhe kombëtare në secilin vend pjesëmarrës në program. Programi MED propozon një fokus të fuqishëm mbi këtë çështje, por me një vëmendje të veçantë kushtuar dimensionit transkombëtar të aktiviteteve të inovacionit (rrjetet transkombëtare, grupimet etj.).

Aksi 2. Programet kombëtare dhe rajonale duhet të përqendrojnë një pjesë të konsiderueshme të buxhetit të tyre për promovimin e ekonomisë me karbon të ulët dhe reduktimin e emisioneve të GHG-së. Edhe pse shkëmbimi i përvojës transkombëtare është i nevojshëm, nevoja për investime të fuqishme dhe ndikimi i rregulloreve kombëtare i japin rol të madh programit kombëtar dhe rajonal. Për këtë arsye, programi MED propozon ndërhyrje më të kufizuara në këtë fushë me një qasje të shënjestër në ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen e ndërgjegjësimit.

Aksi 3. Për shkak të parimeve të përqendrimit të programeve rajonale dhe kombëtare për objektivat tematikë 1, 2, 3 dhe 4, çështjet e mjedisit merren më pak parasysh në këto programe. Megjithatë, këto çështje janë të një rëndësie të madhe në rajonet MED për arsyet mjedisore dhe ekonomike. Zona është subjekt i presioneve të forta njerëzore dhe ndryshimeve globale mjedisore që imponojnë përdorimin e modelit të saj të zhvillimit. Për këtë arsye dhe për të plotësuar programet rajonale dhe kombëtare, programi MED thekson këtë çështje.

Aksi 4. Objektivi kryesor i këtij aksi është të përmirësojë proceset e qeverisjes transkombëtare në Mesdhe. Ai propozon shqyrtimin e mundësive të bashkëpunimit për çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm të Mesdheut. Një projekt i veçantë "platforma" do të përpunohet dhe kryhet. Me qëllim koordinimin e bashkëpunimit shumëpalësh dhe ndërqeveritar gjatë periudhës së programimit, një rrjet i autoriteteve do të funksionojë në zonën e programit. Ky rrjet do të ndihmojë për të organizuar seminare ndërministrore dhe ndërrajonale rreth temave prioritare që kanë nevojë për përgjigje të bashkërenduara në Mesdhe. Partnerëve kryesorë të "projekteve horizontale" që janë përgjegjës për të kapitalizuar punën e disa projekteve tematike MED, u kërkohet të japin informacione te grupet e punës, të cilat nga ana e tyre mund të propozojnë përfshirjen e veprimeve bazuar të paktën pjesërisht në rezultatet e projektit MED. Në këtë mënyrë, programi do të krijojë një mekanizëm sistematik të kapitalizimit dhe të shkëmbimit ndërmjet rezultateve të tij dhe politikave mbizotëruese ose aktuale, veçanërisht programet e fondeve strukturore në vendet e rajonit.

Grupet ndërrajonale të punës që synojnë veçanërisht potencialin e kapitalizimit mes projekteve MED dhe programeve rajonale ERDF/ESF/EARDF dhe kompozimi i autoriteteve menaxhuese rajonale mund të krijohen në kuadër të projektit "platforma".

Përveç aksit 4 dhe në një qasje më të përgjithshme, gjatë zbatimit të programit MED, Pikave Kombëtare

të Kontaktit (PKK-ve) u kërkohet të informohen në lidhje me zbatimin e programeve rajonale dhe kombëtare ERDF dhe të transmetojnë tek autoritetet menaxhuese informacionin që mund të jetë i dobishëm për programin transkombëtar MED (nevojat, boshllëqet, sukseset dhe dështimet, ndryshimi në orientimet strategjike etj.). Gjithashtu, PKK-të shpërndajnë informacion në lidhje me programin MED për autoritetet menaxhuese të programeve rajonale dhe kombëtare në lidhje me aktivitetet dhe rezultatet e projekteve që mund të jenë të dobishme për ta. Programi MED mund të përdoret, gjithashtu, për të financuar studimet paraprake për përgatitjen e projekteve që do të mund të zhvillohen më tej me mbështetjen e programeve rajonale dhe kombëtare.

Shkëmbimet promovohen sidomos me programet kombëtare dhe shumërajonale, përfshi aktivitetet ERDF dhe ESF.

Pikat Kombëtare të Kontaktit mund t'u kushtojnë vëmendje të veçantë rajoneve nën objektivin e "konvergjencës" dhe rajoneve që marrin grante nga fondi i kohezionit.

Lidhur me EAFRD-në dhe EMFF-në, programi MED nuk është duke zhvilluar aktivitete të rëndësishme dedikuar bujqësisë apo peshkimit. Megjithatë, objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtja e mjedisit natyror, konfliktet e përdorimit të tokës ose në det ose diversifikimi i aktiviteteve turistike përbëjnë çështjet përkatëse për projektet MED. Sidomos, promovimi i "rritjes blu" paraqet edhe një mundësi për të eksploruar koordinimin ose kapitalizimin e aktiviteteve me EMFF-në.

Për këtë arsye, është themeluar një kontakt i drejtpërdrejtë me njësinë mbështetëse EMFF (Farnet) dhe programi MED do të marrë informacionin e duhur për aktivitetet e financuara në kuadrin e flamurit (grupet lokale të veprimit të peshkimit) në zonën MED. Kështu komplimentariteti i projekteve MED dhe lidhjet e tyre me flamurin, kur është i përshtatshme, mund të sigurohet gjatë periudhës së programimit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për aktivitetet e parashikuara nën aksin prioritar 3.

6.2. Koordinimi me instrumentet e tjera të Unionit ("Horizont 2020", LIFE, Instrumenti Kyç Financiar i Evropës (CEF), *Cosme, Erasmus* për të Gjithë, Fondi për Azil, Migracion dhe Integrim, Programi për Ndryshime Sociale dhe Inovacionin, Fondi i Sigurimit të Brendshëm - Kufij dhe Visa etj.)

Vlerësimi *in-itinere* (*vlerësimi i bërë gjatë gjithë rrjedhës së programit*) 2007–2013 i programit MED ka pasur rastin të nxjerrë në pah lidhjet dhe efektet e mundshme të sinergjisë ndërmjet programit MED dhe programeve të tjera tematike të BE-së, në veçanti "Horizont 2020", COSME, LIFE, ERASMUS për të Gjithë, Programi për Ndryshim Social dhe Inovacion (PSCI), Evropa Krijuese, Instrumenti Kyç Financiar i Evropës (CEF), Mbrojtja Civile[76].

Në fazën përgatitore të periudhës 2014–2020, programi MED ka përdorur mekanizëm të veçantë për të nxjerrë në pah sinergjitë potenciale, për të shmangur dublimin dhe për të identifikuar fushat ku mbështetja financiare do të ishte e nevojshme. Mund të përmendim:

- Identifikimi specifik i programeve, i instrumenteve dhe i politikave përkatëse që përfaqësojnë interes sipas orientimeve të programit MED (siguruar nga vlerësimi *in-itinere*);
- Thirrjet specifike të "kapitalizimit" për të zbatuar në territorin MED arritjet përkatëse që vijnë nga projektet tematike të BE-së;
- Thirrjet specifike MED, si hapi i parë i projekteve të mëdha që do të financohen nga programe të tjera tematike.

Për programin MED, lidhja ndërmjet 11 objektivave tematikë për vitin 2014 dhe 2020 dhe programit tematik të BE-së është theksuar në tabelën (23bis). Programi MED mund të kontribuojë në financimin e projekteve në koherencë me këto programe tematike, kur është e përshtatshme.

"Horizont 2020", programi për konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve dhe SME-ve (Cosme) dhe Instrumenti Financiar për Evropën (CEF) paraqesin nivel të lartë të koherencës me objektivat e rritjes së zgjuar (objektivat tematikë 1, 2 dhe 3). CEF paraqet, gjithashtu, lidhje mjaft të rëndësishme me objektivin e rritjes së qëndrueshme dhe nevojën për të reduktuar emetimet e gazrave dhe për të mbështetur transportet e qëndrueshme.

Për të gjetur komplementaritetin dhe sinergjitë ndërmjet projekteve MED dhe programeve tematike të përmendura më lart është ngritur në MED SP, një sistem i personave referentë tematikë. Për secilin aks prioritar tematik (1, 2 dhe 3) ka dy persona referentë tematikë, të cilët kanë për detyrë të ndjekin programet tematike përkatëse të sektorit të tyre, duke vendosur shkëmbimin e drejtpërdrejtë me ta dhe

[76] Shih shtojcën 1. Tabela e programit MED në vlerësimin *itinere*. Faza 1 e vlerësimit krahasuar me standardet, nëntor 2012.

koordinimin e vlerësimit të projektpropozimeve sipas temës së tyre specifike. Ky mekanizëm do të sigurojë që projektpropozimet MED, të marrin parasysh aktivitetet e financuara në programet tematike dhe të mbështesin komplimentaritetin dhe sinergjitë me ta. Referentët tematikë kontribuojnë në termat specifikë të referencës për secilën thirrje për projekte (ka një term reference për çdo objektiv specifik) dhe të sigurohet që termi i referencës merr tashmë parasysh komplimentaritetin dhe orienton projektpropozimet në përputhje me rrethanat.

Lidhjet ndërmjet 11 objektivave tematikë për 2014–2020 dhe programi tematik i BE-së

BE 2020	Objektivat prioritarë	Horizont 2020	COSME	LIFE	ERASMUS për të gjithë	PSCI	Evropa krijuese	CEF	Mbrojtja civile
Smt	1 – RDT-ja dhe inovacioni	■	■					■	
Smt	2 – ICT-ja/Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit (TIK)	■			■			■	
Smt Sus	3 - Konkurrueshmëria e SME-ve	■	■				■		
Sus	4 - Ekonomia me më pak karbon (CO_2)	■		■				■	
Sus	5 - Ndryshimet klimatike/rreziqet			■					■
Sus	6 - Mjedisi			■				■	
Sus	7 - Transporti i qëndrueshëm			■				■	
Inc	8 - Punësimi dhe mobiliteti (lëvizshmëria)	■					■	■	
Inc	9 - Përfshirja sociale/varfëria					■			
Smt Inc	10 - Aftësitë dhe arsimimi				■				
Smt/Sus/ /Inc	11 - Kapacitetet institucionale								■

■ Koherencë e fortë ndërmjet objektivit tematik dhe programit tematik.
■ Koherencë mesatare midis objektivit tematik dhe programit tematik.
■ Asnjë lidhje ndërmjet objektivit tematik dhe programit tematik.

1. ***BE 2020.*** *Strategjia për rritjen/ose zhvillimin: Smt:* ***i mençar -*** *Sus****: i qëndrueshëm -*** *Inc.:* ***përfshirës***

2. ***HORIZONT 2020.*** *Programi i ri Kërkim* dhe *Zhvillim dhe Inovim, duke kombinuar Programet FP7 dhe pjesë nga CIP aktual.*

3. ***COSME.*** *Programi për Konkurrueshmënë e Ndërmarrjeve dhe SME-ve (komponenti i sipërmarrjes - CIP).*

4. ***ERASMUS PËR TË GJITHË.*** *Programi i ri për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin (që vazhdon në shtatë programet aktuale, përfshi "Rinia në veprim (YIA)" dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës (LLP).*

5. ***PSCI.*** *Programi për ndryshimet sociale dhe inovacionin social, që vazhdon në programet PROGRESS dhe EURES.*

6. ***EVROPA KRIJUESE.*** *Programi që kombinon në mënyrë të veçantë programet aktuale të kulturës dhe medias.*

7. ***CEF.*** *Instrumenti Kyç Financiar i Evropës që përfshin në veçanti Marco Polo dhe TENT-T.*

6.3. Koordinimi me CEF, ENI, IPA dhe EDF

Për programin MED ka një çështje kyçe me afërsinë e programit ENI CBC Mesdhe dhe krijimin e programit Adriatik-Jon ADRION, territori i të cilit mbulohet pjesërisht nga programi MED.

Për të forcuar dimensionin e tij transkombëtar dhe për të përmirësuar bashkëpunimin me programe të tjera si ADRION, Ballkan MED apo Hapësira Alpine, programi MED do të marrë parasysh objektivat dhe rezultatet e këtyre programeve gjatë zbatimit të aktiviteteve të kapitalizimit, projekteve strategjike dhe në vetëvlerësim.

Bashkëpunimi me ENI CBC MED dhe me ADRION do të jetë veçanërisht i rëndësishëm në lidhje me përcaktimin e përmbajtjes së thirrjeve për projekte dhe ndarjen e rezultateve të projekteve. Kjo mund të bëhet me konsultime dhe shkëmbimin e të dhënave për arritjet e projekteve.


Për më tepër, siç u përmend më parë, programi MED përfshin në territorin e tij të pranueshëm shtetet mesdhetare kandidate ose kandidatë potencialë në Bashkimin Evropian. Fondet evropiane janë vënë në dispozicion të këtyre shteteve për të lehtësuar reformat e tyre politike dhe ekonomike, duke u përgatitur për të marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet që lidhen me pranimin në BE. Kështu Shqipëria, Bosnja-Hercegovina dhe Mali i Zi marrin pjesë në program me fondet e Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit. Menaxhimi i këtyre fondeve është i integruar në sistemin e menaxhimit dhe të kontrollit të programit MED dhe është nën përgjegjësinë e autoritetit menaxhues.

Për sa i përket programit ENI CBC dhe programit ADRION, aktivitetet e koordinimit mund të zbatohen me përcaktimin e thirrjeve apo organizimin e eventeve të përbashkëta/të koordinuara.

Në kohën e paraqitjes së PB-së, këto programe bashkëpunimi nuk janë finalizuar mjaftueshëm për të analizuar në detaje strategjitë, objektivat dhe mundësitë e bashkëpunimit me programin MED.

Për aq sa është e mundur, programi MED do të krijojë kontakte të drejtpërdrejta me të gjitha programet përkatëse të bashkëpunimit në zonën e tij të pranueshme dhe do të përpiqet të fillojë shkëmbimin e të dhënave të përbashkëta dhe kërkimin shkencor për komplementaritetin e projekteve. Kjo mund të kuptojë, për shembull, të dhënat e krahasimit për projektet e financuara në programet ndërkufitare dhe ato të financuara nga MED, kur ka një partner MED ose partnerë të lokalizuar në zonën e programit ndërkufitar, si dhe një potencial për mbivendosje, por edhe se sinergjitë ekzistojnë. Mund të parashikohen evente të përbashkëta të kapitalizimit për tema të veçanta përkatëse, si për programet ndërkufitare/transkombëtare ashtu edhe për MED-në.

Prioritetet e përbashkëta të investimeve ndërmjet programit MED dhe programeve të tjera ETC
(sipas informacionit në dispozicion në datën e dorëzimit të MED PB)



6.4 Koordinimi me instrumentet përkatëse të financimit kombëtar që kontribuojnë për objektivat e njëjtë ose të ngjashëm, si programi i bashkëpunimit ose plotësojnë ndërhyrjet e tij

Gjatë shtjellimit të programit të bashkëpunimit MED, vendet pjesëmarrëse theksuan faktin se disa fusha të ndërhyrjes mbuloheshin kryesisht nga politikat kombëtare dhe rajonale dhe nga programet rajonale ERDF; për shembull rasti për promovimin e eficiencës së energjisë, të energjisë së rinovueshme ose parandalimi i rrezikut.

Në këtë rast, programi e përshtati buxhetin e caktuar për këto çështje dhe fokusoi aktivitetet e tij në llojet e ndërhyrjeve plotësuese/ose komplementare për veprimet e zbatuara tashmë. Ai nuk financon instrumente në shkallë të madhe apo infrastrukturat, por mbështet krijimin e strategjive, përmirësimin e politikave dhe rritjen e përvojave që ndryshojnë nga njëri rajon MED në tjetrin.

Në fusha të tjera, koordinimi dhe komplementariteti me instrumentet kombëtare mbështetet kryesisht në dimensionin transkombëtar të programit që lejon aktorët të zhvillojnë ose të forcojnë nismat rajonale dhe kombëtare me reciprocitetin e mjeteve dhe shkëmbimin e rezultateve në nivel ndërkombëtar.

Gjatë periudhës së zbatimit, programi, në mënyrë të veçantë, do të mbështetet në përpjekjet e qeverisjes dhe të koordinimit, të ofruara në kuadër të projektit "platformë" të aksit prioritar 4, për të siguruar bashkëpunimin dhe komplimentaritetin me instrumentet kombëtare dhe rajonale të financimit.

Po ashtu edhe Pikat Kombëtare të Kontaktit (PKK-të) duhet të veprojnë si transmetues të informacionit ndërmjet programit MED dhe programeve përkatëse kombëtare/rajonale, për të siguruar komplimentaritetin dhe ndikimin e financimit të MED në lidhje me politikat aktuale.

6.5. Koordinimi me BEI-n

Si një program i bashkëpunimit transkombëtar, programi MED mund të përdoret për të eksploruar fusha të ndërhyrjes, të sigurojë studime, të mbështesë kërkimin shkencor, të krijojë rrjete apo të financojë studime fizibiliteti për të përgatitur terrenin për nisma më të gjera që do të financohen nga mjete të tjera të ndërhyrjes.

Kjo mundësi mund të përdoret nga palët e interesuara për të përgatitur një brez të dytë projektesh që më në fund do të financohen nga Banka Evropiane e Investimeve (BEI).

SEKSIONI 7
REDUKTIMI I BARRËS ADMINISTRATIVE PËR PËRFITUESIT

(Referenca: Pika "b" e nenit 8(5) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Përmbledhje e vlerësimit të barrës administrative për përfituesit dhe, sipas rastit, veprimet e planifikuara të shoqëruara nga një kohështrirje për të ulur barrën administrative.

7.1 Vlerësimi i barrës administrative

Burimet kryesore të barrës administrative në periudhën 2007–2013 ishin volumi i madh i të dhënave nga përfituesit dhe koha e nevojshme për të vlerësuar raportet dhe autorizuara, kryerjen e pagesave.

Në lidhje me volumin e madh të të dhënave të marra nga përfituesit, ka një dallim midis fazës së aplikimit dhe periudhës së zbatimit.

Procedura që duhet zbatuar për të dorëzuar aplikimet përfundimtare është e përfshirë, në disa prej thirrjeve, deri në 9 dokumente të ndryshme, ku të gjitha do të dorëzohen në kopje elektronike dhe të printuara. Janë miratuar disa rregulla fleksibiliteti, lidhur me kriteret e pranueshmërisë, gjatë periudhës së programimit, por që ishin të pamjaftueshme për të reduktuar barrën administrative. Rregulloret nuk u kuptuan qartë nga ana e përfituesve dhe gabimet e shumta formale çuan në papranueshmërinë e shumë projekteve.

Për sa ka të bëjë me periudhën e zbatimit, partnerët kryesorë duhet të dorëzojnë çdo gjashtë muaj një raport mbi progresin e punimeve, kërkesat për pagesa dhe certifikatat e kontrolluesve si në kopje elektronike edhe të printuar. Një listë shërbimesh duhet të dorëzohet vetëm elektronikisht.

Gjithsesi, vështirësia kryesore për partnerët kryesorë gjatë periudhës së zbatimit ishte koordinimi i një sërë rregullash komplekse të pranueshmërisë brenda të njëjtit projekti. Çdo sistem kombëtar i kontrollit të nivelit të parë kishte procedurat, modelet dhe vonesat përkatëse.

Për pasojë, si në nivel programi edhe në nivel projekti, janë alokuar burime të konsiderueshme njerëzore për të grumbulluar dhe për të verifikuar dokumentet kryesisht, më tepër se sa për t'u përqendruar në kontrollimin e sigurimit të rezultateve dhe të arritjeve të objektivave, ndaj dhe koha e nevojshme për të vlerësuar raportet dhe për të autorizuar shlyerjen e pagesave ishte shumë e gjatë.

Konkluzioni kryesor është se koha dhe kostoja e nevojshme për të kryer vlerësimin, menaxhimin dhe kontrollin e projekteve MED në periudhën 2007–2013 ishte joproporcionale dhe, për këtë arsye, nevojiten fleksibilitet dhe thjeshtësime.

7.2 Veprimet kryesore të planifikuara për të arritur reduktimin e barrës administrative

Veprimet kryesore të planifikuara për të arritur reduktimin e barrës administrative janë, si vijon:

Miratimi i rregullores së përgjithshme mbi pranueshmërinë e shpenzimeve;

Përdorimi i mundësive të thjeshtuara të kostove në disa kategori buxhetore (në përputhje me nenet 67 dhe 68 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 dhe me nenin 19 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013);

Përdorimi i mjeteve thjeshtuese për zbatimin e projekteve (të harmonizuara, nëse mundet me programet e tjera ETC);

Shkëmbimi elektronik i informacionit midis përfituesve dhe organeve të programit;

Procesi i decentralizimit;

Nënshkrimi elektronik (nëse mundet).

Miratimi i rregullores së përgjithshme mbi pranueshmërinë e shpenzimeve

Rregullorja ETC parashikon nën nenin 18(1) të saj që Komisioni përcakton rregullat specifike mbi pranueshmërinë e shpenzimeve për programet e bashkëpunimit nëpërmjet një akti delegues.

Akti i deleguar mbi pranueshmërinë e shpenzimeve (Rregullorja e Komisionit (BE) nr. 481/2014) përmban dispozita të përgjithshme dhe pesë seksione që lidhen me shpenzimet e stafit, shpenzimet administrative dhe të zyrës, shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit, kostot e ekspertizës së jashtme dhe shërbimeve, si dhe shpenzimet për pajisje.

Shpenzimet e bëra gjatë periudhës së zbatimit të projektit do të deklarohen mbi bazën e këtyre pesë linjave buxhetore, të cilat aplikohen kundrejt të gjithë programeve ETC.

Një udhëzues për kostot individuale të pranueshme të linjës buxhetore sigurohet në një set dokumentesh me informacione faktike të përgatitura nga programi INTERACT. Në këtë mënyrë, të gjithë përfituesit mund të punojnë me një set të harmonizuar rregullash bazë dhe të përqendrohen vetëm mbi kushtet e veçanta, kur ato punojnë përgjatë disa programeve.

Neni 18 (2) i Rregullores ETC parashikon që shtetet pjesëmarrëse në Komitetin e monitorimit do të vendosin rregulla shtesë për pranueshmërinë e shpenzimeve për programin e bashkëpunimit si të tërë.

Përdorimi i mundësive të thjeshtësuara të shpenzimeve, në përputhje me nenet 67 dhe 68 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 dhe nenin 19 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013, mund të propozohet për linjat përkatëse buxhetore.

Në të njëjtën kohë, mjete të reja të zbatimit, të krijuara nga Programi hidhen në sistemin e informacionit të Programit.

Këto mjete marrin në konsideratë, sipas rastit, punën e harmonizimit që koordinohet nga programi INTERACT, së bashku me programet e tjera ETC. Mjetet e harmonizuara të zbatimit janë ndër masat lehtësuese kryesore dhe kanë për qëllim reduktimin e barrës administrative si për organet e programit ETC edhe për përfituesit, duke kaluar fokusin e zbatimit të programit drejt rezultateve dhe cilësisë.

Duke marrë në konsideratë përvojën e periudhës 20017–2013, menaxhimi i shëndoshë financiar kërkon që të gjitha sistemet kombëtare të kontrollit të nivelit të parë të përdorin modele të përbashkëta zbatimi dhe elemente të thjeshtuara në përllogaritjen e kostove.

Kontrolluesit duhet të përshtatin metodat dhe praktikat e tyre të punës. Gjithsesi, ndryshimi i sistemit do t'u sigurojë atyre kohë dhe burime për të përqendruar më shumë në fusha që adresojnë rreziqe madhore (si p.sh., në rastin e procedurave të prokurimeve publike).

Organet përgjegjëse për kontrollin e shkallës së parë në shtetet partnere të ndryshme mbajnë takime të rregullta koordinuese, në lidhje me zbatimin e rregullave të përbashkëta të pranueshmërisë, opsionet e thjeshtësuara të kostos dhe mjetet e harmonizuara. Këto takime mbahen për të përmirësuar cilësinë e kontrolleve dhe për të reduktuar mospërputhjet e mundshme në zbatimin e rregullave të përbashkëta.

Shkëmbimi elektronik i informacionit midis përfituesve dhe organeve të programit

Një sistem për shkëmbimin elektronik të informacionit me përfituesve dhe autoriteteve të programit duhet të krijohet para datës 31 dhjetor 2015, siç përcaktohet në nenin 122(3) të CPR-së dhe në aktin e zbatimit për rregullat që lidhen me shkëmbimin e informacionit me përfituesit (*e-Cohesion*).

Në lidhje me komunikimin me përfituesit, ky shkëmbim mbulon të gjithë kohëzgjatjen e projekteve, nga faza e aplikimit deri në nënshkrimin e kontratës së subvencioneve, derisa dorëzimi i të gjitha dokumenteve që kanë të bëjnë me zbatimin e projektit, si dhe raportin e progresit dhe certifikimin e shpenzimeve.

Për më tepër, procesi i dematerializimit të dokumenteve është në zbatim nëpërmjet sistemit *online* të monitorimit të programit. Ky proces përfshin prodhimin e dokumenteve duke përdorur informacionin e hedhur në sistem për të gjithë kohëzgjatjen e projektit në përputhje me parimin: "vetëm një herë", si dhe ruajtjen e dokumenteve përkatëse për menaxhimin dhe zbatimin e projektit. Ky proces do të reduktojë ndjeshëm sasinë e letrave dhe transferimin e dokumenteve dhe do të mundësojë grumbullimin e dokumenteve në një vend, duke i mundësuar ato për këdo, në çdo kohë: Autoritetet e programit, përfituesit dhe kontrolluesit.

SEKSIONI 8
PARIMET HORIZONTALE
(Referenca: Neni 8(7) i Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

8.1 Zhvillimi i qëndrueshëm

Rregullorja e Dispozitave të Përbashkëta (CPR) përcakton se: *Shtetet anëtare dhe Komisioni sigurojnë që kushtet për mbrojtjen e mjedisit, eficienca e burimeve, lehtësimi dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, mbrojtja e biodiversitetit dhe ekosistemit, qëndrueshmëria ndaj fatkeqësive dhe parandalimi e menaxhimi i rreziqeve, promovohen në përgatitjen dhe zbatimin e Marrëveshjeve të Partneritetit dhe programeve"* (neni 8).

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) dhe vlerësimi *ex-ante* kanë dhënë kontribut për të siguruar që programi ADRION respekton parimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Në nivel programi, vëmendje e veçantë i kushtohet këtij parimi me caktimin e objektivave tematikë dhe prioriteteve të investimeve. Lufta kundër pasojave të ndryshimeve klimatike, ulja e ndikimit të aktiviteteve njerëzore mbi mjedisin dhe mbrojtja e ekosistemeve dhe biodiversitetit mbështeten nga PI-të 4.c dhe 4.e.

Në mënyrë të tërthortë, përfituesve u kërkohet të nxitin ekoinovacionet me qëllimin për të bërë shfrytëzuar burimet natyrore në mënyrë më të qëndrueshme, sipas akseve prioritare (AP-ve).

Më saktësisht, përfituesve u kërkohet të përshkruajnë në projektpropozimet e tyre përpjekjet që ata do të ndërmarrin për të zvogëluar "gjurmët e karbonit" në projekt. Autoritetet e programit (KM, AM, SP, PKK-të) do të adresojnë këtë çështje në lidhje me zbatimin e detyrave të tyre.

Në përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, zbatimi i projekteve vlerësohet duke përdorur kriteret e mëposhtme:

- Projektet të cilat kanë një efekt pozitiv në mjedis ose të cilat konservojnë, rrisin apo rehabilitojnë kapacitetet ekzistuese do të preferohen më shumë se ata që janë neutralë nga kjo perspektivë;
- Projektet që kanë një efekt potencialisht të dëmshëm në mjedis do të përjashtohen;
- Veprimet e përcaktuara, për të rritur ndërgjegjësimin dhe pajtueshmërinë me mjedisin, si brenda sektorëve ekonomikë dhe administrativë dhe midis publikut të gjerë, përfshi edhe pranimin se një nivel i lartë i performancës mjedisore mund të sigurojë avantazh konkurrues afatgjatë, do të mbështeten.

Për procesin e vlerësimit të projektit do të konsiderohen si udhëzim aspektet e mëposhtme:

- Kontributi për efikasitetin e përdorimit të burimeve (p.sh., efikasiteti i energjisë, përdorimi i energjisë së rinovueshme, reduktimi i gazit serrë (GHG), masat për cilësinë e ajrit, në veçanti për reduktimin e PM-së dhe NO_2, furnizimi eficient i ujit, trajtimi i ujërave të zeza dhe ripërdorimi i ujit, përdorimi i qëndrueshëm i tokës, menaxhimi i mbetjeve dhe riciklimi etj.);
- Kontributi në zhvillimin e infrastrukturës së gjelbër;
- Kontributi për zhvillimin e qëndrueshëm e të integruar urban dhe rajonal;
- Kontributi për ndërgjegjësimin më të mirë për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe parandalimin e rrezikut;
- Promovimi i mundësive për punësim, arsimim, trajnim dhe shërbime mbështetëse në kontekstin e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Formulari i kërkesës përmban një kapitull të dedikuar kritereve për zhvillim të qëndrueshëm. Një vëmendje e veçantë u kushtohet projekteve që ofrojnë indikatorë të qartë të matjes për çështjet mjedisore (sipas rastit, në përputhje me objektivat e projektit). Partnerët kryesorë do të sigurojnë një kuadër logjik, ku do të tregohet qartë se si çështjet mjedisore merren në konsideratë (aktivitete të projektit, rezultatet, objektivat specifikë dhe objektivat globalë).

Nëse projektet kanë të bëjnë drejtpërdrejt me çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm ose jo, ata ftohen të zbatojnë veprime/ose të marrin masa specifike për të reduktuar ndikimin mjedisor. Kjo mund të përfshijë, për shembull:

- Përdorimin e video-konferencave për të reduktuar udhëtimin;
- Publikimet mbi certifikimin nga FLC-ja (Këshilli për Mbikëqyrjen e Pyjeve);
- Përdorimin e procedurave të prokurimit publik "të gjelbër" dhe prokurimin inovativ publik sipas rastit;
- Përdorimin e zinxhirëve të shkurtër të furnizimit në realizimin e aktiviteteve të projekteve;
- Rritjen e ndërgjegjësimit të partnerëve, përfituesve dhe grupeve të synuara për çështjet e qëndrueshmërisë;
- Promovimin e aktiviteteve me përdorim të kufizuar të energjisë dhe burimeve natyrore.

Këto masa do të merren në konsideratë edhe në nivel programi për menaxhimin dhe monitorimin e aktiviteteve.

Veç kësaj, vihet re se masat lidhur me thjeshtësimin dhe reduktimin e pengesave administrative të përmendura në pjesën 7.2 të Programit të Bashkëpunimit kanë mundësi të pakësojnë ndikimin mjedisor të programit përmes përdorimit të komunikimit elektronik dhe reduktimit të konsumit të letrës.

Udhëzime më të hollësishme se si të interpretohen parimet kryesore të përshkruara në PB mund të sigurohen në termat e referencës së çdo thirrjeje për propozime.

8.2 Mundësitë e barabarta dhe mosdiskriminimi

Rregullorja e Dispozitave të Përbashkëta (CPR) përcakton se: *"Shtetet anëtare dhe Komisioni do të ndërmarrin masat e duhura për të parandaluar çdo diskriminim në bazë të gjinisë, prejardhjes racore apo etnike, fesë ose besimit, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual gjatë përgatitjes dhe zbatimit të programeve*" (neni 7).

8.2.1 Grupet e synuara dhe masat e ndërmarra për të reduktuar rrezikun e diskriminimit

Duke marrë në konsideratë natyrën dhe objektivat kryesorë të tij, programi MED nuk synon grupe të veçanta lidhur me rreziqet e diskriminimit. Programi MED nuk mbështet as zhvillimin e drejtpërdrejtë të infrastrukturave (të pritshme për projektet pilot), të predispozuar për të ndikuar në grupet e rrezikuara nga diskriminimi.

Grupet e synuara të programit janë kryesisht partnerë institucionalë, organe publike dhe private, të cilat nuk preken në mënyrë të veçantë nga ky rrezik. Gjithsesi, në zonën MED mund të vërehen disa raste të veçanta, me rritjen e numrit të të moshuarve dhe të rinisë së papunësuar. Në objektivin tjetër tematik, përdorimi i TIK-ut mund të shërbejë si mjet për të përmirësuar eksesin e këtij grupi të popullsisë në informacion dhe shërbime. Gjatë zhvillimit të *e-shërbimeve*, inkurajohet përfshirja e përfaqësuesve të këtyre grupeve në konceptimin/zbatimin e projekteve.

8.2.2 Iniciativa për të integruar parimet mosdiskriminuese në përzgjedhjen dhe zbatimin e projektit

Në çdo formular aplikimi, aplikantët kërkohen që të shpjegojnë nëse grupet e rrezikuara nga diskriminimi lidhen me projektin e tyre dhe masat që do të ndërmerren për të shmangur diskriminimin dhe/ose për të përmirësuar integrimin e këtyre grupeve si partner ose përdorues fundorë. Në procesin e përzgjedhjes, mosdiskriminimi do të konsiderohet si dimension i tërthortë i vlerësimit cilësor të projekteve.

Në programin MED, vëmendje e veçantë do t'u kushtohet grupeve në rrezik diskriminimi socioekonomik, për shkak të pasojave të krizës ekonomike (të rinjtë që nuk janë përfshirë në arsimim, punësim dhe trajnime (NEET), me aftësi të kufizuara…) dhe të moshuarve që përfaqësojnë një pjesë në rritje të popullsisë. Partnerët duhet të marrin në konsideratë informacionin dhe masat për komunikimin, në mënyrë që kategori të ndryshme të popullsisë të përfitojnë nga rezultatet e projekteve.

Në varësi të fushës së ndërhyrjes, thirrjet për propozime mund të përfshijnë edhe kushtet specifike dhe veprime mosdiskriminimi, të cilat sigurojnë mbështetje për këtë grup të shoqërisë.

8.2.3 Masat për monitorimin dhe vlerësimin

Gjatë zgjatjes së projektit, mundësitë e barabarta dhe mosdiskriminimi do të përbëjnë një prej kushteve të monitorimit dhe të vlerësimit që do të përdoret nga programi. Programi do të garantojë që iniciativat e parashikuara në aplikime të respektohen, kryesisht ato që kanë të bëjnë me angazhimin e përdoruesve fundorë dhe veprimet e informacionit dhe komunikimit drejt grupeve në rrezik diskriminimi.

8.2.4 Veprimet specifike që do të ndërmerren për të promovuar mundësitë e barabarta dhe për të parandaluar diskriminimin me referencë prioritetin e veçantë të investimeve

Programi MED nuk ka asnjë prioritet investimesh apo objektiv të dedikuar në mënyrë specifike për mundësitë e barabarta dhe mosdiskriminimin.

Gjithsesi, këto pyetje janë kryesisht përkatëse për objektivat specifikë që fokusohen te përdoruesit fundorë, si p.sh., promovimi i eficiencës së energjisë ose aksesi në sistemet e qëndrueshme të transportit (prioritetet e investimeve 4.c dhe 4.e). Projekteve u kërkohet që të identifikojnë dhe të marrin në konsideratë kategoritë e ndryshme të njerëzve të prekur, përfshi ato që janë subjekt i masave diskriminuese.

8.3 Barazia midis burrave dhe grave

Barazia midis grave dhe burrave është një nga vlerat themelore të Bashkimit Evropian dhe është e përcaktuar në Traktatin e Bashkimit Evropian. Neni 3 përcakton se Unioni duhet "*të luftojë përjashtimin social dhe diskriminimin dhe do të promovojë mbrojtje dhe drejtësi sociale, barazi midis burrave dhe grave, solidaritet midis gjeneratave dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve*"[77].

Barazia midis burrave dhe grave parashikohet edhe në Versionin e Konsoliduar të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (neni 8[78]) dhe në Rregulloren e Dispozitave të Përbashkëta (CPR): *"Shtetet anëtare dhe Komisioni do të garantojnë që barazia midis burrave dhe grave dhe integrimi i perspektivës gjinore të promovohet në përgatitjen dhe zbatimin e programeve[79]".*

8.3.1 Kontributi i programit në promovimin e barazisë midis burrave dhe grave

Për programin MED, barazia gjinore nuk përbën prioritet të përcaktuar qartë në objektivat tematikë dhe prioritetet e investimeve. Kjo çështje merret në konsideratë si prioritet horizontal në konceptimin, përzgjedhjen dhe vlerësimin e projekteve.

8.3.2 Masat e planifikuara për të garantuar integrimin e perspektivës gjinore në nivel operacional

Kjo çështje mund të përqaset në disa mënyra, nga rritja e numrit të grave në aktivitetet e menaxhimit në rritjen e numrit të grave në sektorin R-D nëpërmjet trajtimit të barabartë në aspektin e pagesave.

Sakaq, mund të jetë e vështirë që të imagjinosh që pabarazitë në mundësitë gjinore të reduktohen ndjeshëm nëpërmjet programit MED. Parimet e barazisë mund të theksohen duke u kushtuar vëmendje të veçantë iniciativave që mund të kenë ndikim pozitiv në periudhën afatgjatë duke kontribuar në ndryshimin e qëndrimit.

Projektpropozimet, që përmbajnë udhëzime praktike për masat që do të zbatohen për të reduktuar dallimet me bazë gjinore në menaxhimin, ndështkueshmërinë, vendimmarrjen dhe mundësitë e punësimit, mirëpriten brenda vlerësimit. Gjithashtu, masat mund të prekin ndërmjetësimin midis aktiviteteve profesionale dhe familjare, rritjen e ndërgjegjësimit të popullsisë ose analizat me bazë gjinore brenda institucioneve partnere.

Në secilin rast, promovuesit e projekteve duhet të marrin në konsideratë parimin e barazisë midis burrave dhe grave në konceptimin dhe zbatimin e projektit. Termat e referencës së thirrjeve për propozime mund të sigurojnë udhëzime më koncize për këtë tematikë.

8.3.3 Masat për monitorimin dhe vlerësimin

Vlerësuesit do të shqyrtojnë rëndësinë e dhënë për perspektivën gjinore në projekte dhe nëse janë përcaktuar synimet specifike. Për të matur promovimin e barazisë midis burrave dhe grave, përfshirja e tyre mund të kryhet sipas mënyrave të mëposhtme:

Vlerësimit të numrit të grave dhe të burrave që marrin pjesë në projekte dhe aktivitete;

Vlerësimit të numrit të grave që përfitojnë nga fondet;

Vlerësimit se sa mbështetje dhe për cilat projekte gratë dhe burrat marrin fonde.

Në të gjitha rastet, aplikantët duhet të shpjegojnë rëndësinë e barazisë gjinore për projektet e tyre, masat që do të ndërmerren ose arsyetim për mosmarrjen në konsideratë të kësaj çështjeje për projektin.

8.3.4 Veprimet specifike që do të ndërmerren për të promovuar barazinë gjinore me referencë prioritetin e veçantë të investimeve

Programi MED nuk ka asnjë prioritet investimesh apo objektiv të dedikuar në mënyrë specifike për mundësitë e barabarta dhe mosdiskriminimin.

Gjithsesi, këto pyetje janë kryesisht përkatëse për objektivat specifikë që fokusohen te përdoruesit fundorë, si p.sh., promovimi i eficiencës së energjisë ose aksesi në sistemet e qëndrueshme të transportit (prioritetet e investimeve 4(c) dhe 4(e). Në këto raste, projektet mund të aplikojnë masa të veçanta për

[77] Versioni i konsoliduar i Traktatit të Bashkimin Evropian - titulli I: Dispozitat e përgjithshme - neni 3 (p.sh., neni 2 i TEU-së), Gazeta Zyrtare 115, 09/05/2008 P. 0017-0017.

[78] Neni 8, versioni i konsoliduar i Traktatit të Bashkimin Evropian, Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian C 83/49 e datës 30.3.2010.

[79] Neni 7, CPR, COM (2011) 615 përfundimtare/2, Bruksel, e datës 14.3.2012, f. 34.

gratë dhe të përfshijnë mjete specifike monitoruese për të matur progresin e arritur.

SEKSIONI 9
ELEMENTE TË VEÇANTA

9.1 Projekte të mëdha që do të zbatohen gjatë periudhës së programimit

(Referenca: Pika "e" e nenit 8(2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)
Nuk aplikohet për PB MED

9.2 Korniza e performancës së programit të bashkëpunimit

Tabela 24. Korniza e performancës së programit të bashkëpunimit

Aksi prioritar	Indikatori ose hapi kyç i zbatimit	Njësia e matjes, sipas rastit	Arritjet totale për 2018-ën	Objektivi final (2023)
1	1.1.a Numri i instrumenteve operacionale për të favorizuar rinovimin e SME-ve	Instrumente	8	44.00
1	FI Shpenzimet e deklaruara te KE-ja	Euro	12,667,625.00	84,450,833.00
2	2.1.a Numri i mjeteve planifikuese në dispozicion për të monitoruar dhe për të menaxhuar konsumin e energjisë në ndërtesat publike	Mjete	3	5.0
2	2.2.a Numri i mjeteve planifikuese për të hartuar plane të energjisë përfshi RES lokale	Mjete	3	5.0
2	2.3.a Numri i instrumenteve në dispozicion për të nxitur përdorimin e zgjidhjeve të transportit LC, përfshi ato multimodale	Instrumente	3	5.0
2	FI Shpenzimet e deklaruara te KE-ja	Euro	7,917,266.00	52,781,771.00
3	3.1.a Numri i instrumenteve në dispozicion për të rritur zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe të besueshëm	Instrumente	10	17.00
3	3.2.a Numri i planeve të përbashkëta të qeverisjes	Plane	18	36.00
3	FI Shpenzimet e deklaruara te KE-ja	Euro	13,459,352.00	89,729,012.00
4	4.1.a Numri i palëve të interesuara (strukturave) të përfshira në iniciativat mbështetëse (për kategori që përfaqësojnë palët e interesuara publike dhe private)	Organizata	200	1,200.00
4	FI Shpenzimet e deklaruara te KE-ja	Euro	3,166,906.00	21,112,708.00

9.3 Partnerët përkatës të përfshirë në përgatitjen e programit të bashkëpunimit:

Autoritetet kombëtare;
Autoritetet rajonale;
Autoritetet lokale/metropolet/qytetet;
Agjencitë lokale dhe rajonale të zhvillimit/organet publike të zhvillimit/operatorët publikë;
Autoritetet e planifikimit tokësor dhe detar;
Universitetet/qendrat kërkimore/qendrat teknologjike/parqet shkencore;
SME-të/operatorët ekonomikë/përfaqësues të operatorëve ekonomikë/rrjetet dhe grupimet;
Dhomat e tregtisë, industrisë dhe bujqësisë;
Organizatat joqeveritare;
Organet trajnuese;
Autoritetet portale/autoritetet detare;
Autoritetet e transportit;
Autoritetet kombëtare mjedisore të 13 shteteve anëtare dhe partnere të përfshira në fazën e konsultimeve mjedisore.

9.4 Kushtet e aplikueshme të zbatimit të programit që rregullojnë menaxhimin financiar, programimin, monitorimin, vlerësimin dhe kontrollin e pjesëmarrjes së vendeve të treta në programet transkombëtare dhe ndërrajonale nëpërmjet kontributit të ENI-së dhe burimeve të IPA-së

(Referenca: Neni 26 i Rregullores (BE) Nr. 1299/2013)

Në terma të përgjithshëm, rregullat e zbatueshme për përfituesit ERDF zbatohen edhe për përfituesit e IPA-së, në lidhje me kushtet zbatuese për menaxhimin financiar, programimin, monitorimin, vlerësimin dhe kontrollin. Elementet e mëposhtme do të merren parasysh:

- Partnerët IPA nuk mund të jenë partnerë kryesorë në projektet MED;
- Subjektet IPA të së drejtës private nuk kualifikohen për programin MED;
- Fondet IPA mund të financojnë vetëm projekte që ndodhin në vendet IPA;
- Fondet IPA mund të shpenzohen vetëm në shtetet IPA;
-
- Në përputhje me titullin IV, seksioni 3, kapitulli 3 të rregullores (BE, EURATOM) nr. 966/2012 (Rregullore financiare) dhe pjesën e dytë, titulli II, kapitulli 3 i Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) nr. 1268/2012 do të zbatohen rregullat për prokurimet e veprimeve të jashtme për partnerët IPA;
- Një mekanizëm i pagesave paraprake në nivel projekti do të aplikohet për partnerët IPA dhe jo ato ERDF, siç ishte rasti i periudhës së fundit të programimit. Ky mekanizëm do të detajohet në përshkrimin e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit;
- Marrëveshjet e Financimit ndërmjet Komisionit Evropian, AM-së dhe qeverive të Malit të Zi, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Shqipërisë do të nënshkruhen në lidhje me zbatimin e asistencës së IPA-së integruar në Programin MED;
- Në përputhje me nenin 26 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013 (Rregullorja ETC), këto marrëveshje financimi do të përcaktojnë kushtet për zbatimin e Programit MED, udhëzuese për menaxhimin financiar, programimin, monitorimin, vlerësimin dhe kontrollin e fondeve IPA.

Shtojcat (të ngarkuara në SFC 2014 si skedarë të veçantë):

- Projektraporti i vlerësimit *ex-ante*, me një përmbledhje ekzekutive (detyruese);
  (Referenca: Neni 55(2) i Rregullores (BE) nr. 1303/2013)
- Konfirmimi i marrëveshjes me shkrim për përmbajtjen e programit të bashkëpunimit;
  (Referenca: Neni 8(9) i Rregullores (BE) nr. 1299/2013)
- Një hartë e zonës që mbulon programi i bashkëpunimit (sipas rastit);
- Një përmbledhje e qytetarëve për programin e bashkëpunimit (sipas rastit).

FJALOR

Vlera bazë

Çdo tregues/indikator rezultati kërkon një bazë të vlerës (neni 6 i Rregullores ERDF, neni 5, të Rregullores (BE), neni 16 i Rregullores ETC. Bazë është vlera e një treguesi rezultatesh në fillim të periudhës së programimit (për shembull, numri i bizneseve të themeluar rishtazi në atë vit për një prioritet që synon të

nxisë numrin e bizneseve fillestare në një rajon). Kjo mund të jetë e mundësuar nga të dhënat statistikore ose administrative[80].

Përfituesi

Partner i një projekti MED që përfiton fonde ERDF (ose fonde IPA në vendet kandidate ose potencialisht kandidate të Mesdheut).

Rritja "blu"

Rritja blu është strategjia afatgjatë për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm në sektorin detar dhe atë të marinës si një e tërë. Ajo pranon se detet dhe oqeanet janë faktorë zhvillimi për ekonominë evropiane, me potencial të madh për inovacionin dhe rritjen ekonomike. Është kontributi i Politikës së Integruar Detare në arritjen e qëllimeve të strategjisë BE2020 për rritjen inteligjente, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Ngritja e kapaciteteve

Ngritja e kapaciteteve fokusohet në të kuptuarin e pengesave që pengojnë njerëzit, institucionet dhe autoritetet publike nga realizimi i qëllimeve të tyre të zhvillimit, duke rritur aftësitë që do t'i lejojnë ata të arrijnë rezultate të matshme dhe të qëndrueshme.

Kapitalizimi

Organizimi i të dhënave në lidhje me zbatimin e programeve, projekteve dhe me ndikimet e tyre, metodat e përdorura për të bërë përvojën e akumuluar të jetë e përdorshme për programet dhe projektet e tjera apo grupet e interesit.

Grupimet

Grupimi i biznesit është një përqendrim gjeografik i bizneseve të ndërlidhura, furnizuesve dhe institucioneve të lidhura në një fushë të caktuar. Grupimet konsiderohen për të rritur produktivitetin me të cilin kompanitë mund të konkurrojnë, në nivel kombëtar dhe atë global.

Industritë kreative

Industritë që përdorin kulturën si *kontribut* dhe kanë dimension kulturor. Ato përfshijnë arkitekturën dhe projektimin/dizajnin, të cilët integrojnë elemente kreative në proceset më të gjera, si edhe nënsektorë të tillë, si dizajni grafik, dizajni i modës ose reklamat (grupi i punës i ekspertëve të shteteve anëtare të BE-së - metoda e hapur e koordinimit - për industritë kulturore dhe kreative, 2012: Manuali i politikave).

Trashëgimia kulturore dhe burimet kulturore

Trashëgimia kulturore përbëhet nga trashëgimia materiale, që përfshin ndërtesat dhe vendet historike, monumentet etj. dhe trashëgimia kulturore jomateriale e cila u referohet praktikave, përfaqësimeve, shprehjeve, njohurive, aftësive etj.[81]. *UNESCO, "konventa për Ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale", 2003).*

Burimet kulturore përbëhen nga dy elemente, trashëgimia kulturore materiale dhe jomateriale, që përfshin kulturën e tanishme, përfshi këtu kulturën progresive, inovative dhe urbane. Këto burime mund të valorizohen ndër të tjera në industritë kulturore dhe kreative.

Operatori ekonomik

Sipas nenit 1, pika 8 të Direktivës së BE-së 2004/18/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 31 mars 2004, mbi koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave të punëve publike, kontratave të furnizimit publik dhe kontratave të shërbimit publik, konsiderohet si "operator ekonomik" çdo person fizik ose juridik apo subjekt publik ose grup personash dhe/ose organe të tilla që ofron në treg, përkatësisht, ekzekutimin e punimeve dhe/ose një punë, produkte ose shërbime. Në këtë mënyrë, rregullat e konkurrencës nuk varen nga statusi ligjor i çdo institucioni të përfshirë (publik apo privat), por nga natyra e aktivitetit të realizuar.

Operatorët ekonomikë mund t'u drejtohen përfituesve të ndihmave si partnerë në projekte (jo si partnerë kryesorë) sipas Rregullores së Përgjithshme të Përjashtimit në Bllok, *de minimisor* çdo skemë të ndihmës shtetërore që zbatohet për rajonin ku është ndërmarrë aktiviteti.

Efikasiteti i energjisë

Përmirësimet e efikasitetit të energjisë kanë lidhje me reduktimin në energjinë e përdorur për një shërbim të caktuar (ngrohje, ndriçim etj.) apo nivelin e aktivitetit. Reduktimi i konsumit të energjisë shoqërohet zakonisht me ndryshime teknologjike, por jo gjithmonë, pasi ai mund të rezultojë edhe nga organizimi dhe

[80] Dokumenti udhëzues mbi monitorimin dhe vlerësimin - ERDF dhe fondi i kohezionit, konceptet dhe rekomandimet, Komisioni Evropian, mars 2014.

[81] UNESCO: http://www.unesco.org/new/en/cairo/culture/tangible-cultural-heritage

menaxhimi më i mirë apo përmirësimi i kushteve ekonomike në sektor (faktorët joteknikë) (Këshilli Botëror i Energjisë, "Politikat e eficiencës së energjisë rreth botës: Shqyrtimi dhe vlerësimi", 2008).

Mbrojtja e mjedisit

Çdo aktivitet që mban ekuilibrin e mjedisit duke parandaluar kontaminimin dhe përkeqësimin e burimeve natyrore, përfshi aktivitete të tilla si: a) ndryshimet në karakteristikat e mallrave dhe shërbimeve, si dhe ndryshimet në modelet e konsumit; b) ndryshimet në teknikat e prodhimit; c) trajtimi i mbetjeve; d) riciklimi; d) parandalimi i dëmtimit të peizazhit (Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN), "Përkufizime", 2011).

Rritja e gjelbër

Rritja e gjelbër është në lidhje me nxitjen e rritjes ekonomike dhe zhvillimin ndërkohë që siguron që pasuritë natyrore të vazhdojnë të ofrojnë burimet dhe shërbimet mjedisore në të cilat mirëqenia jonë mbështetet. Për ta bërë këtë, ajo duhet të nxisë investimet dhe inovacionin që do të mbështesë rritjen e qëndrueshme dhe do të rrisë mundësitë e reja ekonomike[82].

Treguesi

Një tregues mund të përkufizohet si një mënyrë matjeje për plotësimin e një objektivi, një burim i kryer, një efekt i përftuar, një vlerësues i cilësisë ose një kontekst variabël. Treguesi duhet të përcaktohet nga një përkufizim.

Treguesi i rezultatit

Treguesit e rezultateve lidhen me aktivitetin. Ata maten në njësi fizike ose monetare (p.sh., numri i firmave të mbështetura, numri i planeve të veprimit të përpunuar etj.).

Treguesi i rezultatit

Treguesit e *rezultateve* lidhen me objektivat e akseve prioritare (AP-ve). Ata lidhen me efektet mbi përfituesit e drejtpërdrejtë të krijuar nga një program. Ata japin informacion mbi ndryshimet, për shembull, në sjelljen, kapacitetin apo performancën e përfituesve. Tregues të tillë mund të jenë fizikë (reduktimi i konsumit të energjisë, rritja e kompetencës etj.) ose financiarë (burime financiare shtesë të mobilizuar, ulje e një shpenzimi etj.).

Inovacioni

Inovacioni ka të bëjë me krijimin e produkteve të reja, proceseve të reja, teknologjive të reja, sistemet e reja të organizimit, sistemit të ri shoqëror etj. Pra, inovacioni mund të jetë teknologjik dhe joteknologjik me objektivin për të përmirësuar funksionimin e institucioneve, efikasitetin e zbatimit të strategjive ose konkurreshmërinë e operatorëve ekonomikë.

Aktorët kyç

Aktorët kyç janë institucionet apo individët të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në fushën e veprimit të projektit dhe kanë mundësi të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme për realizimin e tij. Ata kanë kompetenca edhe politike edhe administrative dhe kapacitetet teknike për të zbatuar veprimet e nevojshme për projektin.

Strategjia makrorajonale

Një strategji makrorajonale është një kornizë e integruar, miratuar nga Këshilli Evropian, e cila mund të mbështetet nga *Fondet evropiane strukturore dhe të investimit* (ESIF), *ndër të tjera,* për të adresuar sfidat e përbashkëta me të cilat përballet një zonë gjeografike e caktuar, që ka lidhje me shtetet anëtare dhe vendet e tjera të vendosura në të njëjtën zonë gjeografike. Në këtë kuadër ata përfitojnë nga bashkëpunimi i përforcuar që kontribuon në arritjen e kohezionit ekonomik, social dhe territorial.

Transporti multimodal

Transporti multimodal kuptohet si transporti i personave ose i mallrave nga të paktën dy prej mënyrave të ndryshme të transportit. Zgjidhjet ekologjikisht miqësore të transportit janë ato që lejojnë një reduktim të ndjeshëm të emetimeve të CO_2, NOx, si edhe të zhurmës.

Organizatë jofitimprurëse

Një organizatë jofitimprurëse (shkurtuar "OJF" ose "jofitimprurëse" ose "jo për përfitim") është një organizatë, objektivi kryesor i së cilës është të mbështesë një çështje me interes privat ose shqetësim publik për qëllime jokomerciale. Organizatat jofitimprurëse mund të fitojnë përfitime por këto përfitime duhet të riinvestohen në veprimtarinë e saj.

Operacioni

[82] OECD, Drejt rritjes së gjelbër, monitorimit të progresit, Fjalor termash dhe përkufizimesh, 2011.

Një projekt, kontratë, veprim apo grup projektesh të përzgjedhura nga autoritetet programore të programeve në fjalë ose nën përgjegjësinë e tyre, që kontribuon në objektivat dhe prioritet apo përparësitë.

Veprimet pilot

Një veprim pilot nënkupton zbatimin e skemave të natyrës eksperimentale për të provuar, për të vlerësuar dhe/ose për të demonstruar realizueshmërinë e tij me qëllimin për të përfituar nga këto rezultate dhe për të transferuar praktikat në institucionet dhe territoret e tjera.

Organi ekuivalent publik (sipas Direktivës 2004/18/KE)

Çdo organ juridik që rregullohet nga e drejta publike ose private:

- Themeluar me synimin e veçantë për plotësimin e nevojave në interes të përgjithshëm, që nuk ka karakter industrial ose komercial; dhe
- Që ka karakter juridik; dhe
- Ose financuar, për pjesën më të madhe nga shteti apo autoritetet rajonale ose vendore, ose organe të tjera që rregullohen nga e drejta publike, ose në vartësi të mbikëqyrjes menaxhuese nga këto organe ose që kanë një bord administrativ, menaxherial apo mbikëqyrës, ku më shumë se gjysma e anëtarëve emërohen nga shteti, autoritetet rajonale ose vendore apo nga organe të tjera që rregullohen nga e drejta publike.

Spirale e katërfishtë

Modeli i inovacionit që përfshin organet institucionale, sferën kërkimore, sektorin e biznesit dhe qytetarët në këtë proces.

Aktorët rajonalë

Aktorët rajonalë janë të gjithë aktorët kryesorë që operojnë në nivel rajonal në një fushë të caktuar tematike, në mënyrë të pavarur nga statusi i tyre ligjor, që përfshin publikun, si edhe sektorin privat. Këta sektorë përfshijnë lloje të ndryshme të subjekteve, të tilla si: administratën publike, infrastrukturën, shërbimet e ofruesve dhe operatorët, agjencitë që përfshijnë AZHR-në, grupet e interesit, OJQ-të, qendrat kërkimore, objektet arsimore, ndërmarrjet përfshi SME-të, organizatën për mbështetjen e biznesit etj.

Zonat e veçuara

Një zonë konsiderohet si "e veçuar" nëse më pak se gjysma e banorëve të saj mund të ngasin një mjet për në qendrën e një qyteti me të paktën 50 000 banorë brenda 45 minutave[83].

Burimet e rinovueshme të energjisë

Burimet e rinovueshme të energjisë janë një grup i ndryshëm teknologjish që e kapin energjinë e tyre nga flukset ekzistuese të energjisë, të tilla si: dielli, era, uji, proceset biologjike dhe flukset e ngrohjes gjeotermale.

Zona rurale

Zonat rurale janë të gjitha zonat jashtë grupimeve urbane. Grupimet urbane janë grupe qelizash të afërta të rrjetit prej 1 km² me një dendësi prej të paktën 300 banorësh për km² dhe një popullsi minimale prej 5000 personash[84].

Strategjia e basenit detar

Një kuadër i strukturuar i bashkëpunimit në lidhje me një zonë të caktuar gjeografike, të hartuar nga institucionet e Unionit, shtetet anëtare, rajonet e tyre dhe, kur është e mundur, vendet e treta që ndajnë një basen detar. Një strategji e tillë merr në konsideratë specifikimet gjeografike, klimatike, ekonomike dhe politike të basenit detar.

Zonat sensitive

Zonat me cilësi të padiskutueshme mjedisore, duke marrë në konsideratë cilësinë e peizazhit ose praninë e specieve të rralla apo të rrezikuara. Termi mund të aplikohet edhe për tokën pa vlera thelbësore reale, që konsiderohen të rrezikuara për shkak të presionit të ushtruar mbi to, për shembull nga zhvillimi urban ose turizmi intensiv: rezervate dhe parqe natyrale; zona të "Natura 2000"; zona të mbrojtjes së veçantë; zona të veçanta të ruajtjes; ligatina; rezerva biogjenetike.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME-të)

Rekomandim i Komisionit 2003/361/KE

Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme përcaktohen sipas numrit aktual të punonjësve (stafit) dhe qarkullimit ose bilancit total vjetor.

- Një ndërmarrje e mesme përcaktohet si një ndërmarrje e cila punëson më pak se 250 persona dhe qarkullimi vjetor i së cilës nuk i kalon 50 milionë euro dhe/ose bilanci total vjetor i së cilës nuk i kalon 43

[83] Eurostat 2011: http://epp.eurostat.ec.europa.eu/statistics_explained/index.php/Regional_typologies_overview

[84] Eurostat 2011: http://epp.eurostat.ec.europa.eu/statistics_explained/index.php/Regional_typologies_overview

milionë euro.

- Një ndërmarrje e vogël përcaktohet si një ndërmarrje e cila punëson më pak se 50 persona dhe qarkullimi vjetor dhe/ose bilanci total vjetor i së cilës nuk i kalon 10 milionë euro.
- Një ndërmarrje mikro përcaktohet si një ndërmarrje e cila punëson më pak se 10 persona dhe qarkullimi dhe/ose bilanci total vjetor i së cilës nuk i kalon 2 milionë euro.

Strategjia e "specializimit inteligjent"

Strategjia e "specializimit inteligjent" (S3) nënkupton strategjitë kombëtare ose rajonale të inovacionit të cilat vendosin prioritetet për të mbështetur avantazhin ose epërsinë konkurruese, duke zhvilluar dhe përputhur pikat e forta të kërkimit dhe inovacionit me nevojat e biznesit.

Ajo i trajton mundësitë e reja dhe zhvillimet e tregut në mënyrë koherente, ndërkohë që shmang dublikimin dhe fragmentimin e përpjekjeve dhe mund të marrë formën (apo të përfshihet), në kuadrin strategjik të politikave të kërkimit kombëtar ose rajonal dhe inovacionit (R&I).

Inovacioni social

Inovacionet sociale janë ide të reja (produkte, shërbime dhe modele) që njëkohësisht plotësojnë nevojat sociale (më efektivisht se alternativat) dhe krijojnë marrëdhënie të reja shoqërore apo bashkëpunime (*Murray,* etj. "Libër i hapur i inovacionit social", 2010). Fushat e veprimtarisë janë ndër të tjera integrimi i punës, shërbimet sociale, arsimi dhe hulumtimi, kultura dhe rekreacioni, shëndetësia etj.

Zhvillimi i qëndrueshëm

Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm i referohet një lloj rritjeje ekonomike e cila përmbush nevojat e shoqërisë në aspektin e mirëqenies afatshkurtër, afatmesme dhe mbi të gjitha afatgjatë. Ai përcaktohet mbi supozimin se zhvillimi duhet të plotësojë nevojat e sotme pa zhvlerësuar perspektivat e gjeneratave të ardhshme. Në terma praktikë, ai nënkupton krijimin e kushteve për zhvillimin ekonomik afatgjatë duke respektuar mirë mjedisin.

Grupet/përdoruesit fundorë të synuar

Grupet e synuara apo përdoruesit fundorë kanë të bëjnë me individët dhe/ose organizatat të ndikuar drejtpërsëdrejti pozitivisht nga aktivitetet dhe rezultatet e operacioneve. Jo domosdoshmërisht marrin grant financiar dhe madje jo të përfshirë drejtpërdrejt në operacion, grupet e synuara mund të shfrytëzojnë rezultatet e projektit për përfitimet e tyre.

Vlera e synuar

Një objektiv sasior i shprehur si vlerë që do të arrihet nga një tregues (treguesi i produktit ose i rezultatit), brenda një kohe të caktuar.

www.interreg-med.eu